

LIRIA E NDËRGJEGJES DHE E BESIMIT NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR

Evalda Jera

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në

Shkenca Juridike, me profil- E drejtë publike, për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës Shkencor: Prof. Asc. Dr. Jorgo Dhrami

Numri i fjalëve: 64.319

Tiranë, tetor 2019

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky studim është punë origjinale e imja, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

ABSTRAKTI

Studimi i marrëdhënieve mes shtetit shqiptar dhe komuniteteve fetare paraqet mjaft interes për shkak të tipareve të veçanta, që përmban bashkëjetesa fetare në Shqipëri, si një vend, ku toleranca fetare ndërmjet besimeve të ndryshme është pjesë e vlerave kulturore dhe e traditave ligjore.

Arsyeja e përzgjedhjes së kësaj teme lidhet ngushtë me koherencën. Shqipëria është një vend, që është karakterizuar gjithmonë nga diversiteti fetar i popullsisë së saj, diversitet i shoqëruar me bashkëjetese fetare në parametra të tolerancës dhe mirëkuptimit ndërfetar, por Shqipëria është një shtet me tipare të veçanta përse i përket formës së ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe besimit në periudha të ndryshme historike. Nëpërmjet objektit të kësaj teme është analizuar sistemi ligjor shqiptar në lidhje me normat, të cilat rregullojnë marrëdhëniet e shtetit me komunitetet fetare, që nga krijimi i shtetit të pavarur shqiptar deri më sot, përkundrejt zhvillimeve të jurisprudencës evropiane dhe ndërkombëtare në lëmin e të drejtave të njeriut.

Tema ndiqet nga përshkrimi i historikut të marrëdhënieve të komuniteteve fetare me shtetin shqiptar, evoluimi i këtyre marrëdhënieve gjatë historisë së shtetit shqiptar dhe si kanë ndryshuar ato në periudha të ndryshme historike. Për të kuptuar më mirë karakteristikat e legjislacionit aktual për rregullimin e marrëdhënieve me komunitetet fetare, analizohen elementet, që siguruan vazhdimësinë nga sistemi zogist, në dyzet vitet e regjimit komunist, si dhe legjislacioni fetar pas viteve '90.

Teza ka për objekt legjislacionin me karakter fetar, si dhe statusin që kanë pasur dhe kanë komunitetet fetare në Shqipëri, pra, mënyra se si janë rregulluar këto marrëdhënie

nëpërmjet legjislacionit përkatës. Raporti ndërmjet fesë dhe nacionalizmit dhe si ka rrjedhur ky raport në etapa të ndryshme të historisë së popullit shqiptar.

Fjalë kyçe: komunitete fetare, marrëdhënie, ndërgjegje, fe, besim, legjislacion.

ABSTRACT

The study of the relations between the Albanian state and the religious communities is of great interest due to the special characteristics of religious coexistence in Albania, as a country where religious tolerance between different faiths is part of cultural values and legal traditions.

Albania is a country that has always been characterized by the religious diversity of its population, accompanied by religious coexistence in parameters of tolerance and interfaith understanding. However, Albania is a country with particular features in terms of the form of exercising freedom of conscience and faith through out different historical periods. Serving the scope of this thesis, it is analysed the Albanian legal system regarding religious norms since the establishment of the independent Albanian state until this day, compared to the developments of European and international jurisprudence in the field of human rights.

The analysis is followed by a description of the history of the religious community's relations with the Albanian state, the evolution of these relations throughout the history of the Albanian people and how they have changed in different historical periods. In order to better understand the characteristics of the current Albanian legislation on the regulation of relations with the religious communities, we will analyze the elements that ensured the continuity from the Zogist system to the forty years of the communist regime, as well as the religious legislation after the 90s. The object of the thesis is the legislation of religious nature, as well as the status that religious communities have had and have in Albania, in other words, the way these relations have been regulated through the respective legislation.

Keywords: religious communities, relations, conscience, faith, religion, legislation.

Këtë studim i 'a dedikoj familjes time,

e veçanërisht, tre djemve të mi të shtrenjtë,

Lorik, Dion, Evind!

FALËNDERIME

Ky punim shkencor vjen si rezultat i një pune individuale disa vjeçare, por pa dyshim edhe falë mbështetjes së disa personave, të cilët gjej rastin t'i falënderoj.

Së pari falënderoj bashkëshortin tim të dashur Indritin!

Respekt dhe mirënjohje për ndihmën shkencore të udhëheqësit tim shkencor Prof. Asc. Dr. Jorgo Dhrami.

Gjithashtu, një falënderim të veçantë i'a dedikoj mbështetjes së dhënë nga drejtuesit e Shkollës Doktorale dhe nga i gjithë Departamenti i së Drejtës Publike në Universitetin European të Tiranës.

Dëshiroj të falënderoj pafundësisht prindërit e mi Mira & Beqir!

Falënderoj gjithë Faikun & nëna Hyrin! Falënderoj Norisin & Klodin!

Së fundmi, por jo nga rëndësia, falënderoj për zemërsisht miken time Albën!!!

Falë dashurisë, mbështetjes dhe nxitjes së tyre, dëshira ime u realizua.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: HYRJJE

1.1. Hipoteza dhe pyetja kërkimore	8
1.2. Kontributet dhe kufizimet e punimit	10
1.3. Metodatat dhe metodologjia e punimit	12
1.4. Struktura e punimit	16

KAPITULLI II: LIRIA E NDËRGJEGJES DHE BESIMIT NË SHQIPËRI NË VËSHTRIM HISTORIK

2.1 .Zhvillimet nga shpallja e pavarësisë deri në vitin 1944	20
2.1.1.Përpyjekjet për ngritjen e shtetit të ri shqiptar dhe laiciteti	20
2.1.1.1.Liria fetare dhe besimi pas shpalljes së pavarësisë	20
2.1.1.2.Çështja fetare në Statutin e Lushnjës, Statutin e Zgjeruar të Lushnjës, Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare i vitit 1925 dhe Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare i vitit 1928	29
2.1.1.3.Njohja e lirisë së organizimit të kulteve me Dekretin e vitit 1923, statutet e para të bashkësive fetare	33
2.1.2. Zogu e kombëtarizimi i fesë, raporti i tij me komunitetet fetare	41
2.1.2.1.Dekret-Ligji i 16 Korrikut 1929, “Për formimin e bashkësive fetare”, në periudhën Monarkisë Zogiste	41
2.1.2.2.Raporti i Zogut me bashkësitë fetare, përplasja me Kishën Katolike	45
2.2.Komunitetet fetare dhe politika shtetërore në shtetin komunist	55
2.2.1.Reforma agrare dhe reforma në arsim	55
2.2.2.Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë e vitit 1946, si dhe Dekret-ligji Nr.743, “Mbi Komunitet fetare” 1949	63
2.2.3.Dekret-ligji Nr. 743, datë 26 Nëntor 1949, "Mbi Komunitet fetare"	67
2.2.4.Statutet e komuniteteve fetare	74
2.3.Shqipëria i vetmi shtet ateist në botë	82
3.3.1.Situata që i paraprin Dekretit të vitit 1967	82

2.3.2.Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e vitit 1976	90
2.3.3. Kodi Penal i vitit 1977	93
2.4.Liria e ndërgjegjes dhe besimit në Shqipëri pas vendosjes së demokracisë	96
2.4.1.Liria e ndërgjegjes dhe besimit ne akte kushtetuese.....	96
2.4.1.1.Ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese” Nr.7491, të vitit 1991	96
2.4.1.2.Ligji Nr.506, i datës 3 Prill 1993, “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut	102
2.4.1.3 .Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998	107
2.4.2 .Shteti dhe komunitetet fetare, një marrëdhënie në harmoni të plotë	115
2.4.2.1.Krijimi i “Komuniteti Kombëtar për Kultet”, Vendimi i Qeverisë Nr.459, datë 23.9.1999	115
2.4.2.2.Ligji “Për organizatat jofitimprurëse”, Nr.8788, dt.7.5.2001, në rregullimin e marrëdhënieve me komunitetet fetare	118
2.4.2. Marrëveshjet mes shtetit shqiptar dhe komuniteteve fetare	122
2.4.2.4. Shteti shqiptar shembull i bashkëjetesës dhe tolerancës fetare	133

KAPITULLI III: LIRIA E NDËRGJEGJES DHE BESIMIT NË SHQIPËRI NË VËSHTRIM JURIDIK

3.1.Konceptet ndërgjegje, besim dhe fe në vështrimin juridik	142
3.2.Liria e ndërgjegjes dhe besimit në legjislacionin dhe praktikën juridike shqiptare	146
3.2.1.Preambula e Kushtetutës	147
3.2.2.Besimi te zoti dhe / ose vlera universale	147
3.2.3.Toleranca dhe bashkëjetesa fetare	148
3.2.4.Qëndrimi zyrtar i shteti ndaj fesë	149
3.2.5.Të drejtat dhe liritë themelore	153
3.2.6.Të drejtat dhe liritë vetjake	155
3.3.E drejta ndërkombëtare evropiane në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe fesë	158

3.4.Analiza e nenit 9 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut	160
3.4.1.Parimet e përgjithshme	160
3.4.2.Liria individuale dhe kolektive	161
3.4.3.E drejta e besimit dhe e drejta e shfaqjes së tij	163
3.4.4.Ndërhyrja e shtetit: Detyrimet negative dhe pozitive	164
3.5.Detyrimet e shtetit për garantimin e lirisë fetare	166
3.5.1.Detyrimi për të mos ndaluar funksionimin normal të organizatave fetare	166
3.5.2.Njohja, regjistrimi dhe ndalimi i organizatave fetare	168
3.5.3.Detyrimet pozitive të shtetit	171

KAPITULLI IV: DEBATET MBI LIRINË E NDËRGJEGJES DHE BESIMIN FETAR NË EVROPË, RAJON DHE NË SHQIPËRI

4.1.Liria fetare dhe të drejtat e njeriut në Evropë	174
4.2.Liria fetare dhe të drejtat e minoriteteve në Ballkan	177
4.3.Diskutimet brenda komuniteteve fetare në lidhje me të drejtën e besimit në Shqipëri	180
4.3.. Liria e besimit në ligj dhe në praktikë	180
4.3.2.Bashkëjetesa fetare	182
4.3.3.Roli i shtetit në lidhje me bashkëjetesën fetare	183
4.3.4.Problemet e brendshme dhe të jashtme të bashkësive fetare	185
4.3.5.Edukimi fetar	187
4.3.6.E drejta për të mos besuar apo për të ndryshuar besimin	187
4.3.7.Ndërhyrja e shtetit dhe kufizimi i lirisë së shprehjes së një besimi fetar	188

KAPITULLI V: KONKLUSIONE	190
---------------------------------------	------------

BIBLIOGRAFIA	207
---------------------------	------------

KAPITULLI I: HYRJE

Komunitetet fetare përfaqësojnë një element vendimtar në karakterin e secilit komb. Në ditët e sotme, multikulturalizmi është shndërruar në fenomen universal, veçanërisht në qytetërimin perëndimor. Prurjet e mëdha emigratore e kanë kthyer Evropën në zonë diversiteti kulturor e fetar, ndaj për të mbrojtur komunitetet, të cilat zhvendosen në territore të reja, përvoja shqiptare na tregon rrugën më të përshtatshme, në mënyrë që ky diversitet multikulturor të mos prodhojë vlera regresive por ta detyrojë “të drejtën” të rishikojë vetveten.

Çështja e të drejtave të njeriut dhe aplikimi konkret i tyre bëjnë që multikulturalizmi të shfaqet si komponent thelbësor, me të cilin e drejta duhet të përshtatet. Në ditët e sotme po shkojmë drejt konceptimit multikulturor të të drejtave të njeriut, duke tejkaluar njëherazi edhe idenë e shtetit-komb për mbrojtjen e tyre. Konventa Amerikane e të Drejtave të Njeriut, Karta Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Karta Afrikane e të Drejtave të Njeriut, Karta Arabe e të Drejtave të Njeriut janë dokumente, që kanë tejkaluar diferencat kulturore të shteteve firmëtare për t’u shndërruar në instrumente të unifikimit kulturor të këtyre të drejtave.

Në ditët tona, aspekti mjaft i rëndësishëm, i cili e detyron të drejtën të marrë në konsideratë heterogjenitetin kulturor, lidhet me flukset migratore dhe transformimet që po përballon, veçanërisht, Perëndimi. Shqipëria është shembull i qartë i pranimit dhe i respektit të diversitetit, diversitet ky me karakter përgjithësisht fetar. Zhvendosjet në masë të kulturave të ndryshme drejt hapësirash kulturalisht po aq të ndryshme, zakone të natyrës fetare, kulturore, etnike-morale etj., nuk përputhen me ato të shoqërive pritëse duke bërë të nevojshme zgjidhjen me natyrë juridike. Kështu, legjislatori gjendet përballë nevojës për të normatizuar institucione të posaçme për grupe të posaçme, duke pranuar

faktin se pluralizmi kulturor ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në politikat ligjore të një komuniteti pluralist, ashtu siç konsiderohet edhe Shqipëria. Edhe pse e drejta, si e tillë, qëndron mbi strukturat konkrete, në shumë raste luan rol vendimtar për edukimin e bashkëjetesës, pasi është e aftë të konsolidojë sjellje dhe struktura, që rregullojnë drejtpërsëdrejti marrëdhëniet shoqërore në jetën e faktorëve të ndryshëm shoqëror, duke përbërë, kështu elementet strukturorë, të cilët përcaktojnë tiparet e një sistemi juridik dhe të një bashkësie shoqërore të caktuar.

Vetëdija e të qenurit shqiptar del mbi çdo ndasi fetare, duke synuar promovimin dhe mbrojtjen e diversitetit. Në Shqipëri kanë bashkëjetuar komunitete fetare tradicionale për shkak të historikut të tyre apo komunitete në trajtën e bashkësive, të vendosura më vonë në realitetin shqiptar. Besohet se lidhja e shqiptarëve me përkatësinë e tyre fetare ka qenë krejtësisht formale. Shqiptari nuk është shquar asnjëherë si fanatik i fesë, ai ka praktikuar shpesh si ritet e njëres fe apo tjetres. Feja e vërtetë te shqiptarët ishin krenaria, besa për fjalën e dhënë, nderi, traditat, më së shumti një besim me karakter temperamenti. Ndërgjegjja e kombësisë shqiptare nuk u dominua asnjëherë nga ajo fetare. Në popullsinë shqiptare kombësia ka qenë gjithmonë parësore. Në terrenin e nacionalizmit, fetë shqiptare nuk ndesheshin vetëm me një fenomen të rëndësishëm kulturor e shoqëror, me të cilin duhet të mateshin por, me një fe të vërtetë alternative, me një besim që i konkurronte duke bërë kështu një hyjnizim të identitetit shqiptar.

Arsyeja e përzgjedhjes së kësaj teme lidhet ngushtë me koherencën, duke qenë se Shqipëria është një vend që është karakterizuar gjithmonë nga diversiteti fetar i popullsisë së saj, diversitet i shoqëruar me bashkëjetesë fetare në parametra të tolerancës dhe mirëkuptimit ndërfeetar, e cila mund të jetë objekt frymëzimi për botën e trazuar.

Teza ka objekt analizën e legjislacionit, që rregullon marrëdhëniet me komunitetet fetare, të cilat kanë vepruar në shtetin shqiptar nga themelimi i tij e deri në ditët tona, si dhe statusin që kanë pasur dhe kanë komunitetet fetare në Shqipëri, pra, mënyra se si janë rregulluar këto marrëdhënie nëpërmjet legjislacionit përkatës. Me anë të këtij studimi bëhet një analizë e veçantë e zhvillimit të marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare në Shqipëri, evoluimi i këtyre marrëdhënieve, si kanë ndryshuar ato në periudha të ndryshme historike.

Tema shqyrton ligjet shtetërore në raport me autonominë e veprimit ligjor të komuniteteve fetare, duke analizuar ndikimin e dinamikave të brendshme mes komuniteteve fetare dhe marrëdhënieve të tyre me shtetin. Populli shqiptar nuk njohu asnjëherë grindje e luftëra të brendshme fetare, duke suprimuar gjithmonë lidhjen njerëzore e vlerat humane. Nëpërmjet analizës normative, që ka vepruar gjatë rrjedhës së historisë së shtetit shqiptar, do të kuptojmë ndryshimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve institucionale mes komuniteteve fetare dhe shtetit dhe si rregullohet sot pjesëmarrja në jetën fetare si një nga të drejtat dhe liritë themelore të individit. Për të kuptuar më mirë karakteristikat e legjislacionit aktual shqiptar për rregullimin e marrëdhënieve me komunitetet fetare do të analizoj elementet, të cilat siguruan vazhdimësinë nga sistemi Zogist e duke u ndalur tek ndryshimet, që pati legjislacioni shqiptar gjatë regjimit komunist dhe si ndryshoi ky legjislacion me vendosjen e shtetit demokratik pas viteve '90. Sot Shqipëria i përmbahet standardeve ndërkombëtare për çështjet fetare dhe ka legjislacion përkatës, i cili përcakton mënyrën e krijimit të komuniteteve fetare dhe të zhvillimit të veprimtarisë së tyre, në mënyrë që të mos cenohet siguria publike, rendi, shëndeti dhe morali publik, si dhe të drejtat e të tjerëve.

Nga shqyrtimi i historisë kushtetuese del se që në fillesat e shtetit të vet Shqipëria e kohës moderne ka ndër parimet e saj themelore ndarjen mes shtetit dhe fesë, laicitetin e institucioneve, e kryesisht pluralizmin fetar, i parë si format i rëndësishëm i sistemit ligjor, një prej përbërësve themelore për ndërtimin e unitetit kombëtar, si vlerë e epërme për vendin. Rasti i Shqipërisë është ndryshe nga panorama e përgjithshme e shteteve të tjera, shqiptarët janë në të njëjtën kohë kristianë dhe myslimanë, ata janë katolikë dhe ortodoksë, suni dhe bektashinj. Në Shqipëri ka një pluralizëm të shënuar fetar, ku fetë nuk kanë qenë ndonjëherë burim konflikti.

E drejta kanunore ka pasur ndikim të posaçëm, duke rregulluar të gjitha marrëdhëniet jetësore. Normat zakonore kanë vepruar fuqishëm deri në fund të luftës së Dytë Botërore. Nga pikëpamja institucionale deri në vitin 1913 komunitetet fetare u qeverisën nëpërmjet Mileteve, pavarësisht reformave të ndërmarra nga Perandoria Osmane. Me shpalljen e shtetit shqiptar të pavarur në vitin 1912 lindi nevoja e ngutshme që të gjitha besimeve fetare t'ju jepej dinjitet dhe të drejta të barabarta, duke pasur në thelb qëllimin se ndërtimi i kombit shqiptar kërkon të kapërcehen përçarjet e shkaktuara nga ndasitë fetare. Legjislacioni shtetëror mbi çështjet fetare të viteve '20 rezulton të jetë i panjohur e ndoshta edhe inekzistent. Nëpërmjet shqyrtimit të legjislacionit mbretëror për çështjet e marrëdhënieve të shtetit me komunitetet fetare, kuptojmë se Shqipëria ishte në procesin e gjetjes së mjeteve juridike për të administruar marrëdhëniet mes komuniteteve fetare dhe shtetit. Njohja e besimeve fetare, procedurat për regjistrimin e tyre, si dhe dhënia e personalitetit juridik gjejnë rregullim në të drejtën shqiptare që në vitin 1923. Dekreti i vitit 1923, me anë të të cilit sistemi shqiptar vendosi kriteret për njohjen e personalitetit juridik civil për komunitetet fetare përbën ende një prej normave më të përparuara për rregullimin e marrëdhënieve me kultet dhe një mjet të admirueshëm për parandalimin e

konflikteve ndërfetare. Gjithashtu, njihen procedurat për njohjen e besimeve fetare, për regjistrimin e tyre, si dhe mënyra për të fituar personalitetin juridik, të cilat gjejnë shprehje në të drejtën shqiptare që në vitin 1923, sipas normave të së drejtës civile, e konkretisht, të konsoliduara në Kodin Civil të vitit 1928. Dekret-Ligji i vitit 1929 për formimin e bashkësive fetare në periudhën e Monarkisë Zogiste sanksionon njohjen e komuniteteve fetare, duke arritur që të gjitha komunitetet fetare të njihen njëllor nga shteti.

Republika e Shqipërisë, e dalë nga lufta antifashiste dhe antinaziste, çmoi si një ndër parimet themelore të saj ndarjen e shtetit nga feja, jo si diktat i ideologjisë marksiste-leniniste por si fryt i përvojës historiko-institucionale të vendit. Liria e ndërgegjes buronte drejtpërdrejt nga pluralizmi fetar i sistemit shqiptar, pavarësisht se më vonë u përforcua nga parimet e marksizmit, deri aty sa u bë parimi themelor i sistemit kushtetues të vitit 1976, ku pikërisht, në mbrojtje të lirisë së ndërgegjes por nën dritën e tezës marksiste, u shpall bujshëm ateizmi i shtetit, një qëndrim ekstrem i Shqipërisë brenda bllokut Lindor. Gjatë periudhës komuniste, shohim se legjislacioni shqiptar karakterizohet nga ashpërsia në rritje kundrejt masave të marra ndaj komuniteteve fetare, ligji i konfiskimit të pasurive fetare, sidomos i tokave, pas hyrjes në fuqi të reformës agrare të vitit 1949, duke kulmuar në vitin 1967. Pas vitit 1967, vendosja e diktaturës në Shqipëri solli si rrjedhojë krijimin e shtetit ateist të parë në botë, i cili ndaloi gjithë veprimtaritë fetare duke nxjerrë jashtë ligjit çdo praktikë fetare ose më saktë, vetë besimet fetare, duke ndaluar çdo akt publik, që lidhej me fenë e besimin, duke krijuar kështu shtetin e parë ateist në botë. Regjimi komunist shkatërroi fenë nga pikëpamja institucionale por nga ana tjetër përforcoi ndjenjën kombëtare. Qëllimi i tyre ishte të pushtonin çdo qoshe të sferës publike, në mënyrë që të depërtonin dhe të shkatërronin

sferën private. Është i njohur fakti se persekutimi i feve shkon në favor të përforcimit të ndjenjës kombëtare.

Shqiptarët kanë qenë popull më shumë luftëtar se fetar, është theksuar se feja e vërtetë e shqiptarëve qëndron në krenarinë, në besën për fjalën e dhënë, në ndjenjën e nderit, në lidhje me traditat, me pak fjalë, ishte një fe e karakterit.

Legjislacioni Zogist i periudhës së Monarkisë duket se pati më shumë fat, për faktin se u rikthye në fuqi, qoftë edhe për aq pak kohë, menjëherë pas rënies së regjimit, në vitin 1991.

Jo më parë se në vitin 1991, Shqipëria i'a del të shkëputet prej këtij izolimi dhe u hap rrugë marrëdhënieve me komunitetet e rilindura fetare, pa shpërfillur lidhjet e kahershme me historinë juridike dhe institucionale, çka kërkon, më së pari, rindërtimin e fazave të ndryshme të marrëdhënieve intensive mes shtetit dhe fesë. Do të shohim se Kushtetuta e re shqiptare e pas diktaturës nuk e mori menjëherë përsipër hartimin e normave lidhur me mbrojtjen e lirisë fetare apo të marrëdhënieve me kultet. Duhej pritur disa kohë për këtë, derisa mbërriti udhëzimi prej organizmave ndërkombëtare e sidomos, prej Këshillit të Evropës, ku Shqipëria synonte të ishte anëtare për t'i siguruar vetes legjitimitetin e nevojshëm ndërkombëtar.

Proçesi demokratik në Shqipëri ka fituar tashmë një pamje të qartë politike dhe ligjore. Ky proçes është i vazhdueshëm dhe është një lëvizje e pandërprerë përmirësimi. Harmonia dhe toleranca fetare janë vlera në shoqërinë shqiptare. Gjithashtu, në asnjë rrethanë sociale apo politike nuk u shfaqën konflikte fetare dhe komunitetet fetare kontribuan për zgjidhjen e çështjeve sociale dhe politike.

Duke i rregulluar marrëdhëniet përmes marrëveshjeve, mes qeverisë shqiptare dhe komuniteteve fetare, qeveria shqiptare ka ndërmarrë hapa, së pari me Kishën Katolike dhe më pas, me të gjithë bashkësitë e tjera fetare. Kështu, më 23 Mars të vitit 2002 u firmos marrëveshja e parë mes Selisë së Shenjtë dhe Republikës së Shqipërisë. Kjo shënoi mbylljen e një faze të gjatë përballjesh në marrëdhëniet mes shtetit dhe Kishës Katolike dhe vendosjen e marrëdhënieve të ndërsjella, të cilat do t'i japin liri të plotë veprimi Kishës Katolike, por, ndërkohë, e çlirojnë Shqipërinë nga dyshimet e forta, që ngrinte komuniteti ndërkombëtar për sjelljen e gjatë armiqësore të shtetit shqiptar kundrejt komuniteteve fetare. Marrëveshjet mes qeverisë shqiptare dhe komuniteteve fetare janë mjete, të cilat garantojnë të drejtat e sanksionuara në Kushtetutë për komunitetet nënshkruese, sipas një shkalle prioritetesh të ndryshme të përcaktuara prej tyre por, që konvergjojnë në njohjen e rëndësisë për rolin e strukturës fetare. Komunitetet fetare theksojnë nevojën e mbrojtjes së lirisë fetare individuale, jo vetëm për pjesëmarrjen në ritet fetare por edhe për të ndërruar besimin fetar, duke njohur plotësisht lirinë e proselitizmit dhe të drejtën e secilit për të mos marrë pjesë në asnjë rit fetar, ashtu si të drejtën për të mos qenë pjesë e asnjë kulti. Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë garantohet në marrëveshje me komunitetet fetare, madje në këtë pikë marrëveshjet dallojnë mes tyre.

Komunitetet tona fetare kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre me afat të pakufizuar në një pjesë të vendit ose në gjithë territorin, sipas përzgjedhjes së vetë bashkësisë. Po ashtu, shteti garanton lirinë e shkollimit edhe mësimdhënien fetare.

Nisur nga tiparet që ka sot legjislacioni shqiptar për rregullimin e marrëdhënieve me kultet, duhet të themi se nuk mund të kuptohen bazat e këtij legjislacioni, nëse nuk shqyrtohen paraprakisht përvojat e hershme të tij dhe nuk vlerësohen elementet, të cilat i

sigurojnë vazhdimësinë, jo vetëm me sistemin Zogist por edhe me mjetet juridike të përpunuara gjatë dyzet viteve të diktaturës.

Diversiteti fetar është një rezultat i rëndësishëm që rrjedh nga historia dhe kultura e Shqipërisë dhe që duhet të jetë shembull frymëzimi. Punimi është mbështetur në analizën e legjislacionit fetar, që në momentin kur u ngrit shteti shqiptar e gjatë periudhës së errët të komunizmit, si dhe është analizuar legjislacioni në lidhje me çështjet fetare pas viteve '90, kur në Shqipëri u vendos demokracia. Punimi fokusohet në vështrim historik mbi legjislacionin kushtetues shqiptar mbi fenë, pluralizmin dhe tolerancën fetare në legjislacionin fetar shqiptar si një realitet objektiv. Janë analizuar aktet ligjore në periudhat historike përkatëse, të cilat kanë sanksionuar dhe rregulluar të drejtat fetare nga momenti i krijimit të shtetit të pavarur shqiptar, duke vazhduar me epokën komuniste dhe legjislacionin fetar të kësaj periudhe. Së fundmi, punimi ndalet në analizën e legjislacionit fetar pas viteve '90, ku u arrit vendosja e demokracisë në shtetin shqiptar.

1.1 Hipoteza¹ dhe pyetja kërkimore

“Shqipëria është një vend, që është karakterizuar historikisht nga diversiteti fetar, i cili ka nxitur edhe nevojën për hartimin e modeleve dhe koncepteve të së drejtës, që garantojnë bashkëjetesën fetare në parametra të tolerancës, mirëkuptimit ndërfaqetor dhe respektit të të drejtave të njeriut”.

Shqipëria është një vend, që është karakterizuar historikisht nga diversiteti fetar, i cili ka nxitur edhe nevojën për hartimin e modeleve dhe koncepteve të së drejtës, që garantojnë

¹Hipoteza është një pohim i shprehur si një deklaram, i cili mund të parashikojë një drejtim ose të shpreh një marrëdhënie të pranueshme mes variablave.

bashkëjetesën fetare në parametra të tolerancës, mirëkuptimit ndërfetar dhe respektit të të drejtave të njeriut.

Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe fesë në Shqipëri gjatë rrjedhës kronologjike të historisë së shtetit shqiptar kanë ndikuar në forcimin e unitetit kombëtar dhe tolerancës fetare tek shqiptarët. Rregullimi modern i raporteve të shtetit me fenë dhe institucionet fetare, përbën arritje në Kushtetutë dhe në legjislacionin fetar shqiptar. Kjo arritje mund të shërbejë si frymëzim për mbrojtjen e komuniteteve me diversitet kulturor e fetar, të cilat zhvendosen në territore të reja.

Pluralizmi fetar në harmoni është rezultat i rëndësishëm, që rrjedh nga historia dhe kultura e Shqipërisë. Shqipëria është një vend që është karakterizuar gjithmonë nga diversiteti fetar i popullsisë së saj, diversitet i shoqëruar me bashkëjetesë fetare në parametra të tolerancës dhe mirëkuptimit ndërfetar, që duhet të jenë shembuj frymëzimi.

Studimi i marrëdhënieve mes shtetit shqiptar dhe komuniteteve fetare paraqet tipare të veçanta, si një vend ku triumfon bashkëjetesa fetare ndërmjet besimeve të ndryshme, ndonëse përbën edhe një shembull frymëzues për botën e sotme, të trazuar si rezultat i pakuptimtë i luftërave me kontekst fetar. Ky punim ka si qëllim të analizojë literaturën dhe legjislacionin përkatës në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe besimit, si një e drejtë themelore për gjithë periudhën e marrë në studim, pikërisht nga krijimi i shtetit shqiptar e deri më sot. Gjithashtu, përmes studimit të legjislacionit krijohet një tablo se si kjo marrëdhënie është sot. Duke pasur parasysh se marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe fesë ndërthuren pazgjidhshmërisht, atëherë studimi i politikës fetare të shtetit shqiptar përbën një çështje me mjaft rëndësi. Vlerat fetare janë një aspekt i rëndësishëm i ndërgjegjes kolektive të një kombi. Do të përpiqem të shpjegoj se si vlerat fetare janë të përfaqësuara në ditët e sotme në shoqërinë shqiptare. Vlerat fetare janë të rëndësishme për t'u kuptuar,

ato përcaktojnë kuptimin e një shoqërie, ato ndihmojnë për të përfunduar formula efektive se si shoqëria mund të përmirësohet në të ardhmen.

Studimi i referohet disa pyetjeve kërkimore:

Si i ka rregulluar legjislacioni shqiptar marrëdhëniet mes shtetit dhe komuniteteve fetare që nga krijimi i shtetit shqiptar, si dhe cili është spektri normativ që rregulloi këto marrëdhënie gjatë qeverisjes së Zogut, gjatë periudhës komuniste dhe si janë rregulluar këto marrëdhënie në vitet e demokracisë deri më sot?

Studimi fokusohet në ndryshimet dhe zhvillimin e marrëdhënieve institucionale mes komuniteteve fetare dhe shtetit, si dhe në mënyrat se si rregullohet sot pjesëmarrja në jetën fetare, si një nga të drejtat dhe liritë themelore të individit. Cilat janë garancitë që gjenden në legjislacionin shqiptar dhe evropian për të siguruar lirinë e ndërgjegjes dhe të besimit si një e drejtë themelore?

Si mund të shërbejë njohja e sistemit juridik shqiptar si një shembull për përmirësimin e marrëdhënieve mes grupeve të ndryshme shoqërore dhe fetare, si shprehje e globalizimit dhe e vlerave universale të disa parimeve e sidomos, të rregullave kundër diskriminimit dhe konflikteve me bazë fetare.

1.2. Kontributet dhe kufizimet e punimit

Mund të thuhet se deri më sot nuk ka një studim të mirëfilltë juridik që t'i japë përgjigje shteruese zhvillimit të normave ligjore për çështjet e marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare, por as ndërhyrjeve të vazhdueshme për përpunimin e legjislacionit, i cili, jo vetëm rregullon organizimin e kulteve por, mbi të gjitha, u njeh atyre të drejtën

fetare dhe pavarësinë për t'u vetë-rregulluar. Duke pasur parasysh se marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe fesë ndërthuren pazgjidhshmërisht, hulumtimi i politikës fetare të shtetit shqiptar përbën një çështje me mjaft rëndësi.

Ky punim synon të bëjë një përmbledhje në lidhje me zhvillimin e legjislacionit fetar, që ka vepruar në shtetin shqiptar që nga krijimi i tij e deri sot, i parë ky në spektrin historik të veprimit të normave juridike me karakter fetar. Natyrisht, nuk kemi të bëjmë me hulumtimin për thelbin e fenomenit fetar por, si një kërkim shkencor i bazuar mbi legjislacionin fetar e mbi dokumente historike, të cilat sanksionojnë fenë dhe besimin si një e drejtë themelore.

Së pari, punimi kontribuon në mbledhjen dhe analizimin e tërësisë së legjislacionit fetar, i cili ka vepruar në Shqipëri që nga shpallja e Shqipërisë si shtet i pavarur e deri në normat juridike që janë në fuqi sot. Jepet një kontribut më shumë në literaturën mbi përmbledhjen që i bëhet legjislacionit me karakter fetar. Nëpërmjet këtij punimi hidhet dritë mbi dukuritë që kanë karakterizuar historinë e shtetit shqiptar, të pavarur në marrëdhëniet e tij me bashkësitë e ndryshme fetare.

Së dyti, synohet, që nëpërmjet konkluzioneve të arritura, të jepen rekomandimet e gjetura, të dobishme për harmoninë fetare, e cila sot ka arritur në një pikë kritike për sa i përket cenimit të paqes dhe sigurisë në botë.

Po ashtu, studimi i kësaj teme përbën një rëndësi të veçantë, meqenëse liria e ndërgjegjes dhe e besimit kanë ndikim të posaçëm në jetën e individit si anëtar i një shoqërie të caktuar. Feja dhe besimi mbështeten në norma e rregulla sjelljeje të mirëpërcaktuara. Liria e besimit i përket sferës së përjetimeve të brendshme të individit, prej së cilës buron, gjithashtu, liria e shfaqjes së jashtme të besimit. Individët dhe shoqëritë duhet të

jenë të lirë në formën e tyre të besimit, si një e drejtë e sanksionuar themelore në konventat që mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Feja përbën një faktor të rëndësishëm të integritetit shoqëror, duke i ushqyer anëtarët e vet me vlera dhe norma, si dhe duke ndihmuar konsensusin e tyre për çështjet morale. Pra, është besimi ku individë gjen mbështetje, duke përmbushur edhe një nga të drejtat e tij natyrore, duke vendosur kështu një ekuilibër të drejtë ndërmjet elementeve fetarë dhe socialë.

Përveç kontributeve, ky punim shoqërohet edhe me një sërë kufizimesh:

Së pari, me faktin se nuk mund të konsiderohet si një studim me karakter shterues për asnjë nga dimensionet e analizuara.

Së dyti, meqenëse ky punim ka në thelb analizën e legjislacionit fetar, i cili ka vepruar në shtetin shqiptar që nga themelimi i tij, ndodhemi përballë mungesës së studimeve kërkimore mbi shoqërinë shqiptare të mbas Luftës së Parë Botërore.

Ky punim mbështet gjithmonë multikulturalizmin, pluralizmin e diversitetin fetar, për të cilin Shqipëria mund të shërbejë si shembull.

1.3. Metodatat dhe metodologjia e studimit

Përzgjedhja dhe kombinimi i metodologjive të hulumtimit shkencor në fushën e së drejtës nuk përbën një sfidë, por edhe një domosdoshmëri. Metodologjia e studimit duhet t'i përgjigjet arritjes së qëllimeve të këtij studimi. Në varësi të hipotezës dhe pyetjeve që ngrihen në kapitujt e punimit, zbatohen dhe metodat e hulumtimit shkencor.

Metodologjia e përdorur gjatë hartimit të këtij punimi mbështetet, kryesisht, në pikëpamjet doktrinale dhe në legjislacion. Për rrjedhojë, qasja kryesore metodike është

qasja normative, e shoqëruar me qasjen doktrinare në trajtimin e çështjes, që është marrë si objekt hulumtimi. Kështu, është kryer analiza ligjore e materialit normativ vendas nga krijimi i shtetit të pavarur shqiptar e deri në ditët e sotme.

Gjithashtu, punimi ndiqet nga përshkrimi i historikut të marrëdhënieve të komuniteteve fetare me shtetin shqiptar, evoluimin e këtyre marrëdhënieve gjatë historisë së popullit shqiptar dhe si kanë ndryshuar ato në periudha të ndryshme historike.

Studimi do të përqendrohet në mbledhjen dhe analizën e të dhënave të doktrinės juridike të normave me karakter fetar, të cilat gjenden të shtjelluara në literaturën ku mbështetet studimi, si në format të shkruar, ashtu edhe në format elektronik. Mbledhja dhe analiza sistematike do të adresohet në kuadrin normativ të shtetit shqiptar në lidhje me normat me karakter fetar.

Metoda “rishikim i literaturës”, nëpërmjet metodës historike edhe metodës përshkruese, ka për synim të hedhë një vështrim dhe të bëjë një përmbledhje të literaturës shkencore të mëparshme. Kjo metodë do të na shërbejë për të kuptuar evoluimin historik të lirisë së ndërgjegjes dhe besimit në legjislacionin shqiptar, si dhe elementeve kryesorë të saj, që janë faktorët, të cilët e mbajtën Shqipërinë larg konflikteve fetare. Në të njëjtat korniza metodologjike kam analizuar studime të mëparshme, që kanë bërë autorë të tjerë në lidhje me fenë në Shqipëri, përmes studimit të rrjedhës historike. Kam analizuar aktet, të cilat kanë sanksionuar të drejtën fetare nga momenti i krijimit të shtetit të pavarur shqiptar, duke vazhduar me epokën komuniste, legjislacionin fetar të kësaj periudhe dhe së fundmi, punimi ndalet në analizën e legjislacionit fetar pas viteve `90, ku u arrit vendosja e demokracisë në shtetin shqiptar. Po ashtu, metoda “analizë interpretuese” ka si qëllim interpretimin e dispozitave ligjore me karakter fetar, që shërbejnë si objekt studimi në funksion të hipotezës dhe pyetjeve hulumtuese të punimit.

Literatura, së cilës do t'i referohem mendoj se është mjaft e pasur për analizimin dhe argumentimin e kësaj teme. Ky punim është mbështetur mbi analizën e legjislacionit fetar, përkatësisht, duke u ndalur te normat juridike e dispozitat ligjore, të cilat sanksionojnë të drejtën e ndërgjegjes dhe besimit.

Do të ndalem që në statutet e para të shtetit shqiptar, si paraqitet në to çështja fetare, duke vazhduar më tej me Dekretin e vitit 1923 ku u njoh liria e organizimit të kulteve, dhe u vendosën statutet e para të bashkësive fetare. Po ashtu, është analizuar Dekret-ligji i vitit 1929 për formimin e bashkësive fetare në periudhën e Monarkisë Zogiste.

Gjatë periudhës së errët komuniste do ndalem tek ndikimi i reformës agrare dhe reformës në arsim mbi liritë fetare. Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë e vitit 1946, si dhe Dekret-ligji Nr.743, “Mbi Komunitet fetare” janë objekt studimi, duke vazhduar më tej me analizën e Dekretit të vitit 1967, që shpall ateizmin e shtetit shqiptar të asaj kohe. Po ashtu, sanksionimin që bën Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste e Shqipërisë e vitit 1976 në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe besimit si dhe Kodi Penal i vitit 1977.

Gjatë periudhës së demokracisë do analizoj Ligjin Kushtetues “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, Nr.7491, të vitit 1991, si dhe Ligjin Nr.506, datë 3 Prill 1993, “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut” duke vazhduar më tej me dispozitat më karakter fetar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vitit 1998.

Marrëdhëniet ndërmjet bashkësive fetare dhe shtetit shqiptar kanë qenë në fokus edhe të studiuesve italianë. Një punim, që paraqet mjaft interes për historikun e marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare në Shqipëri, është edhe “Pluralizmi fetar dhe bashkësitë fetare në Shqipëri” i Giovanni Cimbalo-s. Ky punim, studion marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe entiteteve fetare, duke u mbështetur në legjislacionin shqiptar dhe duke na paraqitur një panoramë të shkëlqyer në raportet e shtetit me institucionet e kultit në Shqipëri.

Në studimin “Kombi dhe feja në Shqipëri” (Nazione e religione in Albania) i della Rocca-s, duhet theksuar se punimi i tij mbi fenë në Shqipëri është mbështetur në burime italiane, që shpesh janë të njëanshme dhe të paplota nga mungesa e shfrytëzimit të burimeve arkivore.

Burimet kryesore, të shfrytëzuara për këtë qëllim, ku përpos të tjerash flitet edhe për politikat fetare të regjimit komunist, janë librat e Prof. Valentina Dukës, “Histori e Shqipërisë 1912–2000” Tiranë, 2007. Tjetër libër me rëndësi është edhe ai i Kastriot Dervishit, “Historia e shtetit shqiptar 1912–2005” (Tiranë: 55, 2006), një botim ky mjaft i pasur me të dhëna të dorës së parë, të grumbulluara në arkivat shqiptarë.

Po ashtu, vëllimet me grup autorësh si “Historia e popullit Shqiptar I-Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane, gjatë Shek. XVI-Vitet `20 të Shek. XIX, Akademia e shkencave e Shqipërisë, Toena, Tirana 2002, “Historia e Popullit Shqiptar II-Rilindja Kombëtare- Vitet `30 të Shek. XIX-1912, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Toena, Tirana 2002, “Historia e popullit Shqiptar III- Periudha e pavarësisë, 28 Nëntor 1912–7 Prill 1939”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Toena, Tiranë 2007, “Historia e popullit shqiptar IV- Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj-1939-1990”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë Toena, Tiranë 2009, janë një burim referimi mjaft i rëndësishëm.

Në vitin 2004, në Shqipëri u mbajt një simpozium tjetër shkencor mbi fenë në mijëvjeçarin e tretë, kumtesat e të cilit u botuan në kompendiumin “Fetë dhe Qytetërimet në mijëvjeçarin e ri – rasti i Shqipërisë”, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, 2004.

Nertila Ljarja në botimin “Kisha Katolike dhe shteti komunist në Shqipëri” si edhe monografia e Artan Hoxha “Marrëdhëniet midis Regjimit Komunist dhe Kishës

Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë në vitet 1945–1967” sjellin mjaft fakte e të dhëna të vlefshme.

Gjithashtu, në ndihmë më ka ardhur edhe “Licodu”, e cila është faqe interneti e realizuar nga Universiteti i Bolonjës dhe që kryen përmbledhje të legjislacionit fetar, duke përfshirë edhe atë të shtetit shqiptar.

Puna për përgatitjen e temës kalon në këto faza:

Faza e parë: Mbledhja e të dhënave është bërë përmes instrumentesh të ndryshëm, alternativimi i të cilave shërben për kryerjen e një analize të saktë. Selektimi i një literature të bollshme mbi këtë temë, mundësia e shfrytëzimit të bibliotekës, me fokus kryesor identifikimin e literaturës cilësore dhe bashkëkohore mbi temën. Po në këtë fazë, përfshihet dhe *desktop research* me gjetjen e një pjese të materialit botuar në internet si metodë kërkimore, që përthith informacion dhe analiza.

Faza e dytë: Absorbim i informacionit dhe literaturës së grumbulluar.

Faza e tretë: Analizim i përmbajtjes së kuadrit normativ, mbi lirinë e ndërgjegjes dhe besimit në Shqipëri, me qëllim daljen në konkluzionet përfundimtare të doktoraturës.

1.4. Struktura e punimit

Përgjigjet e pyetjeve hulumtuese gjenden në mënyrë të detajuar në këtë punim shkencor, i cili është strukturuar duke ndjekur një qasje të pavarur në pesë kapituj kryesorë dhe përkatësisht në vijim të kapitullit të parë:

Kapitulli i dytë (historik dhe teorik) analizon së pari, sfondin historik të zhvillimit të marrëdhënieve të komunitetit fetare dhe shtetit shqiptar në fazat fillestare të krijimit të tij. Konkretisht, në Shqipëri, analiza e sfondit historik fillon me përpjekjet për ngritjen e shtetit të ri shqiptar dhe me laicitetin. Liria fetare dhe besimi pas shpalljes së pavarësisë,

çështja fetare në Statutin e Lushnjës dhe në Statutin e Zgjeruar të Lushnjës. Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare i vitit 1925 dhe Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare i vitit 1928. Njohja e lirisë së organizimit të kulteve me Dekretin e vitit 1923, statutet e para të bashkësive fetare janë pika të rëndësishme trajtimi në kapitullin e dytë. Do të ndalemi tek e drejta e ndërgjegjes dhe besimit në shtetin e Zogut, përpjekjet e tij për kombëtarizimin e fesë. Dekret-Ligji i 16 Korrikut 1929 për formimin e bashkësive fetare në periudhën e Monarkisë Zogiste. Përplasja me Kishën Katolike. Raporti i Zogut me bashkësitë fetare.

Së dyti, ky kapitull sjell kornizën ligjore shqiptare në lidhje me legjislacionin fetar në kohën e monizmit. Si ndikoi reforma agrare dhe reforma në arsim. Në këtë kapitull do të analizojmë Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë të vitit 1946, si dhe Dekret-Ligjin Nr.743, “Mbi Komunitet fetare” të vitit 1949, së bashku me statutet e komuniteteve fetare. Situata, që i parapriu Dekretit të vitit 1967, ndalimi i të drejtës së besimit me Dekretin e vitit 1967, Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste e Shqipërisë e vitit 1976 dhe Kodi Penal i vitit 1977.

Së treti, trajton periodikisht lirinë e ndërgjegjes dhe besimit në Shqipëri pas vendosjes së demokracisë, duke analizuar legjislacionin fetar, mbi mënyrën se si rregullohen marrëdhëniet mes shtetit shqiptar dhe komuniteteve fetare. Në këtë kapitull, trajtohen aktet kushtetuese mbi lirinë e ndërgjegjes dhe besimit si: Ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, Nr.7491, i vitit 1991; Ligji Nr. 506, datë 3 Prill 1993, “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut” dhe Kushtetuta Republikës së Shqipërisë e vitit 1998.

Krijimi i Komuniteti Kombëtar për Kultet, Vendimi Qeverisë Nr. 459, datë 23 Shtator 1999. Ligji “Për organizatat jofitimprurëse” Nr. 8788, datë 7 Maj 2001, në rregullimin e marrëdhënieve me komunitetet fetare. Shteti shqiptar, si shembull i bashkëjetesës dhe

tolerancës fetare. Marrëveshja mes shtetit shqiptar e komuniteteve fetare, ku do të ndalem tek “Marrëveshja mes shtetit shqiptar dhe Selisë së Shenjtë” e Marrëveshjet e bashkëpunimit me Myslimanët Sunitë, Bektashianë dhe Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, si dhe marrëveshja për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkësisë fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë”.

Kapitulli i tretë përfshin analizën juridike të punimit. Ai trajton konceptet e ndërgjegjes, besimit dhe fesë në vështirimin juridik, analizon rregullimin kushtetues shqiptar, duke filluar nga preambula dhe në vijim në nenin 3, 10, 18 dhe 24 të Kushtetutës; të drejtën ndërkombëtare dhe evropiane në lidhje me lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, duke u ndalur gjerësisht tek neni 9 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, si nga pikëpamja e objektit dhe bindjeve të mbrojtura nga Konventa, ashtu edhe nga modelet e pranuar të ndërveprimit mes shtetit dhe bashkësive fetare, si dhe detyrimet pozitive dhe negative, në përputhje me kërkesat e Konventës.

Kapitulli i katërt trajton debatet bashkëkohore, veçanërisht në Shqipëri në lidhje me përvojat dhe perceptimet e përfaqësuesve të bashkësive fetare, bashkëjetesën dhe tolerancën, si dhe rolin e shtetit në lidhje me mbështetjen e këtyre vlerave, si të kombit ashtu edhe të kulturës shqiptare. Ky kapitull ndalet edhe në problemet, me të cilat përballen bashkësitë fetare dhe si i perceptojnë ato marrëdhëniet me shtetin.

Kapitulli i pestë “Konkluzione” do të përfshijë në mënyrë të përmbledhur konkluzionet e kapitujve të mësipërm, në lidhje me legjislacionin fetar shqiptar, duke pasur një analizë të këtij legjislacioni që nga themelimi i shtetit shqiptar, duke vazhduar me periudhën e diktaturës, me tolerancën fetare, që karakterizon ditët e sotme, si dhe rekomandimet e mundshme.

KAPITULLI II: LIRIA E NDËRGJEGJES DHE BESIMIT NË SHQIPËRI NË KËNDVËSHTRIM HISTORIK

2.1 Zhvillimet nga shpallja e pavarësisë deri në vitin 1944

2.1.1 Përpyjekjet për ngritjen e shtetit të ri shqiptar dhe laiciteti

Komunitetet fetare përfaqësojnë një element vendimtar në karakterin e secilit komb. Fetë në Ballkan kanë qenë historikisht element i dallimit etnik dhe i konflikteve nacionale (Della Roca, 2003:141). Nëse në Ballkan një komb donte të thoshte një fe dhe një kishë, në rastin shqiptar ishte ndryshe. Vështirësitë e mëdha për përhapjen e idesë kombëtare në radhët e shqiptarëve dëshmohen nga pavarësia e tyre e mëvonshme. Në luftërat çlirimtare është dashur të luftohet edhe për pavarësinë e institucioneve fetare, të dominuara nga kleri i huaj (Maliqi, 2003:21). Gjatë historisë së tyre, shqiptarët nuk kanë pasur institucione kulti kombëtare të cilësdo fe, e cila do të luante ndonjë rol më të spikatur në vetëdijesimin e popullit dhe në luftërat çlirimtare².

2.1.1.1 Liria fetare dhe besimi pas shpalljes së pavarësisë

Ndarja e Perandorisë së lashtë Romake ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, në planin afatgjatë, shkaktoi, ndarjen e Kristianizmit Shqiptar. Perandoria Otomane shkaktoi shtrirjen e Islamit në trojet shqiptare. Nuk qenë shqiptarët ata që zgjodhën këto ndryshime në raportin e tyre me fenë. Nuk ka qenë përzgjedhje e brendshme dhe shqiptarët e dinë këtë, ashtu siç e dinë mirë historinë e tyre (Della Rocca, 2003: 27). Perandoria Osmane vendosi veprimin e Sheriatit, pasi popujt, që hynin në urdhrin e tyre,

² Shqiptarët ftoheshin për bashkim kombëtar, jo duke i mohuar por, duke i respektuar fetë e ndryshme, që ekzistonin në Shqipëri.

i ndanë më dysh, në myslimanë dhe të krishterë, pa marrë në konsideratë kombësinë. Islamizmi nuk njeh kombësi, fenë e merr për kombësi. Turqia, të gjithë ortodoksët i njohu një komb dhe sado që të drejtat politike nuk ua dha, u fali liri fetare të plotë (Frashëri M, 1928:48).

Përgjatë gjithë mesjetës, nuk ka asnjë të dhënë që të pohojë ekzistencën e ballafaqimeve e të konflikteve fetare midis shqiptarëve ortodoksë e atyre katolikë. Kjo bashkëjetesë e ky mirëkuptim u ruajt edhe kur struktura fetare në Shqipëri ndryshoi në mënyrë radikale e kur pjesa më e madhe e popullsisë u konvertua në islamizëm (Akademia Shqiptare e Shkencave, 2002:251-252). Besohet se lidhja e shqiptarëve me përkatësinë e tyre fetare ishte krejtësisht formale. Shqiptari nuk është shquar asnjëherë si fanatik i fesë, ai ka praktikuar shpesh si ritet e njëres fe apo të një feje tjetër (Traja, 2004:190). Feja e vërtetë te Shqiptarët ishin krenaria, besa për fjalën e dhënë nderi, traditat, me pak fjalë, ishte besim me karakter temperamenti (Della Rocca, 1994:7).

Ndonëse gjatë shekujve 18-19-të, islamizmi pati zhvillim masiv fetar dhe kulturor në Shqipëri, Sheriati nuk u bë asnjëherë kod sundues zakonor i shqiptarëve. Periudha e gjatë osmane përfaqëson, përpara se stina e nacionalizmave të shkaktojë ngurtësim në Shqipëri, si dhe në të gjithë Perandorinë, një epokë tolerance relative, falë sistemit të mileteve dhe autonomisë, që ky i fundit lejonte, për të mos folur për një frymë lëshimi të administratës osmane në çështjet e fesë (Della Rocca, 1994:14).

Trajtimi dhe qëndrimi i njëjtë ndaj komuniteteve fetare përbën një ndër tiparet dalluese të traditës shqiptare, zanafillën e të cilit duhet ta kërkojmë te reformat e ndërmarra nga Perandoria Osmane, qysh prej vitit 1839 (Krasniqi, 93:84). Reforma u pasua nga ligje të shumta për sa i përket rolit të komuniteteve fetare, të cilat kulmuan me vendimin e

Himayun-it, më 18 Shkurt 1856, sipas të cilit vendosej barazia e plotë ligjore³ mes qytetarëve të besimeve të ndryshme dhe u njëhej të gjithëve liria fetare, ndërkohë që krerëve të mileteve të ndryshme u ndalohej të ushtronin funksionin shtetëror të mbledhjes së taksave (Cimbolo, 2013:34).

Kriza e stërzgatur e Perandorisë Osmane, e cila çoi drejt shpërbërjes së marrëdhënieve mes qeverisë dhe komuniteteve fetare, po shkëputte gradualisht edhe lidhjen me modelet e statuteve vetjake që mbizotëruan në Shqipëri, kryesisht gjatë asaj kohe kur zbatimi i kanunit ishte shprehje e së drejtës zakonore për gjithfarë grupesh etnike, pavarësisht përkatësisë fetare (Pano, 2003:148).

Kanuni i Lekë Dukagjinit, si më i fuqishmi, veptoi në veri të vendit, bashkë me Kanunin e Skënderbeut dhe atë të Maleve, ndërsa në jug të vendit veptoi kryesisht Kanuni i Labërisë, e pikërisht në nenin 14 të tij thuhet se: “Të gjithë kanë të drejtën për të gëzuar liritë fetare, askush nuk mund t’i shkelë ato, të ndalojë të drejtën e praktikës së lirë të fesë. Kundër personave që shkelin këtë të drejtë, njësitë e bashkive apo komunave kanë të drejtë të marrin masa ndëshkuese deri në dëbimin e tyre nga bashkësitë apo komunat” (Kanuni i Labërisë, 2006:37).

Në Kanunin e Lekë Dukagjinit, kisha është trajtuar si një institucion i paprekshëm dhe kjo për shkak se feja katolike ishte praktikuar në pjesën veriore të Shqipërisë, ku kisha kishte statusin e saj të veçantë. Ndarja e shqiptarëve në besime të ndryshme fetare, të cilat ishin nën varësinë e institucioneve të huaja klerikale dhe politika e tyre përçarëse e vështirësuan bashkimin e popullit shqiptar dhe u bënë pengesë në luftën e tij për çlirim.

³ Për daljen hapur të besimeve të ndryshme fetare si ai ortodoks e katolik, duhej pritur fillimi i viteve tetëqind, kur Perandoria Osmane, në kohën e Tanzimatit, shfuqizoi ligjin për ndalimin e proselitizmit. Kjo lëvizje mori emrin “Rizgjimi Ungjëllor”. Bëhej fjalë për një formë proselitizmi, të bazuar në përhapjen e shkrimeve të shenjta në çdo gjuhë kombëtare, për t’i afruar besimtarët sa më shumë me lëshimin e mesazhit të krishterë.

kombëtar⁴. Dihet se ortodoksët shqiptarë konsideroheshin në Athinë si popullsi helenike, gjë që përbënte një pretendim për të bërë aneksimin e tokave shqiptare të jugut nga “mëmëdheu” grek (Della Rocca, 1994:7). Nga ana tjetër, fetë i kanë lejuar shqiptarët të ruajnë identitetin e vet kombëtar, sepse jashtë fesë kishte shumë pak elemente që do t’u jepnin mundësi të dalloheshin nga serbët ose bullgarët, në mënyrë të atillë, që të ndalohej asimilimi. Islamizimi ka qenë pritë kundër presionit sllav, ashtu sikurse më parë, pranimi i katolicizmit kish qenë një mbështetje kundër greqizimit të favorizuar nga ortodoksia bizantine (Della Rocca, 1994:9).

Të gjithë myslimanët e Shqipërisë janë të kombësisë shqiptare, prandaj ata e kanë parë Shqipërinë si shtëpinë e tyre, po aq sa edhe të krishterët (Nano, 2014:23). Në periudhën kur osmanët po tërhiqeshin, të vetmit myslimanë të pa kërcënuar e të mbrojtur të gadishullit ishin ata shqiptarë, të cilët as nuk u përndoqën e as nuk e lanë vendin për të ikur në atë që kishte mbetur prej perandorisë (Nano, 2014:23). Pashko Vasa, qysh në vitin 1880, doli me parullën: “Feja e shqiptarit është shqiptaria”, e cila u shndërrua në slogan për patriotët e të gjitha kohëve të mëpasshme (Nano, 2014:37). Në luftërat çlirimtare, shqiptarëve u është dashur të luftojnë edhe për pavarësinë e institucioneve të tyre fetare, të dominuara nga kishat dhe kleri i huaj (Nano, 2014:37). Gjatë historisë së tyre, shqiptarët nuk kanë pasur kisha kombëtare të cilësdo fe, gjë që do të luante ndonjë rol më të spikatur në ndërgjegjen e popullit dhe në luftërat çlirimtare, ndryshe nga disa popuj fqinj, tek të cilët kishat nacionale kanë pasur role të rëndësishme në formulimin e ideologjive kombëtare dhe ideve shtetformuese (Maliqi, 2003:21). Si pikë kyçe mund të përmendim rolin që luajti Komuniteti Bektashi, duke predikuar tolerancë e mirëkuptim

⁴ Qeverisja e provincës së Shqipërisë ishte lënë në dorë të klaneve, tribuve e prijësve lokalë, që kishin rënë dakord të bënin vasalë e sulltanit. Vetëm pak muslimanë turq erdhën si kolonë në vend, pushteti kështu iu la vendasve, që kishin rënë në ujdë me sulltanin. Ndonjëherë, ekzistenca në Shqipëri e katër bashkësive fetare kryesore myslimane sunitë, katolike, ortodokse e bektashi ka qenë një faktor përçarjeje në popullin shqiptar, duke i lejuar fuqive të huaja të paraqitën pretendime për Shqipërinë.

mbarë-shqiptar. Ky komunitet kontribuoi në frenimin e prirjeve ndarëse në gjirin e popullsisë dhe në fuqizimin e lidhëzave të unitetit mbi baza etnike e kombëtare.

Kështu, jemi përballë krijimit të një shteti, i cili ndryshe nga të tjerët, ligjërimin kulturor nuk e mbështeste mbi fenë, ku myslimanët dhe të krishterët, që deri në atë kohë e kishin parë njëri-tjetrin me përbuzje apo frikë, duhej ta cilësonin veten vëllezër, duke kapërcyer kështu armiqësitë. Krijimi i një shoqërie kombëtare, që do të dilte nga bashkimi dhe shkrirja e shumë shoqërive dhe bashkësive të mbyllura dhe të vetë-administruara, sikurse kishte qenë shoqëria në hapësirën shqiptare deri në atë kohë. Të gjitha këto përbënin probleme shumë të mëdha për tu kapërcyer për shtetin e ri e të brishtë shqiptar (Hoxha, 2014:23).

Që në zanafillën e vet Shqipëria ka qenë një shtet laik⁵. Qeveria e përkohshme, e cila ishte shpallur nga Kuvendi i Vlorës shquhet nga përbërja e saj mbarëkombëtare dhe përfaqësonte unitetin kombëtar të ëndërruar nga shqiptarët në shekuj, bashkimin dhe krijimin e shtetit të vetëm kombëtar shqiptar. Delegatë nga e gjithë Shqipëria morën pjesë në Kuvendin e Vlorës, i cili mund të quhet ndryshe edhe Asambleja Kombëtare mbarëshqiptare (Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2003:33).

Shpallja e pavarësisë së shtetit shqiptar më 28 Nëntor 1912, përbën një ngjarje themelore në historinë tonë kombëtare pasi u arrit të bëhej bashkimi kombëtar i të gjithë shqiptarëve pa komplekse feje, krahine apo ideje (Anastasi, 2003:33). Sapo u krijua shteti i pavarur shqiptar u theksua asnjënjësia e tij në çështjet e ndërgjegjes dhe të fesë, gjë që ishte frymëzuar më parë nga rilindësit tanë. Kufijtë e shtetit shqiptar u përcaktuan në Konferencën e Londrës në vitet 1912-1913, nga Fuqitë e Mëdha dhe për të garantuar

⁵ Ismail Qemali, theksoi se, në bazë të rrethanave të krijuara nga lufta në Ballkan, mënyra e vetme e shpëtimit për vendin është ndarja e Shqipërisë nga Turqia.

stabilitetin në trevat ballkanike ato vendosën t'i hapin rrugë statutit të parë të shtetit të ri sipas parimeve të liberalizimit, duke i kushtuar, gjithashtu, vëmendje të veçantë rregullimit të çështjeve të fesë, me qëllim që epërsia në numër e popullsisë myslimane të mos bëhej pengesë për bashkimin kombëtar (Anastasi, 2003:33).

Me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë⁶, dolën të panevojshme struktura të tilla si milletet, të cilat nga pikëpamja institucionale qeverisën komunitetet fetare deri në vitin 1913. Lindi kështu, nevoja e ngutshme për tu njohur të gjitha besimeve fetare dinjitet dhe të drejta të barabarta, falë bindjes së plotë se ndërtimi i kombit shqiptar kërkonte të kapërceheshin përçarjet e shkaktuara nga ndarja fetare, në mënyrë që i gjithë populli me grupe etnike dhe përkatësi të ndryshme fetare të bashkëvepronte në rrugën e përbashkët për ngritjen e shtetit të ri (Cimbolo, 2013:8).

Lindja e shtetit të parë shqiptar në vitin 1912 solli edhe nevojën për nxjerrjen e një kushtetute, e cila mbeti vetëm në kuadrin e dokumenteve të përkohshme. Kështu, Kushtetuta e parë e shtetit shqiptar është “Statuti Organik i Shqipërisë”, Vlorë, 10 Prill 1914⁷, një Kushtetutë kjo e njohur si ligji i parë themelor i shtetit shqiptar, e cila i'u dhurua shtetit shqiptar pasi u njoh nga Fuqitë e Mëdha, me në krye të shtetit një prijës të huaj, duke sanksionuar regjimin e princit gjerman Vilhelm Vidit. Aktet kushtetuese të periudhës së pavarësisë, afirmojnë ndarjen e fesë nga shteti, lirinë e ndërgjegjes e të besimit, si dhe të drejtën e ushtrimit të fesë.

⁶ Mbas shpalljes së pamvarësisë e krijimit të shtetit shqiptar, në Shqipëri, nuk ka patur konflikte të drejtëpërdrejta midis popullsisë mbi baza fetare, që provon drejtësinë e përpjekjeve të tyre për krijimin e shtetit unik shqiptar. Shqipëria, në gjithë traditën e saj shtetërore të pavarur, nuk e ka praktikuar ndërthurjen e shtetit me fenë.

⁷ Statuti Organik i Shqipërisë, Vlorë, 1914, nenet 170 deri 177.

Neni i parë i Statutit e shpall Shqipërinë: “Principatë kushtetuese të pavarur dhe të trashëgueshme, nën garancinë e fuqive të mëdha”⁸ megjithëse, pohohet pavarësia e Shqipërisë. Realisht, Statuti e vendosi vendin në pozitën e një shteti gjysëm sovran. Fuqitë e Mëdha garantonin tërësinë dhe paprekshmërinë e tokave shqiptare në kufijtë, që ato vetë kishin vendosur, si dhe u ruajt regjimi i kapitulacioneve (Grup autorësh, 2007:322). Kështu, qysh me Statutin Organik, i cili u miratua në Vlorë më 10 Prill 1914, përcaktohet Shqipëria si një shtet laik, vendoset se Shqipëria nuk ka fe shtetërore, si dhe liria dhe ushtrimi publik i të gjitha kulteve janë të siguruara. Në asnjë pjesë të principatës shqiptare, ndryshimi në fe nuk mund t’i vihet asnjëri si shkak për të përjashtuar ose për ta cilësuar atë si të paafte për sa i përket gëzimit të të drejtave civile e politike, pranimi në punë shtetërore, në funksione dhe ndere ose përsa i përket ushtrimit të profesioneve dhe aktiviteteve të ndryshme⁹. Njihet kështu liria e ushtrimit publik të kulteve, e cila është e siguruar.

Në Statut flitet për kultet fetare në kapitullin XI të titulluar “Kultet”, pikërisht në nenet 170 deri 177. Sipas këtyre neneve të këtij Statuti, ku trajtohen çështjet fetare, mund të përmbledhim se të gjitha komunitetet fetare shqiptare ekzistuese njihen nga shteti. Ky parim zbatohet edhe për sektet e ndryshme myslimane¹⁰. Asnjë pengesë nuk duhet të nxirret për organizimin hierarkik të komuniteteve të ndryshme e as për marrëdhëniet që këto mund të kenë me kryetarët e tyre shpirtërorë më të lartë për çështje të dogmës fetare.

Sipas nenit 171, komunitetet fetare vazhdojnë të ruajnë pasuritë e tyre, gjithashtu, ato ruajnë apo kanë nën mbrojtjen e tyre të ardhurat që burojnë nga zakoni. Njihet

⁸ “Statuti Organik i Shqipërisë” 1914, Kapitulli XI, Kultet, nenet 170-177 <http://licodu.cois.it/547>

⁹Po aty,

¹⁰Po aty,

përfashtimi nga taksat i godinave të kulteve. Njihet e drejta për krijimin e komuniteteve të reja fetare, të cilat shteti i njeh dhe gjithashtu, përcaktohen të drejtat e tyre. Sipas këtij statuti, marrëdhëniet mes kishave ekzistuese në Shqipëri dhe drejtuesve të tyre do të rregullohen nga një marrëveshje e posaçme, e lidhur mes qeverisë shqiptare dhe drejtuesve të kishës. Gjithashtu, shteti shqiptar merr në mbrojtje të gjitha komunitetet fetare dhe klerikët dhe cakton shumën që gjykon të arsyeshme për këtë qëllim nga buxheti i shtetit. Duke pasur parasysh edhe pasurinë që kishin këto kulte, komunitetet fetare në Shqipëri do të ruajnë pasuritë e tyre. Përfashtohen nga taksat godinat që shërbejnë për kultet, për arsimin publik dhe për veprat e bamirësisë.

Gjithashtu, shteti njeh të drejtat e komuniteteve të reja fetare, që mund të formohen nga kultet e ndryshme. Paria dhe klerikët e komuniteteve fetare, të cilat njihen nga shteti do të mbikëqyren nga Princi¹¹. Marrëdhëniet ekzistuese në shtetin shqiptar mes kishave dhe kryetarëve të tyre do të jenë objekt i marrëveshjeve të posaçme, që do të lidhen midis qeverisë shqiptare dhe këtyre krerëve. Shteti duhet të marrë masa për mbajtjen e të gjitha kulteve të njohura, si dhe të klerit, duke caktuar, për këtë qëllim, shumën që do të gjykojë të nevojshme në buxhetin e përgjithshëm shtetëror, gjithashtu, do të ketë parasysh edhe pasuritë e patundshme, që zotërojnë aktualisht këto kulte¹².

Në Shqipëri, ndryshe nga vendet e tjera myslimane, administrimi i pasurive fetare i'u besua komuniteteve fetare, pikërisht për rrethanat në të cilat ishin ngritur këto pasuri. Administrimi i tyre, rregullohet në mënyrë të detajuar nga statutet përkatëse të komuniteteve fetare (Cimbolo, 2013:26). Në Statutin e vitit 1914 pranohet se shteti shqiptar është laik¹³. Gjurma juridike e lënë nga ky sistem, bëri që shteti të njohë të

¹¹ Statuti organik 1914, kapitulli XI "Kultet"

¹² Po aty,

¹³ Statuti Organik i Shqipërisë 1914, Kapitulli XI, "Kultet", nenet 170-177 <http://licodu.cois.it/547>

gjitha komunitetet fetare shqiptare, duke vendosur epërsinë e vet mbi besimet e ndryshme, pa e zbehur mbikëqyrjen ndaj tyre. Statuti pohon gjithashtu, se në gjirin e besimtarëve islam, ekzistojnë dy përbërës kryesorë: sunitët dhe bektashinjtë, prandaj duhej të sigurohej që në zanafillë të shtetit të pavarur, respekti për pluralizmin fetar¹⁴. Nëse do të krijoheshin komunitete të tjera fetare, veç atyre ekzistuese, shteti parashikon t'i njohë ato dhe të përcaktojë të drejtat që u duhen njohur atyre, gjithnjë në përputhje me përvojën e legjislacionit turk, i cili njihte një numër të caktuar miletesh. Shteti nuk ndërhynte për emërimin e anëtarëve të hierarkisë fetare, as për përcaktimin e dogmave apo për organizimin e besimeve fetare në vend¹⁵. Rregullimi i marrëdhënieve mes komuniteteve fetare ekzistuese në Shqipëri dhe krerëve të tyre shpirtërore, përbën thelbin e marrëdhënieve që do të nënshkruhen mes qeverisë shqiptare dhe krerëve të këtyre kulteve. Sistemi shqiptar i përmbahet parimit bilateral në marrëdhëniet me komunitetet fetare, si tipar dallues i formës së shtetit dhe të qeverisë, që në kohën e themelimit të tyre. Një ndër rrjedhojat e para të këtij qëndrimi është fakti se komunitetet fetare në Shqipëri, mund të mbajnë pasuritë e tyre dhe të vazhdojnë të gëzojnë mbrojtjen e shtetit.

Sa i përket çështjes së tatimeve, do të lirohen prej barrës së taksave, godinat e tyre të kultit dhe ato që përdoren për arsim dhe vepra bamirësie. Shteti vendos për shumën që do tu kërkohet komuniteteve fetare nga të ardhurat e deklaruar, gjë që bëhet duke u mbështetur në masën e pasurive të paluajshme në pronësi të tyre. Përdorimi i gjuhës shqipe do të jetë i detyrueshëm, por mësimi fetar mund të zhvillohet në gjuhën e kultit. Ngritja dhe funksionimi i shkollave teologjike do të rregullohet nga ligje të posaçme (Cimbolo, 2013:29).

¹⁴ Po aty,

¹⁵ Kleri dhe krerët fetare të të gjitha komuniteteve, të njohura nga shteti, ngarkoheshin në detyrë pasi merrnin emërimin zyrtar nga Princi, i cili ushtronte të drejtën e *placet-it*, njësoj siç vepronte dikur Sulltani.

Si rezultat i asaj që analizuam, mund të themi se kuadri juridik i marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare është mjaft përparimtar¹⁶.

2.1.1.2 Çështja fetare në Statutin e Lushnjës, Statutin e Zgjeruar të Lushnjës, Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare i vitit 1925 dhe Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare i vitit 1928.

Siç e pamë, me vendosjen e hapave të parë për ngritjen e shtetit shqiptar, përfaqësuesit e lëvizjes kombëtare e panë se për të siguruar njohje ndërkombëtare, duhej të kishin një bashkim ndërmjet feve tek shqiptarët. Lindi nevoja e një riorganizimi kombëtar, në mënyrë që të pengohej synimi i Fuqive të Mëdha, jo vetëm për të copëtuar tokat shqiptare, por për të zhdukur krejtësisht nga harta shtetin e pavarur shqiptar. U mbledh kështu Kongresi i Lushnjës më 28-31 janar 1920, një kongres kombëtar ky, me pjesëmarrjen e shtresave të ndryshme shoqërore në vend, i cili ishte një kuvend mbarëshqiptar. Kongresi synonte bashkimin e të gjithë shqiptarëve në një shtet të vetëm dhe të qeverisur nga një qeveri e ngritur prej tyre¹⁷. Kongresi i Lushnjës, jo vetëm afirmoi pavarësinë e vendit, por mori masa të menjëhershme dhe për organizimin e shtetit të ri shqiptar (Fischer, 2004:168). Këtu u përcaktuan tiparet themelore të shtetit dhe u risanksionua profili i organeve të pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv, u përcaktuan parimet kushtetuese të shtetit në një dokument të posaçëm. Dokumenti përfundimtar u miratua më 31 Janar 1920. Lindi kështu, “Bazat e Kanunores së Këshillit

¹⁶Mund të flitet vetëm për dy qendra kryesore të jetës shoqërore dhe politike gjatë kësaj kohe. Në veri, konkretisht në Shkodër dhe në rrethinat e saj, mbizotëron katolicizmi, me qendër kryesore rreth dioqezës së franceskanëve. Të pranishëm dhe aktivë janë edhe jezuitët, tradicionalisht të ardhur nga provinca e Lambordisë në Itali qysh kur kjo zonë ishte nën ndikimin austriak.

¹⁷Në Kongresin e Lushnjës A. Zogu u emërua Ministër i Punëve të Brendshme. Shpallja e Pavarësisë nuk mund të realizohej pa bashkim kombëtar e unitet territorial, <http://2lonline.com/arkiva/opinion/8725-shpallja-e-pavaresise-nuk-mund-te-realizohej-pa-bashkim-kombetar-e-unitet-territorial.htm>

të Lartë”¹⁸ apo Statuti i Lushnjës (Akademia e Shkencave, grup autorësh, 2007:331). Ky dokument kishte plotësisht karakterin e kushtetutës. Midis çështjeve juridike kushtetuese, të sanksionuara në statut rëndësi të veçantë mori çështja e qeverisjes apo e formës së shtetit, që sanksionohet në mënyrë të tërthortë nga Statuti me ruajtjen e monarkisë si formë e përkohshme qeverisje për shtetin shqiptar, e cila gjen shprehje në pikën 6 të Statutit (Akademia e Shkencave, grup autorësh, 2007:331). U krijua Këshilli i Lartë i Shtetit¹⁹ pra “Këshilli i Naltë”, që ushtron pushtetin ekzekutiv (Pano, 2003:149), i përbërë nga katër anëtarë të besimeve të ndryshme, ku kryetar primus inter partes ishte përfaqësues i komunitetit mysliman. Vendimi për t’ja lënë një kreu të komunitetit fetar detyrën e përfaqësimit të shtetit është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e trashëgimisë osmane, e cila u drejtohej të katër mileteve që përfaqësonin popullsinë e shtrirë në territorin shqiptar (Cimbolo, 2013:34). Ky është, gjithashtu, tregues i prestigjit të lartë që gëzonin komunitetet fetare, por edhe dëshmi e rolit të tyre për bashkimin e vendit. Gjithë forcat politike e njihnin rëndësinë e këtij roli, për shkak të synimit të shprehur qartazi nga komunitetet fetare për bashkëjetesë dhe respekt reciprok mes të gjithëve.

Në vitin 1922, Këshilli Kombëtar miratoi një ligj të ri kushtetues të njohur si “Statuti i Zgjeruar i Lushnjës”,²⁰ i cili ishte vazhdim i Statutit të Lushnjës. “Statuti i Zgjeruar i Lushnjës” ishte një dokument kushtetues me përmbajtje përparimtare për kushtet historike të Shqipërisë së fillimit të viteve `20 dhe miratimi i tij kishte rëndësi në luftën e

¹⁸ Statuti përfaqëson të parën kushtetutë të shtetit shqiptar, të miratuar nga një përfaqësi kombëtare. Teksti i hartuar përbën një arkitekturë të vërtetë kushtetuese të llojit evropian, ndonëse është i paplotësuar dhe si i tillë, nuk mund të konsiderohet kushtetutë në kuptimin e plotë të fjalës. Kështu, Statuti i Lushnjës e shpalli shtetin shqiptar si shtet Sovran. Kongresi Kombëtar, i mbajtur në Lushnje më 28 janar 1920, shpalli themelin e shtetit shqiptar dhe tregoi qartë se shqiptarët janë të zotë për të vetëqeverisur, duke marrë kështu njohjen ndërkombëtare edhe mbështetjen e Britanisë, u pranuan në Lidhjen e Kombeve, duke fituar kështu, për herë të parë, njohjen ndërkombëtare si shtet vetëvendosës.

¹⁹ Ky organ, që përbëhej nga katër veta, zgjidhej nga parlamenti me shumicë absolute për tre vjet dhe gëzonte imunitet parlamentar.

²⁰ Për ruajtjen e një ekuilibri më të madh në marrëdhëniet mes komuniteteve fetare, organi përfaqësues i kryetarit të shtetit u bë kolegjal dhe me rrotacion.

atëhershme politike për çrrënjosjen e feudalizmit dhe demokratizimin e jetës së vendit (Fischer, 2004:169).

Statuti sanksiononte laicizmin e shtetit (Luarasi, 1999:77). Ai trajtonte edhe çështjet e të drejtave dhe lirive të shtetasve, padyshim të drejtat dhe liritë e shpallura përbënin një plotësim të rëndësishëm të “Statutit të Lushnjës”, sanksionimi i tyre ligjor përbënte një fitore për forcat përparimtare. Në sanksionimin e të drejtave dhe lirive të shtetasve statutet nisen nga ndarja e tyre në të drejta civile e politike. Ndryshimi i fesë nuk formon ndalim ose pazotësi juridike për pasjen ose ushtrimin e të drejtave civile e politike. Në këtë dispozitë të bën përshtypje fakti se formulimi i lirisë së fesë, jo vetëm shihet i lidhur ngusht me parimin e asnjësisë së shtetit ndaj saj, por formulohet si një e tërë me këtë parim, duke qenë një dispozitë gati e njëjtë edhe me Statutin Themeltar të Republikës së Shqipërisë të vitit 1925, si dhe në atë të Mbretërisë Shqiptare. Pikërisht, në artikullin nr. 5 të tij sanksionohej shprehimisht se “Shqipëria nuk ka fe zyrtare”. Të gjitha fetë e besimet janë të nderueme dhe liria e ushtrimit dhe e praktikimit të jashtëm të tyre asht e siguruem”²¹. Statuti i Zgjeruar i Lushnjës kishte karakter të përkohshëm. Ai do të mbetej në fuqi deri sa të miratohej përfundimisht statuti i shtetit nga Asambleja Kushtetuese (Akademia e Shkencave, grup autorësh, 2007:343).

Edhe në “Statutin e Zgjeruar të Lushnjës”, siç parashikohej në “Statutin e Lushnjës” roli i garantit, që kishin komunitetet fetare në Këshillin e Lartë, i kushtëzonte ata të kishin një veshje juridike më të përcaktuar dhe i nxiste të hartonin statutet e veta. Përpjekja e institucioneve të reja shtetërore për ndërtimin e rregullit parlamentar, të ngritur mbi një përfaqësi të zgjedhurish, kërkonte përshtatje të plotë me parimet e përfaqësimit dhe të transparencës së aparatit klerikal, drejtuesit e të cilit merrnin pjesë në nivelet më të larta

²¹ Statuti Themeltar i Mbretënis Shqiptare, Fletore Zyrtare, datë 13/12/1928, Nr 111

të jetës politike e rrjedhimisht në transformimin politik dhe social të vendit (Cimbolo, 2013:36).

Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare²², risanksionon parimet e laicitetit të shtetit dhe të lirisë së ndërgjegjes e të besimit fetar, parime këto që gjetën riafirmim edhe në Statutin e Mbretërisë Shqiptare të vitit 1929 (Hoxhaj, 2013:59).

Më 1 Shtator 1928, Asambleja njëzëri vendosi shpalljen e monarkisë së shtetit shqiptar²³. Asambleja Kushtetuese, më 1 shtator, miratoi Statutin e Ri Themelor, që e shpallte Shqipërinë në bazë të nenit 1 “Mbretni, demokratike, parlamentare, të trashëgueshme për nga forma e qeverisjes”²⁴. Krijimi i mbretërisë shtoi ambiciet e Ahmet Zogut për një shtet të fortë. Fusha ku ai u përqendrua, kryesisht, ishte ajo e organizimit të shtetit dhe e hartimit të një legjislacioni modern, për të cilin ai vetë tregoi interes më shumë se për çdo gjë tjetër (Akademia e Shkencave, grup autorësh, 2007:297). Zogu synoi modernizimin e institucioneve fetare në Shqipëri për ndarjen e shtetit nga feja. Në ditën që u bë mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu, më datë 1 Shtator 1928, bëri betimin e tij, duke vendosur duart mbi Bibël dhe Kur'an, duke premtuar, kështu se do të mbronte unitetin kombëtar. Edhe pse i konceptuar në kontekstin e një regjimi autokratik, Statuti i Mbretërisë fiksonte një nga parimet bazë të çdo shteti modern, atë të ndarjes së shtetit nga feja. Në nenin 4 të statutit theksohej shprehimisht se shteti shqiptar nuk ka fe

²²Edhe ky statut bën një ndarje pushtetesh, legjislative ushtrohej nga parlamenti, i cili për herë të parë në shtetin shqiptar përbëhej nga dy dhoma, Dhoma e Deputetëve dhe Senati. Në bazë të nenit 53 Senati shqyrtonte çdo projektligj të miratuar nga Dhoma e Deputetëve përpara se t'i paraqitej Kryetarit të Republikës për miratim. Neni 8 përcaktonte pushtetin ekzekutiv, të cilin e ushtronte Kryetari i Republikës bashkë me ministrat.

²³Valentina Duka, “Institucionet fetare gjatë mbretërimit të Zogut” “Zani i Naltë”, revista shkencore dhe kulturore, janar 28, 2014

²⁴Ky statut i njohu mbretit kompetenca të gjera legjislative dhe ekzekutive si dhe mbreti ishte i përgjegjshëm për çdo lloj veprimi, duke ngarkuar me përgjegjësi ministrat e tij. Parlamenti përbëhej nga dy dhoma dhe ndante pushtetin legjislativ bashkë me mbretin. Ahmet Zogu u shpall Mbret i shqiptarëve. Zogu, emrin e të cilit do të mbajë në fakt historia e Shqipërisë në periudhën midis dy luftrave, pas konsolidimit të pushtetit të vet dhe shpalljes së tij mbret, i çoi më tej nismat e nisura.

zyrtare²⁵. Të gjitha fetë dhe besimet janë të nderuara dhe liria e ushtrimit dhe praktikimit të jashtëm të tyre “është e siguruar” (Luarasi, 1999:108). Feja, në asnjë mënyrë, nuk mund të hasë në pengesa ligjore. Ky ligj, në mënyrë të qartë, shpreh politikën fetare, që më vonë do të ndiqte shteti shqiptar drejt laicizmit, lirisë dhe barazisë fetare, drejt një nënshtrimi të plotë të komuniteteve fetare. Kjo dispozitë e statutit e vinte shtetin mbi besimet e ndryshme fetare, që praktikoheshin në vend, duke shmangur kështu politikat përçarëse, që mund të vinin nga jashtë. Kështu, u përcaktua se fetë dhe besimet fetare nuk mund të përdoren kurrësi për qëllime politike (neni 5).

Zogu u tregua një reformatör i vendosur në çështjen e fesë, duke afirmuar dhe konsoliduar laicitetin e shtetit. Ky parim ishte sanksionuar që në Statutin e vitit 1922, i cili shpallte se “Shteti nuk ka fe zyrtare”. Ai u ripohua edhe në “Statutin Themeltar të Republikës” edhe në “Statutin Themeltar të Mbretërisë”. Zogut i binte si barrë që ky parim të zinte vend në realitetin shqiptar (Puto, 2009:471).

2.1.1.2 Njohja e lirisë së organizimit të kulteve me Dekretin e vitit 1923, statutet e para të bashkësive fetare

Me Dekretin e vitit 1923 “Për komunitetet fetare” pasi sanksionohet se liria e mendimit mbrohet nga neni 93 i Statutit të Shtetit Shqiptar të vitit 1922 dhe nga nenet 1-2 të “Statutit të Zgjeruar të Lushnjës”, thuhet se: “Çdo degë e Myslimanizmës si Synnizma, Bektashizma, Rufaizma, Halvetizma, Kadirizma, Sadizma e të tjera, ashtu dhe çdo degë

²⁵ Neni 4, “Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare”

e Krishtenizmsë, si Katolikizma, si edhe të gjitha degat e çdo feje tjetër, mund të organizohen në një shoqjet fetare independente njana prej tjetrës”²⁶.

Kështu, shprehet qartë pluralizmi fetar dhe secilit prej komuniteteve fetare shteti i njeh të drejtën që të paraqesë statutin dhe rregulloren e vet. Çdo shoqatë fetare mund të ketë me qendrat e mëdha fetare jashtë Shqipërisë vetëm lidhje shpirtërore dhe dogmatike. Marrëdhëniet dhe korrespondencat mes tyre janë të lira, pa farë pengese nga qeveria”²⁷. Pra, marrëdhëniet ndërkombëtare të kulteve nuk janë të ndaluara, por kanë të bëjnë vetëm me çështje dhe veprimtari fetare, si garanci e pavarësisë kombëtare. Për të garantuar respektimin e kësaj dispozite, të gjithë ata që kanë detyra fetare duhet të kenë shtetësi shqiptare dhe të flasin shqip, të gëzojnë të drejta civile dhe politike.

Rëndësi të veçantë paraqet njohja e plotë e autonomisë së komuniteteve fetare, çka e dëshmon fakti se krerët e çdo feje dhe besimi zgjidhen sipas statuteve të tyre dhe njihen nga qeveria nëpërmjet një dekreti, në përputhje me karakterin juridiksional të kësaj norme. Sidoqoftë, çdo shoqatë apo institut fetar si xhami, teqe, kishë, manastir etj., njihet si person juridik dhe përfaqësohet në bazë të rregullave të brendshme fetare të kultit përkatës (Della Rocca, 1994:132).

Nuk mund të ketë garanci më të madhe se kjo për të shprehur njohjen efektive të lirisë fetare, të shoqatave dhe individëve, aq më tepër kur organizatat e ndryshme të kultit kanë të drejtë të zotërojnë, të blejnë, të tjetërsojnë dhe të administrojnë pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, por të drejtat civile që u njihen atyre duhet të jenë në përputhje me natyrën e shoqatave me karakter fetar (Della Rocca, 1994:132). Shteti mjaftohet me të drejtën e kontrollit mbi administrimin e pasurisë dhe të bilancit vjetor të personave

²⁶ “Statuti legal i komuniteteve fetare 1923”, Shih <http://licodu.cois.it/415/view>

²⁷ “Statuti legal i komuniteteve fetare 1923”, Shih <http://licodu.cois.it/415/view>

juridikë të komuniteteve fetare, duke zbatuar një ligj të posaçëm për shoqatat²⁸. Mbështetja tek legjislacioni i përbashkët për kontrollin e ushtruar nga qeveria mbi të mirat e komunitetit fetar dhe të enteve të veta bëhet edhe për çështje që kanë lidhje me sektorin e ndërtimit për kultet (Fischer, 2004:170)²⁹. Nuk ka se si të jetë më e qartë norma për garantimin dhe sigurimin e lirisë dhe autonomisë së plotë të komuniteteve fetare, në një vizion modern, pluralist dhe laik në marrëdhënie me kultet, kur dekreti shkon deri aty sa njeh autonominë e brendshme të komunitetit: “Shoqatat kanë të drejtë të vendosin masa disiplinore mbi klerin dhe vartësit e tyre”³⁰. Për rrjedhojë, në të drejtën civile shqiptare, që nga viti 1923, komunitetet fetare³¹ janë shoqëri individësh, të bashkuar nga një besim i vetëm, kanë një kalendar të vetin liturgjik, respektojnë ditët e festave fetare, respektojnë disa detyrime lidhur me të ushqyerin; kanë shkollat e veta, organizim të vetin komunitar dhe praktikojnë të njëjtin besim, gjë që i vesh ata me personalitet juridik të së drejtës civile. Me këtë ligj, rendi shqiptar fut një nocion për komunitetet fetare, ndër më përparimtarët në nivel evropian (Cimbolo, 2013:46). Mund të themi se pikërisht në Shqipëri arrin kulmin e vet rrugëtimi i gjatë i konceptit të besimit fetar, i cili pasi ka kaluar në sisteme ligjore evropiane, gjen tek pluralizmi fetar dhe e drejta civile mbështetjen e duhur konceptuale dhe strukturore për rregullimin e veprimtarisë fetare, duke i siguruar veshje juridike nocionit komunitet fetar. Lidhur me

²⁸ Gjatë viteve të monarkisë, Zogu nuk i respektoi plotësisht ligjet për bashkësitë fetare, veçanërisht të katolikëve pasi ndryshe nga myslimanët dhe ortodokset, refuzuan t'i nënshtroheshin shtetit sikundër vendoste dekreti, Selia e Shenjtë vazhdoi të kishte me katolikët shqiptarë, jo vetëm lidhje shpirtërore, por edhe administrative e financiare, të huajtë vazhduan të ishin të pranishëm në klerin katolik, që vepronte në Shqipëri.

²⁹ “Statuti legal i komuniteteve fetare” 1923, Shih <http://licodu.cois.it/415/view>

³⁰ Po aty,

³¹ “Statuti legal i komuniteteve fetare” 1923, Shih <http://licodu.cois.it/415/view>

këtë çështje, duhet të themi se Dekreti i vitit 1923 i paraprin kodit të ardhshëm civil shqiptar³².

Pranimi, më datë 5 Qershor 1923, nga Parlamenti Shqiptar i “Statutit Legal të Komuniteteve Fetare” është një hap i rëndësishëm për fetë në vendin tonë. Për herë të parë në programin e saj qeveria e Zogut bënte fjalë dhe për reforma fetare. Ahmet Zogu i kërkoi Parlamentit të votonte ligjin mbi statutin e bashkësive fetare dhe në këtë mënyrë, veçse me dëshirën e tyre, shtetasit shqiptarë nuk do t’i nënshtroheshin më asnjë legjislacioni kanonik por, në çdo rast, duhej tu bindeshin ligjeve të shtetit. Kështu, mund të themi se ishte Ahmet Zogu ai që nisi punën për krijimin e institucione fetare kombëtare, në fillim si Kryeministër dhe Ministër i Punëve të Brendshme e më vonë si Monark³³.

Kështu, u mënjanua feja nga shteti dhe u hoq, gjithashtu edhe legjislacioni osman, duke bërë të nevojshëm edhe riorganizimin e administratës së vakëfeve. Kongresi hartoi një rregullore të posaçme për kalimin e vakëfeve nën administrimin e komuniteteve fetare duke konsoliduar plotësisht ndarjen e shtetit nga feja. Myslimanëve suni u takojnë të ardhurat e zekatit që mblidhen nga anëtarët e këtij komuniteti, ndërkohë që kjo taksë do të marrë formë tjetër për bektashinjtë, të cilët do t’i organizojnë vakëfet e tyre në vitet në vazhdim. Këtij procesi kushtetues, që i trajton komunitetet fetare si subjekte të së drejtës private, nuk i përgjigjet Kisha Katolike, strukturat e të cilës lidhen gushtë me organizimin ndërkombëtar të *Kuries* së Romës, prandaj ajo nuk mund të pranojë të organizohet brenda një dimensionit thjesht kombëtar. Të udhëzuar nga dispozitat

³²Ruga që ndoqi Zogu si Ministër i brendshëm i asaj kohe, gjeti mbështetjen e myslimanëve, por u kundërshtua nga ortodoksët dhe katolikët, të cilët denonconin lindjen e një kontrolli të rreptë shtetëror mbi kultet dhe shkeljen e normave kushtetuese, që garantonin lirinë fetare.

³³Sherif Delvina, Marrëdhëniet e mbretit Ahmet Zogu I me komunitetet fetare në Shqipëri. Si i propozoi parlamentit ligjin mbi statusin e bashkësive fetare, <http://www.forumishqiptar.com/threads/39534-Historia-e-lindjes-se-komuniteteve-fetare-komb%C3%ABtare> 7.08.2015

kushtetuese, komunitet fetare miratuan statutet e veta dhe kjo solli miratimin e ligjit për statutet e ligjshme të komuniteteve fetare duke i njohur kështu personalitetin juridik në vitin 1923³⁴. Gjithashtu, gjatë përpjekjeve të vazhdueshme për marrjen e personalitetit juridik civil të Komunitetit Ungjillor u duk sikur u hap një dritare, sado e vogël, me nënshkrimin e Dekretit të vitit 1923³⁵, por sidoqoftë, ky komunitet ishte ende i ri dhe i dobët për të fituar të drejtat e tij (Cimbolo, 2013:43).

Ndërkohë, që vëmendje i'u kushtua edhe statuteve të para të bashkësive fetare. Në qarqet fetare, në përgjithësi, u pa një predispozicion për t'ju përshtatur situatës së re. Kjo u duk së pari me bashkësinë që ishte më e madhja në numër (Cimbolo, 2013:37).

Në Kongresin e vitit 1921 u miratua Statuti Bektashian. Për drejtimin e komunitetit u caktua Këshilli Atënor, i cili duhet të veprojë në përputhje me “Ligjin e përjetshëm Bektashian”. U përcaktua mënyra e organizimit të Këshillit, kohëzgjatja, mbledhjet periodike dhe detyrat e tij. Pas listimit të masave disiplinore, që Këshilli mund të marrë kundrejt funksionarëve të ndryshëm fetarë, statuti trajton financat e komunitetit për të shqyrtuar gjendjen e pasurisë së përgjithshme dhe të secilës teqe në veçanti, pasuri që mblidhet nga kontributi i besimtarëve dhe krerëve të komunitetit (Fischer, 2004:171). Një çështje tjetër e rëndësishme është themelimi i një shkolle formimi për klerin, e cila do të mbahet me burimet e komunitetit dhe të administratës, nën mbikëqyrjen e një komisioni të posaçëm, të emëruar nga Këshilli Atëror (Cimbolo, 2013:38). Institucionalizimi i besimit bektashian bëhet me mbështetjen e qeverisë shqiptare, ndaj Këshillit Atënor dhe urdhëron të gjithë Baballarët të luten për shtetin shqiptar dhe për

³⁴ “Statuti legal i komuniteteve fetare” 1923, Shih <http://licodu.cois.it/415/view>

³⁵ “Statuti legal i komuniteteve fetare” 1923, Shih <http://licodu.cois.it/415/view>

mbarë kombin³⁶. Me tu miratuar statuti, normat e tij i shtohen ligjit të përgjithshëm bektashian³⁷. Komuniteti Bektashian e ka të nevojshme të forcojë identitetin e vet dhe të qartësojë dallimin me organizatat e besimit islam, qoftë edhe brenda Shqipërisë. Për këtë arsye, kërkohej mbështetja në Dekretin e vitit 1923 në lidhje me natyrën juridike të komunitetit fetar. Kështu, u mbledh Kongresi i Dytë Bektashian pranë teqesë së Tomorit. Duke miratuar statutin e ri të bektashinjve, të cilët dallohen nga komunitetet e tjera myslimane dhe duke u sanksionuar si të pavarur, po brenda islamit, në nenin 1-3³⁸. Gjatë kësaj periudhe, në Shqipëri vepronte qeveria e përkohshme, e udhëhequr nga Fan Noli, e cila qëndroi në pushtet vetëm 6 muaj.

Një çështje tjetër e rëndësishme ishte ajo e autoqefalisë së Kishës Ortodokse shqiptare. Ndonëse ishte bërë një rrugë, që prej shpalljes së autoqefalisë në vitin 1908 dhe ishin hedhur hapa në drejtim të konsolidimit të saj, mbetej ende çështja e raportit me Patrikanën e Stambollit, qendra e ortodoksisë (Puto, 2009:471). Gjithashtu, më datë 28 nëntor 1921, në Tiranë u nënshkrua vendimi nga katër përfaqësues të Kishës Ortodokse dhe u shpall themelimi i Kishës Kombëtare Autoqefale Ortodokse, duke theksuar besnikërinë e saj ndaj kanoneve të shenjta të të gjitha kishave të tjera ortodokse të Krishtit, nën mbrojtjen e Patriarkanës së Kostandinopojës (Cimbolo, 2013:41). Kështu, u mbledh në Berat, më 12 Shtator 1922, Këshilli i asaj, që mund të quhet organizimi i parë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në truallin shqiptar. Nuk mjaftoi as vendimi i Kongresit të Beratit, që e ripohoi autoqefalinë dhe i kërkoi Patrikanës së Stambollit që ta njihte ndarjen. Falë përkushtimit të disa përfaqësuesve të saj, të cilët u vunë në krye të

³⁶Pasuria e komunitetit është ajo e teqeve të veçanta, por ndërkohë, i hapet rrugë procesit për ndërtimin e një pasurie të përgjithshme të vëllazërisë. Komuniteti bektashian nuk e përdor institutin e vakëfit, as nuk mbledh taksat. Të quajtura zekat, por gjatë kësaj kohe mbështetet në kontributet e besimtarëve, lutjet e besimtarëve zhvillohen në gjuhën amëtare.

³⁷Shih <http://licodu.cois.it/421/view>

³⁸Statuti i Komunitetit Bektashi, Neni1.

përpyjekjeve për modernizimin e kombit dhe të gjuhës shqipe, pas Luftës I Botërore, bashkësia ortodokse shqiptare vendosi shpalljen e Kishës Ortodokse shqiptare dhe e emëroi Fan Nolin peshkop (Puto, 2009:472).

Statuti u miratua më 17 Shtator 1922 por, megjithatë, bëhej fjalë për një statut të përkohshëm, derisa marrëdhëniet me Patriarkanën Ekumenike të Kostandinopojës të hynin në rrugën e duhur. Është kjo arsyeja që Kisha Ortodokse, në pritje të këtij miratimi, drejtohej nga një komitet i përkohshëm, përbërja e të cilit përcaktohej në nenin 3 të Statutit³⁹. Kështu, u krye, akti i parë themelor i pranisë ortodokse të pavarur në vend, i cili ishte ende në gjendje embrionale dhe e priste një rrugë sa e gjatë aq edhe e vështirë për marrjen e autoqefalisë (Cimbolo, 2013:40). Qeveria shqiptare e njohu rezolutën e këtij Kongresi të Kishës së pavarur Ortodokse të Shqipërisë, por vendimet e Kongresit dhe emërimi i ipeshkëve u gjykuan jo korrekte nga Patriarkana e Kostandinopojës që ishte e gatshme të pranonte formimin e një kishe të pavarur por, jo autoqefale edhe për faktin se vendi përbëhej nga shumicë myslimane dhe jo ortodokse (Beduli,1992:22).

Kur ishte kryeministër Zogu dha një kontribut të rëndësishëm për suksesin e Kongresit Themeltar të Kishës Autoqefale Ortodokse⁴⁰. Në dritën e sabotimit të vazhdueshëm të qeverisë greke, përpjekjet e Zogut ndihmuan hierarkinë e Kishës Ortodokse Shqiptare për të fituar pavarësinë e tyre (Gjuraj, 2013:97). Patrikana ishte gjithnjë një instrument i propagandës greke. Në këtë mënyrë, mbreti shqiptar vendosi të hyjë në veprim duke e marrë këtë çështje në duart e veta (Fischer, 1997:185). Në Shkurt të vitit 1929 ai arriti të krijojë Sinodin e Shenjtë të ortodoksisë shqiptare, i cili nisi nga puna për strukturimin e

³⁹Statuti i Kishës kombëtare të pavarur Ortodokse në Shqipëri, neni 3.

⁴⁰Sherif Delvina, Marrëdhëniet e mbretit Ahmet Zogu I me komunitetet fetare në Shqipëri. Si i propozoi parlamentit ligjin mbi statusin e bashkësive fetare, <http://www.forumishqiptar.com/threads/39534-Historia-e-lindjes-se-komuniteteve-fetare-komb%C3%ABtare> 7.08.2015

hierarkisë kishtare. Më 16 Qershor, në përputhje me nenin 14⁴¹ të Statutit të Beratit, sipas së cilit, 3 muaj pas krijimit të Sinodit të Shenjtë duhej të mblidhej një Asamble Kishtare, që kishte për detyrë të hartonte statutin e përhershëm të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Kështu, u mblodh Kongresi II Panortodoks Shqiptar, i cili u zhvillua në Korçë, ku edhe u miratua statuti i Kishës Ortodokse (Fischer, 2004:170). Ky statut u miratua nga qeveria shqiptare më 26 Korrik të po atij viti dhe u dekretua nga mbreti më 6 gusht të po atij viti (Dervishi, 2006:305). Pas hartimit të tij, u sanksionua ndarja e juridiksionit kishtar ortodoks në 4 peshkopata, ndryshimi i të cilave mund të bëhej vetëm me miratimin e qeverisë dhe me dekret mbretëror (Hoxha, 2014:8). Duke e ndier rrezikun, Zogu në shkurt të vitit 1929 mori iniciativën për të organizuar një sinod shqiptar. Siç mund të pritej, përpjekjet për sanksionimin përfundimtar të autoqefalisë ndeshën në kundërshtimin e Athinës (Puto, 2009:473). U desh të kalonin disa vjet të tjerë që gjendja të zhblllokohej. Në vitin 1936, Zogu i intensifikoi përpjekjet për njohjen e autoqefalisë. Më në fund, Patriarkana njohu Kishën Ortodokse shqiptare si të shkëputur nga Kisha Ekumenike dhe më pas, si kishë autoqefale në vitin 1937 (Della Rocca, 1994:63-65).

Për sa i përket Komunitetit Mysliman, në datat 24 Shkurt-12 Mars të vitit 1923, u mblodh në Tiranë Kongresi i Parë, në të cilin morën pjesë 36 përfaqësues nga të gjitha krahinat e Shqipërisë. Hapat e para në këtë drejtim u hodhën që në mars 1923, kur në Tiranë u mblodh “Kongresi i Parë Muhamedan”. Kongresi shqyrtoi ndërprerjen e marrëdhënieve të varësisë me Stambollin dhe caktoi organet e Komunitetit kombëtar Sunit, që janë kryemyftiu (Tiranë), myftinj të rrethëve (Shkodër, Tiranë, Gjirokastrë), emëroi “Këshillin e Lartë të Sheriatit” dhe hartoi statutin e vet (Cimbolo, 2013:41). Me mbylljen e Kongresit, Komuniteti Mysliman vazhdon të sjellë risi të tjera, gjë që i'a

⁴¹ Statuti i Kishës kombëtare të pavarur Ortodokse në Shqipëri, neni 14.

forcon më shumë identitetin. Këto risi kanë të bëjnë me konsolidimin e hierarkisë fetare dhe administrative, me shqyrtime autonome të kuadrit teologjik, duke rivlerësuar rolin e gruas në shoqëri. Gjithashtu, Komuniteti Mysliman shprehet kundër poligamisë, mbulimit të grave me shami, si dhe kundër disa ritualeve (Cimbolo, 2013:41). Kongresi i Myslimanëve Shqiptarë vendosi asgjë më pak se: Shkëputjen nga Kalifati, zëvendësimin e liturgjisë nga gjuha arabe në gjuhën shqipe, heqjen e ferexhesë, kryerjen e lutjes në këmbë dhe abrogimin e poligamisë, gjunjëzimin para faljes, pra zhveshje nga thelbi i vet i ritualeve⁴². Statuti i Komunitetit Mysliman doli në vitin 1923 dhe aty vihet në dukje se Këshilli i Naltë i Sheriatit duhet të jetë prej racës shqiptare (Cimbolo, 2013:37).

2.1.2 Zogu e kombëtarizimi i fesë, raporti i tij me komunitetet fetare

2.1.2.1 Dekret-Ligji i 16 Korrikut 1929, “Për formimin e bashkësive fetare”, në periudhën monarkisë Zogiste

Zogu dha shembullin personal duke mbajtur qëndrim të ekuilibruar ndaj besimeve fetare. Zogu ishte personalisht indiferent ndaj fesë, nuk tregohej aktivisht antifetar por nuk kishte asnjë simpati për fenë në çfarëdo forme dhe në çfarëdo shtate. Veç kësaj, pushteti ndërhyri në jetën e brendshme të bashkësive fetare, duke kërkuar ndryshimin e rriteve edhe strukturave. Lidhur me këtë, duhet përmendur Dekret-Ligji “Mbi komunitetet fetare”, datë 9 Gusht 1929, miratuar nga Parlamenti më 9 Janar 1930 (Puto, 2009:472).

⁴²Valentina Duka, Institucionet fetare gjatë mbretërimit të Zogut, Zani i Naltë revista shkencore dhe kulturore, janar 28, 2014

Me Dekret-Ligjin “Mbi formimin e komuniteteve fetare”,⁴³ u bë njohja e komuniteteve fetare dhe u përcaktua statusi ligjor në lidhje me funksionimin e tyre. Sipas nenit 1 të këtij ligji, “Kushdo gëzon lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë që dëshiron, një liri e garantuar nga nenet 5 dhe 203 të Statutit bazë të Mbretërisë”. Kështu, ky dekretligj rregullonte të gjitha sferat e veprimtarisë fetare në raport me pushtetin publik. Në dekretin që përbëhej prej 33 nenesh, do të veçonim nenin 3, i cili i quante personat fetarë persona moralë, ata gëzojnë të gjitha të drejtat relative me këtë personalitet, në përputhje me këtë dekretligj dhe me ligjet e tjera të shtetit por, këta persona nuk mund të ndjekin qëllime politike as drejtpërsëdrejti, as tërthorazi (Fischer, 2004:169). Gjithashtu, nuk mund të ushtrojnë të drejtë gjykimi apo juridiksion për asnjë çështje. Parimet e politikës fetare të shtetit shqiptar përcaktoheshin mbi bazën e laicitetit të shtetit, liri fetare, barazi e feve, nënshtrimi i tyre ndaj autoritetit të shtetit (Puto, 2009;472).

Kështu, dekreti përcakton se komunitetet fetare janë persona moralë dhe gëzojnë të gjitha të drejtat e lidhura me këtë personalitet, në përputhje me këtë dekret-ligj dhe me ligjet e tjera të shtetit nuk mund të ndjekin qëllime politike, si dhe nuk kanë të drejtë gjykimi apo juridiksion për asnjë çështje. Ato kanë vetëm të drejtat që u njeh ligji i shtetit, që do të thotë se statuti i tyre duhet të aprovohet nga Këshilli i Ministror dhe të dekretohet nga mbreti. Sipas këtij dekreti, kryetarët e feve dhe klerikët e tjerë duhet të jenë shtetas shqiptarë, që shkruajnë e flasin gjuhën e tyre dhe të mos jenë të njohur në Shqipëri për vepra antikombëtare. Kryetarët, pasi zgjidhen sipas statutit të tyre, emërohen me dekret mbretëror. Në këtë dekret, shohim influencën dhe kontrollin e madh që ushtron mbreti ndaj tyre, emërimi dhe shkarkimi i klerikëve të lartë të komunitetit bëhet me dekret mbretëror. Lejohet arsimimi i klerikëve në shkolla fetare si seminare e medrese, por leja

⁴³Art. 1 “Çdo njeri në Shqipëri gëzon lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë që dëshiron; kjo liri është e garantueme me artikujt 5 e 203 të statutit themeltar të Mbretërisë.” Dekret-Ligj mbi Formimin e Komuniteteve Fetare, 9 korrik 1929.

miratohet me dekret ligj të veçantë për këtë qëllim. Përmes këtij ligji, Mbreti Zog ka si qëllim për të fituar kontrollin e plotë mbi të tre komunitetet fetare⁴⁴. Gjithashtu, qëllimi tjetër ishte nënshtrimi i popullsisë katolike me qendër qytetin e Shkodrës, ku ka pasur institucione arsimore dhe kulturore të tilla si kolegji Saverino, Jezuitët etj. Politika e Zogut ishte drejtuar formalisht drejt një shteti absolut laik, kjo jo e shkaktuar nga nevojat praktike të modernizimit të shtetit, por nga dëshira e tij për të kufizuar pushtetin e kundërshtarëve të mundshme politike, si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm dhe nga pikëpamja praktike ajo synonte të mposhte komunitetet fetare nga autoriteti i shtetit (Fischer, 2004:170).

Në dekretin e Mbretit Zog të korrikut 1929 është e sanksionuar zyrtarisht ekzistenca e tri feve në Shqipëri, të cilat duhet të hartonin statutet e tyre. Dekreti thotë se komunitetet fetare nuk mund të financohen nga jashtë dhe nuk duhet të kenë marrëdhënie me institucionet, organizatat dhe individët e huaj. Nëpërmjet këtij dekreti, komunitetet fetare i'u nënshtruan autoritetit të shtetit, e cila ishte e papranueshme për ta (Cimbolo, 2013:138). Shteti shqiptar shton qëndrimet e veta autoritare dhe përpjekjet për institucionalizimin e plotë të marrëdhënieve me besimet fetare.

Në lidhje me çështjet fetare, politika e Zogut kishte për qëllim forcimin e unitetit të grupeve të ndryshme fetare. Duke qenë të vetëdijshëm për veçoritë e shoqërisë shqiptare, qëndrimi i Zogut ndaj feve ishte nacionalist. Duke njohur përbërjen e popullit të tij, Zogu dëshironte që t'i mbante ata sëbashku. Kjo do të ishte shumë e rëndësishme për forcimin dhe ruajtjen e fuqisë së tij, asnjënjësia duhej për të karakterizuar politikën e tij të brendshme (Gjuraj, 2013:96). Edhe pse Zogu ishte një mysliman, ai vendosi për të ndarë

⁴⁴www.Licodu.com, Albania sikundër shkollat, Zogu donte t'i lidhte më fort pas shtetit edhe bashkësitë fetare dhe t'i çlironte ato nga ndikimet e huaja. Që në korrik të vitit 1929, atyre iu kërkuar të hartonin statute dhe t'ia paraqisnin ato qeverisë për shqyrtim. Nga ana tjetër, bashkësitë u ndaluan të marrin ndihma financiare nga jashtë vendit. Drejtuesit e bashkësive fetare duhej të miratoheshin nga mbreti.

shtetin nga feja duke mos njohur asnjë fe zyrtare në vend. Kjo ndarje ishte absolute dhe qëllimi i tij ishte për të vënë të gjitha fetë nën kontroll. Por, duhet të theksojmë se Zogu nuk ishte indiferent ndaj fesë, ai ishte në favor të një shteti të fortë ku shteti do kishte rolin dominues ndaj feve. Kështu, Ahmet Zogu këmbënguli se shteti ishte neutral në lidhje me komunitetet fetare⁴⁵. Objektivi i mbretit Zog ishte që të tri bashkësitë fetare të vireshin nën kontrollin e tij të plotë. Për këtë arsye, u përshpejtuan përgatitjet për ligjin e bashkësive fetare, që u miratua më 16 Korrik 1929. Ligji ‘Mbi komunitetet fetare’ siç e analizuam më sipër i dha goditje të plotë imunitetit të vjetër fetar dhe një nga shkaqet e kësaj goditje ishte përjashtimi i klerikëve nga fondet fetare të kultit, duke i detyruar kështu të mbështeten tek ndihma italiane (Haxhija, 2012:41). Por, nëse kemi parasysh rastin e veçantë të katolikëve, mund të themi se ndoshta gjatë viteve të monarkisë, mbreti nuk e respektoi plotësisht ligjin për bashkësitë fetare.

Siç edhe u përmend, ky ligj vendos detyrimin që kleri aktiv në Shqipëri të ishte i kombësisë dhe i trungut etnik shqiptar dhe parashikonte kontrollin e shtetit mbi administrimin e pasurive të çdo besimi fetar⁴⁶. Por, në rrafshin praktik zbatimi i ligjeve nuk ishte i vazhdueshëm. Katolikët, ndryshe nga myslimanët dhe ortodoksët, refuzuan t’i nënshtroheshin shtetit, sipas dekretit të 16 Korrikut 1929, për formimin e bashkësive fetare të njohura zyrtarisht. Ata hoqën dorë nga fitimi i personalitetit juridik, vazhduan

⁴⁵Si kryetar shteti Zogu donte të dukej formalisht i distancuar njësoj nga tri besimet kryesore të vendit. Donte një bashkëshorte kristiane, që do t’ia rriste besimin në sytë e shqiptarëve jo myslimane, duke bashkuar simbolikisht në familjen e tij besimet e vendit. Një bashkëshorte kristiane do t’i lejonte, gjithashtu, Zogut që të depërtonte në monarkitë kristiane evropiane, duke kapërcyer origjinën e tij. Katolikët dhe ortodoksët shqiptarë u kënaqën që do të kishin një mbretëreshë të krishterë por jo myslimanët, të cilëve nuk u pëlqente një martesë e përzier. Martesa me Gjeraldin, për kuptimin që kishte nga pikëpamja e politikës fetare, do ta përsoste por, nuk do ta përtërinte rregullimin e çështjeve fetare në Shqipëri, rregullim që Zogu, tanimë, e kishte konsoliduar sipas planeve të veta.

⁴⁶ Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare, titulli I, “shteti shqiptar nuk ka fe zyrtare, të gjitha fetë dhe besimet janë të nderume dhe liria e ushtrimit dhe e praktikimit të jashtëm të tyre është sigurue. Feja nuk mund të formojë pengime juridike me asnjë mënyrë . Fetë dhe besimet kurrësi nuk mund të përdoren për qëllime politike”.

lidhjet, jo vetëm shpirtërore, por dhe administrative dhe financiare me Selinë e Shenjtë dhe elementë klerikë katolikë jo shqiptarë vazhduan veprimtarinë në Shqipëri.

2.1.2.2 Raporti i Zogut me bashkësitë fetare, përplasja me Kishën Katolike

Gjatë qeverisjes së vendit nga Ahmet Zogu (periudhës pas Revolucionit të Qershorit, respektivisht Republikës (1925-1928) dhe Monarkisë Zogiste (1928-1939), marrëdhëniet tolerante mes elementeve të ndryshëm fetare në vend, në një farë mase, arritën të vendoseshin (Della Roca, 1994:117). Në metodat e tij të qeverisjes Zogu kishte hequr dorë nga metodat osmane dhe zyrtarisht, mendohej të jepte përshtypjen se synonte drejt evropianizimit të vendit dhe madje ai bëri mjaft në këtë drejtim, si pasojë e natyrshme dhe e përshtatjes me kushtet që ofronte jeta shqiptare dhe veçanërisht, me prirjet e tij politike, që rridhnin nga natyra e tij personale (Della Roca, 1994:120). Ai nuk mund të shkëputej nga metodat e vjetra administrative despotike. Politika e Zogut, në pikëpamje formale, ka qenë një politikë, e cila synonte një laicizëm absolut dhe nga pikëpamja praktike, ka ndjekur një politikë të vendosjes në varësi të shtetit të komuniteteve fetare. Zogu inkurajoi diversitetin e mëtejshëm fetar në Shqipëri, por pati edhe përplasje me bashkësitë fetare e kryesisht, me Kishën Katolike (Ljarja, 2012:36).

Në gusht 1929, u mbajt Kongresi i Suniteve shqiptarë, i cili mori disa masa radikale. Para së gjithash, u ripohua shkëputja nga Kalifati, u vendos që kleri të ndahej përfundimisht nga autoriteti hierarkik i Stambollit dhe tu jepej fund marrëdhënieve me Islamin. Ndër vendimet kryesore ishin, po ashtu, përdorimi ekskluziv i gjuhës shqipe për lutjet dhe predikimin, unifikimi i medreseve dhe seminareve në një institut të vetëm arsimimi, mbyllja e shumicës së xhamive duke mbajtur dy ose tri në çdo qytet.

Diplomatët e huaj raportonin se këto vendime ishin marrë nën presionin e Zogut (Fischer, 2004:170). U vunë re disa ngurrime në radhët e klerit mysliman, sidomos atij të Shkodrës, por theksohej se reforma u bë pa shumë vështirësi. Në shtetin e Zogut do të shënohen edhe përplasjet e para midis dëshirës për pushtet të klerit dhe fuqisë së vetë shtetit, që për ballafaqim do të zbatojë kombëtarizimin e tyre (Puto, 2009: 472). Duke e kuptuar mirë pozicionimin e veçantë që kishte Kisha Katolike ndaj një komuniteti mjaft ndikues në Shqipërinë e Veriut, Ahmet Zogu bëri çmos që ta vinte nën kontroll të plotë atë (Ljarja, 2012:36). Në këtë drejtim, ai pati edhe mbështetjen e posaçme edhe të qeverive të ndryshme italiane. Këto vite përbëjnë një periudhë të vështirë marrëdhëniesh të komuniteteve fetare me shtetin shqiptar, ende i pastabilizuar institucionalisht e politikisht dhe i paplotësuar nga një legjislacionin modern perëndimor, i cili do të rregullonte deri në detaje çështje shumë të rëndësishme të marrëdhënieve me komunitetet fetare, si problemin e martesës civile, problemin e shkollave shtetërore, problemet e legjislacionit civil etj., të cilat si të tilla, tashmë ishin të zgjidhura në Evropën Perëndimore (Ljarja,2012:36).

Në momentet e para të përpjekjeve për krijimin e një shteti demokratik, vihen re kontradiktat mes intelektualëve katolikë, të formuar në universitetet perëndimore evropiane dhe pronarëve të mëdhenj të tokave pro turq, apo borgjezisë (Fishta, 1921:1-17), që vazhdonin të mbaheshin pas privilegjeve dhe nuk ishin aspak të interesuar për një rindërtim demokratik të sistemit institucional e shoqëror në Shqipëri (Peters, 2010:43-44). Kjo është edhe arsyeja që përpjekja për krijimin e një legjislacioni modern, apo edhe të një sistemi shkollor shtetëror kombëtar, shkonte në kah të kundërt me përpjekjet e pavarura të Kishës Katolike për një jetesë normale në një vend demokratik dhe evropian,

apo me përpjekjet e këtij institucioni për shkollimin e fëmijëve shqiptarë të të gjitha besimeve⁴⁷.

Në përpjekjen e shtetit vërehet një tejkalim i masave reformuese deri në cenimin e të drejtave fetare të pakicës katolike në Shqipëri deri në tejkalim kompetencash. Arsytet mund të konvergojnë në komplekset që mbartnin personazhet kryesore të politikës shqiptare të kohës, përfshirë edhe vetë kreun e shtetit, si rrjedhojë logjike e prejardhjes dhe formimit të tyre. Qëndrimi i Zogut ndaj Kishës Katolike shfaqet si pjesë e formimit dhe qëndrimit të tij kompleks, në të cilin përzihehin fryma despotike antidemokratike dhe metodat feudale por paralelisht, në politikën e tij nuk mungonin edhe elementet e modernizmit, aq të domosdoshëm për t'u afruar me Evropën (Ljarja, 2012:37).

Siç edhe e përmendëm, politika e Zogut, në pikëpamje formale, ka qenë një politikë që synonte një laicizëm absolut, nga pikëpamja praktike ka ndjekur një politikë të vendosjes të komuniteteve fetare në varësi të shtetit. Kjo lëvizje e fundit i ra tërësisht ndesh Kishës Katolike. Këtë e provon karakteri universal i saj në pikëpamje organizative dhe fakti i mirënjohur i kontributit të kahershëm të këtij institucioni në formimin e vetëdijes kombëtare shqiptare e vizionit të qytetërimit perëndimor (Ljarja, 2012:38). Duke e kuptuar mjaft mirë pozicionin krejt të veçantë, që kishte Kisha Katolike ndaj një komuniteti mjaft ndikues në Shqipërinë e Veriut, Ahmet Zogu bëri çmos që ta vinte nën kontroll të plotë atë⁴⁸.

⁴⁷Duhet të theksojmë se procesi europianizues i legjislacionit ka gjetur pengesa jo vetëm të mbartura nga konceptimi otoman i pushtetit. Fakt është, se një pjesë e rëndësishme dhe e fuqishme e klasës drejtuese të Shqipërisë së pavarur të viteve 1920, 1930, ka qenë e formuar dhe e mbartur në pikëpamje politike dhe ekonomike në periudhën vijuese të pavarësisë. Një ndikim të veçantë në këtë proces kanë ushtruar edhe mendësitë e pareformuara të subjekteve drejtuese të komuniteteve përbërëse të Shqipërisë së asokohe.

⁴⁸Vetë Zogu e ka vështiruar me shumë dyshim institucionin e kishës në Shqipëri. Ai, në vend që ta shihte këtë institucion si një aleat të vetin në rrugën e vështirë të konsolidimit të shtetit, e ka konsideruar atë në pjesën më dominuese të saj, si një institucion të huaj dhe klerikët katolikë si shërbëtorë të vendeve të huaja.

Që në fund të vitit 1922, ende pa u bërë mbizotërues i plotë i politikës shqiptare, Zogu, me marrjen në dorë të frenave të qeverisë filloi të marrë disa masa kundër kundërshtarëve të tij demokrate liberale, të cilët ishin për vendosjen e një sistemi politik dhe institucional përfundimor, në vendin e sapo dalë nga suaza e Perandorisë Osmane (Ljarja, 2012:39). Sulmi kryesor do të duhej të drejtohej ndaj vatrës kryesore formuese të këtij orientimi, Kishës Katolike dhe pjesës formuese të tij, shkollës, d.m.th.-në, shkollës si institucion edukimi civil, e mbështetur dhe e financuar nga kisha. Zogu mbylli disa shkolla dhe pushoi nga puna disa funksionarë të këtij komuniteti (Ljarja, 2012:39).

Më 7 Mars 1925, hyri në fuqi Kushtetuta e Republikës, e cila garantonte formalisht lirinë e besimit. Në janar 1926, Zogu bëri një takim me klerikët në Tiranë, duke i siguruar mes të tjerash se në të ardhmen mund të kishte në perspektivë një marrëveshje (Della Roca, 1994:137).

Nga fundi i dhjetorit të vitit 1927 apo në fillim të janarit të vitit 1928, një delegacion i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Shqiptare, i përbërë nga zotërinjtë Dhimitër Popa dhe një deputet i Shkodrës i quajtur Jak Toci, u nisën për në Romë për të filluar bisedimet rreth një marrëveshjeje mes Selisë së Shenjtë dhe Shtetit Shqiptar (Ljarja, 2012:41), por nuk pati rezultat sepse kishte të bënte me kërkesën e qeverisë shqiptare që asnjë i huaj të mos caktohej si ipeshkëv dhe arqipeshkëv në këtë vend dhe më e rëndësishmja, ishte refuzimi i Vatikanit për të plotësuar përfundimin e ndonjë marrëveshjeje, për sa kohë që në Kodin e ri Civil shqiptar, i cili do t'i paraqitej për aprovim parlamentit në pranverën e ardhshme, parashikohej martesë civile dhe prishja e saj nga gjykata shtetërore, divorci (Ljarja, 2012:41).

Objektivi i Mbretit Zog ishte që të tri bashkësitë fetare të vireshin nën kontrollin e tij të plotë. Për këtë arsye, u përshpejtuan përgatitjet për ligjin e bashkësive fetare që u miratua

më 16 Korrik 1929. Ligji “Mbi komunitetet fetare” siç e analizuam më sipër i dha goditje të plotë imunitetit të vjetër fetar. Një nga shkaqet e kësaj goditje ishte përjashtimi i klerikëve nga fondet fetare të kultit duke i detyruar kështu të mbështeten tek ndihma italiane (Ljarja, 2012:41). Katolikët, ndryshe nga myslimanët dhe ortodoksët, refuzuan t’i nënshtroheshin shtetit, sipas dekretit të 16 Korrikut 1929, për formimin e bashkësive fetare të njohura zyrtarisht. Ata hoqën dorë nga fitimi i personalitetit juridik, vazhduan lidhjet jo vetëm shpirtërore por dhe administrative dhe financiare me Selinë e Shenjtë dhe elementët klerikë katolikë jo shqiptarë vazhduan veprimtarinë në Shqipëri (Ljarja, 2012:41). Dekreti shtetëror ishte në kundërshtim me disa parime dogmatike, nga të cilat Kisha Romake nuk mund të hiqte dorë. Dekreti shtetëror përfytyronte, në fakt, një “Kishë patriotike”, siç do të quhej në disa vende komuniste pas Luftës së Dytë Botërore, një kishë e shkëputur nga Selia e Shenjtë⁴⁹ e formuar vetëm nga kleri autokton, e mbyllur për misionarët e huaj, e nënshtruar ndaj kontrollit qeveritar (Ljarja, 2012:42). Katolikët nuk i’u nënshtruan ligjit të korrikut të vitit 1929 duke krijuar kështu një atmosferë pasigurie juridike në marrëdhëniet mes shtetit dhe Kishës Katolike që vazhdoi deri më 1939 (Haxhija, 2012:43).

Në fillim të vitit 1930, çështja e nënshkrimit të marrëveshjes u paraqit me nismën e Kishës Katolike. Qeveria shqiptare nxori pretendimin se nënshkrimit të marrëveshjes t’i paraprinte vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Selinë e Shenjtë (Fischer, 2004:170). Për këtë arsye, Selia e Shenjtë vuri disa kushte paraprake, siç ishin përjashtimi i Kishës Katolike, zbatimi i dekretligjit për komunitetet fetare; mbrojtja e parimeve themelore të Kishës Katolike nga ana e shtetit, zhvendosjen e negociatave në Romë, modifikimin nga ana e shtetit shqiptar të fjalës “komb”, të përdorur në nenin 7 të

⁴⁹Një përpjekje, kjo, për ndarje nga Selia e Shenjtë që do të ndeshet përsëri pas vendosjes së qeverisë komuniste, por që është absolutisht e papranueshme nga pikëpamja e Kishës Universale Katolike Romake.

Statutit Themeltar të Monarkisë Shqiptare, zëvendësuan atë me termin “shtetas”⁵⁰. Në fillim të korrikut të vitit 1930, delegacioni qeveritar shqiptar u nis për në Romë dhe aty nga fundi i nëntorit u duk se negociatat do kishin marrë një fund të mbarë (Cimbolo, 2013:77). Zogu i frikësohej se nënshkrimi i marrëveshjes me komunitetin mund ta forconte atë, deri aty sa të krijonte një shtet brenda shtetit, prandaj i preu përfundimisht bisedimet. E pasigurt për të ardhmen, Kisha Katolike, në atë kohë, nuk kishte vullnet t’i përgjigjej nevojës së hartimit të një marrëveshjeje me shtetin (Cimbolo, 2013:77).

Shteti e quante Kishën Katolike si një organizatë jo të ligjshme, pa personalitet juridik dhe pa të drejtën që të ndihmohej ekonomikisht nga qeveria (Della Roca, 1994:141-144). Një konflikt i ashpër mes qeverisë dhe kishës u zhvillua për shkollat katolike, të cilat u mbyllën në vitin 1933, për tu rihapur më 9 Maj 1936 (Blart, 1999:60). Faktorët, që ndihmuan për këtë çështje, ishin marrëveshjet politike me italianët në vitin 1936, ku një nga pikat, që u rishikua, ishte çështja arsimore dhe dënimi i Zogut nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve, i cili më 6 Prill 1935 kritikoi politikën arsimore të Mbretërisë Shqiptare. Ndalimi i arsimit privat lidhej me praninë katolike në këtë fushë (Haxhija, 2012:44).

Kushtetuta e vitit 1928 apo Statuti Themeltar i Monarkisë Shqiptare, për sa i përket sistemit të edukimit privat, përcaktonte në nenin 207⁵¹, se ky sistem duhej të ishte konform me ligjin, parimet dhe kurrikulat e aprovuara prej shtetit për shkollat e veta dhe se këto shkolla i nënshtroheshin një kontrolli efektiv prej qeverisë në pikëpamje të kurrikulave teorike dhe praktike. Të huajt mund të autorizoheshin të themelonin shkolla teknike dhe bujqësore vetëm me kurrikula teorike dhe praktike. Në mënyrë të ngjashme, shkollat fetare mund të themeloheshin prej bashkësive fetare me lejen e ministrit kompetent dhe në përputhje me të drejtën, numri i shkollave fetare të çdo komuniteti dhe

⁵⁰Kushtetuta e vitit 1928, “Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare”, 1928 licodo /568/view

⁵¹Po aty, neni 207

numri i nxënësve duhej të përcaktohej prej ministrit kompetent pas konsultimeve me Këshillin e Ministrave (Ljarja, 2012:44).

Në vitin 1933, nenet 206 dhe 207 të Kushtetutës u modifikuan si më poshtë vijon “mësimdhënia dhe arsimimi i nënshtetasve shqiptarë ishte një çështje që i rezervohet shtetit, i cili ishte përgjegjës për dhënien e këtij mësimi dhe edukimin në shkollat e veta. Shkolla fillore ishte e detyrueshme për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe do të jepej falas. Shkollat private të të gjitha kategorive në këtë kohë duhet të mbylleshin”. Pas hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve të reja në nenet 206 dhe 207 të Kushtetutës, me dekretin e mbretit Zog, të datës 22 Prill 1933, shkollat private në Shqipëri u mbyllën (Ljarja, 2012:44).

Kisha Katolike protestonte ndaj pranimet të divorcit në legjislacionin civil të Mbretërisë shqiptare. Kjo gjë, në këndvështrimin e ipeshkëve binte ndesh me martesën katolike, e cila vazhdonte të ishte e rregulluar nga e Drejta Kishtare. Gjithashtu, ipeshkëvijtë protestonin edhe për shkeljen e artikullit të Deklaratës së Këshillit të Lartë të Lidhjes së Kombeve, që u lejonte të gjithë banorëve të Shqipërisë të ndërronin fenë (Haxhija, 2012:46). Protestohej, po ashtu, ndaj dekret-ligjit, të aprovuar nga mbreti i shqiptarëve më 9 Korrik 1929⁵², sipas të cilit Kisha Katolike në Shqipëri bëhej thjesht një organ i shtetit, duke ruajtur lidhjet dogmatike me Selinë e Shenjtë, ligj që shkatërronte organizimin e vërtetë dhe vetë ekzistencën e Kishës Katolike Romake në Shqipëri. Protestonin kundër veprimit të autoriteteve mbretërore shqiptare, mbylljes sipas një dekret-ligji, të shkollave private katolike pas një ekzistence 60-70 vjeçare, shkolla që kishin qenë gjithmonë vatër e vërtetë e kulturës, e qytetërimit dhe e patriotizmit shqiptar. Kështu, thyhej siguria e dhënë nga Statuti Themeltar mbi ushtrimin e lirë të të gjitha

⁵²Dekret-ligji nuk ishte aplikuar akoma për karolikët por që nga dita në ditë mund të zbatohej.

besimeve në Shqipëri. Statuti siguronte, gjithashtu, lirinë e arsimimit dhe në të njëjtën kohë të moralit dhe civilizimit të krishterë pra, është e qartë se ky ligj lidhej me shkollat private të krishtera, duke cenuar të drejtat e Kishës Katolike mbi edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të krishterë, gjë që parashikohej dhe mbrohej nga Statuti i Mbretërisë Shqiptare. Gjithashtu, ky ligj shtypte të drejtat e parashkruara që kishin shkollat katolike (Haxhija, 2012:47). Krijimi i një shkolle kombëtare shtetërore, e cila do të duhej të ishte një proces i pavarur, nuk mund të zhvillohej në kurriz të sistemit arsimor të traditës, apo duke i'u kundërvënë atij. Para së gjithash, ajo duhej të ecte mbi bazën e kësaj tradite dhe paralel saj. Shkolla shtetërore nuk mund të hynte në mjedisin apo në tregun shqiptar duke shkatërruar shkollat ekzistuese (Haxhija, 2012:48). Qeveria shqiptare i ka konsideruar gjithmonë katolikët si pjesë përbërëse e kombit shqiptar dhe atyre u jep të gjitha të drejtat që kushtetuta e vendit u'a garanton qytetarëve shqiptarë. Mund të themi se, në qoftëse përpjekjet për përshtatjen e legjislacionit civil të shtetit shqiptar me atë të vendeve perëndimore përbënin një masë më se normale në kushtet e procesit modernizues të një shteti ende me struktura ligjore otomane në veprim. Goditja kaq drastike e sistemit të kahershëm arsimor ishte një veprim që propaganda shtetërore nuk arriti asnjëherë ta justifikonte, as nga pikëpamja morale, as nga pikëpamja juridike (Haxhija, 2012:48).

Prania katolike në arsim, veçanërisht në veri të Shqipërisë është një faktor, gjithashtu, i rëndësishëm shoqëror. Ndalimi i arsimit privat, ishte i lidhur me elementin katolik në këtë fushë. Ndoshta, kjo ishte një arsye që me mbylljen e të gjitha shkollave të huaja private⁵³, qëllimi ishte për të kufizuar përhapjen e shkollave të financuara nga Italia. Kjo politikë e ndjekur tregoi qëndrimin e shtetit kundër lirisë fetare përmes keqpërdorimit të

⁵³Zogu duke u përpjekur për të qëndruar larg varësisë italiane, me një masë anti-italiane, që ishte e fokusuar, në mënyrë të veçantë, në popullsinë katolike të veriut.

proçesit të laicitetit, një qëndrim anti-evropiane dhe anti-katolike, i maskuar përmes veprimeve të disa individëve katolike të inkorporuar në doktrinat e tyre anti-klerikale⁵⁴.

Një politikë e tillë do të jetë një tregues i rëndësishëm, që do të paraqiste vështirësitë, me të cilat vendi do të përballej në shekullin e ardhshëm, në vendosjen e demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Për më tepër, ky ishte tregues që udhëheqja politike e vendit do të ishte e polarizuar më tej nga forcat e fuqishme konservative dhe jo të emancipuara, as të shkolluara dhe as të civilizuara të vendit⁵⁵.

Duke përfunduar, mund të themi se gjatë gjithë periudhës 1920-1939, politika e shtetit synoi në vendosjen e parimeve të rrepta kombëtare për veprimtarinë e institucioneve fetare, por edhe një kontroll të përgjithshëm të shtetit mbi bashkësitë fetare. Kjo politikë u përpunua me qëllim që të arrihej bashkëjtesa dhe mirëkuptimi i të tria bashkësive fetare në Shqipëri, si dhe për t'i shndërruar ato në përkrahëse të regjimit të Ahmet Zogut (Anastasi, 2003:34). Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe komuniteteve në këtë kohë nuk vendoseshin me marrëveshje të ratifikuara me ligj, por me statute, që pasi miratoheshin nga organizmat përfaqësuese të komuniteteve fetare, kalonin në Këshillin e Ministrave për tu verifikuar nëse ishin në përputhje me normën dhe ligjet në fuqi. Kështu, mund të themi se në periudhën e qeverisjes apo mbretërimit të Ahmet Zogut u bënë përpjekje të veçanta për të krijuar norma dhe rregullime ligjore për krijimin e një shteti laik, krijimin e komuniteteve fetare, sanksionimin e të drejtës së qytetarëve për zgjedhje të besimit fetar dhe mbi të gjitha për krijimin e komuniteteve dhe bashkësive fetare, me pavarësi të mirëfilltë jo vetëm ndaj shtetit, por edhe ndaj hierarkive të huaja me qëllime politike krahas atyre religjioze. Ahmet Zogu duket se vuri si qëllim dhe ndoqi këtë veprimtari me

⁵⁴Valentina Duka, Institucionet fetare gjatë mbretërimit të Zogut, [Zani i Naltë](#) revista shkencore dhe kulturore, janar 28, 2014

⁵⁵Po aty.

synim krijimin e një shteti oksidental, evropian dhe laik por, njëkohësisht, jo rrallëherë ai ishte i orientuar në ndërtimin e bashkësive dhe klasës së klerikëve të pavarur e të papolitizuar pasi shpesh opozita e pushtetit të tij e kishte luftuar edhe nëpërmjet figurave klerike dhe komuniteteve që jepnin mbështetje për ta. Zogu synoi të zvogëlonte efektin përçarës të fesë në vend, kështu ai ndoqi një politikë të kombëtarizimit të fesë, duke nxitur dhe mbështetur pavarësinë politike dhe administrative të feve të ndryshme në Shqipëri nga çdo ndikim i klerit të huaj dhe duke promovuar një politikë e cila ishte pro diversitetit fetar (Nano, 2014:216). Menjëherë Zogu filloi punën për të modifikuar kodin e mëparshëm edhe për çështjet penale, civile dhe tregtare, në bazë të modelit evropian.

Më 1 Janar 1928, hyri në fuqi Kodi i ri Penal, i bazuar pothuajse pa ndryshim në Kodin Penal Italian. Kodi Civil, që hyri në fuqi më 1 Prill 1929, ishte një ndër aktet ligjore fundamentale (Puto, 2009:471) e gjithashtu, një etapë e avancuar e legjislacionit. Dokumentacioni zyrtar i kohës, i përmbledhur në botimin: “Shqipnija më 1937”, e cilëson Kodin e ri Civil si “reformën më të madhe në legjislacion”. Përpara tij, si e drejta private, ashtu edhe shumë dispozita të tjera të së drejtës formale, ishin përmbledhur pa sistem në Kodin Civil osman të botuar më 1876. Si tipar karakteristik i përgjithshëm i Kodit të ri Civil ishte se ai kishte në themel Kodin Napoleonian me formulime të huajtura nga Kodi Civil Italian. Kodi i vjetër nuk trajtonte aspak të drejtën familjare. Çështja e martesës, trashëgimisë rregulloheshin sipas përkatësisë fetare. Kodi i ri kishte një përmbajtje më përparimtare, duke dhënë zgjidhje të reja të njehsuara për të gjithë shtetasit shqiptarë⁵⁶. Po ashtu, në Kodin e ri Civil, një seri artikujsh ishin në kundërshtim

⁵⁶Ato sollën si pasojë shpërndarjen e gjykatave fetare. Veçanërisht, rëndësi kishte përmirësimi i pozitës juridike të gruas, që ishte nën pushtetin e burrit. U ndalua poligamia. Në shkurorëzim gruaja, do të kishte të drejta të barabarta me burrin, ndërsa më parë mund të ushtrohej prej burrit dhe përjashtimisht mund t'i cedohej edhe gruas. Më parë, njihej vetëm martesa mbi bazë fetare, kurse Kodi i ri bënte të detyrueshme martesën civile dhe nuk i njihte asnjë efekt juridik asaj fetare. Hiqej ndalimi i martesës së një gruaje myslimane me një burrë të një feje tjetër. Bashkëjetesa ndalohej, partnerët trajtoheshin si bashkëshorte ilegale dhe u nënshtroheshin sanksioneve penale, më të rënda për burrin.

me parimet bazat të ligjit e të kanunit. Pas shpalljes së Kodit Civil, familja nuk do të jetë objekt i rregullimeve nga e drejta fetare, kishtare (Cimbalo, 2013:72-74). Zogu ishte i vendosur të mos bëjë lëshime, për shkak se kjo do të çonte në nënshtrimin e normave civile nga ato kishtare.

2.2. Komunitetet fetare dhe politika shtetërore në shtetin komunist.

Për rreth 45 vjet, e vetme ndër shtetet evropiane Partia Komuniste në Shqipëri ruajti pandërprerë një regjim të mbështetur në modelin sovjetik Stalinist (Pano, 2003:146). Rrënjësia e politikës së Hoxhës në të gjitha aspektet e jetës dhe ndikimi i tij tek pasardhësit ishin ato që ndihmuan për të siguruar se Shqipëria do të ishte vendi i fundit nga të gjitha shtetet partiake të Evropës Lindore që do të braktiste komunizmin (Pano, 2003:146). Qeveria komuniste gjatë kohës në pushtet pati një rekord tronditës kundër të drejtave të njeriut⁵⁷. Që nga fillimi i saj në 1944, kjo qeveri ka abuzuar vazhdimisht me të drejtat dhe liritë më elementare të qytetarëve shqiptarë duke shkelur hapur ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, për të cilat ajo ka rënë dakord që t'i përmbushë në mënyrë solemne⁵⁸.

2.2.1 Reforma agrare dhe reforma në arsim

Pas Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri u vendos regjimi komunist dhe Shqipëria i'u nënshtrua diktaturës komuniste,⁵⁹ të udhëhequr nga Enver Hoxha sipas modelit jugosllav

⁵⁷ Për të ndjekur këtë program dhe për të arritur qëllimin e saj, qeveria dhe partia komuniste shpikën metoda të ndryshme për t'iu privuar të drejtat fetare, një politikë e qëllimshme, procesi i nxitjes së urrejtjes ndaj fesë në mënyrë të qartë vërteton vendosmërinë e qeverisë shqiptare dhe partisë komuniste të eliminojë fenë dhe besimin duke synuar veçanërisht, kundër klerit katolik.

⁵⁸ Qeveritë e pasluftës e shpallën hapur platformën antiperëndimore. Shteti shqiptar vuri në përdorim të gjitha mjetet për të shkëputur çdo lidhje me Perëndimin dhe për të realizuar më lehtë shtypjen me dhunë të çdo rezistence të komunitetit katolik kundër ideologjisë komuniste.

⁵⁹ Enver Hoxha nis shkatërrimin e lirisë religjioze, një proces i cili me kalimin e kohës është intensifikuar.

dhe sovjetik. Në Kongresin e Beratit, të mbajtur nga 20 deri më 23 Tetor të vitit 1944 nga Këshilli Antifashist Nacional Çlirimtar, ky i fundit u shndërrua në një qeveri demokratike provizore. U miratua Deklarata e të Drejtave të Qytetarit, e cila garantonte lirinë e besimit dhe të ndërgjegjes, si dhe i'u njohën të njëjtat të drejta të gjitha feve (Hoxha, 2014:20). Qeveria shqiptare, e papërvojë e angazhuar në shumë fronte kishte

lënë hapësira vakumi në drejtimin dhe organizimin e vendit, përfshirë këtu edhe çështjet fetare (Hoxha, 2014:17). Pasi morën pushtetin,⁶⁰ komunistët vendosën të sulmonin të gjitha institucionet fetare (Gjuraj, 2013:98). Trendi i tyre ishte kontrollues ndaj tërësisë së veprimit të nënshtetasve të vet⁶¹. Politika e diktaturës Hoxha buron nga pikëpamjet e vetë Hoxhës rreth fesë. Ai ishte me dhunë anti-fetar dhe qëllimi i tij ishte për ta bërë Shqipërinë një shtet ateist (Pano, 2014:146). Për këtë arsye, periudha komuniste në Shqipëri ishte më e rëndë për institucionet fetare të vendit duke e krahasuar me vendet e tjera komuniste. Feja dhe komunizmi janë të papërputhshëm me njëri-tjetrin (Hoxha, 2014:12). Shteti mbajti kontroll të rreptë mbi klerin.

Marrëdhëniet e institucioneve të kultit me shtetin rregulloheshin njëjloj si edhe më parë nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë. Në vitet e para të regjimit komunist⁶² zbatimi i dispozitave statusore ishte çështje e brendshme e komuniteteve fetare. Kjo varësi institucionale në raportet me shtetin do të ruhej deri në fund të vitit 1949 (Hoxha, 2014:12). Edhe pse “Komiteti për çështjet e kultit”, i formuar në vitin 1929 dhe i mbijetuar deri në vitin 1944 u suprimua pas ardhjes së komunistëve në pushtet, tradita e

⁶⁰Votimet e 2 dhjetorit të vitit 1945 sanksionuan pushtetin e Partisë Komuniste, ku Shqipëria do të ishte për tridhjetë vjetët e ardhshme një Republikë Popullore.

⁶¹Nuredin Nazarko, “Feja e Shekullarizimi në Shqipëri pas 1944”, Zëri Naltë, 15 dhjetor, 2014

⁶²Komunizmin mund ta përcaktojmë si udhëheqësi, i cili cilësohet i pagabueshëm, udhëheqës i madh, të cilit i atribohen cilësitë më të mira dhe pozitive. Ai është i përjetshëm në qeverisje, i pazëvendësueshëm, i pandryshueshëm, absolut në sundimin e tij, pa kujdesin e të cilit çdo gjë shkatërrohet e humbet.

mëparshme, ku Ministria e Drejtësisë⁶³ ishte lidhja ndërmjet enteve fetare dhe shtetit mbeti e pandryshuar. Por, në ndryshim nga gjendja e mëparshme, tanimë, ky raport ishte i përqendruar dhe bëhej drejtpërdrejtë nga Ministri dhe jo nga ndonjë departament i ministrisë sikundër ndodhte përpara vitit 1944. Kjo gjendje do të vazhdonte deri në vitin 1949⁶⁴.

Pranë Ministrisë së Drejtësisë u themelua sërish: “Komiteti për çështjet fetare”, organ që kishte funksionuar në kohën e mbretit Zog. Detyra e tij ishte të mbante raportet mes shtetit dhe bashkësive fetare (Cimbolo, 2013:100). Komiteti kontrollonte projektet e statuteve të komuniteteve fetare dhe rregulloret e komuniteteve fetare, të cilat i paraqiteshin Këshillit të Ministrave për miratim⁶⁵. Kështu pra, krijimi i një organi *ad hoc* për të mbajtur marrëdhënie me bashkësitë fetare ishte një rregull konstant, që mori formë me ligjin e vitit 1928, i cili përdori “Komitetin për çështjet fetare”, që u propozua me të njëjtin emër nga legjislacioni pas vitit 1945 (Pano, 2014:146). Synohej që me të, të kryheshin negociatat me bashkësitë fetare për miratimin e legjislacionit të propozuar. Kjo zgjedhje tregon interesin e shtetit për shmangien e përplasjeve me komunitetet fetare duke kërkuar një konsensus të negociuar, së paku gjatë fazës së parë, kur qeveria komuniste ishte ende në fazën e konsolidimit (Pano, 2003:146).

Situata përmbysset kur qeveria vendos t’i rregullojë marrëdhëniet politike me kultet, duke u mbështetur në shembullin sovjetik, drejt refuzimit total të fesë (Cimbolo, 2013:100).

⁶³Ishte kjo ministri ajo që miratonte emërimin e hierarkëve të lartë fetarë, bënte edhe emërimet.

⁶⁴Duke nisur nga gjysma e dytë e vitit 1945 shohim një ndërhyrje gjithnjë e më të madhe të shtetit në çështjet e bashkësive fetare, jo nëpërmjet ndryshimeve të aparatit ligjor por, përmes ndërhyrjes jashtëligjore për të ndryshuar hierarkitë e larta klerikale dhe vendosjes në krye të tyre të mbështetësve komunistë.

⁶⁵Komiteti kontrollonte mesazhet baritore, qarkoret e përgjithshme dhe çdo lloj dokumenti tjetër publik, të nxjerrë nga Komunitetet fetare, propozonte mosqarkullimin e atyre që ishin në kundërshtim me ligjet e shtetit, kontrollonte buxhetin e komuniteteve, që i paraqiteshin për miratim Këshillit të Ministrave. Mbante një regjistër, ku shënohej përbërja e organeve qendrore të komuniteteve fetare, dhe mbaheshin shënimet enevojshme. Krijimi i këtij Komiteti dëshmonte vullnetin e Shtetit për të vënë nën kontroll aktivitetin e komuniteteve fetare.

Mjafton të kujtojmë ndërhyrjen sistematike të shërbimeve të fshehta të kohës së Zogut në punët e brendshme të bashkësive fetare për të kuptuar se praktikat e manipulimit kanë qenë pjesë e një tradite, e cila në kohën e sistemit stalinist, thjesht, u zhvillua dhe u theksua më tej. Nga ana e tyre, bashkësitë fetare kërkonin bashkëpunimin me shtetin (Dervishi, 2007:107)

Mund të themi se, goditja e shtetit ndaj fesë kishte nisur qysh në gjysmën e dytë të vitit 1945, pikërisht në gusht, nisin reformat e para agrare në Shqipëri⁶⁶. Ndër masat e para të marra të diktaturës komuniste kundër komuniteteve fetare në Shqipëri ka qenë realizimi i reformës agrare përmes konfiskimit të pasurisë së tyre (Cimbolo, 2013:99). Ligji Nr. 108, datë 29 Gusht 1945, “Mbi reformën agrare”, i shpallur nga kryesia e Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar, kapitulli i parë, neni 1 përcakton: *“Tokat që goditen nga ç’pronësimi dhe përjashtimet, dhe konkretisht në paragrafin 3 të tij thuhet 3) pronat bujqësore private dhe të enteve private dhe fetare me përjashtimet dhe përcaktimet e përshkruara në nenin 2 të kësaj ligje”*⁶⁷

Me shpalljen e këtij ligji shpronësohen detyrimisht pronarët dhe tokat u ndahen fshatarëve nënshtetas shqiptarë që s’kanë tokë të tyre ose që nuk u mjafton toka. Tokat i’u merren pronarëve të pasur dhe i’u jepen fshatarëve. Po ashtu, nacionalizohet prona e objekteve fetare. Sipas ligjit “Për reformën agrare” të gushtit të vitit 1945, tokat e punueshme të Shqipërisë u rishpërndahen për t’i dhënë fund pronësisë së madhe të tokës dhe për rritjen e prodhimit në fermë. Pronat e institucioneve fetare ishin në mesin e atyre që u shtetëzuan (Pano, 2003:153). Gjithashtu, sipas këtij ligji, shpronësoheshin familjet e mëdha latifondiste, bashkësitë fetare dhe çifligjet e shtetit, si dhe pronarët, të cilët kishin përfituar nga reforma e Zogut e vitit 1936 (Hoxha, 2014:37). Megjithatë, kjo reformë u

⁶⁶Shih ligjin nr. 108 datë 29gusht 1945 “Mbi Reformën Agrare”

⁶⁷Po aty, kapitulli 1, neni 1,2

zbatua në dy shkallë dhe goditja më e madhe ndaj institucioneve fetare do të vinte në fazën e dytë (Fishta, 1984:185).

Pasi fituan zgjedhjet⁶⁸ dhe u siguruan se tashmë mund të çonin më tej programin e tyre për të shoqërizuar pronën përmes copëtimit të mëtejshëm të pronës private, qeveria e re në 27 Maj të vitit 1946, nisi fazën e dytë të reformës agrare, sipas së cilës çdo kryefamiljari nuk i jepej më shumë se pesë hektarë tokë dhe kur familja kalonte gjashtë frymë për çdo kurorë shtesë jepeshin edhe dy hektarë. Nga vetë kushtet e këtij projektligji të ri, nuk mund të shpëtonin shumica e pronarëve të mesëm (Hoxha, 2014:38). Reforma preku rëndë pronat e institucioneve fetare.

Nga faza e parë e reformës agrare, enteve fetare nuk u lihej më shumë se 20 hektarë tokë (Grup autorësh, 2009:66-67). Në fazën e dytë, sipas së cilës nuk lejohej më shumë se 5 hektarë për kryefamiljar, u shpronësuan më tej edhe 480 prona fetare (Cimbolo, 2013:84). Pas kësaj faze, pronat tokësore të enteve fetare nuk mund të tejkalonin 5 hektarë sipërfaqe, me përjashtim të manastireve që mund të zotëronin deri në 20 hektarë, çka vlente edhe për administratën klerikale deri në rang nënprefekturë⁶⁹.

Konfiskimi i pasurive të enteve fetare ishte i mundshëm sepse duke qenë se komunitetet fetare ishin të veshura me personalitet juridik civil dhe meqenëse myslimanët i mbarështonin pasuritë e tyre nën formën e vakëfeve (Cimbolo, 2013:104), nuk gëzonin ndonjë mbrojtje të veçantë, por u nënshtroheshin rregullave të përgjithshme, të cilat rridhnin nga legjislacioni i zakonshëm për të gjitha pasuritë private të tokës⁷⁰.

⁶⁸Shumica dërmuese e popullsisë përbëhej nga pronarë të mesëm dhe përpara zgjedhjeve qeveria e Frontit nuk mund të rrezikonte të tërhiqte zemërimin e shumicës të popullsisë.

⁶⁹Kështu nga rreth 4225 ha toka që të gjitha entet fetare kishin përpara reformës agrare në përfundim të saj atyre u ishin shpronësuar 3163 hektarë tokë.

⁷⁰Qeveria, më 30 tetor 1945, u kërkoi enteve fetare informacione të detajuara rreth pasurive, si për shpërndarjen në zona të ndryshme, ashtu dhe për mënyrën e administrimit. Komitetet e fshatarëve të

Pas shumë kërkesave nga ana e komuniteteve fetare, më 10 Tetor 1946, ministri i Bujqësisë u kërkoi organeve drejtuese të komuniteteve fetare të paraqisnin regjistrat me të dhënat e pasurive të patundshme të vakëfeve. Duke qenë se gjatë luftës një pjesë e dokumentacionit, ashtu si shumë regjistra, ishin zhdukur apo shkatërruar, komunitetet fetare u detyruan të paraqisnin dokumente të mangëta (Cimbolo, 2013:104).

Goditje e veçantë ra mbi Kishën Katolike, zotëruese e pasurive të shumta. Për më tepër, Kisha Katolike vuajti krizën e strukturave të saj, të shkaktuar nga dëbimi i atyre që nuk kishin shtetësi shqiptare si dhe nga fajësimi i klerikëve dhe laikëve (PEPA, 1993), dënimi i tyre në burgje çnjerëzore, në mos dënimi me pushkatim, u shoqërua me konfiskimin e të mirave të tyre, si dhe të institucioneve kishtare ku bënë pjesë.

Për shpronësimin, merrej vendim nga një komision shtetëror, i cili vepronte “Në emër të popullit”, përbëhej nga funksionare të zonave, ku duhej kryer shpronësimi dhe drejtohej nga kryetari i seksionit të sigurisë së komunave.

Siç e përmendëm më lart, me lënien në fuqi të legjislacionit të miratuar në kohën e Zogut, për besimet fetare zbatohesh neni 4 i Dekret-ligjit “Mbi formimin e komuniteteve fetare” të datës 7 Maj 1929, si dhe neni 11 i Dekretit “Mbi formimin e komuniteteve fetare”, datë 9 Korrik 1929⁷¹. Të dy ligjet duheshin parë nën dritën e neneve 450 e 451 të Kodit Civil mbi entet morale e për më tepër komunitetet fetare konsideroheshin si personalitet juridik civil, që i nënshtrohej normave të përgjithshme të kodit për të mirat nën zotërimin e tyre (Cimbolo, 2013:105).

varfër, të ngarkuar për zbatimin e reformes agrare, nuk pritën të mbërrinte informacioni nga komunitetet, por zunë të pushtonin pasuritë e vakëfeve, çka bëri që komunitetet fetare t'i drejtoheshin qeverisë për t'i kërkuar që ky ligj të mos i prekte vakëfet.

⁷¹Shih neni 4 i Dekret-Ligjit mbi Formimin e Komuniteteve Fetare të datës 7 maj 1929 dhe neni 11 i dekretit “Mbi formimin e komuniteteve fetare”, datë 9 korrik 1929

Mbi pasurinë e komuniteteve fetare pati ndikimin e vet edhe reforma tatimore. Vënia në fuqi të taksës mbi përfitimet nga lufta, taksë kjo, që do të godiste pronarët e ndërtesave, tokave, dyqaneve si dhe të çdo aktiviteti ekonomik, pavarësisht nëse pronarët ishin apo jo klerikë. Me Ligjin Nr.37, datë 13.1.1945, “Ligji i tatimit të jashtëzakonshëm për fitimet e luftës”⁷², taksat vendoseshin shumë të larta dhe institucionet fetare patën kundërshtime. Gjithashtu, u synua shkëputja e arsimit nga feja, në mënyrë që t’i jepej një tjetër goditje komunitetit fetar. Qëllimi i reformës arsimore të vitit 1946 ishte të mbante rininë mes të tjerash, në harmoni të plotë me shkencën dhe t’i largonte fëmijët nga besëtytnitë dhe fanatizmi fetar. Arsimi, në këtë kohë, kishte kryesisht si qëllim të përhapte shkencën dhe të krijonte kushtet për industrializimin dhe modernizimin e vendit (Tartari, 2008:47). Goditja ndaj shkollave të klerit nisi në 6 Mars të vitit 1946, kur ende nuk ishte miratuar Kushtetuta e re dhe binte në kundërshtim me të.

Interpretimet e neneve të Kushtetutës të vitit 1946 ishin arbitrare. Neni 28 i saj i lejonte shkollat fetare të funksionin, veprimtaria e të cilave duhej të ishte nën kontrollin e shtetit.⁷³ Por, sikurse ndodhte në këto raste, kush e bënte ligjin gëzonte edhe të drejtën për ta shkelur atë (Hoxha, 2014:44). Po në këtë nen shpallej edhe ndarja e shkollës nga kisha. Kjo nuk nënkuptonte asgjësimin e shkollave fetare por, vetëm eliminimin e lëndës së fesë nga programet e shkollave shtetërore. Por, sidoqoftë mund të kuptohej edhe ndryshe që arsimi fetar ndalohej. I tillë ishte edhe neni në fjalë⁷⁴ që fliste për arsimin, ku ndërsa nuk thuhej shprehimisht se ndalohej arsimi privat, nga ana tjetër thuhej se shkollat private mund të hapeshin vetëm me ligj. Në fund të vitit 1946 ishin mbyllur të gjitha shkollat fetare për fëmijët (Hoxha, 2014:45-46).

⁷²Ligji nr.37, datë 13.1.1945 “Ligji i tatimit të jashtëzakonshëm për fitimet e luftës”,

⁷³ Shih Kushtetutën e 1946, neni 28

⁷⁴ Po aty

Politika antifetare e Enver Hoxhës konfirmoi në një farë mase raportet e mira ndërmjet komuniteteve fetare shqiptare. Komunitetet fetare, të vëna nën presionin e shtetit ateist, i dhanë jetë formave të reja të solidaritetit të fshehtë. Besimtarët përpiqeshin të ndihmonin njëri-tjetrin në një kontekst të vështirë (Della Roca, 2003:27).

Si përfundim, goditja ndaj komuniteteve fetare në vitet 1946–1947 u shtri në tri drejtime⁷⁵: në fushën e pronave, të arsimit dhe ndaj elementëve të caktuar klerikë. Reforma agrare i varfëroi bashkësitë fetare por, kjo nuk do të thotë se shteti i la pa subvencione (Hoxha, 2014:45). Edhe para reformës, varësia nga financimet e qeverisë ishte aq e madhe, saqë pa to entet fetare nuk mund të mbijetonin. Për sa i takon reformës arsimore, ajo që goditi më shumë strukturat fetare ishte heqja e të drejtës për të dhënë mësim në shkollat fillore, si edhe ndalimi për të hapur shkolla fillore fetare. Për sa i takon arsimit të klerit, seminarët nuk u mbyllën nga komunistët, por ata nga ana tjetër nuk e lejuan entin të ngrinte seminare të reja (Gjuraj, 2013:98). Në këtë mënyrë, në fushën e arsimit reforma në fjalë krijoi mundësinë për të shkëputur komunitetin e besimtarëve nga praktikat fetare e sidomos rininë⁷⁶.

Po ashtu, të tjera masa të marra nga komunistët për të dobësuar veprimtarinë e klerit ishin mbyllja e gjithë periodikëve, revista dhe publikimeve të tjera, si dhe shkollat, të cilat ishin drejtuar nga kleri vetë. Kjo u pasua nga represioni i paparë ndaj klerikëve me dënim të rëndë, duke përfshirë tortura dhe ekzekutime (Fischer, 2003:16). Klerikët u dënuan kryesisht duke manipuluar gjyqe⁷⁷ ose pa pjesëmarrjen e tyre. Me kalimin e

⁷⁵ Mbyllja e shkollave fetare si dhe ndalimi i shtypjes së librave fetarë dhe periodikëve bashkë me përjashtimin nga mjetet e komunikimit, të kontrolluara këto prej shtetit, i izoluan edhe më tej entet fetare nga shoqëria.

⁷⁶ Pengesat për të hapur shkolla klerikale nuk ishin pasojë e reformës arsimore, por e vullnetit të atyre që drejtonin shtetin. Këtu, dëmi, që shkaktuan komunistët, nuk ishte mbyllja e shkollave, pasi ato nuk ekzistonin por, ishte, mbi të gjitha, moslejimi i rihapjes së tyre.

⁷⁷ Mbyllja e periodikëve, arrestimi dhe dënimi i shumë klerikëve të shquar, të cilët gëzonin një reputacion të madh në mesin e njerëzve shkatoi zemërim e revoltë në masat e popullit

kohës, humbja e pavarësisë ekonomike shtyn bashkësitë fetare në falimentim ekonomik, si një nga mjetet më efektive për shkatërrimin e tyre dhe për të përmbushur strategjinë afat-gjatë, që synon eliminimin e fesë në Shqipëri (Cimbolo, 2013:108).

Përveç kolapsit ekonomik, sidomos Kisha Katolike tashmë po vuan një krizë objektive të saj, si pasojë e dëbimit nga vendi i klerit me nënshtetësi të huaj dhe dënimin e të tjerëve me burg dhe në shumë raste dënime me vdekje⁷⁸. Një fushë tjetër e konfrontimit mes shtetit dhe Kishës Katolike ishte ai i arsimit përmes reformave në arsim, që kanë pasur dy linja kryesore: laicizmin e arsimit dhe ndarjen e shkollës nga feja⁷⁹.

2.2.2 Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë e vitit 1946, si dhe Dekret-ligji Nr.743, “Mbi Komunitet fetare” i vitit 1949

Menjëherë me zgjedhjen e presidiumit të Asamblesë u nisën diskutimet për Kushtetutën, e cila do të miratohej më 14 Mars të vitit 1946. Kështu, Kushtetuta e parë e regjimit komunist në Shqipëri është Kushtetuta e vitit 1946, e cila sanksionoi regjimin monist dhe u miratua nga Asambleja Kushtetuese, duke u kthyer në Kuvend Popullor pas miratimit të Kushtetutës. Organi, i dalë nga zgjedhjet e reja, shkoi më tej drejt legjitimitimit të institucionit, që do të zbatonte këtë program (Pano, 2003:150).

Më 16 mars, Asambleja mori vendimin të shndërrohej në Kuvend Popullor. Gjithashtu, pas miratimit të Kushtetutës, Kuvendi Popullor më 18 mars, ngarkoi Enver Hoxhën të

⁷⁸ Paralelisht me reformën agrare dhe atë arsimore të regjimit u goditën fortë edhe elementët që e kundërshtuan atë. Sulmi u përqëndrua ndaj atyre klerikëve që kishin dalë hapur kundër sistemit të ri.

⁷⁹ Këto masa çonin në ndalimin e mësimdhënies dhe përgatitjes të klerit të ardhshëm dhe madje, u bë edhe mbyllja e shtypit fetar.

krijonte qeverinë e re, e cila më 22 mars do të bënte betimin⁸⁰. Marrëdhëniet midis pushtetit politik dhe enteve fetare vazhduan të rregulloheshin edhe për disa vjet, në përputhje me ligjin fetar të vitit 1929 të Zogut (Hoxha, 2014:14). Kjo vazhdimësi shfaqet në faktin se marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare rregulloheshin njëjloj si edhe më parë, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë. Kjo varësi institucionale në raportet me shtetin do të ruhej deri në fund të vitit 1949.

Në nenin 1 të Kushtetutës,⁸¹ Shqipëria shpallet Republikë Popullore,⁸² ku i gjithë pushteti buron nga populli dhe i takon popullit⁸³. Pushteti politik i takon klasës punëtore në aleancë me fshatarësinë punëtore sipas neneve 2 dhe 4.

Një kapitull i veçantë sanksionon të drejtat dhe detyrat e shtetasve. Ato u hartuan mbi bazën e Deklaratës mbi të Drejtat e Qytetarëve, pranuar në mbledhjen e Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtare, në tetor 1944 (Anastasi, 2012:52). Kushtetuta e vitit 1946 njihte një serë të drejtash dhe lirish themelore të shtetasve, të cilat mbetën thjesht formale (Hoxhaj, 2013:51). Kështu, në nenin 9⁸⁴ ndërsa shpallej se prona dhe nisma private mbroheshin, këtyre u vihehin kufij të rëndësishëm, si në përmasa ashtu edhe në sektorët ku ajo mund të shtrihej. Po ashtu, në nenin 6 përcaktohej se jeta ekonomike e vendit drejtohej nga shteti në bazë të një plani të përgjithshëm ekonomik, kurse në nenet 7 dhe 8 theksohej përkrahja e veçantë, që vetë shteti i bënte sektorit shtetëror të ekonomisë. Ndërsa të drejtat dhe liritë e njeriut si: e drejta e fjalës, e shtypit, e organizimit, paprekshmëria e personit, fshehtësia e korrespondencës, në përputhje me

⁸⁰Hapat e komunistëve për të kapur institucionalisht pushtetin, tashmë po përktheheshin në transformim të institucioneve drejt krijimit të aparatit shtetëror sipas modelit sovjetik. Menjëherë më pas, qeveria e re nisi nga puna për konsolidimin e pushtetit të vet, si dhe të Partisë Komuniste, përfaqësuese e të cilës ajo ishte.

⁸¹Kushtetuta e Republikës Popullore 1946, neni 1.

⁸²Karakteristike është uniteti i pushtetit, i përfaqësuar nga Kuvendi popullor dhe Këshillat popullorë që ushtronin pushtet legjislativ dhe ekzekutiv.

⁸³ <http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2012/10/STATUTI-I-ASAMBLESE-KUSHTETONJE> êSE-1946 .pdf

⁸⁴Shih nenet 6,7, Kushtetuta 1946

nenet 18–22 mbroheshin dhe garantoheshin me ligj⁸⁵. Në Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë të vitit 1946, ishte sanksionuar liria e ndërgjegjes dhe e besimit si dhe liria e ushtrimit dhe e praktikimit të tyre, e garantuar nga asnjë detyrë dhe laiciteti i shtetit. Paragrafi i katërt i nenit 18 ndalonte që kisha dhe feja të shpërdoreshin për qëllime politike, shërbeu si bazë për persekutimin e dhjetëra klerikëve, të cilët u akuzuan për pjesëmarrje politike, me qëllim rrëzimin e regjimit (Anastasi, 2003:34). Për sa i përket çështjeve fetare, në nenin 13 nënvizohej barazia e shtetasve pa dallim feje, race apo kombësie dhe deklaroheshin ndëshkimi i çdo lloji diskriminimi me bazë fetare, racore, kombëtare⁸⁶. Në nenin 16 të Kushtetutës shpallej ndarja e shtetit nga kisha⁸⁷. Ndalohej angazhim i klerikëve në politikë si dhe përdorimi i fesë për qëllime politike. Liria e besimit dhe ushtrimi i detyrave nga bashkësitë fetare mbrohej me ligj. Shteti mund të ndihmojë materialisht komunitetet fetare. Në këtë mënyrë, Kushtetuta e linte të hapur si mundësinë e ndihmës, ashtu edhe mosdhënien e saj, pa përcaktuar asnjë kriter për komunitetet fetare (Hoxha, 2014:17). Kështu pra, Kushtetuta theksonte laicitetin e shtetit dhe të sistemit arsimor, garantonte pronën dhe ndërmarrjen e lirë private, ndonëse u vendos që prona private mund të kufizohej dhe të tjetërsohej kur ta kërkonte interesi i përgjithshëm, gjithnjë në bazë të ligjit⁸⁸.

Një kapitull i tërë i Kushtetutës, i trembëdhjeti, trajtonte të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, të cilëve u garantohej liria dhe barazia fetare dhe sanksiononte ndarjen e

⁸⁵Njihej liria e fesë, liria e fjalës, e shtypit, e organizimit, e demonstrimeve publike, e drejta e hapjes së shkollave private, mbrohej privatësia etj., por kjo kushtetutë i jepte mundësi pushtetit shtetëror t'i shkelte këto të drejta dhe liri themelore.

⁸⁶ Shih neni 13 Kushtetuta 1946

⁸⁷ Po aty, neni 16

⁸⁸Neni 11 i Kushtetutës së vitit 1946 thotë: “Garantohen pronësia private dhe iniciativa private në ekonomi. Garantohet e drejta e trashëgimit të pasurisë private. Asnjëri nuk mund të përdorë të drejtën e pronësisë private në dëm të kolektivitetit. Pronësia private mund të kufizohet e të shpronësohet kur e lyp interesi i përgjithshëm dhe në bazë të njëligje. Me ligje do të caktohet në ç'rast dhe sa do të shpërblehet pronari. Po me ato kushte munt të shtetëzohen disa degë t'ekonomisë ose sipërmarrje, kur e do interesi i përgjithshëm. Ndalohej monopole, trustet, kartelet etj., të krijuara me qëllim që të diktojnë çmimet e të monopolizojnë tregjet në dëm të ekonomisë nacionale”. Kushtetuta e Republikës Popullore e Shqipërisë;

<http://licodu.cois.it/574/view>

shtetit nga feja, megjithëse shteti mund t'i mbështeste ekonomikisht besimet fetare. Në nenin 7 të Kushtetutës thuhej se organet shtetërore kompetente ndalonin formimin e partive politike, që kishin për qëllim ndërrimin apo përmbysjen e regjimit kushtetues të Republikës Popullore të Shqipërisë, që kishin karakter antidemokratik, që organizoheshin mbi bazën e fesë, duke mbjellë urrejtje mes kombësive të ndryshme, racave dhe besimeve fetare. Ndalohej formimi i aktiviteteve të një partie politike kur themeluesit apo anëtarët e kryesisë së saj nxisnin ndjenjat dhe veprimet e sipër përmendura (Cimbolo, 2013:91).

Kushtetuta e 1946 pësoi ndryshime nëpërmjet procesit rishikues, që ndodhi në vitin 1950, ndryshime këto, që kanë të bëjnë me deklarin e Partisë Komuniste si determinuese në të gjithë jetën e vendit. U morën masa për kolektivizimin masiv dhe vendosjen e sistemit socialist edhe në bujqësi, besimi fetar u vendos nën kontroll, gjë e cila do të çonte më pas në ndalimin e plotë të kësaj të drejte themelore, duke kufizuar apo eliminuar edhe atë frymë të paktë demokratike që mbarte Kushtetuta e 1946⁸⁹.

Nga pikëpamja institucionale, ndonëse Komiteti për Çështjet e Kultit, i formuar në vitin 1929, u suprimua pas ardhjes së komunistëve në pushtet, Ministria e Drejtësisë vazhdoi të ishte nyja lidhëse ndërmjet bashkësive të kultit dhe shtetit. Megjithatë, daljen e Kushtetutës dhe ruajtjes së ligjit “Për komunitetet fetare”, u goditën komunitetet dhe u vunë në jetë politika antifetare. I mësipërmi ka qenë, pikërisht, njëri nga mekanizmat kryesorë, përmes të cilave regjimi stalinist shqiptar vetëquhej demokraci popullore – zbatonte nenin e parë të Kushtetutës, ku pohohej se *“i gjithë pushteti buron nga populli dhe i takon popullit.”* (Hoxha, 2014:19). Komunistët nuk kishin fe, ata ishin ateistë.

Ligji për partitë politike (neni 7) ndalonte themelimin e atyre me sfond fetar⁹⁰, ndërsa komuniteteve fetare u kërkohet nga qeveria të rivendosnin hierarkinë klerikale, së cilës i garantohej liri e plotë për të kryer veprimtarinë e saj sipas ligjit dhe statuteve të miratuara në periudhën e Mbretit Zog⁹¹. Gjatë kësaj kohe, qeveria vuri nën varësinë e plotë të shtetit socialist, komunitetet fetare, të cilat u ndoqën dhe u persekutuan deri në asgjësimin e plotë të tyre (Cimbolo, 2013:91).

2.2.3 Dekret-ligji Nr. 743, datë 26 Nëntor 1949, "Mbi Komunitet fetare"

Më 26 Nëntor 1949, qeveria komuniste shpalli Dekretin Nr.743, me titull "Mbi komunitetet fetare". Më 26 Dhjetor 1949, u miratua Dekret-ligji për "Mbi komunitetet fetare" në Shqipëri, i cili hapet me disa pohime në dukje pozitive: kërkohet të ketë garanci kushtetuese për lirinë fetare dhe parashikon sanksione kundrejt gjithë atyre që cenojnë ushtrimin e lirë të fesë apo nxisin urrejtjen fetare (Cimbolo, 2013:116). Ky dekret vulosi se garancia kushtetuese e lirisë së besimit ndalonte aktivitetet fetare të adhurimit në xhami dhe kisha dhe i kufizonte ato vetëm në mbajtjen e shërbimeve fetare (Tartari, 2008:47). Në Dekret-ligjin "Mbi komunitetet fetare" shprehet vija e drejtë e pushtetit popullor ndaj komuniteteve fetare dhe sekteve fetare, prandaj pritet respektimi rigoroz i tyre, me kusht që njohja e këtyre enteve mund të arrihej vetëm me aprovimin e statuteve të tyre nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me propozim të qeverisë, në të kundërt humbnin statusin e tyre juridik e për rrjedhojë edhe ekzistencën e tyre si komunitete apo sekte fetare. Kështu, kërkohet detyrimisht nënshtrimi i institucioneve të

⁹⁰Ligji "Mbi formimin e partive politike", Gazeta Zyrtare, nr. 115, 23 dhjetor, 1946

⁹¹Miratimi i ligjit shënon fundin e fazës së parë të marrëdhënieve të vendosura gjatë procesit të themelimit të unitetit kombëtar, pas së cilës hapet një fazë e re marrëveshjeje mes autoriteteve politike dhe komuniteteve fetare, që zgjati deri në vitin 1976.

kultit ndaj ligjeve të shtetit dhe slogani, që e ndiqte ishte “sovrانيتet të plotë të shtetit tonë” (Hoxha, 2014:94).

Në nenin 1 të tij thuhet: *Në konformitet me nenin 16 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë të gjithë shtetasve u garantohet liria e ndërgjegjes dhe e besimit*⁹². Sipas këtij dekreti, besimi dhe feja janë të ndara nga shteti, çka do të thotë se kemi të bëjmë me një shtet laik. Respekti për të drejtat civile të njeriut dhe për të gjitha detyrimet e parashikuara nga ligji, kërkohet një lloj për të gjithë qytetarët, qofshin këta besimtarë apo jo (Cimbolo, 2013:117). Personeli fetar mund ta ushtrojë punën e vet vetëm me miratimin e qeverisë dhe (sipas nenit 13), duhet të ketë reputacion të mirë, të dëshmojë besnikëri dhe ndershmëri kundrejt popullit, shtetit dhe të gëzojë të gjitha të drejtat civile. Për këtë arsye, komunitetet fetare duhet të hartojnë listat e plota të personelit fetar dhe administrativ dhe t’ja dorëzojnë qeverisë për miratim (Cimbolo, 2013:117). Komunitetet fetare ushtrojnë veprimtari, që nuk vihen në kundërshtim me ligjet e shtetit, me rendin publik dhe zakonet e mira. Ky dekret kufizoi të drejtat e besimtarëve për të ndjekur praktikën fetare dhe të praktikojnë bindjet e tyre fetare, me kusht që këto rregulla dhe besimet fetare nuk duhet të jetë në kundërshtim me ligjet e shtetit, rendin, dhe moralin e mirë⁹³.

Nuk lejohet marrja e personelit me shtetësi të huaj për kryerjen e funksioneve fetare, masë kjo që godet veçanërisht Kishën Katolike, e cila pas persekutimeve të vazhdueshme dhe dëbimeve të mëparshme, ka mungesë të ndjeshme të klerit vendas për përmbushjen e detyrimeve fetare kundrejt besimtarëve dhe për kryerjen e aktiviteteve të institucioneve

⁹²www.LiCoDu.com,Albaniahttp://licodo.cois.it/?p=206

⁹³ Po aty,

të mbijetuara (Cimbolo, 2013:117). Neni 16 i dekretit i lejon qeverisë kontroll ekonomik mbi komunitetet fetare nëpërmjet miratimit të preventivit të bilancit të tyre⁹⁴.

Marrëdhëniet e shtetit me komunitetet fetare do të vendoseshin mbi bazën e disa parimeve, siç ishin ndarja e komuniteteve fetare nga shteti dhe nga qendrat fetare të huaja, ndarja e shkollës nga feja dhe laiciteti i saj, shpallja e fesë si çështje private e shtetasve (Hako, 1972:20).

Neni 7 i këtij dekreti thotë se: për të ushtruar aktivitetin e tyre “komunitetet fetare duhet të njihen nga Shteti, kjo do të thotë se statuti i tyre duhet të miratohet nga Presidiumi i Kuvendit Popullor mbi propozim të Qeverisë”⁹⁵. Në aspektin financiar, veprimtaria financiare e komuniteteve fetare kontrollohet nga organet financiare të shtetit, po në atë mënyrë që kontrollohen të gjitha organizatat shoqërore të vendit. Kështu edhe një herë, parimi kushtetues i ndarjes së shtetit me fenë doli të ishte fiktiv (Tartari, 2008:47).

Lidhjet mes komuniteteve fetare dhe qeverisë bëhen me anë të kryesisë së komunitetit dhe Këshillit Ministerial. Rol i rëndësishëm në veprimtarinë e komuniteteve është të zhvillojnë te besimtarët ndjenjën e besnikërisë ndaj pushtetit të popullit dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë si dhe të përforcojnë bashkimin kombëtar.⁹⁶

Për përgatitjen e funksionarëve fetare komunitetet fetare nuk mund të hapin ose të mbajnë shkolla të arsimit të përgjithshëm por me autorizimin e Këshillit Ministerial. Dërgimi i të rinjve për studime në shkollat fetare jashtë shtetit lejohet vetëm me autorizimin e Këshillit Ministerial (Cimbolo, 2013:118). Ligjet e reja gjithashtu,

⁹⁴E gjithë veprimtaria e komuniteteve fetare duhet të synojë “zhvillimin e ndjenjës së besnikërisë ndaj pushtetit popullor dhe Republikës” neni 12, ndërsa aktivitetet e tyre të bamirësisë, edukimit dhe arsimit i merr përsipër vetë shteti.

⁹⁵www.LiCoDu.com,Albania

⁹⁶Të gjithë personat në shërbim të komuniteteve fetare duhet të jenë shtetas shqiptarë besnikë të popullit dhe të shtetit. Këshilli i Ministrave ka kontroll të plotë të lidhjeve që mund të kenë komunitetet me jashtë.

urdhëruan më tej situatat që kishin të bënin me edukimin e të rinjve, i cili do të kryhej vetëm nga shteti. Hapja e shkollave të reja fetare varet nga autorizimi i qeverisë dhe paraprakisht, kërkohet hartimi i rregullores për mënyrën e organizimit të saj dhe programet e institucioneve shkollore, në mënyrë që të fitojnë lejen për të vepruar.

Neni 24 i ligjit, u ndalon komuniteteve fetare hapjen e spitaleve, jetimoreve apo institucioneve të tjera ndihmëse, ndërkohë që, pas hyrjes në fuqi të dekret ligjit, do të shtetëzohen pa kompensim institucione të tilla ekzistuese dhe pasuritë e tyre të tundshme dhe të patundshme do të kalojnë nën administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë. Gjithashtu, u ndalohej e drejta për të poseduar pasuri të paluajtshme (Sinishta, 1983:6). Neni 29, *“Pasurija e komuniteteve fetare të çdukura ose t’atyre që ju hiqet njohja i kalon Shtetit. Edhe qendrat e komuniteteve fetare caktohen me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor”*⁹⁷ Aktiviteti i shoqatave dhe organizatave fetare duhet të zhvillohet në baza kombëtare duke i’u shërbyer interesave të popullit dhe të shtetit dhe funksionarët e tyre duhet të jenë besnik të popullit dhe të shtetit. Korrespondenca, qarkoret dhe e gjithë literatura fetare vihen nën kontrollin e shtetit, i cili mund të pezullojë botimin dhe shpërndarjen e tyre, në rast se bien ndesh me rendin publik dhe zakonet e mira (Cimbolo, 2014:187). Komunitetet fetare mund të kenë lidhje me komunitete fetare, institute, organizata dhe persona zyrtare që kanë qendrën ose banimin jashtë shtetit, vetëm me autorizimin e mëparshëm të Këshillit Ministerial dhe me anë të Ministrisë së Jashtme.

Përdorimi i fesë për propagandë kundra pushtetit popullor dënohet. Gjithashtu, ndalohet përdorimi i Kishës dhe i fesë për qëllime politike, si edhe formimi i organizatave politike me baza fetare. Liria e ndërgjegjes dhe e besimit, sipas këtij dekreti, nuk mund të

⁹⁷Dekret ligji nr. 743 datë 26 nëntor1949, “Mbi Komunitet fetare”, Neni 2

kufizohet si dhe nuk mund të privilegjohet askush për shkak se i përket një feje të caktuar, ndalohet urrejtja fetare⁹⁸.

Sipas nenit 35⁹⁹ komunitetet fetare detyrohen që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj dekret-ligje, t'i paraqesin Këshillit Ministerial për aprovim Statutet e tyre të rregulluara në konformitet me dispozitat e kësaj Dekret-ligje¹⁰⁰. Në qoftë se statutet e paraqitura përmbajnë dispozita në kundërshtim me ligjet e shtetit, rendin publik dhe zakonet e mira, Presidiumi i Kuvendit Popullor mund të kërkojë heqjen e tyre. Presidiumi i Kuvendit Popullor mund ta refuzojë aprovimin e statutit¹⁰¹ në qoftë se komuniteti nuk plotëson atë çka parashikon dekretligji.

Dekreti parashikon ta thjeshtojë përbërjen e organizatave fetare, prandaj në nenin 8, pasi thekson organizimin e pavarur të Komunitetit Bektashian, kërkon me detyrim bashkimin e vëllazërive të ndryshme myslimane në një prej dy komuniteteve islame (Cimbolo, 2013:116). Sipas statutit të ri, zgjedhja e drejtuesve të komunitetit fetar, të rregullores së tij, buxhetit, botimeve, të vulave dhe shenjave të tjera simbolike duhet të kenë miratimin e Këshillit të Ministrave, ose duhet të vlerësohen më para nga zyrtarët lokalë të partisë. Kështu, forcohet kontrolli i shtetit mbi veprimtarinë dhe synimet e institucioneve fetare, të cilët, ndërkohë, duhet të rrisin besnikërinë ndaj popullit dhe Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të përpiqen të ruajnë unitetin kombëtar (Sadikaj, 1972:480).

⁹⁸Keqpërdorimi i fesë për propagandim kundër pushtetit popullor ishte vepër penale. Neni 31 dhe 32, 33, 34 parashikojnë sanksione si çdo provokim për urrejtje fetare që bëhet me anë të fjalës, shtypit ose me mënyra të tjera, duke dënuar me privim të lirisë, jo më pak se një vit dhe më gjerë në 10.000 lekë. Dënohet, gjithashtu, edhe ai që me dhunë apo me kanosje ndalon shtetasit ose komunitetet fetare të njohura të ushtrojnë lirisht besimin e tyre dhe të kryejnë aktivitetin fetar që nuk shkel ligjet e shtetit, rendin publik dhe zakonet e mira.

⁹⁹ Dekret ligji nr. 743, datë 26 nëntor 1949, "Mbi Komunitet fetare", neni 35

¹⁰⁰ www.LiCoDu.com,Albania

¹⁰¹ Po aty

Duke e krahasuar këtë dekret me atë të kohës së Zogut, mund të thuhet se ai mbart ndryshime rrënjësore në statusin juridik të komuniteteve fetare, pasi u kufizon ndjeshëm lirinë e veprimit dhe ndërhyr në punët e tyre të brendshme. Gjithashtu, siç e theksuam ndaloreshin marrëdhëniet e klerit shqiptar me klerin e huaj jashtë vendit. Por, dispozita më e rëndësishme e këtij ligji parashikon, që çdo komunitet fetar duhet të rishikojë statutin e vet, në përputhje me 37 nenet e dekretit, si dhe në përputhje me Kushtetutën, e më pas t’ja paraqesë atë për miratim brenda 90 ditëve, Këshillit të Ministrave (Hulusi, 1972:20). Meqenëse, asnjë nga bashkësitë fetare nuk mund të kryenin një gjë të tillë brenda kësaj kohe krejtësisht të shkurtër për një kthesë kaq radikale, statutet e secilit komunitet u diktuan prej Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe u shpallën në emër të tyre (Pearson, 2006:331).

Ligji është projektuar për të ngritur përsëri marrëdhëniet ndërmjet bashkësive fetare dhe shtetit. Statutet zyrtare të sekteve të tjera fetare janë përpunuar dhe miratuar nga qeveria (Pano, 2003:150). Qëllimi i sistemit ishte eliminimi në mënyrë graduale i ideologjisë fetare. Kështu, për të sanksionuar shtetin laik synohej ndarja e komuniteteve fetare nga shteti dhe nga qendrat fetare të huaja, ndarja e shkollës nga feja dhe laiciteti i saj, shpallja e fesë si “çështje private” e shtetasve (Hulusi, 1972:20). Nga ligji kërkohej besnikëria e plotë e klerit ndaj shtetit dhe udhëheqësve të tij, në të kundërt ligji i jepte gjithë fuqinë shtetit të merrte masa si ndaj klerikëve të veçantë ashtu edhe ndaj enteve fetare. Besnikëria ndaj shtetit dhe udhëheqjes komuniste ishte filozofia kryesore e ligjit (Hoxha, 2004:92). Dhe në këtë pikë, ai barazohej me ligjin e 9 Korrikut të vitit 1929 ku enteve fetare u kërkohej varësia ndaj pushtetit politik¹⁰². Megjithatë, ky ligj shkonte edhe më tej (Hoxha, 2004:92). Edhe pse e shprehur në mënyrë të kamufluar tashmë shteti fitonte të drejtën të nxirrte jashtë ligjit ente të tëra fetare.

¹⁰²“Dekret–ligjë mbi komunitetet fetar”, neni 3.

Po ashtu, në ligjin e ri, ndryshe nga ligji i mëparshëm parashikohej edhe dhënia e subvencioneve për bashkësitë fetare, vetëm se një gjë e tillë ishte fakultative. Kjo pikë e ligjit ishte në përputhje me nenin 16 të Kushtetutës, sipas të cilit “*Shteti mund të ndihmojë materialisht komunitetet fetare*”. Pra, shteti nëse nuk i nxirrte jashtë ligjit komunitetet fetare, mund t’i linte ato pa asnjë të ardhur duke i çuar në falimentim.

Reforma i zhveshi bashkësitë fetare nga një pjesë e mirë e të ardhurave të tyre, fakt është se edhe pa shpronësimet, komunitetet fetare ishin krejtësisht të varura nga shteti. Siç e thamë, subvencionet nga jashtë nuk mund të pranoreshin prej kujt do institucioni kulti dhe një gjë e tillë ishte e përcaktuar qysh në ligjin fetar të Zogut të vitit 1929, i cili ashtu sikurse e kemi përmendur edhe më sipër vazhdonte të ishte në fuqi (Hoxha, 2014:40). Neni 20 i këtij ligji i ndalonte entet fetare të pranonin ndihma nga jashtë pa miratimin e shtetit¹⁰³. Subvencionet shtetërore ishin mjeti kryesor për të lejuar bashkësitë e tjera fetare, që të mund të mbijetonin (Hoxha, 2014:40). Asnjë nga komunitetet fetare nuk mund të kryejë një veprim pa u diktuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë (Pearson, 2006:331). Kështu, ripërcaktohet roli i “Komitetit për çështjet fetare” që duhet t’i paraprijë zbatimit të ligjit dhe të sigurojë lidhjet mes shtetit dhe komunitetit fetar, të përkujdeset për përmbushjen e akteve ligjore të parashikuara nga dekreti si dhe për përpilimin e statuteve të reja, gjithnjë në përputhje me linjën e Partisë Komuniste (neni 32). Prandaj, komunitet fetare deri në miratimin e statutit janë në gjendje paligjshmërie (Cimbolo, 2013:119). Komunitetet fetare mund ta rifitojnë të drejtën për të qenë persona juridikë, duke respektuar ligjet e shtetit, rendin publik dhe zakonet e mira me miratimin e statutit të ri. Drejtuesit e komuniteteve fetare, funksionarët fetare si dhe i gjithë personeli në shërbim të tyre, duhet të kenë shtetësi

¹⁰³ Dekret–Ligj, “Mbi formimin e Komuniteteve Fetare“ 1929,

shqiptare dhe t'i qëndrojnë besnikë popullit shqiptar. Të zgjedhurit si drejtues të komunitetit fetar duhet të kenë miratimin e Këshillit të Ministrave, ndërsa drejtuesit vendorë duhet të regjistrohen pranë këshillave popullorë në rrethe (Cimbolo, 2013:120). Komunitetet që tregohen më të zellshëm për përmbushjen e kërkesave të qeverisë janë ato Myslimane, Bektashi dhe Ortodokse, të cilët, më 4 Maj 1950 paraqitën statutet e tyre, që u miratuan nga shteti.

Duke përmbledhur çka u analizua më lart, mund të them se Dekreti i lëshuar me 26 Nëntor 1949 kishte për qëllim të rregullonte marrëdhëniet e bashkësive fetare dhe shtetit. Nuk parashikohej vetëm çështja e statutit por, ligji detyronte bashkësitë fetare për të kërkuar nga besimtarët besnikëri ndaj pushtetit, ndaj popullit dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, për ta forcuar unitetin kombëtar. Më tepër se sa të nxirrte në pah të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella midis shtetit dhe fesë në këtë ligj, përcaktohej vargu i tërë i të drejtave të shtetit kundrejt bashkësive për të kontrolluar, madje edhe çështjet e brendshme të këtyre të fundit. Sikurse ndodhte shpesh në vendet e botës sovjetike, dekret-ligjet e nxjerra nga Këshilli i Ministrave hynin në fuqi menjëherë, pa pasur nevojë të miratoheshin nga parlamenti. Miratimi i këtij të fundit ishte formal. Kështu do të ndodhte edhe me Ligjin “Mbi komunitetet fetare”, miratimi formal i të cilit u bë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor më 16 janar të vitit 1950.

2.2.4 Statutet e komuniteteve fetare

Statuti i Komunitetit Mysliman. Më 4 Maj 1950 u miratua statuti i ri për drejtimin e Komunitetit Mysliman (Pano,2003,150). Ky statut ashtu si edhe statuti i mëparshëm hyn në fuqi që ditën e aprovimit nga Presidiumi i Kuvendit Popullor¹⁰⁴. Ky statut është më i plotë se statuti i mëparshëm. Në parathënie thuhej se statuti u miratua nga Këshilli i

¹⁰⁴ Shih, dekreti nr. 1064 datë 4.5.1950

Përgjithshëm i Komunitetit Mysliman, duke u bazuar në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë, sipas së cilës të gjithë qytetarëve u njihej dhe garantohej liria e ndërgjegjes dhe e fesë. Statuti hapej me pohimin se Komuniteti Mysliman përbëhej nga të gjithë qytetarët shqiptarë myslimanë që i përkasin çdo lloj vëllazërie (Cimbolo, 2013:121). Detyra e komunitetit ishte të mbante gjallë dhe të zhvillonte tek besimtarët ndjenjën fetare të patriotizmit dhe të besnikërisë ndaj atdheut, Republikës Popullore, pushtetit popullor dhe vëllazërisë kombëtare. Organet drejtuese të komunitetit ishin po ato që kishte statuti i vjetër (Pano, 2014:146). Në nenet 4-5 jepej përkufizimi i Komunitetit Mysliman si një person moral, që gëzonte të gjitha të drejtat e një personi juridik¹⁰⁵. Gjuha e Komunitetit Mysliman ishte shqipja. Jepej mënyra e organizimit të këtij komuniteti. Marrëdhëniet e komunitetit me qeverinë rregullohen me anë të Kryeministrit. Në ndryshim me statutin e mëparshëm është mënyra se si zgjidhet Kryetari i Komunitetit Mysliman, i cili pavarësisht se zgjidhet nga Këshilli i Përgjithshëm nuk mund të fillojë detyrën pa dalë dekreti nga Këshilli Ministrave, i ashtuquajtur në atë kohë Këshilli Ministerial dhe pa u betuar përpara Këshillit të Përgjithshëm.¹⁰⁶ Sipas Art. 15. *Kryetari i Komunitetit Mysliman është përgjegjës përpara Shteti dhe mund të shkarkohet nga ofiqi me dekret të Këshillit Ministerial simbas dispozitave të Ligjës mbi komunitetet fetare, dhe simbas Art. 36. të këtij Statutit*¹⁰⁷. Gjithashtu, mbi bazën e këtij statuti, një pjesë e të ardhurave të komunitetit të tyre vijnë nga subvencioni i shtetit.¹⁰⁸ Po ashtu, rregulloret apo statuti i komunitetit hyjnë në fuqi dhe bëhen të detyrueshme sapo të marrin aprovimin e Këshillit të Përgjithshëm dhe të

¹⁰⁵Statuti i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Dekret Nr. 1064 Datë 4.maj.1950

¹⁰⁶Po aty, Art 2 www.licodo.com

¹⁰⁷ Po aty

¹⁰⁸Është e rëndësishme të theksohet se në këtë statut cilësohet se nuk mund të pranohen në asnjë mënyrë ose të dërgohen dhuratë ose subvencione nga shtetet e huaja, përveç kur është pëlqyer nga Kryeministria (Art 52).

Këshillit Ministerial¹⁰⁹. Edhe pse, si fillim, statuti u miratua, “Komiteti për çështjet fetare”, disa muaj më vonë, ndryshoi mendim dhe u shpreh i pakënaqur, vuri në dyshim punën e bërë, duke pohuar se në statutin e Komunitetit Mysliman, nuk ishin bërë ndryshime rrënjësore në krahasim me atë të vjetrin, siç kërkohej në dekretligj (Pano, 2003:150). Drejtoria e komunitetit u detyrua që më 25 Korrik 1950 të paraqiste ndryshimet e kërkuara (Cimbolo, 2013:124).

Nuk ka asnjë dyshim se statuti i ri e vë Komunitetin Mysliman nën kontrollin e rreptë të qeverisë. Së fundmi, me ndryshimet e bëra në vitin 1950 mbi numrin e myftinjve, merret zotim për zvogëlimin gradual të personelit fetar, në mënyrë që të ndryshonte puna e komunitetit. Duke vepruar kështu, qeveria çon përpara politikat e saj për riformulimin gradual të komuniteteve fetare, sidomos të atyre që kanë treguar më pak gatishmëri dhe pëlqim për transformimin e shoqërisë shqiptare në shoqëri socialiste. Gjithashtu, si në statutin e mëparshëm del në pah roli i madh që ka Këshilli Ministrat në ndryshimet që mund të kërkohej t’i bëhen statutit, ndryshime për të cilat duhet patjetër pëlqimi nga Këshilli Ministerial. Në bazë të nenit 72, ky statut hyn në fuqi që në ditën e aprovimit nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me të gjitha efektet e tij. Ky statut është aprovuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me Dekret Nr. 1064, datë 4.5.1950¹¹⁰.

Pas Komunitetit Mysliman, edhe ai Bektashian i’a dorëzoi qeverisë statutin e tij. Komuniteti Bektashian shihej si një shoqatë, përcjellëse e vlerave tipike të popullit shqiptar, thuajse si një shoqatë me karakter kulturor dhe etik, e aftë të kontribuojë për zhvillimin e progresit civil të shoqërisë sipas kornizës së projektuar nga partia komuniste

¹⁰⁹Nenet në vijim, 55-59 trajtojnë çështjet e medresesë së përgjithshme, e cila konsiderohej një institucion qendror i komunitetit.

¹¹⁰www.licodo.com Statuti i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Dekret Nr. 1064, datë 4.5.1950, Gazeta Zyrtare, 29 Qershor 1950 Nr. 40

në pushtet. Statuti i rishikuar me kërkesën e qeverisë ndahet në tetë kapituj¹¹¹. Neni 1 pohon se Komuniteti Bektashian është person juridik, në përbërje të të cilit ka familje me një traditë të gjatë bektashiane. Klerikët dhe funksionarët e Komunitetit Bektashian duhet të kenë shtetësi shqiptare, të jenë besnikë ndaj popullit dhe atdheut dhe të gëzojnë të drejtat civile¹¹². Kryetari i Komunitetit Bektashian shqiptar do të jetë njëkohësisht edhe Kryegjyshi Botëror dhe ka të drejtë të mbajë lidhje me selitë e tjera bektashiane në të gjithë botën (neni 1-7). Kjo është e mundur, ndryshe nga ç'parashikohet për komunitetet e tjera, lidhur me marrëdhëniet ndërkombëtare, meqenëse selia qendrore e këtij besimi gjendet në Shqipëri, prandaj ky besimi mund të konsiderohet “veçanti” shqiptare, në përputhje me karakterin kombëtar të këtij komuniteti (Cimbolo, 2013:127). Në vijim, statuti trajton mënyrën e organizimit të Komunitetit Bektashian, i cili përbëhet nga 6 Gjyshata dhe përcakton organet drejtuese dhe të përfaqësisë. Gjithsesi, sipas Dekretit të vitit 1949 “Mbi komunitetet fetare”, mbetej në fuqi kontrolli i shtetit mbi këto aktivitete. Me sa parashikohet në kapitullin e gjashtë të statutit, kujdes i veçantë i kushtohet pasurisë së komunitetit, mënyrës së administrimit të teqeve dhe të godinave të kultit, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Pasuritë dhe çdo e mirë tjetër e disponueshme administroheshin nga organet kompetente për territorin. Të ardhurat mblidheshin nga pasuritë e teqeve, nga ndihmat e besimtarëve e sidomos nga subvencionet e shtetit (Cimbolo, 2013:132). Territori i banuar nga bektashinjtë ndahej në dhjetë gjyshata, gjashtë prej të cilave brenda kufirit politik shqiptar dhe katër jashtë vendit. Përkujdesja e veçantë e qeverisë kundrejt këtij komuniteti shprehej me përpjekjen e vazhdueshme për afrimin e militantëve të këtij komuniteti me partinë

¹¹¹ Statuti i komunitetit bektashian shqiptar, Dekreti nr. 1066 dt. 4.5.1950, <http://licodu.cois.it/594/view>

¹¹² Gjuha e komunitetit është shqipja por gjatë predikimit dhe funksioneve fetare mund të përdoren edhe gjuhë të huaja. Ky përjashtim rrjedh nga fakti se selia botërore e këtij komuniteti është në Shqipëri. Marrëdhëniet e komunitetit me shtetin shqiptar rregullohen nëpërmjet nenit 16 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

(Cimbolo, 2013:133). E privuar nga lidhjet me vendet perëndimore, qeveria shqiptare u kujdes që, nëpërmjet përfaqësuesve më të përgatitur të këtij komuniteti, të mbante lidhjet me pjesën tjetër të botës, falë faktit se në Shqipëri ishte qendra botërore e këtij besimi. Bektashizmi prezantohej si një tipar kombëtar shqiptar, thënë ndryshe si një tregues i shqiptarizmit edhe brenda komuniteteve të emigruara. Aftësia e këtij komuniteti për tu shekullarizuar dhe për të lëvizur brenda mekanizmave të kulturës dhe mendimit perëndimor qenë një ndihmë jo e vogël për Partinë Komuniste për t'i siguruar asaj lidhjet me intelektualët e partisë komuniste të Perëndimit dhe për të qenë, hera-herës, shtysë për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, si dhe për shprehjen e mendimeve të saj politike në arenën komuniste ndërkombëtare (Cimbolo, 2013:133).

Edhe Komuniteti Ortodoks e paraqiti statutin e tij të përbërë nga 92 nene¹¹³. Në të pohohej se Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, si pjesë e pandarë e Kishës Ortodokse të përgjithshme apostolike është një person juridik, i përbërë nga të gjithë ortodoksët, që jetojnë brenda vendit dhe atyre me qëndrim jashtë, por që ruajnë dogmat kanonike dhe traditën e shenjtë. Me këtë përkufizim, Kisha e deklaronte veten kombëtare, duke i paraprirë një plani afatgjatë për autoqefali si dhe dëshirave të qeverisë së asaj kohe. Marrëdhëniet e Komunitetit Ortodoks me shtetin ngriheshin mbi dispozitat e ligjit “Për Komunitetet Fetare”. Gjuha zyrtare ishte shqipja, por për kryerjen e shërbimeve fetare mund të përdroreshin edhe gjuhë të huaja, në mënyrë që të ruhej liturgjia greke e përdorur në ritin bizantin (neni 1-3). Kisha angazhohej të zhvillonte të besimtarët e vet edhe ndjenjën e besnikërisë ndaj pushtetit popullor dhe Republikës së Shqipërisë; patriotizmi dhe forcimi i bashkimit kombëtar përbënin një prej qëllimeve të veprimtarisë pastorale. Funkionarët dhe personeli laik i komunitetit duhet të ishin shtetas shqiptarë, të ndershëm, besnike ndaj popullit dhe atdheut dhe të gëzonin të gjitha

¹¹³<http://licodu.cois.it/569/view>

të drejtat civile. Kisha Ortodokse mund të bashkëpunonte me kishat e tjera ortodokse që respektonin parimet e larta ungjillore për paqe dhe vëllazërinë e vërtetë mes popujve (neni 4-5), duke ruajtur tiparin kombëtar, çka e dëshmonte shtrirja e juridiksionit edhe mbi besimtarët e vet jashtë vendit. Kisha Ortodokse organizohej në formën e mitropolisë, nën titullin: “Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë”, sipas rregullave kanonike dhe administrative kishtare¹¹⁴. Autoriteti më i lartë i Kishës ishte, Sinodi i Shenjtë Episkopal, i përbërë nga peshkopë të çdo dioqeze, nën drejtimin e mitropolisë qendrore dhe të mitropolitit të mbarë Shqipërisë¹¹⁵. Kriteret për emërimin e peshkopit ishin të ngjashme me ato të komuniteteve të tjera fetare për emërimin e funksionarëve të lartë fetare, ku përfshihej edhe formula e betimit¹¹⁶. Më pas, vinin dispozitat organizuese dhe ato lidhur me funksionet e peshkopëve, të mitropolitëve dhe të meshtarëve¹¹⁷. Organi më i lartë i kishës për çështjet ekonomike dhe administrative ishte Këshilli i Përzier, i cili përbëhej nga titullarët e dioqezave dhe nga katër anëtare laike, një për çdo dioqezë dhe drejtohej nga arqipeshkvi për një afat kohor katër-vjeçar (Cimbolo, 2013:137).

Statuti i Kishës Katolike të Shqipërisë. Përpjekjet e diktaturës për ta vendosur Kishën Katolike nën varësinë e shtetit shqiptar ishin gjithmonë e më të dukshme. Statutet zyrtare të sekteve të tjera fetare ishin përpunuar dhe aprovuar nga qeveria, vetëm ai i Kishës Katolike ishte kthyer tri herë (Pepa, 2007:219). Qeveria shqiptare kërkonte me ngulm shkëputjen e Kishës Katolike Shqiptare nga politika e Vatikanit. Kështu, nën presionin dhe gjenocidin 5-vjeçar ndaj tyre, klerikët katolikë të mbetur më 26 Qershor 1951 në mbledhjen e tyre të përgjithshëm në Shkodër, në bazë të parimeve dhe dispozitave të përgjithshme, që përmenden në të drejtën kanonike dhe në përputhje me dispozitat

¹¹⁴ Statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale Nenet 8-9

¹¹⁵ Po aty, Nenet 12-15

¹¹⁶ Neni 17

¹¹⁷ “Statuti i Kishës Katolike të Shqipërisë” Nenet 37-44

përkatëse të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të Dekret-ligjit “Mbi Komunitetet Fetare” për të caktuar mënyrën, sipas të cilës Kisha Katolike e Shqipërisë rregullon, drejton dhe administron çështjet e saj fetare, duke hyrë kështu në fuqi pasi aprovohet nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë. Kështu, Kisha Katolike aprovon statutin e ri, i cili kufizonte për herë të parë hierarkinë organizative ndaj kishës brenda vendit. Ky statut u aprovua nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me Dekretin Nr.1322, datë 30 Korrik 1951 (Sinishta, 1976:59).

Dekreti u emërua “Miratimin i Statutit të Kishës Katolike të Shqipërisë” dhe statuti u bë ligj, një ligj, i cili shpallte se Kisha Katolike e Shqipërisë nuk do të kishte asnjë lidhje organizative, politike apo ekonomike me Vatikanin në koordinimin e çështjeve fetare (Pearson, 2006:430) dhe se koordinimi i çështjeve fetare duhej të kalonte patjetër dhe vetëm përmes strukturave shtetërore. Statuti u botua më 3 Gusht 1951 në të përditshmen Zëri i Popullit (Ljarja, 2012:195). Ligji ishte një nënshtrim të plotë i kishës ndaj shtetit dhe duhet theksuar se disa nene (ndalimi i pjesëmarrjes në politikë, statutet, mbështetja e patriotizmit) ishin, gjithashtu, të njëjtë me nenet, që ishin në fuqi në periudhën e Mbretit Zog (Pearson, 2006:430).

Neni 1 thotë: *“Kisha Katolike Shqiptare nuk mban më asnjë marrëdhënie organizative, ekonomike ose politike me Papën”* (Shehu, 2000:360).

Në Nenin 3 të tij përcaktohet se : *“Krahas me zhvillimin e ndjenjave fetare, funksionarët e Kishës Katolike të Shqipërisë do të zhvillojnë ndër besimtarët edhe ndjenjat e besnikërisë ndaj Pushtetit të Populli. Neni 4, Juridiksioni i Kishës Katolike të Shqipërisë shtrihet në të gjithë territorin e Republikës Popullore të Shqipërisë ku ka besimtarët e vet. Funksionarët dhe personeli i saj duhet të jenë shtetas të Republikës Popullore të Shqipërisë”*. Gjithashtu, në statut përcaktohet se në veprimtarinë e saj, Kisha Katolike e

Shqipërisë i nënshtrohet si ligjës së Zotit ashtu edhe ligjeve të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Në nenin 11 thuhet se: *“Arqipeshkvi mitropolitë dhe në mungesë të tij ipeshkvi i zgjedhun nga Episkopati, mund të mbajë n’emër të Episkopatit, lidhje me komunitete fetare ose institucione zyrtare që e kanë qendrën jashtë Republikës Popullore të Shqipërisë”¹¹⁸. Këto lidhje nuk mund të kenë karakter mvarësie dhe nënshttrimi organizativ, ekonomik ose politik, ato mund të kenë vetëm karakter koordinimi për çështje fetare dhe kryhen me anën e kanaleve zyrtare të Republikës Popullore të Shqipërisë, konform nenit 25 të dekretligjës Nr. 743 datë 27.II.1949 “Mbi Komunitetet Fetare”¹¹⁹.*

Qeveria kishte premtuar hapjen dhe subvencionimin e seminareve dhe kishave si dhe t’i lejonte prindërit t’i çonin fëmijët në kishë për mësimet fetare, por këto premtime nuk u mbajtën (Sinishta, 1976:59). Sipas statutit, shteti i jepte kishës një subvencion, i cili erdhi duke u pakësuar gjithnjë e më shumë.

Kështu, mund të përmbledhim se në bazë të këtyre statuteve, komunitetet fetare janë persona juridike, veprimtaria e tyre rregullohet nga statutet e tyre të brendshme pasi janë miratuar nga Këshilli i Ministrave, i ashtuquajtur i Këshilli Ministror. Kjo rregullore duhet të jetë gjithmonë në përputhje me ligjet e shtetit. Përfaqësuesit më të lartë të fesë duhet të jenë shtetas shqiptarë. E drejta për arsim e klerin në periudhën kur u hartuan dhe vepruan këto statute ishte e lejuar¹²⁰.

Komunitetet duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke qenë besnikë ndaj shtetit, ky nen, i sanksionuar në të gjitha statutet e komuniteteve të ndryshme fetare, ndoshta mund të përbëjë një shkak akuze për përndjekjen që do t’i bëhet klerit në vitet në vijim.

¹¹⁸ www.licodo.com

¹¹⁹ Po aty

¹²⁰ Po aty,

2.3 Shqipëria, i vetmi shtet ateist në botë

2.3.1 Situata që i paraprin Dekretit të vitit 1967

Vërtetë se feja cilësohej gjerësisht si armike, në përgjithësi organet shtetërore, si në qendër dhe periferi, mbanin një qëndrim armiqësor ndaj enteve fetare dhe klerikëve (Pano, 2014:146). Situata sovjetike u reflektua deri diku edhe në Shqipëri, përfshi këtu edhe politikat fetare¹²¹. Reduktimi i subvencioneve ishte vetëm njëra anë e një politike më të gjerë, të ndërmarrë nga regjimi për të reduktuar aftësinë e klerit për të ushtruar veprimtarinë e tij. Një tjetër aspekt i kësaj politike ishte edhe ajo që synonte pakësimin e klerikëve dhe faltoreve funksionale të komuniteteve fetare (Pano, 2014:147).

Nga fillim të viteve 1960, Hoxha pas prishjes me Jugosllavinë (në vitin 1948) si edhe me Bashkimin Sovjetik dhe aleatët e saj Evropiano-Lindorë (në vitin 1961), po e shihte veten si një ndër të paktët udhëheqës të mirëfilltë marksistë-leninistë të mbetur brenda kampit socialist. Si rezultat i zhvillimit të aleancës kinezo-shqiptare dhe në fillim të çarjes së aleancës kinezo-sovjetike, Hoxha ndjeu sigurinë që i duhej për të vazhduar të ndiqte politikat e tij të brendshme (Pano, 2003:147). Meqenëse Hoxha vuri re se atë, që ai e konsideroi si prishje të pastërtisë doktrinare brenda lëvizjes komuniste botërore gjatë fundit të viteve 1950 dhe në fillim të viteve 1960, ai që i detyruar të siguronte që Shqipëria të mos devijonte nga kursi “marksist-leninist”, të cilin ai e kishte skicuar, një kurs që e kishte futur atë në konflikt me “kampin revizionist”, të kryesuar nga Bashkimi Sovjetik (Pano, 2003:147).

Pra, gjatë mesit dhe nga fundi i viteve 1960, njëkohësisht me Kinën, Shqipëria nisi atë që Hoxha do ta quante “Revolucioni ideologjik dhe kulturor”. Një nga aspektet më

¹²¹ Format administrative, siç ishin survejimi, kontrolli dhe kooptimi nga organet e shtetit, sidomos nga Ministria e Brendshme dhe Komiteti i Kulteve, ishin instrumentet më efikase për të kufizuar punën e institucioneve fetare.

domethënëse dhe unike në versionin shqiptar të kësaj lëvizjeje ishte përpjekja për të bashkërenduar për të shkatërruar organizatat fetare të vendit dhe për të fshirë të gjithë ndikimin fetar në vend. Në të vërtetë, kur faza e parë më përçarëse e fushatës antifetare e kishte mbaruar kursin e saj aty nga fundi i verës së vitit 1967, regjimi shpalli fitore në luftën e tij kundër fesë (Pano, 2003:146).

Nis kështu, ngulazi, likuidimi i institucioneve fetare. Me gjithë tryshinë e vazhdueshme, që shteti kishte ushtruar ndaj fesë dhe institucioneve fetare, e shoqëruar edhe me dënimin dhe persekutimin e klerikëve e të besimtarëve, feja ruante ende ndikimin e vet në jetën shoqërore të vendit. Kongresi VI i Partisë së Punës së Shqipërisë, në nëntor 1966 e cilësoi luftën kundër fesë si një aspekt me rëndësi të luftës klasore, e cila synonte zhdukjen e kësaj pengese, që sipas Partisë së Punës, frenonte përparimin e vendit (Pano, 2014:146). Për këtë qëllim, para Kongresit u zhvillua një propagandë dhe një fushatë e gjerë kundër fesë, botëkuptimit fetar dhe institucioneve fetare ndaj shtypit, radios, televizionit etj¹²². Përfashtim u bë vetëm për disa objekte me vlera të veçanta, të cilat arritën që të ruheshin. Këto veprime u paraqitën nga propaganda zyrtare si një fitore historike, që kishte çuar në likuidimin e fesë dhe në ndërtimin e një shoqërie ateiste, pa institucione e veprimtari fetare (Grup autorësh, 2009:287). Edhe në kushtet e terrorit shtetëror ndaj fesë, njerëzit do të vazhdonin të ruanin besimin te Zoti dhe në fshehtësi të kryenin ritet fetare (Grup autorësh, 2009:287). Më 26 Shkurt 1951, dekretohet Dekreti Nr.1223, i cili i jep fund ekzistencës së shtetit ligjor dhe shtetit të së drejtës në Shqipëri. Ky dekret u hartua për të justifikuar vrasjen e paligjshme të 22 viktimave me pretekstin e

¹²²Në qendër të goditjes u vunë rregullat, ritet dhe ceremonitë fetare, që përbenin thelbin e botëkuptimit fetar. Ndërkohë, organizatat partiake në rrethe mbështetën dhe nxitën rininë drejt nismave dhe veprimeve ekstreme, që çuan në shkatërrimin total të bazës materiale të fesë, të kishave e të xhamive, të dorëshkrimeve dhe të simboleve fetare, si kryqe, ikona, literature fetare etj., të cilat ishin pjesë e trashigimisë kulturore të vendit.

bombës në Ambasadën Sovjetike, skenar politik ky i përgatitur më parë nga Sigurimi i Shtetit dhe Ministria e Brendshme (Ljarja, 2012:204).

Në vitin 1953, numri i kishave ishte zvogëluar nga 253 në 100 dhe vetëm 2 nga manastiret ishin në veprim. Të gjitha institucionet e tjera ishin shkatërruar ose konfiskuar (Peters, 2010:199).

Kleri në veprimtarinë e tij i qëndroi besnik statutit dhe rregullores në çdo pikë, ndërsa Shteti Shqiptar, ndonëse e aprovoi atë nuk e respektoi¹²³.

Masat e para, të marra nga komunistët për të dobësuar veprimtarinë e klerit ishin mbyllja e gjithë periodikëve, revista dhe publikime të tjera, si dhe shkollat, të cilat ishin drejtuar nga vetë kleri. Kjo u pasua nga represioni i jashtëzakonshëm ndaj klerikëve, që patën dënime të rënda, duke përfshirë tortura dhe ekzekutime. Klerikët u dënuan, kryesisht, duke manipuluar gjyqe ose mbi të gjitha, pa paraqitjen e tyre fare në gjykatë. Edhe në qoftë se komunistët kishin lejuar publikimin e periodikëve, klerikët, me siguri, nuk do të ishin angazhuar në një veprimtari të tillë, për shkak të censurës komuniste të tmerrshme, që ka ekzistuar në Shqipëri (Gjuraj, 2013:98).

Gjatë kësaj periudhe, nuk mund të mos marrim parasysh ndryshimet ndërmjet realitetit juridik dhe atij praktik të marrëdhënies ndërmjet pushtetit politik dhe enteve fetare. Kështu, në rrafshin e të drejtës entet gëzonin ushtrimin e disa të drejtave, ndonëse nën kontroll të rreptë, të pashqetësuar në një pjesë të madhe të veprimtarisë e tyre (Pano, 2014:148). Ndërsa në praktikë, realiteti paraqitej kompleks dhe jo uniform, si brenda strukturave qendrore ashtu edhe në ato vendore. Ndërkohë që vitet 1950–1953 dallohen nga një zbutje e qëndrimit të regjimit ndaj fesë, vite qetësie (Ljarja, 2012:219). Në

¹²³ Kryesia e kishës katolike të Shqipërisë-Episkopati Katolik Shqiptar, Statuti i Kishës Katolike të Shqipërisë, Rregullore mbi administrimin e përgjithshëm të kishës katolike të Shqipërisë, Shkodër 1952, fq 9

gjysmën e parë të viteve 50 regjimi po konsolidonte institucionet e tij, shtetërore dhe partiake¹²⁴. Për sa i takon fesë, qëndrimi i aparatit shtetëror dhe partiak ishte ende i pakonsoliduar dhe kështu, grupe apo seksione brenda tij kishin qasje të ndryshme ndaj fesë, pa qenë domosdoshmërisht të bashkërenduara¹²⁵.

Në vitin 1952 kemi një ndryshim thelbësor, nga 31 marsi deri në 6 prill të këtij viti u mbajt Kongresi II i Partisë së Punës së Shqipërisë, ku u vendos që ndryshimet kulturore në shoqërinë shqiptare të zhvilloheshin paralelisht me ndryshimet e bazës ekonomike (Ljarja, 2012:219). Veçanërisht, kleri katolik asnjëherë nuk pranoi t'i nënshtrohej regjimit persekutues, ndonëse mes tyre ekzistonte një marrëveshje e pranuar nga kleri katolik dhe e nënshkruar nga qeveria komuniste siç ishte “Statuti i Kishës Katolike të Shqipërisë”. Shteti ndërhynte gjithnjë e më shumë në punët e kishës, liria e ndërgjegjes dhe besimit si një e drejte themelore po dhunohej gjithnjë e më shumë (Ljarja, 2012:219).

Në mbështetje të nenit 58, pika 6 të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë me propozimin e Qeverisë, Presidiumi i Kuvendit Popullor nxjerr këtë dekret: (Dekret Nr.3660, datë 10.4.1963), dekret mbi disa ndryshime në Dekretin Nr.743 datë 26.11.1949 “Mbi komunitetet fetare”, të titulluar “Ndryshime në ligjin për Bashkësitë Fetare”. Nga pikëpamja juridike kjo ishte një goditje tjetër ndaj komuniteteve fetare si gjithmonë të sulmuara nga regjimi komunist. Ky dekret vendos se çdo aktivitet fetar do të miratohet nga qeveria ose organet lokale si dhe çka është edhe më absurde është se shteti, pa asnjë argument, njeh ose nuk njeh bashkësitë fetare (Ljarja, 2012:220). Kështu,

¹²⁴ Kjo ishte një periudhë fuqizimi i vazhdueshëm i institucioneve të dala nga lufta apo të krijuara pas saj. Pavarësisht të gjithave, feja mbeti në sytë e regjimit një armik por, sidoqoftë, një armik i pranuar të bashkëekzistonte brenda një shoqërie, që synonte të bëhej socialiste

¹²⁵ Pushteti politik nisi të përgatiste terrenin për goditjen e ardhshme. Feja shihej si pengesë serioze, për shkak të ndikimit të saj të fortë në popull. Kështu pra, feja ishte në shënjestrën e regjimit e fillimisht me propagandë.

sipas nenit 1, në Dekretin Nr.743, Datë 26.11.1949, aprovuar me Ligjin Nr.773, Datë 16.1.1950 “Mbi komunitetet fetare”, kryhen ndryshimet që vijnë: 1. *Paragrafi i parë dhe i katërt i nenit 7 ndryshohen përkatësisht si më poshtë: “Komunitetet fetare që të mund të organizohen dhe të funksionojnë duhet të njihen nga shteti. Njohja bëhet me aprovimin e Statutit të tyre nga Këshilli i Ministrave.”*¹²⁶*Njohja e Komunitetit fetar mund të revokohet me vendim të Këshillit të Ministrave, kur me veprimtarinë e tij, Komuniteti fetar ka shkelur ligjet, rendin juridik dhe zakonet e mira”.*2. *Neni 30, ndryshohet si më poshtë: “Qendrat e Komuniteteve fetare caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.* *Neni 2, ky dekret hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Gazetën zyrtare.*¹²⁷

Ndërkohë shkatërrimi përfundimtar i klerit dhe institucioneve të tij po shkonte drejt finalizimit.¹²⁸ Në dhjetor të vitit 1966 Komiteti Ekzekutiv i Shkodrës kërkoi nga qeveria disa kufizime të të drejtave që statuti i jepte Kishës Katolike shqiptare, të tilla si: mohimi i rolit të saj për të kontribuar në të mirën materiale të popullit të saj, të hiqej nga përdorimi gjuha latine si gjuhë kulti edhe pse predikimet bëheshin në çdo rast në gjuhën shqipe, të mbylleshin kishat, seminarët fetare e shkollat katolike¹²⁹, megjithëse shkollat fetare kishin rreth 20 vite të mbyllura sepse ato po zhvillonin aktivitet të dëmshëm armiqësor në edukimin e rinisë, si dhe të rishikohej statuti. Qeveria i'u përgjigj kërkesës me Dekretin Nr.4263, viti 1967, “Për bashkësitë fetare”, duke i'u hequr atyre siguritë ligjore dhe duke i shpronësuar tërësisht, duke lejuar kishën për përdorimin vetëm të objekteve të kultit dhe françeskanëve përdorimin e kuvendeve të tyre (Pano, 2014:148). Filloi shkatërrimi i objekteve të kultit, klerikët, që bënë rezistencë u pushkatuan (Pllumi,

¹²⁶ Dekret Nr. 3660, datë 10.4.1963

¹²⁷ www.LiCoDu.com/Albania

¹²⁸ Ajo që shqetësonte në të vërtetë Enver Hoxhën ishte të përforconte rolin si udhëheqës të PPSH-së në të gjithë sektorët e jetës së vendit. Por, të gjitha këto vështirësi nuk e lëkundën vullnetin e kreut të regjimit, që priste në të vërtetë ditë më të vështira, për të vazhduar me planet e tij për ndërtimin e një shoqërie socialiste.

¹²⁹ Shkollat fetare kishte rreth 20 vite të mbyllura.

2006:471) duke i kthyer kishat e xhamitë në monumente kulturore. Kështu, duke i'u referuar revistës së përmuajshme “Nëntori” rreth 2169 xhami, kisha, manastire e ndërtesa të tjera fetare u shkatërruan ose u kthyen në objekte që do të shërbenin për qëllime të tjera¹³⁰.

Me 19 Nëntor 1967, regjimi komunist shpalli Dekretin Nr.4337 “Mbi abrogimin e disa dekretëve”¹³¹, dekret ky që shfuqizoi dekretet e nxjerra në vitet 1949-1951, të cilat legalizonin statutet e rishikuara të katër komuniteteve fetare në Shqipëri. Ky Dekret ndalonte të gjitha ritet fetare dhe vendoste dënime të rrepta për shkelësit e ligjit dhe binte ndesh me parimet kushtetuese. Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë në kreun 3, neni 18 garantonte lirinë e ndërgjegjes dhe besimit fetar. Më 22 Nëntor 1967, Fletorja Zyrtare e Qeverisë shqiptare publikoi Dekretin Nr.4337. Sipas këtij dekreti bëhej anulimi me ligj i marrëdhënieve shtet-kishë, duke hedhur poshtë Dekretin e 30 Korrikut të vitit 1951, i cili kishte aprovuar Statutin e Kishës Katolike të Shqipërisë (Sinishta, 1976:189). Kështu, Shqipëria u bë vendi i parë ateist në botë (Pearson, 2006:624). Eliminimi i lirisë së besimit ishte bërë pa asnjë bazë juridike, pasi dekretet fetare të viteve 1949-1951 ishin hequr që më 13 nëntor 1967. Nga aspekti kushtetues situata jo-ligjore do të zgjasë deri në vitin 1976. Kushtetuta e Shqipërisë e plotësoi *post mortum* bazën ligjore të mungesës së lirisë fetare (Ljarja, 2012:229). Të parët që vuajnë nga ky nënshtrim ishin klerikët, kryesisht progresiv dhe elementet nacionalistë (Gjuraj, 2013:98).

¹³⁰ Shih, Revista Nëntori, Tiranë, shtator 1967

¹³¹ Dekret Nr.4337, datë 13.11.1967, në mbështetje të nenit 58, pika 6, të Kushtetutës; Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore të Shqipërisë vendosi dhe me propozimin të qeverisë, Neni 1 Dekreti Nr. 743 datë 26.11.1949 “Mbi komunitetet fetare”, siç është ndryshuar me dekretin Nr. 3660 datë 10.4.1943, dekreti nr. 1064 datë 4.5.1950 “Mbi aprovimin e statutit të komunitetit mysliman shqiptar”, dekreti Nr. 1065 datë 4.5.1950 “Mbi aprovimin e statutit të kishës autoqefale të Shqipërisë”, dekreti Nr.1066 datë 4.5.1950 “¹³¹Mbi aprovimin e statutit të komunitetit bektashian shqiptarë”, dekreti nr.1322 datë 30.7.1951 “Mbi aprovimin e statutit të kishës katolike të Shqipërisë”, çfuqizohen. Neni 2 Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Kështu, në vitin 1967 qeveria nxjerr jashtë ligjit praktikat fetare, në fakt duke bërë të ligjshëm persekutimin fetar (Sinishta, 1983:4). Për realizimin e këtij qëllimi, regjimi ka ndjekur tre strategji të ndara por edhe të ndërlidhura si tolerimi, brenda kufijve, të Islamit. Në përgjithësi, me disa përjashtime të klerit të lartë, feja myslimane nuk ishte një pengesë e madhe ndaj regjimit të ri, qeveria dëshironte ta përdorte atë si një mjet propagande ndaj botës myslimane. Gjithashtu, edhe pse regjimi e konsideronte Ortodoksinë Lindore në përgjithësi një armik, ata u përpoqën të përdorin Kishën Ortodokse për shkak të patriotizmit të saj tradicional, si një instrument për afrimin e popullsisë me politikën e saj. Po ashtu, regjimi u përpoq të bënte eliminimin e plotë të katolicizmit për shkak të forcës së tij tek fuqia shpirtërore, kulturore dhe organizative. Për shekuj me radhë kleri katolik dhe pasuesit e kësaj kishe ishin kryesuesit e Shqipërisë e të rinovimit kombëtar, kulturor dhe fetar. Pjesa më e madhe e katolikëve ishin mospërfillës ndaj regjimit të ri komunist (Sinishta, 1983:4). Të gjitha vendet e adhurimit, xhamitë dhe kishat u mbyllën. Shqipëria u bë shteti i parë ateist në botë dhe ngritja e Muzeut Ateist u konsiderua si një simbol i përpjekjeve të popullit që “vullnetarisht” arriti të shfuqizonte praktikën fetare (Peter R. Prifti 1978:152). Duhet thënë se prova fetare kishte një ndikim të tillë të fortë në mendimin politik të qytetarëve për dy arsye: Së pari, klerikët e feve të ndryshme nuk e mohuan asnjëherë Zotin dhe së dyti shumë shpesh gjykimet e tyre u kthyen si akuza të hapura nga sistemi komunist (Gjuraj, 2013:101).

Lufta ndaj fesë, duke nisur nga fillimi i viteve `50, zhvillohej kryesisht, në rrafshin kulturor, kurse në gjysmën e parë të viteve `60, ishin marrë masa konkrete për shkurtimin e organikës klerike (Sadikaj, 1981:114) masa këto, të cilat kishin nisur të praktikoheshin në mënyrë të jashtëligjshme, që para ndryshimeve të ligjit në vitin 1963.

Ato ishin produkt i formave informale, përmes të cilave vepron në fund të fundit çdo shtet totalitar¹³².

Megjithatë, mbyllja totale e institucioneve fetare në Shqipëri nuk u shoqërua me një reagim të ashpër nga ndonjë organizëm ndërkombëtar si Kombet e Bashkuara. Paradoksi është se, ndonëse Shqipëria ishte shtet anëtar, kishte shkelur parimet e Kombeve të Bashkuara, të sanksionuara në Kartat e OKB-së që nga viti 1948 (Gjuraj, 2013:100).

Pas Luftës së Dytë Botërore, ndërkohë që në Perëndim, kushtetutat e reja demokratike i hapin portat lirisë fetare, madje, në disa raste, duke i dhënë konkretisht mbështetje veprimtarisë dhe predikimit të kulteve të reja⁴⁷, në vendet e Evropës Lindore, ku erdhën në krye udhëheqës të demokracisë socialiste, përfshirë dhe Shqipërinë, liria dhe besimi fetar i'u nënshtruan një persekutimi të pashoq, gjithnjë e në rritje. Fillimisht, kjo u vu re me mënjanimin gradual të çdo besim fetar, më pas masat u ashpërsuan me shpronësimin e të mirave materiale të tyre, për të kulmuar në vitin 1967 me zhdukjen e plotë të çdo kulti dhe shpalljen e ateizmit shtetëror (Pano, 2014:151).

Po ashtu edhe për Komunitetin Ungjillor, ndonëse në dekretet e asaj kohe nuk pasqyrohet zhbërja e Komunitetit të Ungjillorëve, ky ashtu si komunitetet e tjera fetare është i detyruar të heqë dorë nga predikimi i fesë, ndërkohë, që të gjitha veprimtaritë dhe pasuritë e tij i kalojnë shtetit. Një gjendje e tillë vazhdon deri në vitin 1990, vit, në të cilin bie regjimi komunist.

¹³²Me urrejtje, qeveria shqiptare shkatërroi ose iu ndërroi destinacionin të gjitha objekteve katolike të kultit, por që nuk e bëri për gjithë objektet e tjera të kultit. Edhe pas shpalljes së Shqipërisë vend ateist, megjithë fasadën kushtetuese se shteti i trajton të barabartë qytetarët, persekutimi dhe represioni kundër komunitetit katolik bëhej në mënyrë të programuar, por të kamufluar.

2.3.2 Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e vitit 1976

Politikat e sforcuara dhe masat radikale të zbatuara në fusha të ndryshme kishin çuar në kufijtë ekstrem shoqërizimin e pronës dhe ekonominë e centralizuar (Grup autorësh, 2002:301). Nga ana tjetër, lëvizjet shoqërore dhe ideologjike, të zhvilluara në kuadër të të ashtuquajturit revolucionarizim të jetës së vendit, kishin sjellë pasoja në jetën shoqërore, në kufizimin e demokracisë, në cenimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të drejtave themelore të njeriut.

Në rrethana të tilla, shumë nga dispozitat e Kushtetutës dhe në përgjithësi, të legjislacionit ekzistues ishin kapërcyer. Për rrjedhojë ishte bërë i domosdoshëm hartimi i një kushtetute të re, në të cilën do të gjenin pasqyrim këto ndryshime. Për këtë qëllim, udhëheqja e vendit mori vendimin për hartimin e kushtetutës së re, e cila do të pasqyronte e ligjësonte ndryshimet e ndodhura në jetën ekonomike, shoqërore e politike të vendit (Grup autorësh, 2002:301). Për përgatitjen e projektit të Kushtetutës, me vendim të Byrosë Politike u ngrit një komision i posaçëm, të cilin do ta kryesonte vetë Enver Hoxha¹³³. Në dhjetor të vitit 1976, Kushtetuta u paraqit për shqyrtim në Kuvendin Popullor, i cili e miratoi atë njëzëri dhe në këtë mënyrë, ajo hyri në fuqi menjëherë. Kushtetuta ishte një dokument tërësisht i politizuar, me dispozita ekstreme, që do të sillte pasoja të rënda në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit. Kushtetuta sanksiononte rolin udhëheqës e kontrollues të PPSH-së në të gjitha fushat e jetës. Ajo e cilësonte shtetin si shtet të diktaturës së proletariatit, PPSH-në si forcën e vetme udhëheqëse në vend, marksizëm-leninizmin si ideologji sunduese, kurse luftën e klasave si forcën kryesore lëvizëse të shoqërisë (Grup autorësh, 2002:301).

¹³³Pasi u hartua në bazë të orientimeve të PPSH-së, siç ishte dhe në praktikën e atëhershme, projekti i kushtetutës u diskutua në popull.

Në këtë mënyrë, Kushtetuta mbyllte çdo hapësirë për mendim e veprim të lirë demokratik¹³⁴. Në këtë mënyrë, Kushtetuta do të bëhej pengesë për zhvillimin ekonomik, shoqëror e kulturor të vendit (Grup autorësh, 2002:302).

Goditja përfundimtare ndaj besimeve, e filluar me Revolucionin Ideologjik dhe Kulturor të vitit 1967 ishte miratimi i Kushtetutës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të vitit 1976,¹³⁵ kur ky vend u shpall botërisht shtet ateist. Kushtetuta e re, zëvendësoi Kushtetutën e vitit 1946, e cila ishte rishikuar me 1950 (Pano, 2014:154). Kjo Kushtetutë nuk sjell në fakt asgjë të re në raport me Kushtetutën e mëparshme veçse forcoi diktaturën dhe pozitën interveniste të partisë në vend.

Karakteristikë e përbashkët e dy Kushtetutave 1946 dhe 1976 është se asnjëra nuk e njeh parimin e ndarjes së pushteteve. Partia shtet ishte ajo që kishte përqafuar të gjitha pushtetet dhe roli i organit më të lartë përfaqësues, Kuvendit Popullor ishte krejt formal. Duke u mbështetur në parimin formal të kuvendit, ky i fundit zgjidhte, emëronte dhe shkarkonte Presidiumin e Kuvendit Popullor, Këshillin e Ministrave, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme dhe zëvendësit e tij. Të gjitha këto organe përgjigjeshin para Kuvendit Popullor dhe i jepnin llogari atij (Omari, 2005:204)

Që në krye duhet të themi se, nenet 1 dhe 2 ndryshuan emrin zyrtar të shtetit në Republikë Popullore Socialiste e Shqipërisë¹³⁶. Sipas të gjitha gjasave regjimi diktatorial nuk e ndjente më të nevojshme të fshihte identitetin e tij të vërtetë prapa “Frontit demokratik”, dhe shpalli Marksizëm-Leninizmin të vetmen ideologji sunduese në vend dhe Partinë e Punës së Shqipërisë të vetmen parti politike në vend (neni 3). Neni 2 i kësaj

¹³⁴ Ajo solli izolimin e plotë të vendit nga bota. Kushtetuta ishte një hap prapa në krahasim me dy kushtetutat e mëparshme, të miratuara në vitet 1946 dhe ndryshimet e bëra në vitin 1954. Dispozitat e saj do të ndikonin në përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes ekonomike dhe në mbylljen e në izolimin e vendit nga bota.

¹³⁵ Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë 1976, Tiranë 1977, fq 23

¹³⁶ Nenet 1, 2 Kushtetuta 1976

Kushtetute sanksionon se RPSSH është shtet i diktaturës së proletariatit, duke thelluar kështu karakterin komunist të rendit kushtetues shqiptar. Gjithashtu, fuqizohej roli i Partisë së Punës të Shqipërisë si forcë e vetme politike e vendit. Si nene tipike të kësaj Kushtetute mund të përmendim nenet 3 e 5, të cilat sanksionojnë Marksizëm-Leninizmin si ideologji sunduese, në nenin 4 sanksionohej lufta e klasave, neni 16 ndalonte pronën private, ndalohej marrja e ndihmave dhe kredive nga jashtë në bazë të nenit 28. Ndalohej liria fetare, të drejtat dhe liritë e qytetarëve që parashikoheshin në një kapitull të veçantë mbetën krejtësisht formale. Tashmë me vendosjen e Kushtetutës së 1976 nuk njihej më prona private si formë pronësie as formalisht¹³⁷.

Për sa i përket çështjes fetare me Kushtetutën e 1976 u ndalua dhe u hoq liria e fesë nga tërësia e të drejtave dhe lirive konstitucionale (Pano, 2014:154). Mund të themi se me përjashtim të nenit 55 të saj, nen ky që ndalonte krijimin e organizatave me karakter fetar dhe propagandën fetare, fjala fe nuk ishte e përdorur pothuajse aspak në tekstin e saj. Neni 55 ndalonte formimin e organizatave me karakter fetar bashkë me aktivitetet fetare dhe propagandën¹³⁸. Por, megjithatë, nuk mund të çrrënjoseshin nga ndërgjegjja e njerëzve bindjet fetare, madje as të pengoheshin ata të praktikonin në fshehtësi ritet fetare. Komunizmi si sistem politik dhe si ideologji ishte deklaruar kundër fesë. Ishte kjo arsyeja se pse gjatë regjimit komunist në Shqipëri marrëdhëniet midis shtetit nga njëra anë dhe fesë e klerit nga ana tjetër kanë qenë gjithmonë problematike. Gjatë regjimit komunist, ndjenjat fetare u shtypën në mënyrë të egër nga ana e shtetit. Një numër jo i vogël njerëzish, që dëshironin të praktikonin ritet fetare ose të mbanin në shtëpitë e tyre objekte kulti, u persekutuan. Për vite me radhë vazhdoi kalvari i vuajtjeve të rënda për klerikët dhe një pjesë të popullsisë shqiptare. Kështu, në Kushtetutën e vitit 1976 nuk

¹³⁷ Shih nenet 3,4,5,28, 55 Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë 1976, Tiranë 1977,

¹³⁸ Po aty, fq 30

kishte referenca të drejtpërdrejta për fenë në Shqipëri (Pano, 2014:146). Ajo ndryshe nga kushtetutat e vendeve të tjera, madje edhe nga kushtetutat e mëparshme shqiptare, ndalonte zbatimin e riteve fetare, ngritjen dhe funksionimin e institucioneve fetare, kryerjen e riteve dhe shërbesave fetare dhe gjithashtu, ndalonte propagandën fetare (Kristafi. Dammacco., 2008:43).

Neni 37 i kësaj Kushtetute thoshte: “*Shteti nuk njeh asnjë fe në asnjë mënyrë dhe ai mbështet propagandën ateiste me qëllimin e rrënjosjes së botëkuptimit materialist shkencor tek njerëzit*”. Me këtë nen legalizohet politika e qeverisë në lidhje me fetë. Kjo Kushtetutë vazhdoi të jetë në fuqi deri në prill të vitit 1989, e në vazhdim nuk u kërkuar më të zbatohet (Ljarja, 2012:243). Periudha anti-fetare e diktaturës Hoxha arriti një pikë të lartë me Kushtetutën e vitit 1976.

2.3.3 Kodi Penal i vitit 1977

Qëndrimi antifetar i regjimit u theksua edhe më shumë me shpalljen e Kodit të ri Penal të RPSSH-së, që u vu në zbatim pas vitit 1977. Neni 55 i këtij Kodi përcaktonte dënimin për agjitacionin dhe propagandën edhe fetare. Ky nen përcaktonte krejt qartë se propaganda fetare dhe gjithashtu, prodhimi dhe shpërndarja si dhe ruajtja e literaturës së këtij lloji, ndëshkohej nga 3 deri në 10 vite burg. Në kohë lufte ose kur krimi konsiderohej serioz, burgimi nuk ishte më pak se 10 vite dhe madje mund të jepej edhe dënimi me vdekje¹³⁹. Të mbështetura tashmë edhe nga ndryshimet kushtetuese dhe të ligjit parësor, regjimi diktatorial e forcoi luftën e tij për çrrënjosjen e plotë të besimeve fetare.

¹³⁹ Shih neni 55, Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë 1977

Kështu, Kodi Penal i kohës dhe i referohemi këtu Kodit Penal të vitit 1977, parashikonte dënime tepër të ashpra ndaj atyre që guxonin të shprehnin, të përhapnin apo të aplikonin në jetën e tyre idetë e ritet fetare. Kodi Penal i vitit 1977 dënonte propagandën fetare si dhe përhapjen e liturgjisë.

Formulat më elementare të lirisë së ndërgjegjes u hoqën plotësisht nga Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (1976), duke sanksionuar kështu politikën e shtetit komunist, të ndjekur që nga viti 1967, për goditjen e komuniteteve fetare deri në eliminimin e plotë të tyre. Kjo Kushtetutë afirmoi parimin e ateizmit (neni 37), kur theksonte se, shteti nuk njeh asnjë fe dhe përkrah e zhvillon propagandën ateiste për të rrënjosur tek njerëzit botëkuptimin materialist shkencor. Kështu, ndalohej çdo propagandë fetare dhe krijimi i çfarëdo organizate me karakter fetar, njësoj sikurse ndalohej krijimi i organizatave me karakter fashist, antidemokratik, fetar dhe antisocialist, neni 55 (Anastasi, 2003:34).

Gjithashtu, si pjesë e lëvizjes antifetare, regjimi diktatorial inkurajoi dhe në një farë mënyre edhe i shtrëngoi prindërit që tu jepnin fëmijëve të tyre emra jo fetarë. Kur një gjë e tillë nuk rezultoi të ishte një masë e suksesshme, atëherë qeveria përdori forcën dhe shpalli një dekret, mbi bazën e të cilit urdhëronte të gjithë shqiptarët të merrnin emra laikë. Kjo filozofi absurde e udhëheqjes shqiptare u përmbyll në Dekretin e famshëm të 25 Shtatorit 1975, botuar në Fletoren Zyrtare në Tiranë, më 11 Nëntor 1975, i cili deklaronte se: *“qytetarët që kanë emra të papërshtatshëm dhe mbiemra ofensivë nga pikëpamja politike, ideologjike dhe morale janë të obliguar t’i ndryshojnë ato”*. Ky dekret shtonte se personat e prekur nga ky ligj pritet që të kryejnë në mënyrë vullnetare një ndryshim të tillë dhe ata që nuk dëshirojnë ta bëjnë një gjë të tillë, duhet të detyrohen nëpërmjet organizatave shoqërore dhe krahinore (Glenny, 2000:222). Duhet të saktësohet

se një fushatë e tillë ka dhënë rezultate pozitive dhe në një farë mënyre, periudha në fjalë ka ndikuar në krijimin e një bashkësie të madhe shqiptarësh që kanë emra të përbashkët, pavarësisht se cilit besim fetar i përkisnin (Ljarja, 2012:243).

Duke përfunduar këtë kapitull përmbledhim se menjëherë pas ardhjes në fuqi, komunistet riafirmuan Shqipërinë si një shtet laik, jo ateist, ku besimi fetar ishte i lirë. Kushtetuta e vitit 1946 ligjëroi lirinë e besimit, vendosi ndarjen e kishës nga shteti dhe mori përsipër subvencionimin ekonomik të saj. Mirëpo, kjo mbeti vetëm në letër, kurse në planin praktik nuk ndodhi kështu.

Objektivi më i madh i regjimit komunist shqiptar, sikurse i të gjitha regjimeve të tjera të ngjashme të ish-blokut komunist, në vitet e para, ka qenë përgatitja e rrugës për shoqërinë komuniste të së ardhmes. Në të gjitha vendet e blokut komunist, ku mbizotëronte ideologjia e doktrinës Marksiste-Leniniste, feja do të konsiderohej si një element i padëshirueshëm në procesin e ndërtimit të shoqërisë dhe shtetit komunist. Përplasja mes kishës dhe shtetit komunist ka qenë një dukuri e pashmangshme. Regjimi komunist shqiptar dhe Partia e Punës së Shqipërisë, zbatoi në Shqipëri një nga variantet më rigoroze të Marksizëm-Leninizmit dhe të ateizmit shtetëror.

Lufta kundër fesë në Shqipëri zgjati për rreth 25 vjet. Gjatë këtyre viteve u zhvillua një proces jo i menjëhershëm, por i shtrirë historik, gjatë të cilit shteti komunist veproi dhe hartoi platforma politike, gjithnjë në përputhje me kushtet konkrete të vendit dhe zbatoi metoda antifetare, kryesisht anti-katolike, tepër të sofistikuara.

2.4 Liria e ndërgjegjes dhe besimit në Shqipëri pas vendosjes së demokracisë

2.4.1 Liria e besimit në aktet kushtetuese

Pas vitit 1990, liria e fesë u rivendos plotësisht. Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përbën një shqetësim konstant si në planin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Duke bërë një retrospektivë historike dallojmë qartë pse njerëzit kanë luftuar apo kanë kryer revolucione, pikërisht për të fituar liritë e tyre, që këto liri të gjenden të sanksionuara diku, në norma, akte apo dispozita juridike (Gjuraj, 2013:101). Sot, në shekullin e 21-të, kemi sisteme të konsoliduara të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të subjekteve të së drejtës. Sundimi i ligjit është tipar esencial dhe dallues i çdo shoqërie. Në themel të çdo demokracie është aksioma e qeverisjes nga populli për popullin. Pa shtetin e së drejtës, të qeverisurit do të gjendeshin në mënyrë të paevitueshme nën arbitraritetin e atyre që i qeverisin (Basha., Marko.,2000:127).

2.4.1.1 Ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese” Nr. 7491, i vitit 1991

Pas një kalvari të gjatë, ku ndër të tjera ishte dhunuar edhe e drejta e ndërgjegjes dhe besimit, në vitin 1990, Shqipëria, pas një periudhe të gjatë izolimi, ishte duke i hapur rrugë një sistemi të ri¹⁴⁰.

Kështu, ngjarjet që ndodhën në Shkodër, më 4 dhe 11 Nëntor 1990, pikërisht në segmentin më të persekutuar të popullit shqiptar, respektivisht, Komunitetin Katolik, përmbysën në një formë, le ta quajmë revolucionare, çdo parashikim dhe plan për hapje të ngadalshme dhe të komanduar nga lart (Anastasi, 2004:209). Pas vitit 1990, liria e fesë

¹⁴⁰Diskutimet e tij me Presidentin e asaj kohe, Ramiz Alia, u perqëndruan, së pari në përmirësimin e të drejtave të njeriut nëpërmjet një bashkëpunimi më të ngushtë të OKB-së, duke filluar në këtë mënyrë procesin e përfundimit të izolimit të Shqipërisë.

u rivendos plotësisht. Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përbën një shqetësim konstant si në planin kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar (Gjuraj, 2013:101). Duke bërë një retrospektivë historike, dallojmë qartë pse njerëzit kanë luftuar apo kanë kryer revolucione, pikërisht për të fituar liritë e tyre, që këto liri të gjenden të sanksionuara diku, në norma, akte apo dispozita juridike¹⁴¹.

Pas ndryshimeve demokratike të viteve 1990 u rivendos liria e fesë dhe të drejtat e komuniteteve të vjetra fetare në Shqipëri. Madje, një varg besimesh të reja fetare hynë rishtazi, për të ushtruar praktikat dhe ritet e tyre. Gjatë gjithë periudhës së tranzicionit demokratik, shteti nuk ka ngurruar të shprehë të gjithë asnjansinë e vet dhe për një popullsi me shumë besime, si rasti i Shqipërisë, neutraliteti i shtetit duket si një zgjidhje e përshtatshme, që nuk do të thotë indiferentizëm. Si rezultat i këtij indiferentizmi, gjatë gjithë këtyre viteve, ka munguar një ligj i plotë, që të rregullojë marrëdhëniet në këtë fushë (Anastasi, 2003:34).

Ndryshimet që solli ardhja e demokracisë në Shqipëri bënë që Kushtetuta e vitit 1976 të ishte krejtësisht e papërshtatshme për sistemin e ri që u krijua. Do të flasim kështu, për Ligjin Nr. 7491, datë 29.04.1991, “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese,” i cili është një paketë kushtetuese, e miratuar nga Parlamenti i parë pluralist. Ky ligj u miratua si paketë kushtetuese e përkohshme derisa Shqipëria të miratonte kushtetutën e saj, të ndërtuar mbi parimet e shtetit të së drejtës, duke rregulluar kështu një sistem demokratik. Prandaj, ashtu siç e përcaktonte neni 44¹⁴² i këtij ligji do të mbetej në fuqi deri në hartimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹⁴³. Mbi bazën e këtij ligji kushtetues, Shqipëria

¹⁴¹ Prandaj sot në të gjitha vendet demokratike në aspektin e respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, parimet e përgjithshme të lirive dhe të drejtave të njeriut afirmohen në Kushtetutë. Rregullimi modern i raporteve të shtetit me fenë dhe institucionet fetare përbën një arritje të Kushtetutës shqiptare, si dhe një nga meritat e veçanta të saj.

¹⁴² Shih nenin 44, ligjin Nr. 7491 dt 29.04.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”

¹⁴³ Poaty, <http://licodu.cois.it/619/view>.

ishite Republikë Parlamentare për sa i përket formës së qeverisjes, afirmohen parimet demokratike të qeverisjes siç mund të përmendim, nenin 3 i cili sanksionon parimin e ndarjes së pushteteve,¹⁴⁴ pushteti legjislativ do të ushtrohet nga Kuvendi, pushteti ekzekutiv do të ushtrohet nga Qeveria, neni 6 sanksionon pluralizmin politik. Meqë solli një sistem të ri, ky ligj parashikonte edhe ndryshime e shtesa për të ardhmen (Anastasi, 2004:209).

Kështu, skenari i ri politik dhe shoqëror, natyrisht nuk do të mund të gjendet në legjislacionin e regjimit totalitar komunist¹⁴⁵.

Në Ligjin “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”, Nr.7491, Datë 29.4.1991,¹⁴⁶ Kuvendi Popullor i Republikës Shqipërisë vendosi: Së pari në nenin e tij të parë sanksionohet sovraniteti i popullit dhe shpall Shtetin Shqiptar Republikë Parlamentare, kështu Shqipëria nuk emërohet më Republika Socialiste. Në neni 2 sanksionohet se Republika e Shqipërisë është shtet juridik dhe demokratik. Dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, zhvillimi i lirë i personalitetit të tij si dhe rendi kushtetues, barazia para ligjit, drejtësia shoqërore dhe përkrahja shoqërore, si dhe pluralizmi janë bazat e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë e mbrojë ato. E ndikuar nga presioni i brendshëm dhe ai i jashtëm, në mënyrë që të arrihej demokratizimi i vendit dhe sidomos garantimi i të drejtave dhe lirive të njeriut. Neni 4 sanksionon: “*Republika e Shqipërisë njeh dhe garanton të drejtat themelore të njeriut, minoritetet etnike, të pranuar në Traktate Ndërkombëtare*”. Në nenin 7¹⁴⁷ njihen liritë fetare dhe u vendos shfuqizimi i sanksioneve aq të rënda të Kodit

¹⁴⁴Po aty, neni 3

¹⁴⁵Po ashtu, lindte nevoja e mjeteve juridike për rishikimin dhe shfuqizimin e normave të sistemit shqiptar, i cili trashëgonte normat për rregullimin e ateizmit shtetëror, në mënyrë që të sigurohej disi mbrojtje për grupet fetare, që po rimëkëmbnin veprimtaritë e tyre të mëparshme në shoqërinë shqiptare.

¹⁴⁶Ligji “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese” Nr. 7491, Datë 29.4.1991

¹⁴⁷Po aty, neni 7

Penal të periudhës komuniste. Kështu, neni 7 sanksionon se Republika e Shqipërisë është shtet laik. Shteti respekton lirinë e besimit fetar dhe krijon kushte për ushtrimin e tij¹⁴⁸.

Gjithashtu, garantohej liria për të lëvizur jashtë territorit kombëtar, garantohej e drejta e pronës private dhe e drejta e sipërmarrjes së lirë. Garantohet në këtë mënyrë e drejta e pronës dhe e drejta për të kryer veprimtari ekonomike të pavarur, e drejtë kjo dhënë, gjithashtu edhe në favor të personave fizike e juridike që janë shtetas të huaj (Anastasi, 2004:206).

Filluan të ndërmerreshin hapat e para të demokratizimit të vendit. Neni 8 thotë se legjislacioni i Republikës së Shqipërisë merr parasysh, njeh dhe respekton parimet dhe normat përgjithësisht të pranueshme, të së drejtës ndërkombëtare (Anastasi, 2004:206). Zbatimi i përpiktë dhe i njëllojtë i normave juridike është i detyrueshëm për të gjitha organet shtetërore, partitë politike, organizatat e tjera, për nëpunësit, si dhe për personat e tjerë fizikë e juridikë. Të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit¹⁴⁹. Neni 45 i ligjit rishfuqizon Kushtetutën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të vitit 1976 dhe ndryshimet e saj të mëvonshme¹⁵⁰. Në këtë mënyrë, Shqipëria po ndërmerre hapat e para drejt demokratizimit të saj (Anastasi, 2004:208).

Në të njihen parimet themelore të shtetit demokratik, të tilla si ndarja e pushtetit, mbrojtja e minoriteteve, miratimi i konventave kryesore të së drejtës ndërkombëtare, pluralizmi politik, njohja dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, përfshirë edhe ato me karakter fetar (Dammacco, 2000:152). Njihet sovraniteti i popullit, nëpërmjet votës së lirë dhe demokratike.

¹⁴⁸<http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2013/02/Kushtetuta-në-një-vështrim-perspektiv.docx>

¹⁴⁹Në paragrafin e fundit të nenit 26 parashikon se funksioni i Presidentit është i papajtueshëm me ndonjë funksion tjetër, me përjashtim të atyre funksioneve të parashikuara me ligj. Pra, Presidenti i Republikës nuk mund të jetë më zyrtar i Partisë.

¹⁵⁰ U shfuqizua Kushtetuta e RPSSH, e miratuar më 28.12.1976, si dhe të gjitha ndryshimet e mëvonshme të saj.

Qëllimi i Parlamentit ishte për të filluar një proces rindërtimi të shtetit modern, duke i'u përgjigjur standardeve evropiane, duke synuar, gjithashtu, hyrjen e Shqipërisë në organizatat e mëdha ndërkombëtare, të tilla si OSBE-ja dhe Këshilli i Evropës. Rëndësia e Ligjit Kushtetues Nr.7491 qëndron në faktin se i mundësoi vendit për tu bashkuar me një sistem evropian, nga i cili ajo është e tërhequr jo vetëm nga historia por edhe në politikën e saj ekonomike dhe sociale (Dammacco, 2000:152).

Por, megjithëse u vendos ligji kushtetues, përsëri kishte mungesë të mjeteve juridike për administrimin dhe rregullimin e veprimtarisë së komuniteteve fetare, të cilat u sforcuan të përdornin institute të caktuara për të mbuluar boshllëkun normativ, në të cilin ndodheshin dhe t'i hapnin rrugë misionit të tyre në territorin e shtetit shqiptar.

Një mënyrë tjetër veprimi gjendet, fillimisht, në Ligjin Nr.7512, datë 10 Gusht 1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarisë private të pavarur dhe privatizimit”¹⁵¹. Ky ligj synonte të formonte një rend të ri ekonomik që do të thotë kalimin nga një sistem me ekonomi të planifikuar e të kontrolluar, gjithashtu, nga shteti, drejt një sistemi ekonomik të bazuar në parimet e tregut të lirë sipas neneve 10, 11, 12, 16, të Ligjit Nr.7491, datë 29 Prill 1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”¹⁵². Ky ligj, ndonëse nuk kishte të bënte direkt me aktivitetin fetar, deri në vitin 1993 u bë një ndër rregullat juridike të përdorura nga entet fetare për mbrojtjen e personalitetit juridik civil¹⁵³.

Për të ushtruar veprimtarinë e tyre, disa komunitete fetare kërkuan nga gjykatat e rretheve regjistrimin si organizata shoqërore jofitimprurëse, sipas Ligjit Nr.2362, datë 16

¹⁵¹Ligji nr. 7512, datë 10 gusht 1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarisë private të pavarur dhe privatizimit”.

¹⁵²Nenet 10, 11, 12, 16, të ligjit nr. 7491, datë 29 prill 1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

¹⁵³ Në vazhdim do hynte në veprim ligji, “Për Fondacionet”, nr. 7695, datë 7.4.1993

Nëntor 1956, “Për organizatat shoqërore që nuk ndjekin qëllime ekonomike”¹⁵⁴. Ky ligj nuk u shfuqizua asnjëherë, duke krijuar kështu një listë të gjatë shoqatash të krijuara në kohë trazirash për vendin (Cimbolo, 20013:159).

Për sa i përket të drejtës për arsimin fetar, në nenin 57, pika 6 të Kushtetutës së vitit 1991 thuhet se nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jo publike, të çdo niveli, që ngrihen dhe funksionojnë në bazë të ligjit, çka tregon se u lejuan shkollat private dhe fetare. Po ashtu, në pikën 7 thuhet se liria dhe autonomia akademike e institucioneve të larta garantohet me ligj.

Ndërkohë, nisma për riorganizimin e pranisë ortodokse në Shqipëri, ndërmerret nga Patriarkana Ekumenike në muajt e parë të vitit 1991, e pikërisht në 1-2 gusht të këtij viti thirret Asambleja e Përgjithshme e klerikëve dhe laikëve (Cimbolo, 20013:182).

Myslimanët e rifillojnë zyrtarisht veprimtarinë e tyre në vitin 1991 në Shkodër, pranë Xhamisë së Plumbit, pesë ditë pasi katolikët kishin celebruar meshën e parë në një klimë solidariteti mes besimeve të ndryshme (Cimbolo, 2013:183).

Bektashinjtë, po ashtu, përpiqen të riorganizojnë komunitetin e tyre, megjithëse me burime të pakta. Më 22 Mars 1990, me rastin e ditës kushtuar Sulltan Nevruzit, pas një ndërprerjeje, për rreth 50 vjetësh, u hap zyrtarisht aktiviteti i Kryegjyshit Botërore Bektashiane. Për më tepër, në vitin 1992 filluan të botoheshin periodikët mujore me tematikë fetare (Cimbolo, 2013:184).

Për të mënjeluar vakumet, ky ligj pati edhe 3 ligje të tjera shtesë¹⁵⁵ por, Shqipëria kishte nevojë për një kushtetutë të mirëfilltë bashkohore.

¹⁵⁴ Ligji nr. 2362, datë 16.11.1956 “ Mbi organizatat shoqërore jo fitimprurëse”, kjo normë do të shfuqizohet nga neni 1167 i kodit civil i vitit 1994.

2.4.1.2 Ligji Nr. 506, i datës 3 Prill 1993, “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”

Arsyet për kthimin masiv të shqiptarëve ndaj feve, pavarësisht luftës së gjatë komuniste kundër fesë, janë të shumta. Së pari ishte nevoja për të besuar, nevoja për identitetin dhe ajo shpirtërore, nevoja për të gjetur përgjigje tek liria e ndërgjegjes dhe e besimit e cila del nga izolimi i gjatë.

Liria e ndërgjegjes dhe e besimit u riafirmua sipas standardeve ndërkombëtare, në Ligjin Nr.506, i datës 3 Prill 1993, “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, i cili përfaqëson një ligj kushtetues, shtojcë të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” 1991¹⁵⁶.

Ligji Kushtetues i vitit 1991, së bashku me Ligjin Nr.506, i datës 3 Prill 1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, të cilët përfaqësojnë një ligj kushtetues¹⁵⁷, do të jenë i vetmi ligj themelor i shtetit shqiptar, deri në shfuqizimin e tyre me Ligjin Nr.8417 të vitit 1998 dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së re. Ligji është i përbërë nga 42 nene dhe paraprihet nga një preambulë e shkurtër, e cila mund të konsiderohet si premisë historike, prej nga rrjedh urgjenca për të nxjerrë këtë akt ligjor (Dammacco, 1995:393). Në të thuhet: *“Duke pasur parasysh se gjatë diktaturës së egër dhe çnjerëzore për 46 vjet të partisë-shtet në Shqipëri, ku janë shkelur e mohuar, për mes terrorit shtetëror, të drejtat civile e politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe liritë themelore të njeriut”* (Anastasi, 2004:208).

¹⁵⁵ Një kapitull i ri që rregullonte organizimin e drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese iu shtua ligjit kushtetues në prill të vitit 1992. Ndërsa, në qershor, një tjetër ligj do të rregullonte pushtetin lokal e në mars 1998 do t'i shtohet një kapitull tjetër, që rregullonte të drejtat dhe liritë themelore të njeriut

¹⁵⁶ Kështu pra, lidhur me veprimtarinë shoqërore të komuniteteve fetare si dhe të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë së tyre vjen dekreti i Presidentit të Republikës, nëpërmjet të cilit i shtohet një kapitull ligjit kushtetues 1991, “Për një shtojcë në ligjin nr. 7491, 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”, Ligji Nr.7692, 31.3.1993, <http://licodu.cois.it/615/view>

¹⁵⁷ Shtojcë të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” 1991

Duke marrë parasysh se respekti dhe gëzimi i plotë i këtyre të drejtave dhe lirive, përbën një nga aspiratat e larta të popullit shqiptar dhe një nga parakushtet e domosdoshme për garantimin e lirisë, drejtësisë sociale dhe progresit të shoqërisë sonë demokratike (Hyseni :2000).

Gjithashtu, ligji është edhe garanci e lirisë së ndërgjegjes dhe besimit¹⁵⁸. Neni 18 i ligjit sanksionon se liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit janë të paprekshme¹⁵⁹. Gjithkush është i lirë për të ndryshuar fenë ose besimin e tij, t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private përmes së drejtës për të adhuruar, të arsimimit, të praktikave ose kryerjes së riteve fetare. Liria e shprehjes së mendimit apo e besimit fetar nuk mund të kufizohet, përveçse kur kërkohet me ligj për të mbrojtur interesin apo rendin publik, shëndetin, moralin dhe të drejtat dhe liritë e të tjerëve¹⁶⁰.

Komunitet fetare do të rregullojnë veprimtarinë e tyre me anë të ligjit “Për Fondacionet”¹⁶¹, në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, i miratuar me propozim të Këshillit të Ministrave. Kështu, neni 7 përcakton: “*Fondacioni fiton cilësinë e personit juridik që në çastin e regjistrimit të tij. Regjistrimi i fondacionit bëhet në gjykatën e rrethit ku do të vendoset selia e fondacionit. Ministri i Drejtësisë përcakton kriteret dhe mënyrën e regjistrimit të fondacionit*”¹⁶². Boshllëku legjislativ do të mbulohej me norma dhe rregulla të

¹⁵⁸Ligjiedhe pse jo indarë në pjesë, mund të ndahet në pjesë të caktuara si: të drejtat, ndalimet dhe garancitë. Ndërtë drejtat e garantuar dhe të mbrojtur angjigjii ri, ndër të tjera, ekzistone drejta për jetëdheliria e mendimit, procesit të rregullt ligjor dhe prezumimii pafajsisë.

¹⁵⁹ Shih nenin 18 ligji nr. 506i datë 3prill 1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”

¹⁶⁰Kështu, riafirmimi ilirisë fetaresjellnjë ndryshim të madhnëshoqërinë shqiptare. Në Shqipëri tashmëvinë misionarët e të gjitha feve, të krishterët, myslimanët, ortodoksët, bektashinjetj., gjithashtu, simbolet fetarekthehenkudo.

¹⁶¹Ligj nr.7695, datë 7.4.1993“Për Fondacionet”,

¹⁶²Ligji nr.7695, datë 7.4.1993 “Për Fondacionet”, shpallur me dekretin nr. 513, datë 16.4.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë

përkohshme, në mënyrë që tu jepej zgjidhje kërkesave të komuniteteve dhe të grupeve fetare për zhvillimin e veprimtarive të tyre.

Fakti se liria fetare është e garantuar sërish u reflektua në Kodin e ri Civil të vendit në vitin 1994. Neni 39 i Kodit thotë se: *Shoqatat janë grupime shoqërore që ndjekin një qëllim politik, shkencorë, kulturorë, sportive, fetare, bamirësie ose çdo lloj qëllimi përveç atij fitimprurës*¹⁶³. Kështu, komunitetet fetare përfshihen në ato grupime shoqërore, veprimtaria e të cilave rregullohet nga legjislacioni i së drejtës së përbashkët. Gjithashtu, bashkë me mundësitë që i'u ofron ligji të drejtës së tyre për tu organizuar, shtohet edhe mundësia e rihapjes së veprimtarisë së komuniteteve fetare, duke filluar që me çeljen e procedurave për kthimin dhe kompensimin e pasurive të konfiskuara që në vitin 1945, e që zgjati deri në shpërbërjen e plotë të tyre në vitin 1967¹⁶⁴. Kryesisht, bëhej fjalë për kompensimin e tokës, meqë në kohën e konfiskimit ajo ishte ndër të mirat kryesore¹⁶⁵. Pas tokës ishin ndërtesat të cilat ishin kthyer tashmë në pronë publike¹⁶⁶. Për këtë arsye u ngrit “Agjencia për kthimin dhe kompensimin e pronave”, e cila shqyrtonte dokumentacionin e nevojshëm si dëshmi e pronësisë së hershme¹⁶⁷.

Kthimi i pronave të komuniteteve fetare pati vështirësi prandaj, në vitin 1993, në bazë të nenit 16, të Ligjit Nr.7491, “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”, hyn në fuqi Ligji

¹⁶³ Neni 39, Kodi Civil, ligji nr. 7850, dt 29 korrik 1994,

¹⁶⁴Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7699, 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”, Ligj Nr.7981, 27.7.1995, <http://licodu.cois.it/591/view>

¹⁶⁵ Ligji nr. 7695, datë 7.4.1993 “Për tokën”, Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit <http://licodu.cois.it/600/view>

¹⁶⁶Per privatizimin e banesave shtetërore <http://licodu.cois.it/601/view>

¹⁶⁷shih: Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7699, 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronareve të tokës bujqësore”, Ligj Nr.7981, 27.7.1995, <http://licodu.cois.it/591/view>; Për tokën, Ligj Nr.7695, 7.4.1993, <http://licodu.cois.it/599/view>, Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit <http://licodu.cois.it/600/view>; Për privatizimin e banesave shtetërore <http://licodu.cois.it/601/view>.

“Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve”¹⁶⁸. Kështu, ky ligj sipas nenit 1 të tij, i njeh ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre legjitim, të drejtën e pronësisë mbi të mirat e shtetëzuara, të shpronësuara apo të konfiskuara sipas ligjit, masave administrative apo vendimeve gjyqësore, të zbatuara pas datës 29 Nëntor 1944, si dhe përcakton mënyrat për rikthimin dhe kompensimin e tyre. Në këtë ligj nuk përfshihet pasuria e paluajtshme, siç parashikohet në ligjin e sipër përmendur “Për tokën”. Meqenëse drafti është përgjithësues, për ta konkretizuar, në vitin 1995, hynë në fuqi rregulla të veçanta, të cilat i mundësojnë komuniteteve fetare kthimin e pronave bujqësore, të konfiskuara në vitin 1967¹⁶⁹. Për pronat e tjera parashikohet kompensim ose transferim i tyre pa zhdëmtim, nëse çmohet se prona ka ruajtur të njëjtën vlerë të mëparshme¹⁷⁰.

Efektet e lirisë së rifituar të ndërgjegjes dhe besimit do t’i shohim edhe në Kodin Penal të vitit 1995, i cili u miratua me Ligjin Nr.7895 dhe do të parashikonte veprat penale kundër lirisë fetare në kreun X, e pikërisht nenet 131- 133¹⁷¹. Në nenin 131 përcaktohet: *“Pengesja e aktiviteteve të organizatave fetare, si dhe pengimi i ushtrimit të lirë të veprimtarive të tyre, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet”*.

Në nenin 132 janë dënuar në të njëjtën mënyrë shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit, që shkakton humbjen e pjesshme apo të plotë të vlerave të besimit: *“Shkatërrimi apo dëmtimi i objektivet të kultit, kur ata prodhuan humbjen plotësisht ose pjesërisht të vlerave të tyre, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”*.

¹⁶⁸Ligji nr. 7698, 15.04.1993, Fletorja zyrtare, nr 5, 1993, <http://licodu.cois.it/602/view>

¹⁶⁹“Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7699”, 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”, Ligj, Nr.7981, 27, 7. 1995, <http://licodu.cois.it/598/view>.

¹⁷⁰ “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, Ligji Nr.8053, 21.12.1995, <http://licodu.cois.it/603/view>

¹⁷¹ Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7895, datë 27 .1.1995

Neni 133, gjithashtu, parashikon sanksione kundër atyre, që pengojnë ceremonitë fetare dhe pjesëmarrjen në to të popullit. Pengesa për të marrë pjesë në ceremonitë fetare edhe cenimi i shprehjes së lirive fetare përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Gjithashtu, mbrojtja shtrihet edhe mbi lirinë e shprehjes së bindjeve fetare. Kështu, Kodi Penal i vitit 1995 është një akt ligjor, i cili tregon ndryshimin e thellë, të cilin vendi kalon nga ateizmi, në mbrojtjen e plotë të të drejtave dhe lirive fetare, në mënyrë që të shmangen konfliktet fetare.

Parashikimet e kreut X të Kodit të sipërpërmendur lidhen ngushtë me çfarë parashikon neni 73 i Kodit Penal, që ndalon krimin e gjenocidit duke parashikuar për të nga dhjetë vjet deri në burgim të përjetshëm, apo dhe dënim me vdekje¹⁷². I njëjti dënim parashikohet në nenin 74 për “Krime kundër njerëzimit”. Neni 118, gjithashtu, përfshin edhe dhunimin e varreve apo varrezave, qoftë kjo edhe vjedhje sendesh apo mungesë respekti kundrejt të vdekurit: dënimi për krime të tilla varion nga marrja e gjobës, deri në pesë vjet heqje lirie, në varësi të shkallës së dhunimit, e cila arrin kulmin e saj kur dhunuesi e kryen veprën e tij penale i shtyrë nga përkatësia fetare apo etnike e të vdekurit¹⁷³. Po ashtu, kjo sërë krimesh gjen pasqyrimin e vet në nenin 265, sipas të cilit dënohen të gjithë ata që nxisin konflikte kombëtare, racore apo urrejtje dhe konflikte fetare, qoftë edhe nëpërmjet përgatitjes, propagandës apo ruajtjes me qëllim propagande të shkrimeve me përmbajtje të tillë. Dënimi për këto raste varion nga marrja e gjobës deri në dhjetë vjet heqje lirie. Shteti shqiptar me miratimin e standardeve të reja normative, të cilat ndërtojnë dhe mbrojnë lirinë fetare, tregoi se ai ishte shkëputur tërësisht nga përvoja e tij e mëparshme komuniste.

¹⁷² Shih neni 73, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7895, datë. 27.1.1995 <http://licodu.cois.it/300/view>

¹⁷³ Po aty, neni 118,

Shqipëria ka hyrë në Këshillin e Evropës më 13 Prill 1995 dhe ka ratifikuar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në vitin 1996. Sistemi shqiptar filloi të krijojë gjithnjë e më shumë hapësira komuniteteve fetare duke i lehtësuar ato nga barra fiskale duke mos u'arë mohuar privilegjet për t'i dhënë dorë rindërtimit të tyre. Në të njëjtën kohë, bënë kujdes të mos i pengojë marrëdhëniet e tyre me selitë përkatëse jashtë vendit¹⁷⁴ dhe i mbështet në përpjekjen për tu rrënjësuar sërish në shoqërinë civile (Cimbalo, 2013:181).

2.4.1.3 Kushtetuta Republikës së Shqipërisë e vitit 1998

Projekt-kushtetuta u miratua nga një komision parlamentar, i asistuar edhe nga mekanizma ndërkombëtare siç ishte Komisioni i Venecias¹⁷⁵, Kushtetuta¹⁷⁶ e re i përgjigjet kriterëve të vendosura nga Këshilli i Evropës për vendet që aspirojnë të bëhen pjesë e këtij bashkimi. Në përputhje me të gjitha standardet ndërkombëtare, shprehja “liria e ndërgjegjes dhe e fesë”, kujton direkt edhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut apo Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 9.1) (Dammacco, 2002:155).

Me 21 Tetor Parlamenti miratoi Kushtetutën¹⁷⁷ e cila u votua me referendum popullor me 22 Nëntor 1998 dhe hyri në fuqi me shpalljen nga Presidenti Republikës me 28

¹⁷⁴ Për një ndryshim në ligjin nr. 8182, 22.12.1996 “Për një ndryshim në ligjin” nr. 7609, 22.09.1992, “Për tarifatat doganore”, Dekreti nr. 1807, datë 30.05.1997.

¹⁷⁵ Është Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit, i njohur si Komisioni i Venecias, një organ Këshilli Konsultativ Evropian, themeluar në vitin 1990. Komisioni ka luajtur një rol kyç në miratimin nga vendet ish-komuniste të Evropës Lindore të Kushtetutës plotësojnë standardet e trashëgimisë kushtetuese të Evropës. Punimet e Komisionit në katër fusha: 1) ndihmës kushtetuese; 2) zgjedhjet dhe referendimet; 3) bashkëpunimi me Gjykatat kushtetuese; 4) studime, raporte dhe seminare ndërkombëtare.

¹⁷⁶ Procesi i hartimit përfshiu një trup të gjerë, përfaqësues të aktorëve politikë, me përjashtim të Partisë Demokratike, i cili nuk pranoi të marrë pjesë. Përfaqësuesit e dy partive të pakicave kryesoi Komisionin për të nxitur një qasje të hapur dhe gjithëpërfshirës. Struktura e rezultuar i dha Partisë Socialiste një shumicë prej një vendi. Kjo strukturë provokoi një bojkot nga Partia Demokratike, e cila këmbënguli se ka të drejtën e vetos.

¹⁷⁷ Tipari më domethënës i shtetit të së drejtës është Kushtetuta, e cila është një marrëveshje publike ndërmjet gjithë individëve. Prandaj sot, në të gjitha vendet demokratike në aspektin e respektimit të lirive

Nëntor. Kushtetuta e vitit 1998, nga pikëpamja formale, është në pajtim të plotë me standardet ndërkombëtare (Cimbolo, 2013:157). Me ndryshimet e vogla ajo riprodhon në mënyrë të përmbledhur legjislacionin kushtetues, të miratuar në Shqipëri pas vitit 1991¹⁷⁸.

Kushtetuta e vitit 1998¹⁷⁹, përcakton institucionet themelore të një shteti demokratik dhe siguron mbrojtje për të drejtat themelore të njeriut (Anastasi, 2004:206). Kështu, sipas saj, qeverisja është strukturuar si një Republikë Parlamentare me një dhomë. Në përgjithësi, Kushtetuta e vitit 1998 është shembull i një kushtetute moderne, demokratike hartuar nëpërmjet një procesi kryesisht të hapur, transparent dhe gjithëpërfshirës¹⁸⁰.

Kushtetuta jonë ka theksuar parimin e një shoqërie në bashkëjetesë fetare që në Preambulën e saj. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si ligji themelor, i cili sanksionon parimet bazë të organizimit dhe funksionimit të shtetit i rezervon një vend të veçantë lirisë së ndërgjegjes dhe besimit. Kushtetuta e re ka bërë shkëputje krejtësisht nga përvoja e mëparshme e shtetit komunist (Anastasi, 2004:206).

Në nenin 3¹⁸¹ thuhet se sovraniteti i shtetit dhe integriteti i tij territorial, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, sistemi i pluralizmit kushtetues, identiteti kombëtar dhe trashëgimia, bashkëjetesa fetare si dhe të kuptuarit e shqiptarëve ndaj pakicave, janë themeli i këtij shteti, i cili ka detyrimin për t'i respektuar dhe mbrojtur ata (Durham, 2004:85). Në përputhje me të gjitha standardet ndërkombëtare, termi “liria e

dhe të drejtave të njeriut, parimet e përgjithshme të lirive dhe të drejtave të njeriut sanksionohen në kartën juridike me fuqinë më të lartë siç është kushtetuta.

¹⁷⁸ Kushtetuta e vitit 1998 u shfaq në mes të paqëndrueshmërisë politike që shkaktuan skemat piramidale, operimet e mëvonshme të NATO-s, dhe ndarja mes partisë Demokratike dhe asaj Socialiste

¹⁷⁹ Kështu, u rikonfirmua natyra laike e shtetit, e përcaktuar kjo që në statutin e vit 1914 si dhe forma e rinjohjes së personalitetit juridik, të cilit i nënshtrohen komunitet fetare. Pra, kushtetuta mbështetet në trungun e traditës juridike të vendit, i cili që në vitin 1923 ka shfaqur një tipar dallues të saj, pluralizmin e besimeve fetare, tipar ky që e bën Shqipërinë një rast unik mes vendeve me shumicë islame.

¹⁸⁰ <http://www.constitutionnet.org/country/constitutional-history-albania>

¹⁸¹ Neni 3, Kushtetuta 1998

ndërgjegjes dhe besimit”, kujton direkt edhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut e vitit 1948¹⁸².

Neni 10 i Kushtetutës rregullon marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare, shteti dhe feja janë të ndara dhe të dy palët janë të detyruar të respektojnë sovranitetin dhe lirinë e të tjerëve. Prandaj, siç e pamë, “Shteti nuk ka fe zyrtare, duke mohuar plotësisht urdhrin komunist të vitit 1976, i cili përcaktoi ateizmin e shtetit. (Durham, 2004:83). Të gjitha bashkësitë fetare janë të barabarta duke përcaktuar neutralitetin e tyre në çështjet e fesë dhe të ndërgjegjes. Duke pasur parasysh kontekstin historik të shtetit shqiptar mund të kuptojmë parimin e ndarjes së shtetit dhe bashkësive fetare, sanksionuar në nenin 10 të Kushtetutës së vitit 1998. Shqipëria nuk ka një fe zyrtare por njeh, respekton dhe mbron të gjitha komunitetet fetare. Baza e çështjes fetare në Shqipëri është se të gjithë komunitetet fetare janë njësoj të rëndësishme, pra janë të barabarta përpara ligjit (Hazizaj, 2004:179). Myslimanët, katolikët e ortodoksët kanë të njëjtin legjitimitet. Komunitetet fetare kanë kontributin e tyre të rëndësishëm në rrugën e popullit shqiptar për liri dhe emancipim, duke qenë pjesë e pandarë e trupit kombëtar. Ky bilanc dhe legjitimitet tregon në thelb se Shqipëria edhe pse është një vend me tre fe të ndryshme, ajo nuk identifikohen me asnjë nga ato (Kadare, 2004:18).

Neni 10 i Kushtetutës, tregon se marrëdhëniet mes shtetit dhe komuniteteve fetare shqiptare janë karakterizuar nga neutraliteti. Ajo afirmon natyrën laike të shtetit, neutralitetin e tij institucionale. Ky raport nuk është thjesht një imitim i përvojës perëndimore por, kjo është një vazhdimësi e traditës shqiptare ligjore mishëruar gjithmonë në të. Kjo traditë është e kushtëzuar nga tradita fetare e shoqërisë shqiptare, e

¹⁸²“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit; kjo e drejtë përfshin lirinë e ndryshimit të besimit ose bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët dhe në publik ose privat, për të manifestuar fenë ose bindjen e vet në mësimdhënie, praktikë, kultit dhe ceremonive fetare”, të nenit 18, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut të vitit 1948.

cila për më shumë se pesë shekuj, karakterizohet nga bashkëjetesa nga të katër fetë e mëdha: myslimane, bektashiane, ortodokse dhe katolike (Durham, 2004:81). Karakteristikë e kësaj tradite është mungesa e dominimit të njërit mbi të tjerat. Fakti se kushtetuta e tanishme nuk njih asnjë fe zyrtare, bën të mundur barazinë midis komuniteteve fetare. Pika 5 e nenit 10 përcakton pavarësinë e komuniteteve fetare nga shteti (Anastasi, 2004:207).

Duke përmbledhur, siç edhe cituam, neni 10, pika e parë pohon se Republika e Shqipërisë nuk ka ndonjë fe zyrtare dhe në pikën e dytë thekson paanshmërinë e shtetit në punët e fesë e të besimit dhe mbi të gjitha, siguron lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike (Durham, 2004:85). Pika e tretë njih barazinë fetare. Sipas pikës së katërt, si shteti ashtu edhe komunitetet fetare angazhohen për të ruajtur pavarësinë e ndërsjellë dhe bashkëpunimin për të mirën e përbashkët, duke i paraprirë kështu, me pikën vijuese, nënshkrimin të marrëveshjeve të bashkëpunimit mes përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje duhet të miratohen nga Parlamenti¹⁸³. Pika e gjashtë i njih komunitetet fetare si persona juridike dhe njih gjithashtu të drejtën e tyre për të administruar pasuritë e tyre sipas rregulloreve përkatëse, me kusht që të mos cenohen interesat e të tretëve (Cimbolo, 2013:167).

Neni 24 i Kushtetutës mishëron parimin e bashkëpunimit në mes të shtetit dhe komuniteteve fetare. Ky nen është, pa dyshim, neni klasik i lirisë fetare¹⁸⁴. Në nenin 24, liria e ndërgjegjes dhe e besimit janë të shprehura në kuptimin e tyre të dyfishtë (Anastasi, 2004:206). Në radhë të parë, është menduar që secili është i lirë, jo vetëm për

¹⁸³ Mbrojtja juridike sigurohet nga neni 134 i kushtetutes, sipas të cilit “Gjykata kushtetuese ushtron kompetencat e saj me kërkesë të organeve të bashkësive fetare vetëm për çështje që u takojnë atyre. Në këtë mënyrë, komuniteteve fetare u krijohet mundësia të kenë mbrojtjen e drejtëpërdrejtë nga Gjykata Kushtetuese, duke u njohur këtyre organizatave shoqërore një rol kryesor në shoqërinë shqiptare dhe duke i siguruar mbrojtje të veçantë lirisë fetare”.

¹⁸⁴ Kushtetuta 1998

të zgjidhur besimin, por gjithashtu edhe për të gëzuar të drejtën për të ndryshuar fenë ose bindjet e tyre;

Së dyti, kjo do të thotë se gjithkush ka të drejtën të ushtrojë “lirinë e adhurimit”¹⁸⁵. Gjithkush mund të shprehë besimet e tij individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private nëpërmjet kultit, arsimit dhe praktikës ose kryerjes së riteve (Anastasi, 2004:206). Kjo kërkon që shteti të njohë të drejtën e çdo besimtari për të marrë pjesë në ceremonitë e fesë së tyre ose të jetë indiferent ndaj të gjitha veprimtarisë fetare. Neni 24 i atribuon shtetit rolin e garantit të së drejtës për këto komunitete, për të shpallur e praktikuar publikisht besimin përkatës. Është detyrë kushtetuese ruajtja e parimit të paanshmërisë së shtetit për çështje fetare, roli mbrojtës i tij për të drejtën e komuniteteve fetare për të marrë pjesë në jetën publike të vendit (Hazizaj, 2004:179).

Në planin individual, neni 24 garanton lirinë e ndërgjegjes dhe të besimit dhe të drejtën për të zgjedhur, ndërruar dhe shpallur besimin dhe bindjet vetjake, privatisht apo në publik nëpërmjet kultit, arsimit dhe shërbesave fetare. Pika 3 e nenit 24, synon të trajtojë në mënyrë të barabartë si përkatësinë ashtu edhe mos përkatësinë fetare, me qëllim që të mbrojnë lirinë e ndërgjegjes, pra edhe prirjet ateiste të individit. Ky nen hedh bazat kushtetuese për zhvillimin e veprimtarive fetare dhe i siguron mbrojtje kushtetuese mësimi të fesë në shkollën publike në Shqipëri (Cimbolo, 2013:169).

Përveç nenit 24, Kushtetuta përmban shumë dispozita të tjera, që shërbejnë për të siguruar dhe për të sanksionuar lirinë fetare (Durham, 2004:81) dhe standardet që shteti ka detyrimin për të respektuar dhe mbrojtur (neni. 3).

¹⁸⁵ Po aty,

Bashkëjetesa paqësore fetare ka ekzistuar gjithmonë në realitetin shqiptar. I lidhur me nenin 3 është neni 9, paragrafi 2 i Kushtetutës, i cili ndalon partitë politike dhe organizatat e tjera, aktivitetet programet e të cilëve janë të bazuara në metoda totalitariste, që nxisin urrejtjen apo mbështesin diskriminim racor, fetar, krahinore ose etnik.

Komunitetet fetare janë përcaktuar si “Persona juridik” të pavarur, të vetë-rregulluar dhe janë kufizuar vetëm për të mos ndërhyrë në interesat e palëve të treta. Marrëdhëniet e tyre janë rregulluar me marrëveshje të paraqitura në Parlament për ratifikim. Shteti duhet të përcaktojë ligjin e veçantë, kushtet për të fituar personalitet juridik, por shteti nuk mund të ndërhyjë në rregullat e brendshme të këtyre komuniteteve (Anastasi, 2004:207).

Bashkësive fetare u është njohur autonomia në administrimin e pronave dhe organizimin e brendshëm të tyre. I vetmi kufizim është mbrojtja e interesit të palëve të treta. Ajo i përgjigjet një perspektive sociale dhe ligjore të gjerë, e cila është projektuar për të parandaluar faktin e interesit fetar si interes dominues ndaj interesit të të tjerëve. Norma e lidhur në mënyrë të tërthortë me liritë fetare, është neni 166 i ri i Kushtetutës (Anastasi, 2004:209).

Kushtetuta e Shqipërisë, në pjesën mbi “Forcave të Armatosura” dhe në një nga parimet e saj themeluese, parashikon të drejtën për kundërshtim të ndërgjegjshëm ose e drejta e çdo qytetari të mos kandidojë në një detyrim të përgjithshëm, që kërkohet me ligj, në këtë rast shërbimin ushtarak, në qoftë se bie në kundërshtim me bindjet e tij fetare, ideologjike dhe moralin (Balsamo, 1994:304), parashikimi i kundërshtimit të ndërgjegjshëm në këtë pjesë përbën një element progresiv¹⁸⁶. Që në fillim të vitit 1995, me Ligjin “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” pritej të jepte si

¹⁸⁶Ligji nr. 7978, datë 26 korrik1995, “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

alternativë për të përmbushur detyrimin ushtarak pagesa e një shumë të hollash, që përcaktohej sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e fundit, të bëra në ligjin e mësipërm, sigurojnë mundësinë për kundërshtuesit e ndërgjegjshëm për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak “pa armë”¹⁸⁷.

Kështu, neni 18 i Kushtetutës mbron një parim themelor, atë të barazisë. Të gjithë janë të barabartë para ligjit, pa dallim gjinie, race, feje, etnie, gjuhe, bindjesh politike, fetare dhe filozofike, gjendjes ekonomike, shoqërore, të drejtës për tu arsimuar dhe përkatësisë prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për ndonjë nga arsyet e sipërpërmendura, përveç rasteve të parashikuara paraprakisht (Durham, 2004:85). Shteti garanton me anë të nenit 20, të drejtat e pakicave etnike, që duhet të gëzojnë të njëjtat të drejta dhe liri para ligjit, mund të shprehin lirisht përkatësinë e tyre etnike, kulturore, të arsimohen në gjuhën e tyre amtare dhe të mund të bashkohen në organizata dhe grupe të ndryshme për mbrojtjen e interesave dhe të dinjitetit të tyre (Cimbolo, 2013:169).

Tiparet e veçanta të qytetërimit juridik dhe institucional, përkujdesi ndaj pluralizmit fetar, e bëjnë sistemin shqiptar të aftë t’i garantojë shoqërisë stabilitetin e duhur dhe të shmangë çdo lloj lufte e konflikti fetar, që ka karakterizuar hapësirën ballkanike (Durham, 2004:85).

Së fundmi, neni 167 siguron, që në sistemin juridik shqiptar, të zbatohen vendimet e dala nga Gjykata e Strasburgut. Pra, gjykatat shqiptare janë të detyruara të zbatojnë juridiksionin e Gjykatës së Strasburgut lidhur me lirinë e besimit dhe të ndërgjegjes. Kjo dëshmon se jemi përballë një hapeje të qartë e të padiskutueshme të vendit ndaj garancive të lirisë edhe për çështje të fesë dhe të lirisë së ndërgjegjes, në përputhje me

¹⁸⁷Ligji nr. 9047, datë 10 korrik 2003, “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, nenet. 20-23

traktatet e nënshkruara lirisht, pas mbylljes së epokës së izolimit të plotë të Shqipërisë nga pjesa tjetër e Evropës.

Kështu, duke përmbledhur atë që analizuam më sipër, mund të themi se procesi demokratik në Shqipëri, tashmë i është futur një rrugë të qartë politike dhe ligjore. Ky proces është i vazhdueshëm, është një lëvizje e pandërprerë, që synon gjithnjë përmirësimin (Hazizaj, 2004:179-183). Ligjvënësit shqiptarë kanë punuar për të përshtatur sistemin ligjor në standardet ndërkombëtare, të nevojshme për të realizuar ëndrrën evropiane. Hapi i parë i Shqipërisë, ishte garancia kushtetuese e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë këtu, gjithashtu edhe lirinë e ndërgjegjes dhe besimit. Kështu, ushtrimi i fesë dhe besimit si dhe prania e komuniteteve fetare në vend duhet të jenë në përputhje me legjislacionin dhe konventat ndërkombëtare (Durham, 2004:85).

Lind, në këtë mënyrë, nevoja për të hyrë në veprim legjislacioni për çështjet fetare (Hazizaj, 2004:179-183). Për të ndërtuar kështu marrëdhëniet juridike ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare, për të krijuar një hapësirë të gjerë ligjore për liritë fetare, në përgjithësi, si dhe për të krijuar një hapësirë ligjore të nevojshme për kthimin e pronës së konfiskuar në fund në vitin 1967. Legjislatori i ka parashikuar liritë fetare në ligjin themeltar të shtetit, në Kushtetutë, siç edhe e pamë më lart. Kujtojmë se neni 24 i Kushtetutës garanton dhe mbron lirinë fetare. Shqipëria i ka pranuar dhe i ka të garantuara me kushtetutë liritë fetare, duke krijuar kushtet e nevojshme legjislative për përhapjen në vend të grupeve të ndryshme fetare (Cimbolo, 2013:116).

Demokracia e rilindur shqiptare duhet të dëshmojë se i ka kthyer krahët ateizmit të shtetit në çështje të lirisë fetare, me perspektivën e shumëpritur për t'u bërë pjesë e Bashkimit

Evropian. Qeveria shqiptare ka përparësinë të punojë në një vend ku pluralizmi fetar është traditë e rrënjësuar mes vetë komuniteteve fetare.

2.4.2 Shteti dhe komunitetet fetare, një marrëdhënie në harmoni të plotë

Marrëdhëniet mes shtetit dhe komuniteteve fetare morën një drejtim të ri dhe krejt original pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1998 por pa cenuar traditën e sistemit shqiptar, thellësisht pluralist me grupet fetare dhe në dakordësi të plotë me organizmat e zgjedhur apo emëruar lirisht prej tyre. Normat kushtetuese sanksionojnë lirinë për proselitizëm, rolin “kombëtar” të grupimeve fetare, që shihet dhe vlerësohet si dukuri e përbashkët kolektive për të gjitha shtresat shoqërore, që konvergojnë në interesin e përbashkët të kohezionit dhe bashkimit kombëtar (Cimbolo, 2013:185).

Mungesa e një legjislacioni të posaçëm që rregullon marrëdhëniet e shtetit me komunitetet fetare, do të thotë se Këshillit të Ministrave të Shqipërisë i duhej të ndër marrë disa veprime legjislative për të përmbushur nevojat në legjitimitimin e aktivitetit të bashkësive fetare.

2.4.2.1 Krijimi i “Komitetit Kombëtar për Kultet”, Vendimi i qeverisë Nr.459, datë 23.9.1999

Pasi u mbushën thujt dhjetë vjet nga rihapja e komuniteteve fetare, qeveria shqiptare ndjeu nevojën e rregullimit të marrëdhënieve të ndërsjella me to, kështu që në vitin 1999

u themelua “Komiteti Shtetëror për Kultet”¹⁸⁸, para të cilit shtroheshin të gjitha çështjet e hapura me komunitetet fetare e veçanërisht, zhvillimi i negociatave për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, sipas nenit 10 të Kushtetutës. Kështu, sistemi i Republikës së Shqipërisë favorizon përdorimin e legjislacionit për rregullimin e çështjeve të lirisë fetare vetjake dhe kolektive dhe shfrytëzon mjete juridike të posaçme për t’i konkretizuar këto të drejta, gjë që e dëshmon nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit, konfigurimi juridik i të cilave është i ngjashëm me atë të ligjeve të negociuara (Cimbolo, 2013:187).

Krijimi i “Komitetit Shtetëror për Kultet” ka si qëllim të lehtësojë krijimin, modifikimin, mbylljen e marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare që kanë për qëllim punët e fesë, në respekt të ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Pika e parë vendimmarrëse përcakton krijimin e këtij organizmi të quajtur “Komiteti Shtetëror për Kultet”, veprimtaria e të cilit ka si qëllim vendosjen e marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare apo organizatave të ndryshme fetare, nën vartësinë e Këshillit të Ministrave.

Sipas pikës 2 të vendimit, “Komiteti Shtetëror për Kultet” përgjigjet përpara Këshillit të Ministrave për veprimtarinë e tij. Ai rregullon marrëdhëniet me komunitetet fetare, shoqatat, fondacionet fetare ose humanitare-fetare, negocion për përgatitjen e marrëveshjeve ndërmjet përfaqësuesve të bashkësive fetare dhe Këshillit të Ministrave, është asnjans në çështjet e besimit, njeh barazinë e bashkësive fetare dhe respekton pavarësinë e tyre (Cimbolo, 2013:187). Gjithashtu, punon për garantimin e lirisë së besimit dhe për zhvillimin, bashkëpunimin, mirëkuptimin e tolerancën ndërfetare në

¹⁸⁸shih: “Për krijimin e komitetit shtetëror për kultet”. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 459, datë 23 shtator 1999, <http://icodu.cois.it/305/view..>

Shqipëri, ndihmon dhe mbështet veprimtaritë e mirëfillta fetare, bazuar në Kushtetutën dhe në ligjet përkatëse, që rregullojnë problemet konkrete¹⁸⁹, merr pëlqimin e qeverisë për mundësinë e hapjes së shkollave private dhe të instituteve shkollore, ku jepen mësim për fenë, duke mbajtur parasysh ndarjen administrative të territorit (Cimbolo, 2013:187). Qeveria, gjithashtu, bashkëpunon me bashkësitë fetare për përgatitjen e projektligjeve dhe të akteve nënligjore, që kanë të bëjnë me kultet fetare¹⁹⁰. Kështu pra, Komiteti duhet të ndjekë parimin e barazisë për trajtimin e komuniteteve fetare dhe të respektojë pavarësinë e tyre sepse sipas parimeve të sipërpërmendura, Komiteti duhet të ruajë barazinë dhe të njohë autonominë e përbërësve shoqërorë e fetarë.

Struktura organizuese dhe rregullorja e funksionimit të “Komiteti Shtetëror për Kultet” miratohen nga Kryeministri¹⁹¹.

Duke përmbledhur mund të themi se “Komiteti Shtetëror për Kultet” është një institucion kombëtar i veshur me personalitet juridik dhe varet nga Këshilli i Ministrave. Drejtori dhe katër anëtarët që përbëjnë këtë Komitet, emërohen nga Këshilli i Ministrave. Për zgjedhjen e këtyre funksionareve, Këshilli i Ministrave duhet të mbajë parasysh parimet e paanshmërisë së shtetit dhe barazinë mes komuniteteve fetare, si dhe faktin që vendimet e marra duhet të pasqyrojnë identitetin dhe vlerat e komuniteteve fetare. Struktura dhe rregullorja për veprimtarinë e Komitetit miratohen nga

¹⁸⁹ Bashkëpunon me komunitetet fetare për hartimin e projektligjeve dhe për punët që i takojnë, bazuar në nenin 10 të Kushtetutes, Komiteti i hap rrugë legjislationit të negociueshëm.

¹⁹⁰ Sipas pikës 2 të vendimit, i paraqet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës mendimin e tij lidhur me planin mësimor, programet lëndore dhe teksetet e pjesës jolaike, për kërkesat e paraqitura për hapjen e institucioneve arsimore jopublike, institucioneve arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare dhe në bashkëpunim me atë institucion, në varësi të ndarjes administrative territoriale, të nevojave e interesave të përbashkëta ekonomike dhe të traditës historike e fetare, përcakton dhe numrin e institucioneve arsimore jopublike dhe institucioneve plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare. Në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe me komunitetet fetare interesohet për ruajtjen e vlerave të objekteve të kultit. Vendos dhe zhvillon lidhje me institucionet homologe të vendeve të tjera e të diasporës. I paraqet Ministrisë së Financave mendimin e tij lidhur me hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të mallrave me karakter fetar për komunitetet fetare dhe për përjashtimin e tyre nga taksa doganore, në përputhje me ligjet në fuqi.

¹⁹¹ “Për krijimin e komitetit shtetëror për kultet”, <http://licodu.cois.it/305/view>

Kryeministri, sipas propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave (Cimbolo, 2013:190).

2.4.2.2 Ligji “Për organizatat jofitimprurëse” Nr.8788, datë 7.5.2001, në rregullimin e marrëdhënieve me komunitetet fetare

Edhe pse besimet fetare, në një formë a në një tjetër, e kishin rifituar personalitetin juridik, kjo nuk i jepte zgjidhje problemit të njohjes së personalitetit juridik të Kishës Katolike e as komuniteteve të tjera fetare (Kadare, 2004:31-46) e aq më pak kulteve të reja që u shfaqën në Shqipërinë e viteve '90, prandaj si Këshilli i Evropës, ashtu edhe Komisioni i Venecias kërkonin rregullimin me ligj të tyre. Garantimi i lirisë për pjesëmarrje në një grupim të caktuar fetar është e drejtë e të gjithëve, në sintoni të plotë me parimin e ndarjes dhe të laicizmit të shtetit

Ligji i miratuar në vitin 1993 “Për fondacionet” nuk ishte i mjaftueshëm për rregullimin e aspektit juridik të komuniteteve apo shoqatave të tjera të bamirësisë¹⁹². Lindi, kështu, nevoja për miratimin e një ligji të detajuar dhe gjithëpërfshirës për rastin e organizatave jofitimprurëse¹⁹³, hartimi i të cilit do tu jepte zgjidhje këtyre problemeve me anë të normave të së drejtës së përbashkët, bazuar në traditën e ndarjes mes shtetit dhe fesë në sistemin shqiptar¹⁹⁴.

¹⁹²Ndërkohë që ligji i vitit 1956 “Mbi organizatat shoqërore jofitimprurëse” ishte shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Kodit të ri Civil 1994, neni 1167

¹⁹³Ligji nr.8788, datë 7.5.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, <http://licodu.cois.it/610/view>

¹⁹⁴Neni 51 i ligjit shfuqizon ligjin e mëparshëm nr.7695, date 7.4.1993 “Për fondacionet”, <http://licodu.cois.it/609/view>.

Ligji “Për organizatat jofitimprurëse” Nr. 8788, datë 7.5.2001¹⁹⁵ u përdor në rregullimin e marrëdhënieve me komunitetet fetare. Ky ligj shfuqizon Ligjin Nr.7695, datë 7.4.1993 “Për Fondacionet”. Ky ligj u përgjigjet plotësisht të gjitha nevojave të karakterit juridik, me të cilat mund të përballlet një komunitet fetar apo edhe grupet fetare të sapo vendosura në vend.

Neni 1 i ligjit, pasi përcakton kuadrin e zbatimit ligjor, shpreh normat për krijimin, regjistrimin, administrimin, organizimin dhe funksionimin e organizatave jofitimprurëse që veprojnë për të mirën dhe interesin publik, me vetëdijen se në mesin e tyre mund të përfshihen edhe ato organizata që bëjnë propagandë fetare. Pika 3 e nenit 2, thotë se ligji njeh si organizata jofitimprurëse shoqatat, fondacionet dhe qendrat, veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe të pandikuar nga shteti¹⁹⁶. Duhet të mbajmë parasysh se strukturat organizuese, që rregullon ky ligj, nuk duhet të kenë qëllim fitimprurës. Veprimtari të tilla mund të zhvillohen edhe nga shtetas të huaj¹⁹⁷.

Me veprimtari shoqërore nënkuptohet përkujdesje shëndetësore, ofrimi i shërbimeve dhe asistencës sociale, zhvillimi i arsimit dhe ngritja e shkollave, qoftë edhe për formim shpirtëror, pra veprimtari, që përfshijnë edhe besimet fetare (Della Roca, 1994:304). Neni 3 i këtij ligji përjashton nga kuadri i zbatimit të këtyre normave sindikatat, partitë politike dhe organizatat e tjera jofitimprurëse, ndërkohë që i njeh kujt do të drejtën të bëjë pjesë në një organizatë kolektive, pa qenë nevoja që kjo të jetë medoemos e regjistruar si organizatë jofitimprurëse (Cimbolo, 2013:174).

¹⁹⁵ Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi, ligjin “Për organizatat jofitimprurëse” nr. 8788, datë 7.5.2001

¹⁹⁶ Neni 3, pika 2 Ligji “Për organizatat jofitimprurëse” nr. 8788, datë 7.5.2001 <http://licodu.cois.it/?p=333>

¹⁹⁷ Ligji thekson se veprimtaria shoqërore, duhet të synojë të mirën dhe interesin publik, në mënyrë që të përfitojë mbështetjen ligjore.

Në kreun e dytë të ligjit vendosen parimet e përgjithshme, sanksionohet e drejta e çdo personi fizik ose juridik, vendas ose i huaj për themelimin e ndonjë organizate jofitimprurëse apo për të qenë anëtar ose pjesë e organeve drejtuese të saj, si dhe pjesë e personelit administrativ të kësaj organizate¹⁹⁸. Pa e humbur pavarësinë e tyre, kërkohet që gjatë gjithë veprimtarisë dhe administrimit të tyre të brendshëm, këto shoqata (neni 5) të respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj¹⁹⁹. Përveç rasteve të parashikuara me ligj²⁰⁰, autoriteti i shtetit synon të mos ndërhyjë në punët e organizatave jofitimprurëse dhe të mos bëhet pengesë për veprimtarinë e tyre. Me qëllim që tu sigurojë autonomi të plotë organizatave në fjalë, ligji njeh lirinë e vullnetit për pjesëmarrje në to, fikson numrin pesë për themelimin e tyre por, lë të hapur mundësinë që organizata të mund të formohet edhe nga shoqata të tjera ekzistuese (Cimbolo, 2013:175). Kjo i mundëson një grupi organizatash, të cilat më parë funksiononin të ndara formalisht nga njëra-tjetra, të riorganizohen për të arritur qëllimin e përbashkët të tyre. Për të siguruar sa më mirë lirinë e bashkëpunimit brenda organizatës, ligji garanton të drejtën e shkëputjes kurdo prej saj, duke respektuar lirinë e secilit e në të njëjtën kohë, mundësinë e organizatës për të ndjekur synimet e saj dhe për të ngritur një strukturë që i vjen për shtat komunitetit fetar²⁰¹.

Organizatat jofitimprurëse kanë të drejta dhe përmbushin detyrimet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në dispozita të tjera ligjore²⁰². Qendra krijohet nga një a më shumë persona fizikë a juridikë me akt

¹⁹⁸ Kjo u siguron mundësinë të gjithëve edhe shtetasve të huaj të zhvillojnë veprimtarinë e tyre pranë këtyre organizatave, çka e shmang pengesën që i privon ata nga detyra e drejtuesit të kultit, në mungesë të shtetësisë shqiptare.

¹⁹⁹ Shteti krijon kushtet për lehtësimin e praktikave dhe mjeteve për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tyre, pa anashkaluar kushtëzimet dhe caqet përkatëse, të parashikuara me ligj

²⁰⁰ Neni 7, Ligji “Për organizatat jofitimprurëse” nr.8788, datë 7.5.2001 <http://licodu.cois.it/?p=333>

²⁰¹ Po aty, Neni 10

²⁰² Po aty, Neni 8

noterial²⁰³. Për themelimin, organizimin dhe funksionimin e qendrës zbatohen dispozitat ligjore përkatëse të fondacionit, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj dhe dispozita të tjera ligjore²⁰⁴. Gjithashtu, për tu siguruar liri të plotë organizative, parashikohet edhe mundësia e krijimit të organizatave, të cilat nuk kanë kurrfarë detyrimi të regjistrohen në gjykatat civile dhe si të tilla, nuk e përfitojnë statusin e personalitetit juridik civil, por mbeten thjesht shoqata²⁰⁵. Organizatat jofitimprurëse mund të kenë selitë e tyre lokale ose filialin në territorin shqiptar dhe nëse nuk gëzojnë personalitet juridik të pavarur, po ashtu u lejohej të ngrenë filial jashtë vendit për shkak të natyrës së tyre fetare. Edhe organizatat jofitimprurëse mund të veprojnë në Shqipëri²⁰⁶, me kusht që veprimtaria e tyre të mos bjerë ndesh me Kushtetutën e vendit dhe pasi të jenë regjistruar në gjykatë, ashtu siç e sanksionon ligji.

Organizatat jofitimprurëse mund të mbledhin fonde, donacione dhe mund të marrin pjesë në të njëjtat kushte me ente të tjera juridike. Shteti i heq organizatave detyrimin e taksës mbi të ardhurat e përfituara nga donacionet dhe nga ndihmat që mbërrijnë prej enteve të ndryshme në shërbim të veprimtarisë së tyre. Personat fizikë dhe juridikë që u ofrojnë ndihmën e tyre nëpërmjet donacioneve organizatave jofitimprurëse, fitojnë të drejtën për lehtësim të taksave mbi të ardhurat e tyre, sipas parashikimit me ligj²⁰⁷. Për atë që i cakton ligji shteti merr përsipër të mbikëqyrë organizatat jofitimprurëse²⁰⁸.

²⁰³ Neni 11, pika2

²⁰⁴ Neni 11 pika4

²⁰⁵ Kjo ndodh, jo vetëm për të respektuar autonominë për t'u organizuar, por edhe për t'u ardhur në ndihmë grupimeve të ndryshme gjatë fazës së parë të themelimit të një shoqate, së cilës i nevojitet kohë për t'u strukturuar në nivelet e duhura. Ligji përcakton, me anë të nenit 11, domethënien e termit *Qendër përkatësie*, që nënkupton një person juridik, që synon të ofrojë shërbime dhe të realizojë projekte në të mirë të interesit publik, por pa ushtruar aktivitet tregtar. Ajo mund të themelohet me një akt noterial me kërkesë të themeluesit të saj dhe, në të, mund të bëjnë pjesë një ose më shumë persona fizikë ose juridikë.

²⁰⁶ Neni 12

²⁰⁷ Shih nenin 41, Për organizatat jofitimprurëse, Ligji nr. 8788, datë 7.5.2001

²⁰⁸ Po aty, Neni 44,

Neni 44 pohon “Gjykatësi mund të vendosë për shkrirjen e organizatës jofitimprurëse, bazuar në kërkesën e anëtarëve të saj, të organeve të saj vendimmarrëse, ndërsa organizmi shtetëror është kompetent kur: a) Veprimtaria e organizatës jofitimprurëse bie ndesh me Kushtetutën; b) Organizata jofitimprurëse ka kryer veprë penale; c) Organizata jofitimprurëse nuk kryen detyrimet tatimore të parashikuara në ligj; d) Organizata jofitimprurëse ka falimentuar sipas ligjeve të falimentimit”. Gjithashtu, dhe kur aktiviteti i organizatës përbën rrezik për publikun, gjykatësi i dërgon si masë paraprake organizatës, një ankesë me shkrim, duke i lënë 30 ditë në dispozicion për të korrigjuar mënyrën e saj të veprimit²⁰⁹.

Ligji “Për shoqatat jofitimprurëse” përfundon me disa dispozita kalimtare, që rregullojnë çështjen e mbylljes së aktivitetit të këtyre shoqatave, të cilat nëse kanë interes, mund ta vazhdojnë veprimtarinë tyre duke u mbështetur në kuadrin e ri legjislativ, po të riorganizohen në harkun kohor prej një viti për tu përshtatur me gjendjen e re juridike²¹⁰. Regjistrimi rregullohet nga një ligj i veçantë²¹¹.

2.4.2.3 Marrëveshjet mes shtetit shqiptar dhe komuniteteve fetare

Tashmë, procesi demokratik në Shqipëri ka fituar një pamje të qartë politike dhe ligjore.

Ky proces është i vazhdueshëm, është një lëvizje e pandërprerë përmirësimi (Hazizaj,

²⁰⁹ Shkrirja e një organizate jofitimprurëse mund të bëhet me kërkesën e organit mbikëqyrës apo të ortakëve.

²¹⁰ Po aty, neni 49

²¹¹ Procedurat për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse në gjykatë dhe për depozitimin e akteve të tyre në regjistrin përkatës rregullohen me ligj të veçantë. Ligj nr. 8789, datë 7.5.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”. Tashmë, përcaktohet konkretisht gjykata kompetente për mbajtjen e regjistrit të organizatave jofitimprurëse, mbahet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës. Ndërkohë, në kreun e VIII tek dispozitat e fundit, përcaktohet edhe regjistrimi i shoqatave dhe i fondacioneve të regjistruara më parë. Neni 40, Rregjistrimi i shoqatave dhe i fondacioneve të regjistruara më parë brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, gjykatat e rretheve gjyqësore janë të detyruara të transferojnë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës aktet e regjistrimit të shoqatave dhe të fondacioneve, si dhe dokumentacionin shoqëruar të regjistrimit.

2004:179-183). Harmonia dhe toleranca fetare janë vlera në shoqërinë shqiptare. Gjithashtu, në asnjë rrethanë sociale apo politike, komunitetet fetare nuk shfaqën konflikt fetar, por kontribuan për zgjidhjen e çështjeve sociale dhe politike (Hazizaj, 2004:181). Problemet, që bashkësitë fetare në Shqipëri kanë pasur në ushtrimin e aktiviteteve të tyre, të identifikuar me statuset e tyre ligjore, me regjistrimin e tyre në gjykata si dhe në marrëdhëniet me shtetin (Anastasi, 2004:211).

Marrëveshjet janë mjete për garantimin e të drejtave të sanksionuara në Kushtetutë për komunitetet nënshkruese, sipas një shkalle prioritetesh të ndryshme të përcaktuara prej tyre, por që konvergojnë në njohjen e rëndësisë për rolin e strukturës fetare. Është gjë e veçantë që liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë të garantohet në marrëveshje me komunitetet fetare, madje, në këtë pikë, marrëveshjet dallojnë mes tyre. Nënshkrimi i marrëveshjes midis shtetit shqiptar dhe komuniteteve fetare do t'i hapë rrugë hartimit dhe miratimit të një pakete ligjore, e cila mbush vakumin ligjor që ekzistonte në vend, lidhur me financimin e komuniteteve fetare, sistemin arsimor fetar dhe kthimin e kompensimin e pronave të këtyre komuniteteve (Pano, 2003:158). Kjo përbën një investim serioz për sigurinë kombëtare.

Duke i rregulluar marrëdhëniet përmes marrëveshjeve mes qeverisë shqiptare dhe komuniteteve fetare, qeveria shqiptare ka ndërmarrë hapa, së pari me Kishën Katolike dhe më pas, me të gjithë bashkësitë e tjera fetare. Kështu, më 23 Mars të vitit 2002 u firmos marrëveshja e parë mes Selisë së Shenjtë dhe Republikës së Shqipërisë dhe u miratua nga Parlamenti më 21 Shtator 2002. Kjo shënoi mbylljen e një faze të gjatë përballjesh në marrëdhëniet mes shtetit dhe Kishës Katolike dhe vendosjes së marrëdhënieve të ndërsjella, të cilat do t'i japin liri të plotë veprimi Kishës Katolike, gjithashtu, po aq, e çlirojnë Shqipërinë nga dyshimet e forta, që ngrinte komuniteti

ndërkombëtar për sjelljen e gjatë armiqësore të shtetit shqiptar kundrejt komuniteteve fetare (Pano, 2003:159).

Në mbështetje të nenit 10, pika 5, e nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të nenit 7 të Ligjit Nr.8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave lidh marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë ²¹² për rregullimin e marrëdhënieve reciproke, e cila sanksionon se Republika e Shqipërisë garanton lirinë për të shpallur dhe praktikuar në publik Fenë Katolike. Kisha Katolike në Shqipëri ka të drejtë të organizohet dhe të plotësojë misionin e saj²¹³. Po ashtu, Republika e Shqipërisë njeh zotësinë juridike të personave ligjore për entitete të tilla të Kishës Katolike, të cilat janë të parashikuar në të Drejtën Kanonike, si arkidioqezat, dioqezat apo administratat apostolike, famullitë, bashkësitë fetare, misionet, shoqatat, seminarët, shkollat dhe institucionet arsimore të të gjitha niveleve, institucionet shëndetësore, mbas regjistrimit të tyre nga organet e drejtësisë²¹⁴. Personat juridikë kishtarë gëzojnë të gjitha të drejtat dhe përbushin të gjitha detyrimet e parashikuara nga dispozitat e Kodit Civil dhe të normave të tjera juridike në fuqi për të gjithë personat juridike, ndërsa në përputhje me të drejtën kanonike, ata mund t’i modifikojnë dhe t’i shfuqizojnë këto norma. Njohja e tyre bëhet pasi përfaqësuesi ligjor të ketë dorëzuar, në Gjykatën e Tiranës, kërkesën të shoqëruar me aktin juridik të themelimit të entit kishtar të miratuar nga autoriteti kompetent i Kishës. Gjykata e Shkallës së Parë e Tiranës, brenda 30 ditëve nga data e kërkesës dhe dorëzimit të dokumentacionit, bën njohjen e personalitetit juridik dhe

²¹²Vendim Nr. 96, datë 21.3.2002 “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”

²¹³ Neni 1

²¹⁴ Neni 2

regjistrimin e Kishës me anë të miratimit të këtij vendimi²¹⁵. Në bazë të marrëveshjes shpallet liria e ushtrimit në publik të fesë katolike dhe gjithashtu, si edhe për besimet e tjera fetare pohon të drejtën e Kishës Katolike për të kryer veprimtarinë e saj (Durham, 2004: 85). Kishës i njihet personaliteti juridik publik i institucioneve të saj. Sipas nenit 3 Selia e Shenjtë dhe Kisha Katolike në Shqipëri gëzojnë lirinë e plotë të komunikimit dhe të korrespondencës me njëra-tjetrën. Kisha Katolike ka të drejtë të posedojë mjete të veta të komunikimit masiv dhe ka të drejtën të përdorë mjetet publike të komunikimit masiv, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë²¹⁶. Neni 5 i marrëveshjes thotë se autoriteti kompetent kishtar ka të drejtë të krijojë strukturat përkatëse të Kishës, e në veçanti të krijojë dhe të modifikojë personat juridikë kishtarë, në përputhje me të Drejtën Kanonike dhe duke respektuar ligjet shqiptare. Neni 6 lejon klerikët e huaj që me anë të leje-qëndrimit nga qeveria shqiptare, të ushtrojnë funksionet e tyre pranë Kishës Katolike. Marrëveshja i garanton Selisë së Shenjtë dhe Kishës Katolike në Shqipëri lirinë e plotë të komunikimit dhe të korrespondencës, Kisha Katolike mund të ngrejë dhe drejtojë shkolla, spitale, klinika dhe qendra shoqërore, në përputhje me ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë (Anastasi, 2004:2011). Sipas nenit 8, Republika e Shqipërisë do të rikthejë pasuritë e këtij besimi fetar, sipas ligjeve shqiptare dhe do të mbështesë regjistrimin për herë të dytë të tyre në emër të Kishës Katolike, pranë zyrave kompetente të Republikës²¹⁷. Për çështje të veçanta, mund t'i referohet legjislacionit të përbashkët dhe organit të “Agjencisë për kthimin dhe kompensimin e pronës”. Neni 9 dhe 10 i’u jep zgjidhje mosmarrëveshjeve të mundshme. Kështu, në rastet e çështjeve të dyshimta, të pazgjidhura dhe të diskutueshme, të cilat kanë të bëjnë me Kishën Katolike në Shqipëri,

²¹⁵ Kjo procedurë nuk është aspak e ndryshme nga ajo e parashikuar në ligjin për shoqatat jofitimprurëse, sipas së cilës enti ka detyrimin të regjistrohet pranë zyrave të tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve të parashikuara me ligj, në varësi të aktivitetit që ushtron.

²¹⁶ Vendim Nr. 96, datë 21.3.2002 “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, neni 4

²¹⁷ Po aty, neni 8

në përgjithësi ose me komunitetet apo institucionet katolike në veçanti, Kisha Katolike në Shqipëri dhe autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë do të krijojnë një komision “ad hoc”, të përbashkët me detyrën për të gjetur zgjidhje të pranueshme nga të dyja palët.

Marrëveshja mbi çështjet juridike të nënshkruara nga palët, përbën një pikë referimi nga ku rrjedhin aktet e mëtejshme normative dhe marrëveshje që kthehen në ligje të zakonshme apo në norma rregulluese, ndërsa negociatat për përcaktimin e marrëveshjeve rreth çështjeve të tjera vijojnë ende. Kështu, nuk është e pazakontë që, në vitin 2002, u miratua një ligj, i cili i përjashton komunitetet fetare nga barra e taksës lokale mbi pasuritë e paluajtshme dhe transferimin e pasurisë²¹⁸. Kjo masë, që rregullon edhe shoqatat jofitimprurëse, ka për qëllim garantimin e aktiviteteve të ushtruara nga kultet e tjera, të cilët ndihmohen nga persona moralë për përmbushjen e funksionit të tyre shoqëror, nëpërmjet aktiviteteve që kryhen pa qëllim fitimi²¹⁹.

Negociatat ndërmjet tri komuniteteve të tjera fetare, historikisht të pranishme në Shqipëri dhe Komitetit Shtetëror për Kultet do të çojnë në nënshkrimin e marrëveshjes mes shtetit shqiptar dhe secilit prej këtyre bashkësive fetare, në tetor 2008. Kështu, u vendosën marrëveshjet e bashkëpunimit mes Shtetit Shqiptar dhe Myslimanëve Sunitë, Bektashianë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Siç edhe u përmend, për të fituar personalitetin juridik civil, komunitetet fetare, nënshkruese të marrëveshjes, duhet të paraqesin kërkesë pranë Gjykatës së Tiranës, por edhe këtu udhëzimet ndahen²²⁰.

Myslimanët dhe Bektashinjtë duhet ta paraqesin kërkesën nëpërmjet përfaqësuesit të tyre

²¹⁸Ligj nr. 8982, 12.12.2002, “Për sistemin e taksave vendore”<http://licodu.cois.it/593/view>

²¹⁹Ajo lidhet edhe me aktivitetin e “Agjencisë për kthimin dhe kompensimin e pronave”, që ka si qëllim t’u japë zgjidhje çështjeve të shumta, që presin kthimin e të mirave të shpronësuara pas vitit 1945 ose mundësinë e dëmshpërblimit për të mirat e pakthyeshme

²²⁰Juridiksioni i besimeve fetare shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përjashtuar atë Bektashian, që ka shtrirje ndërkombëtare.

ligjor, kërkesë, e cila duhet shoqëruar me aktin themeltar, ku tregohet vendi i selisë: natyra dhe veprimtaria e komunitetit; statuti, që hedh dritë mbi organet dhe detyrat funksionarëve e tyre, të dhëna për të ardhurat financiare në zotërim si dhe mirëkuptimin për mënyrat e humbjes së personalitetit juridik. Krahas kësaj, kërkohet edhe pëlqimi i Komitetit Shtetëror për Kultet, i cili konfirmon njohjen e misionit fetar të atij që shtron kërkesën. Në rastin e Kishës Ortodokse, Gjykata e Tiranës bazohet në veprimtarinë e mëparshme por, kjo nuk e përjashton nga detyrimi i formulimit të kërkesës për dhënien e personalitetit juridik dhe të hartimit të statutit. Brenda tridhjetë ditëve nga depozitimi i kërkesës, Gjykata e Tiranës u bën të ditur vendimin e saj të gjithë të interesuarve (Cimbolo, 2013:226).

Në nenin 10 të marrëveshjes, komunitetet fetare marrin përsipër të respektojnë Kushtetutën dhe ligjet e shtetit, ndërkohë që ky u njeh të drejtën për tu organizuar dhe për të ushtruar veprimtarinë e tyre në pavarësi të plotë, duke i qëndruar besnik parimit të ndarjes mes komuniteteve fetare dhe shtetit. Kjo bëhet në të mirë të interesit kombëtar, të ndarjes, të laicitetit, të pluralizmit, pra të bashkëjetesës dhe tolerancës së plotë mes komuniteteve të ndryshme fetare, parime këto në të cilat duhen mbështetur statutet e tyre (Cimbolo, 2014:226). Marrëveshja siguron edhe autonominë organizuese të komuniteteve fetare për sa e shihet të mundshme kryerjen e roleve statusore. Emrat e atyre që ngarkohen me poste drejtuese për komunitetin i duhen bërë me dije “Komitetit Shtetëror për Kultet”, në mënyrë që tu garantohet liri e plotë në ushtrimin e veprimtarisë së tyre fetare, administrative dhe organizuese, gjithnjë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet. Marrëveshja garanton, gjithashtu, të drejtën e komunitetit fetar për të pasur lidhje me komunitetet fetare të huaja dhe të pranojnë prej tyre apo individëve të huaj ndihma,

qoftë edhe në të holla por me kushtin që aktivitetet e kryera të mos cenojnë rendin e brendshëm, atë ndërkombëtar, legjislacionin në fuqi dhe vetë marrëveshjen.

Marrëveshjet u ndërtuan me dispozita të përbashkëta, pa anashkaluar ato ndryshime të veçanta që lindin për shkak të traditës apo nevojave të secilit komunitet, e për rrjedhojë, natyrshëm, gjejnë pasqyrim në statutet përkatëse. Komunitetet e tjera tradicionale në vend si ato Sunite, Bektashiane, Ortodokse, nënshkruan marrëveshjet bashkëpunimit në vitin 2009²²¹. Bazuar në nenin 10 të Kushtetutës, palët nisën nënshkrimin e marrëveshjeve të ndërsjella, që u ratifikuan nga Këshilli i Ministrave, i cili i'a paraqet për miratim Parlamentit, duke vijuar më pas me publikimin e ligjit përkatës (Cimbolo, 2013:3). Delegacionet negociuese ngrihen nga Komiteti Shtetëror për Kultet dhe nga përfaqësues të nivelit të lartë të komuniteteve, të cilët kanë hartuar statutet përkatëse²²². Edhe pse skema e marrëveshjes dhe një pjesë e mirë e neneve janë identike, palët duhet të mbajnë parasysh natyrën e ndryshme juridike për secilin komunitet. Kështu pra, marrëveshja ka miratimin e të gjitha komuniteteve, lidhur me tekstin e përbashkët ku përcaktohen qëllimet, mbështetet në dispozitat kushtetuese dhe ligjet në fuqi, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për interpretimin që i bëhet zbatimit të marrëveshjes.

Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve nuk cenon laicitetin e shekullarizimin, të cilat janë të shenjta për një shtet demokratik. Marrëveshjet nuk cenojnë të drejtën e besimit të

²²¹Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Islam Shqiptar për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta”, Ligji nr. 10056, datë 22.01.2009, <http://licodu.cois.it/622/view>; Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta” Ligji nr. 10057, datë 22. 01.2009,

Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshit Botërore Bektashiane për rregullimin e Marrëdhënieve të ndërsjellta” Ligji nr. 10058, datë 22.01.2009, <http://licodu.cois.it/623/view>;

²²²Statutet e Komunitetit Musliman të Shqipërisë, Tiranë 14. 05. 2005, <http://licodu.cois.it/632/view>; Statuti i Kryegjyshit Botërore Bektashiane, Tiranë, më 06 . 07 . 2009, [http://licodu.cois.it/617 /view](http://licodu.cois.it/617/view); Statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, 04. 11 .2006, Tiranë, <http://licodu.cois.it/641/view>

njerëzve si një e drejtë e jetës private, e cila njihet dhe mbrohet në të gjitha dokumentet ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Përkundrazi, me qëllim që liria e besimit të mos mbetet deklarative, shteti ka për detyrë që të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar gëzimin efektiv të kësaj lirie, për ta mbrojtur atë, sidomos nga ndërhyrjet, të cilat synojnë të nxisin deformime, prirjeve ekstremizuese apo të çdo shfaqjeje tjetër ashpërsie në mjediset e besimtarëve (Cimbolo, 2013:223).

Marrëveshjet e nënshkruara me komunitetet fetare janë tepër të rëndësishme sepse ndër të tjera, për herë të parë pas vendosjes së demokracisë, bëhen përpjekje për ta disiplinuar në rrugë ligjore sistemin arsimor fetar në vend. Në akt-marrëveshjet me komunitetet fetare, shteti i'u njeh të drejtën që ato “në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, të ngrejnë dhe të administrojnë institucione edukative dhe arsimore të të gjitha niveleve” por, vetëm në bashkëpunim me shtetin. Komunitetet fetare duhet të hartojnë kurrikulat përkatëse për shkollat fetare jopublike, si dhe bëjnë vlerësimin dhe çertifikimin e personelit pedagogjik. Për miratimin e tyre ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kjo është e një rëndësie të veçantë, pasi edukimi fetar, për kushtet e vendit tonë, që ka një popullsi relativisht të vogël, me katër besime fetare tradicionale, nuk mund të jetë thjesht një problem pedagogjik dhe arsimor, por ai ka ndikimet e tij edhe në sigurinë kombëtare.

Shteti shqiptar u njeh komuniteteve të drejtën për t’ju dhënë jetë strukturave të tyre, të cilat mund të fitojnë aty për aty njohjen e personalitetit juridik civil, duke fituar të drejtën e vetëorganizimit të strukturave përkatëse fetare, menjëherë pas dorëzimit të draftit të marrëveshjes për themelimin e tyre pranë Komitetit Shtetëror për Kultet. Si komunitetet, ashtu edhe çdo degëzim i tyre janë persona juridikë jofitimprurës, prandaj mbi to

zbatohet legjislacioni për çështjet financiare dhe juridike, i parashikuar për këto shoqata²²³.

Njëkohësisht, u jepet garanci komuniteteve për ushtrimin e veprimtarive shoqërore me karakter ekonomik, edukativ dhe shëndetësor dhe për ngritjen e organizatave humanitare, qoftë edhe në formën e shoqatave jofitimprurëse (Cimbolo, 2013:222). Shteti Shqiptar, duke qenë se u njeh komuniteteve fetare një rol pozitiv në jetën shoqërore, parashtron në nenin 13 të marrëveshjes disa norma për çështje të financimit nga shteti dhe dhënies së ndihmave materiale si për organet qendrore, ashtu dhe për entet e ngritura nga komunitetet fetare. Masa të tilla parashikohen në një ligj të veçantë, të miratuar në maj të vitit 2009²²⁴, i cili u rezervon disa lehtësira komuniteteve fetare nënshkruese të marrëveshjes. Në nenin 2 thuhet: *“Shteti mund të financojë pjesërisht komunitetet fetare për ndërtimin apo mirëmbajtjen e godinave të kultit si dhe për rinovimin dhe restaurimin e qendrave të tyre të pelegrinazhit dhe strukturave ndihmesë të tyre, objektet që lidhen me turizmin fetar, sipas projekteve të paraqitura nga komunitetet fetare, nga shteti apo Komuniteti shtetëror për kultet dhe të miratuara nga ministria kompetente, Këshilli i Ministrave përcakton masën e këtyre financimeve, duke iu përmbajtur minimumit të shumës që është sa gjysma e buxhetit minimal për nëpunësit e personelit, bazuar në dëshminë e pagave që i paraqitet institutit kompetent për sigurime shoqërore”*.

Tek përmbajtja e marrëveshjeve, vihet re ndonjë dallim që ka të bëjë me rregullat e zhbërjes së saj sepse nëse është e vërtetë se pranohet prej të gjithëve që zgjidhja e

²²³Sipas prof Cimbolo, shpeshherë ka rikthim tek ligji “Për organizatat jofitimprurëse”, nr. 8788, datë 7.5.2001, <http://licodu.cois.it/610/view>, i cili përbën një mjet kryesor për entet e komunitetit fetar që përdorin për t’u strukturuar si organizata në shërbim shoqëror dhe për kryerjen e veprimtanserisë së tyre. Ligji lidhur me marrjen e personalitetit juridik për personat juridike të Kishës Katolike të vitit 2005 nga njëra anë dhe marrëveshjet e nënshkruara në vitin 2009 me komunitetet fetare nga ana tjetër, shërbejnë si mjete të veçanta, që mundësojnë ngritjen e enteve fetare, falë një procedure, në thelb të njëjtë me atë të parashikuar në ligj.

²²⁴ Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave, Ligj nr. 10140, 15.5.2009, <http://licodu.Cois.it/612/view>

mosmarrëveshjeve të bëhet duke rënë në ujdë mes palëve, duket se Bektashinjtë i'a besojnë Komitetit Shtetëror për Kultet këtë rol të veçantë ndërmjetësimi (Cimbolo, 2013:232).

Shqipëria përmbyll kështu kuadrin normativ lidhur me marrëdhëniet me kultet kryesore në vend (Cimbolo, 2013:232). Komunitetet fetare, të veshura me personalitet juridik të së drejtës civile, fitojnë dinjitet të plotë juridik dhe gëzojnë trajtim të njëjtë nga ana e shtetit, ndërkohë që marrëveshjet e nënshkruara prej tyre, garantojnë zbatimin e plotë të detyrimeve kushtetuese.

Marrëveshja u nënshkrua gjithashtu mes Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe komunitetit fetar Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë, për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella. Marrëveshja bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.902, datë 10 Nëntor 2010²²⁵. Marrëveshja u bë pjesë e sistemit shqiptar nëpërmjet Ligjit Nr.10 394, datë 10 Mars 2011, më të njëjtën procedurë të ndjekur për komunitetet e tjera fetare, pas një diskutimi të gjatë, ku u vunë në dukje lidhjet e forta kulturore dhe patriotike të Vëllazërisë Ungjillore²²⁶.

Marrëveshja u referohet normave të përdorura edhe për besimet e tjera fetare, që në parathënie dhe në veçanti, nenit 10 të Kushtetutës dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë²²⁷. Në nenin 2 flitet për komunitetet e tjera si

²²⁵U firmos nga ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

²²⁶Po ashtu, u vu në pah fakti se VUSH-i nuk është një përvojë e huaj për popullin dhe shoqërinë shqiptare por është pjesë e rëndësishme e jetës historike dhe shoqërore të saj, ligji nr. 10 394, datë 10.3.2011 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkësisë fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë” për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta, botuar në “Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë”, nr. 34, datë 7 prill 2011

²²⁷Në dispozitat e përgjithshme lidhur me objektin e marrëveshjeve, përdoret po ai formulim që gjejmë për çdo marrëveshje të nënshkruar, ndërkohë që vihet re një dallim në nenin 2, aty ku pohohet se “VUSH-i” është bashkësia e kishave dhe OJF-ve Ungjillore (protestante), të regjistruara ose jo në përputhje me legjislacionin në fuqi, në të cilën janë organizuar individë që shfaqin e shprehin të njëjtat bindje e besime fetare.

organizatë individësh, për Bektashinjtë, për Sunitët; ndërsa për Ortodoksët i referohet nenit 2 të statutit të këtij komuniteti²²⁸. Qëllimet e organizatës (neni 3), nuk ndryshojnë nga ato të komuniteteve të tjera. Kjo mund të theksohet edhe për nenin 4, që rregullon zbatimin e marrëveshjes për nenin 5, i cili detyron palët të respektojnë parimin e ndarjes, të laicitetit dhe të ligjshmërisë, ashtu edhe për nenin 6, që bashkërendon punët mes organeve shtetërore dhe atyre të komunitetit (Cimbolo, 2013:245).

Duhet të theksojmë se ajo çfarë e dallon dukshëm marrëveshjen e Vëllazërisë Ungjillore nga marrëveshja e të gjitha komuniteteve të tjera është fakti që Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë nuk kërkon fare financim nga shteti për kryerjen e veprimtarive të kultit, gjë që parashikohet me ligj për të gjitha komunitetet fetare²²⁹. Ky është një tregues që e bën këtë marrëveshje më koherente ndaj parimit të ndarjes, të laicitetit, të pluralizmit dhe të autonomisë së komunitetit fetar, çka përbën edhe tiparet dalluese të sistemit ligjor shqiptar (Cimbolo, 2013:253).

Kështu, siç e pamë edhe më sipër, pluralizmi fetar është konsideruar si një vlerë thelbësore në shoqërinë demokratike, ku bashkëjetesa e shumë besimeve fetare garanton në mënyrë jo të drejtpërdrejtë edhe të drejtat e minoriteteve (Kokona, 2003:101).

Laiciteti, ose ndryshe ndarja e fesë nga shteti është pa dyshim një nga fitoret më të mëdha humane të historisë dhe një nga arritjet më të rëndësishme që qytetërimi ka prodhuar dhe që u jep mundësi individëve të kenë bindje të ndryshme e të jetojnë së bashku në paqe, duke gëzuar të njëjtat të drejta e të njëjtat detyrime, e si e tillë duhet mbrojtur (Kokona, 2003:102).

²²⁸ Neni 2 i marrëveshjes

²²⁹ Ky qëndrim përjashton çdo lloj lehtësimi apo financimi, përveç rasteve kur kjo e drejtë buron nga legjisllacioni i përbashkët, duke e vënë komunitetin fetar dhe veprimtarinë e tij në të njëjtat pozita me veprimtarinë e zhvilluar nga subjekte jofetare, si, për shembull, me organizatat jofitimprurëse.

2.4.2.4 Shteti shqiptar shembull i bashkëjetesës dhe tolerancës fetare

Shqiptar i lindur, në terma të gjerë, do të thotë të lindësh tolerant ndaj diversitetit fetar. Arsyet për këtë tolerancë qëndrojnë në faktin se ndryshe nga fqinjët e saj, kombi Shqiptar nuk është formuar mbi një fe. Ndërtimi i kombit është mbështetur në një pluralizëm të brendshëm (Surroi, 2004:45). Veçanërisht në mesin e brezit të ri të cilët kanë tendencë të emigrojnë dhe të ndikohet nga media perëndimore është toleranca më e zhvilluar dhe butësia e bindjeve fetare. Ata transmetojnë në të gjithë shoqërinë një pozicion shumë elastik në raport me fetë e tjera dhe e konsiderojnë fenë thjesht si një çështje private individuale (Fuga, 2004:111-112).

Shqipëria e re dhe ajo e vjetër karakterizohet nga marrëdhënie të mira mes besimtarëve. Toleranca fetare është vlera më e madhe e shqiptarëve dhe kjo nuk është diçka proverbiale. Shqiptarët ditën të përballën me holokaustin.²³⁰ Pas Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria ishte vendi i vetëm ku numri i hebrenjve u rrit gati dhjetë-fish. Megjithëse në Shqipëri ekzistojnë tre besime fetare dhe katër komunitete dhe ne nuk shquhemi si populli i urtë, nuk i kemi njohur kurrë konfliktet fetare. Dy vëllezërit, njëri katolik dhe tjetri mysliman kanë jetuar nën një pullaz”. Ismail Kadare. Duke u bazuar në ngjarje historike, kuptojmë lehtësisht se mungesa e lirisë fetare dhe mohimi i të drejtës për besim mund të çojë në pasoja mjaft të rënda për stabilitetin politik të një vendi dhe për paqen ndërkombëtare. Zhvillimi i vetë shteteve, rendit shoqëror apo edhe vetë qytetërimeve i ka bazat dhe mbështetjen në normat dhe rregullat e sanksionuara vetë në të drejtën fetare, një e drejtë kjo me karakter të qëndrueshëm (MC Gure, 2007:308).

Liria fetare është një e drejtë e garantuar me akte ndërkombëtare dhe kombëtare. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si ligji themelor i shtetit, qysh në Preambulën e saj

²³⁰ <http://www.albasoul.com/vjeter/modules.php?op=modload&name=Neës&file=article&sid=1252>

shprehet qartë se në shtetin e së drejtës, si një shtet demokratik e social, e drejta e besimit është universale, ashtu si edhe të drejtat e tjera themelore të njeriut duke u bazuar tek fryma e tolerancës dhe bashkëjetesës fetare²³¹. Mund të themi se shoqëria jonë paraqitet tolerante ndaj besimeve të ndryshme, prandaj duhet të vazhdojë rrugën e tolerancës, e cila na karakterizon, si një vend ku nuk ka shprehje të ekstremizmave fetarë. Prandaj, është tepër e rëndësishme që të argumentojmë ushtrimin e lirisë fetare dhe se e drejta për realizimin e kërkesës duhet të bëhet me anë të mjeteve paqësore, duke respektuar ligjet në fuqi, normat etike dhe normat e tolerancës ndërjetare, për të mos arritur në shprehjet ekstreme të besimit fetar duke sjellë kaos në botën moderne (Krasniqi, 2007:190).

Për sa i përket qëllimit që ka feja, kryesisht, mund të themi se tashmë ajo është bërë faktor stabiliteti në shoqëri. Feja përbën një faktor të rëndësishëm të integritetit shoqëror. Kështu, ajo i ushqen anëtarët e vet me vlera dhe norma si dhe ndihmon konsensusin e tyre për çështjet morale. Të gjithë përkufizimet mbi fenë na tregojnë rolin social të fesë dhe të institucioneve të saj, si pjesë integrale e shoqërisë si një nga të drejtat themelore të individit. Ndjenjat fetare janë ndjenja sociale, ndjenja bashkësie që realizohen jo vetëm individualisht por edhe si grup social i bashkuar në shoqata, organizata dhe institucione fetare.

Toleranca, një term që ne e përdorim herë pas here në vend të fjalëve respekt, mëshirë, bujari ose vetëpërmbytje është elementi më thelbësor për sistemet morale, burimi më i rëndësishëm i disiplinës shpirtërore dhe një virtyt mjaft i çmuar për njerëzit e përkryer.

Duke i'u referuar historisë së njerëzimit vërejmë se toleranca në shoqërinë njerëzore është shumë e hershme. Ajo ka lindur bashkë me njeriun. Ndërsa si dukuri religjioze

²³¹<http://www.lawfirmh-h.com.al/publikime.html>

është shfaqur që kur lindën besimet dhe fetë. Një fe është tolerante ndaj tjetrës. Toleranca nënkupton atë liri shprehjeje për çështje dukshëm të vogla (Krasniqi, 2007:185).

Në Shqipëri ka një pluralizëm të shënuar fetar. Fetë nuk kanë qenë dhe nuk janë një burim konflikti për shoqërinë shqiptare. Në historinë e Shqipërisë komunitetet fetare kanë arritur gjithnjë të bashkë-ekzistojnë në mënyrë paqësore. Kjo tolerancë buron nga ndërgjegjësimi i shqiptarëve se ato i përkasin të njëjtit komb, duke pasur një identitet të fortë etnik, pavarësisht faktorëve të jashtëm, të cilët ndikuan në përcaktimin e ndryshimit fetar tek shqiptarët. Siç edhe e përmendëm, ndarja e Perandorisë së lashtë Romake në atë të lindjes dhe Perëndimit shkaktoi në planin afatgjatë edhe ndarjen e fesë së krishterë të shqiptarët. Perandoria Osmane ishte shkak i përhapjes së Islamizmit. Shqiptarët janë të vetëdijshëm se këto ndryshime janë faktorë të jashtëm të pashmangshëm, duke bërë që dallimet fetare apo kufiri ndarës i tyre të jetë krejt i zbehtë. Shqiptarët, gjithnjë, kanë qenë të vetëdijshëm se i përkasin të njëjtit komb, dhe pavarësisht se shpesh janë gjendur në luftëra në aspektin e jashtëm, ato asnjëherë nuk patën mes tyre konflikte të natyrës fetare. Gjithashtu, një tjetër faktor që ndikoi në konsolidimin e tolerancës dhe bashkëpunimit të fshehtë në mes komuniteteve fetare ishte edhe politika ateiste që ndoqi Enver Hoxha. Shpirti i vullnetit të mirë dhe harmonia që i karakterizon komunitetet fetare tradicionale janë ndikuar nga vështirësitë e përbashkëta që ato kanë hasur e kanë kaluar gjatë periudhës komuniste (Krasniqi, 2007:35). Toleranca fetare është shkelur rëndë gjatë regjimit komunist 1945-1991.

Pra, gjithë ky diversitet religjioz tek shqiptarët nuk ka sjellë përçarje por unitet në mes tyre. Toleranca fetare ka qenë gjithmonë e pranishme në trojet shqiptare. Festat fetare, jo vetëm që respektohen nga besimtarët e feve të ndryshme, por shpesh, ato përbëjnë edhe

një shkak për të festuar, pavarësisht se cilës fe i përket festa në fjalë. Konkretisht, Shkodra është një shembull konkret i tolerancës dhe bashkëjetesës fetare, që karakterizon, po ashtu, të gjithë shqiptarët (Krasniqi, 2007:46).

Ndërmjet komuniteteve ekziston toleranca dhe mirëkuptimi duke i bërë krenarë shqiptarët për marrëdhëniet që ekzistojnë mes tyre. Mund të themi se toleranca fetare në traditën kombëtare shqiptare është një nga karakteristikat kryesore të moralit të popullit shqiptar. Shumica dërmuese e popullit shqiptar është e besimit islam, por të gjithë e dinë se të parët e tyre kanë qenë kristianë dhe askush prej tyre nuk e mohon këtë fakt historik. Nga ana tjetër lidhjet familjare fisnore dhe kombëtare kanë bërë që shqiptari gjithmonë ka qenë e ka mbetur para së gjithash shqiptar, ndërsa feja ka qenë dhe është bindje, përcaktim dhe problem privat. Meqenëse shqiptarët i përkasin kryesisht tre feve, ka bërë që ato të mos dominojnë në jetën shoqërore, në asnjë periudhë kohore, në asnjë sistem dhe qeveri shtetërore në Shqipëri, feja nuk ka qenë komponente e shtetit. Ato kanë qenë të ndara nga shteti, i cili i respekton ato, përveç periudhës së errët të diktaturës, regjimit komunist të Enver Hoxhës 1945-1991, kur toleranca fetare u shkel rëndë, kur Shqipëria detyrimisht u kthye në vend ateist. Duket se shqiptarët gjatë gjithë historisë së tyre kanë qenë dhe janë orientuar drejt Evropës Perëndimore, drejt kulturës së saj të krishterë, demokracisë, politikës, ekonomisë dhe interesit të tyre kombëtar. Interesi i kombit gjithmonë ka qenë parësor në raport me çështjet fetare, se shqiptari, para së gjithash, është shqiptar, ashtu siç ka thënë edhe Pashko Vasa në shekullin e XIX “të mos na ndajë kisha e xhamia se feja e shqiptarit është shqiptaria”. Në botën moderne, shumë qëllime të përbashkëta dhe ideale të larta, mund të arrihen jo me anë të asimilimit por, me anë të integritit, jo nëpërmjet dhunës por, nëpërmjet dialogut. Për këtë arsye dialogu mbetet rruga e vetme përpara njerëzimit, i cili dëshiron të ndërtojë një të ardhme më të mirë.

Kështu, nëpërmjet fesë ruhet identiteti i komunitetit fetar e kombëtar, historik, shpirtëror e moral. Ndërkohë, një mbrojtje të veçantë e drejta e lirisë dhe besimit gjen edhe në nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si një ndër të drejtat themelore të individit. Duke u bërë kështu dëshmi, se liria e fesë është pranuar dhe njohur në mendimin politiko-juridik ndërkombëtar nga bashkësia e kombeve të civilizuar, si një nga të drejtat themelore të individit. Çdo qytetar mund të zgjedhë lirisht besimin e tij dhe t'i shfaqë lirisht bindjet fetare. Individi në çdo institucion dhe hapësirë publike ka te drejtën e legjitimuar me Kushtetutë të respektojë dhe deklarojë besimin e vet fetar pa frikën e diskriminimit.

Gjithashtu, njihet laicizmi i shtetit. Marrëdhëniet në mes shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Shteti nuk mund të ndërhyjë në çështjet e komuniteteve fetare veçse nëpërmjet marrëveshjeve të sipërpërmendura. (Hetova, 1996:27)

Në vitet 1967 komunitetet fetare patën një krizë si rezultat i regjimit totalitar, i cili i hoqi komuniteteve fetare njohjen juridike, duke mos mundur të zhvillojnë asnjë veprimtari fetare (Magris, 2001:18).

Në mënyrë që t'ja vishte pushtetit të vet besimin e popullit, regjimi komunist gjatë 50 viteve shkatërroi objektet e kultit pa dallim, si nëse ato ishin myslimane, katolike apo ortodokse, duke u justifikuar si lëvizje e rinisë ateiste. Por, besimi dhe feja nuk u shuan asnjëherë në zemrat e shqiptarëve. Fundi i rendit ateist në Shqipëri u mbyll me ardhjen e demokracisë në 4 Nëntor 1990, datë në të cilën pas kaq shumë vitesh censurë u mbajt mesha e parë (Sinani, 2008:18).

Kjo tolerancë buron nga ndërgjegjësimi i shqiptarëve se ato i përkasin të njëjtit komb, duke pasur një identitet të fortë etnik, pavarësisht faktorëve të jashtëm që ndikuan në përcaktimin e ndryshime fetare tek shqiptarët. Gjithashtu, një tjetër faktor që ndikoi në konsolidimin e tolerancës dhe bashkëpunimit të fshehtë në mes të komuniteteve fetare ishte edhe politika ateiste që ndoqi Enver Hoxha. Shpirti i vullnetit të mirë dhe harmonia, që i karakterizon komunitetet fetare tradicionale, janë ndikuar nga vështirësitë e përbashkëta, që ato kanë hasur e kaluar gjatë periudhës komuniste. Feja civile është një tërësi e bindjeve dhe ritualeve, që ndërthuren me të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e një kombi, mund të themi se feja civile është vetë shprehja e kohezionit të një kombi. Mund të themi, gjithashtu, se feja civile është e ngjashme me nacionalizmin, ku gjen pasqyrim edhe identifikimi i fuqishëm me anë të kombit, kur interesi kombëtar lartësohet (Kruja, 2008:28).

Toleranca është në interesin e çdo individi, çdo familjeje, çdo kolektivi dhe çdo shteti. Ajo krijon atmosferë humane dhe hap rrugën e paqes e të miqësisë mes njerëzve jo vetëm në Shqipëri por, në mbarë botën. Shqipëria është shembulli më i mirë i bashkëjetesës dhe tolerancës fetare, ka qenë dhe do të jetë gjithmonë (Kruja, 2008:28).

Sipas studiuesit Roberto Morozzo della Rocca, pikërisht në kohën e drejtimit të vendit nga Ahmet Zogu (periudhës pas Revolucionit të Qershorit, respektivisht Republikës (1925-1928) dhe Monarkisë zogiste (1928-1939), në një farë mase, arritën të vendoseshin marrëdhënie tolerante mes elementeve të ndryshëm fetare në vend. Këtu mund të ketë vend për të diskutuar, pasi ajo çfarë vihet re në ndjesinë e bashkësisë katolike flet për diçka të ndryshme, mjaft larg qëndrimit të shtetit, në pozicionin e gjykatësit të paanshëm dhe pajtuesit e tutorit të rendit në një shoqëri (Krasniqi, 2007:184). Mund të themi, se kemi të bëjmë me një stabilitet jo të përkryer, nëse matet

me shpeshhtësinë e krizave të brendshme dhe të kërcënimeve të jashtme, të cilave iu desh që t'i bëjë ballë Ahmet Zogu, megjithatë, ishte një ekuilibër i qëndrueshëm, po të krahasohet me vitet e para të trazuara të pavarësisë shqiptare (Della Roca, 2003:144).

Politika antifetare e Enver Hoxhës kontribuoi, në një farë mase, raportet e mira ndërmjet komuniteteve fetare shqiptare. Të vënë nën tryshninë e shtetit ateist, ata i dhanë jetë formave të reja të solidaritetit të fshehtë. Besimtarët përpiqeshin të ndihmonin njëri-tjetrin në një kontekst të vështirë.

Pluralizmi paqësor fetar i Shqipërisë është një vlerë për vendin e për Ballkanin e për Evropën. Ai mund të jetë një model i bashkekzistencës në një Evropë me shumë besime. Karakteri me shumë besime i Evropës nuk është i lidhur me homogjenitetin etnik, siç ndodh në Shqipëri, ku ndarja e vlerave, gjuhës, kulturës, e bëjnë më të lehtë bashkekzistencën ndërmjet komuniteteve fetare (Della Roca, 2003:144). Modeli Shqiptar i bashkëjetesës dhe tolerancës mund të frymëzojë Evropën.

Komunitetet fetare shqiptare kanë mësuar të bashkëjetojnë. Dy elemente janë kryesorë për bashkekzistencën e mirë: së pari, fakti se ato janë të gjitha të rrënjosura në të njëjtët njerëz dhe së dyti, fakti se ata të gjithë ndajnë të njëjtën dashuri të fortë për vendin dhe për kombin (Della Roca, 2003:144). Çdo komunitet fetar shqiptar konkurren me të tjerët me dashurinë për vendin.

Tani gjendja po ndryshon, shqetësimi lidhet me organizatat terroriste, të cilat përdorin besimin fetar për radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm veçanërisht të grup-moshave të reja dhe të marginalizuara. Problemi është delikat dhe i ndërlikuar. Rreziku i ekstremizmit nuk përjashton edhe vende me traditë paqësore tolerance dhe bashkëjetese si Shqipëria. Ekstremistët e huaj mundohen të hyjnë madje edhe të influencojnë individë

të caktuar, jo vetëm të përkatësisë islame. Ndonëse islami shqiptar, historikisht ka qenë tolerant dhe larg ekstremeve (Della Rocca 2003:144).

Shqiptarët kanë në dispozicion të tyre një vaksinë të besueshme kundër çdo ekstremizmi fetar. Kjo vaksinë është dëshira e tyre për botën tolerante dhe të lirë Perëndimore. Në të ardhmen e feve në Shqipëri nuk ka modele ekstremiste, ka përballje të lirë, ndoshta konkurrencë të lirë dhe sigurisht përkushtim për të mirën e kombit, pa të cilën nuk do të ketë hapësirë për fetë në shoqërinë shqiptare (Della Roca, 2003:144).

Kështu siç e pamë edhe më sipër pluralizmi fetar është konsideruar si një vlerë thelbësore në shoqërinë demokratike, ku bashkëjetesa e shumë besimeve fetare garanton në mënyrë jo të drejtpërdrejtë edhe të drejtat e minoriteteve (Kokona, 2003:101).

Laiciteti ose ndryshe ndarja e fesë nga shteti është pa dyshim një nga fitoret më të mëdha humane të historisë dhe një nga arritjet më të rëndësishme që qytetërimi ka prodhuar dhe që u jep mundësi individëve të kenë bindje të ndryshme e të jetojnë së bashku në paqe, duke gëzuar të njëjtat të drejta e të njëjtat detyrime, e si e tillë duhet mbrojtur (Kokona, 2003:102).

Feja dhe demokracia kanë të përbashkët konceptin e njohjes dhe respektimit të tjetrit. Evropa, projekti i integritetit evropian dhe i krijimit të hapësirave evropiane është shumë dimensionesh, është Evropa e diversitetit por, njëherësh e dialogut dhe tolerancës, ku pikërisht dimensionin ndërkombëtar e ndërfetar luan rol të rëndësishëm (Kokona, 2003:102).

Dialogu ndërfetar është sot një domosdoshmëri. Nuk ka dyshim se bota sot ka nevojë më shumë se kurrë më parë për dialog ndërmjet kulturave dhe qytetërimeve. Bashkë me problemet kronike të qytetërimit modern, të tilla si përhapja e terrorizmit global,

përhapja e dhunës dhe e armëve të shkatërrimit në masë, nga të cilat çdo njëra shkon në mbështetje të tezave të konflikteve. Iniciativa për dialog mes qytetërimeve dhe kulturave janë miratuar gjithmonë prej shumicës së njerëzve në botë (Kruja, 2008;23). Bota e sotme karakterizohet nga rritja e ndërvarësisë dhe e bashkëpunimit ndërmjet popujve, grupeve, institucioneve dhe kombeve, në të njëjtën kohë konfliktet etnike-fetare dhe ndërfetare si dhe përdorimet e instrumentalizuara dhe politike të fesë janë në rritje në shumë rajone të botës.

KAPITULLI III: LIRIA E NDËRGJEGJES DHE BESIMIT NË SHQIPËRI NË VËSHTRIMIN JURIDIK

3.1 Konceptet ndërgjegje, besim dhe fe në vështrimin juridik

Liria e ndërgjegjes dhe besimit është pjesë e korpusit universal të të drejtave të njeriut, që lidhen me lirinë e mendimit, por edhe me liri dhe të drejta të tjera mjaft të rëndësishme. Siç shprehet edhe Swaine (2018) liria e mendimit është pararendësja e lirive të tjera.²³²Në këtë kuptim, ajo përfshin disa nga llojet më të njohura të lirive si ajo e besimit, fjalës dhe shprehjes. Benjamin Franklin (1722) thotë se “pa lirinë e mendimit nuk mund të këtë urtësi ashtu si liri publike pa të drejtën e fjalës”. Liria e të menduarit nuk mund të jetë e plotë pa lirinë për të shprehur atë që mendon. Pra në këtë kuptim liria e të menduarit lidhet ngushtë me të drejtën e fjalës dhe shprehjes.

Ndonëse në ditët tona liria e mendimit dhe shprehjes duket si një e drejtë natyrore, shoqëritë njerëzore kanë kaluar shekuj kundërshtish dhe luftërash për arritjen e tyre. Nga shekulli 16 dhe deri tek Revolucioni Francez, një sërë ngjarjesh të rëndësishme historike lidhen pikërisht me lirinë e mendimit²³³ (Bury, 2011). Para shekujve XVII dhe XVIII, trajtimi i qytetarëve që gjendeshin brenda kufijve shtetërorë karakterizohej nga diskrecioni i pakufizuar për trajtimin e subjekteve dhe nga paprekshmëria e zyrtarëve, nën teorinë më të vjetër të së drejtës hyjnore, aq sa çdo rezistencë e brendshme ndaj kurorës nuk ishte legjitime²³⁴. Që me teoricienët modernë liberalë të filozofisë së mendimit politik si për shembull John Locke filloi përcaktimi i domenit natyror të të

²³² Lucas Swaine, “Freedom of Thought as a Basic Liberty”, *Political Theory*, 46:3 (2018): 405-25. <https://doi.org/10.1177%2F0090591716676293>

²³³ John B. Bury, 2011, *A History of Freedom of Thought. Short overview from ancient Greece to the 19th century*. BoD – Books on Demand, faqe 1-9.

²³⁴ Leif Wenar. 2005. *The Nature of Human Rights nga Real World Justice*, ed. A. Føllesdal and T. Pogge (Kluwer, 2005).

drejtave përkundrejt vendosjes së kufijve të veprimtarisë së ligjshme të shtetit (Wenar, 2005).

Kështu, duke u gjetur të lidhura në pjesën më të madhe të dokumenteve të së drejtës ndërkombëtare, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë përfshin tre nocione, të cilat, ndonëse u jepet i njëjti nivel mbrojtje, nuk janë të mbivendosura në aspektin e kuptimit dhe të përmbajtjes. Pasi analizon gjerësisht debatet, që nga viti 1946 në OKB-ë, lidhur me kodifikimin e kësaj hapësire dhe të praktikave të shteteve në këtë fushë, de Jong (2000)²³⁵, vjen në përfundim se “liria e mendimit, ndërgjegjes, fesë apo besimit janë instrumenti më i mirë kundër një bote të qeverisur nga forcat materialiste dhe janë tashmë më shumë se të rëndësishme për të mbrojtur dhe nxitur zhvillimin e mëtejshëm të ndërgjegjes së njeriut”.

Ndonëse nuk ka ndonjë konsensus mes studiuesve se çfarë është feja, në vijim do t'i referohemi disa përkufizimeve. Për shembull, sipas Durkheim (1912), “feja është një sistem i unifikuar i besimeve dhe praktikave në lidhje me të shenjtën [...] - besime dhe praktika, të cilat bashkohen në një bashkësi të vetme morale të quajtura Kishë, për të gjithë ata që u përmbahen atyre”²³⁶.

Feja mund të karakterizohet nga disa elemente, si për shembull “besimi” në një realitet transcendental apo që nuk kapet plotësisht nga shqisat dhe mendimi racional; në një apo më shumë qenie të mbinatyrshme, ndonëse në disa fe e mbinatyrshmja shkrihet me universin, natyrën apo me forma të tjera ekzistence; “e shenjta”, “gjërat apo praktikat e

²³⁵C. D. de Jong, 2000, The freedom of thought, conscience and religion or belief in the United Nations (1946-1992), Intersentia

²³⁶ Emile Durkheim, 1912, The Elementary Forms of the Religious Life, Courier Corporation, 2012, faqe 47

shenjta”; rituale të ndryshme individuale apo kolektive, të cilat e vendosin individin apo bashkësinë në lidhje me “të shenjtën”; “urdhëresa,” të cilat bëhen burime apo pararendëse të marrëdhënieve, vlerave, normave apo fuqive të përhershme apo të përkohshme.

“Besimi fetar” është besimi në një sistem apo doktrinë të caktuar. Besimi nuk kërkon detyrimisht vërtetimin përmes arsytimit logjik që realiteti mbinatyror ekziston. Ndonëse besimi dhe arsyeja nuk përjashtojnë njëri-tjetrin në fushën e njohjes dhe verifikimit të realitetit, duke i’u referuar Thomas D’Acquinas-it, besimi nuk kërkon investigimin përmes arsyes²³⁷. Përveç pranimi me apo pa prezencën e arsyeshme të “hyjnore” apo “të shenjtës”, praktikat fetare mund të përfshijnë rituale dhe një sërë veprimtarish apo shërbimesh me karakter publik, të cilat lidhen me aspekte të kulturës, shoqërisë, sistemit ekonomik dhe legjitimitetit të vet, autoritetit apo qëllimit të shtetit. Feja në aspektin individual dhe kolektiv lidhet ngushtë me kuptimin dhe qëllimin e jetës. Përmes simboleve, narrativave, që krijohen përmes tyre, apo thënieve ose shkrimeve të shenjta, të cilat synojnë të shpjegojnë origjinën e universit dhe të jetës në tokë.

Përkufizimi i besimit dhe fesë është mjaft i vështirë. Mjaft gjykata apo sisteme ligjore e kanë gjetur këtë përkufizim mjaft problematik. Si Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ashtu edhe Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave Civile dhe Politike kanë qenë si të pamundura por edhe nuk kanë dashur të ofrojnë një përkufizim. Ndonëse doktrina të ndryshme ligjore i janë referuar përkufizimit të fesë në kontekste të ndryshme, mund të arrihet në përfundimin se është sa e pamundur aq edhe e padëshirueshme të hartohet një përkufizim ligjor i fesë. Nga njëra anë, një përkufizim i çfarëdo lloji do t’i shtrëngonte

²³⁷Saint Thomas (Aquinas). On Faith and Reason. Hackett Publishing, 1999, faqe 25, 70.

apo përjashtonte disa grupe, nga ana tjetër mungesa e një përkufizimi mund të çonte në abuzime, në emër të interesave fetare apo perceptimeve publike në lidhje me to. (Bury, 2011: 5-7)

Feja është domeni apo fusha e veprimtarisë, e cila mbrohet nga ligji. Nocioni i fesë është një nocion pluralist, i cili mbron qëndrimet mbi realitetet metafizike, besimet dhe praktikatat, të cilat burojnë nga këto mendime dhe qëndrime sepse këto të fundit nuk mund të vlerësohen nga rendi juridik. Qëndrimet mbi këtë realitet metafizik jo detyrimisht lidhen me ekzistencën e këtij të fundit.²³⁸ Në këtë kuptim, liria e besimit lidhet me lirinë e ndërgjegjes si një koncept, i cili reflekton botëkuptimin e individit nisur jo nga e ekzistenca e hyjnore, e mbinatyrshmes apo fesë por nga pikëpamja e lirisë së individit për të pasur qëndrimet, besimet dhe mendimet e veta si dhe për t'i manifestuar dhe mbajtur ato lirisht dhe pa u shtrënguar apo shqetësuar në lidhje me to nga shteti. Për sa kohë njihen dhe mbrohen si të tilla këto liri nuk mund të të jenë, gjithashtu, të pakufizuara. Për sa i përket ndërgjegjes, është e rëndësishme si njohja por edhe mbrojtja juridike si e të drejtës për të pasur besime dhe botëkuptime me natyrë fetare por edhe me natyrë morale, të vlerave apo edhe besimeve me natyrë jo fetare, si dhe e drejta për të mos besuar.

Shekullarizimi është një koncept mjaft i rëndësishëm për të shpjeguar si mungesën ashtu edhe refuzimin për të përkufizuar ndërgjegjen dhe besimin. Shekullarizimi, duhet të kuptohet në kontekstin e idealit më të përgjithshëm të asnjësisë së shtetit në çështjet e ndërgjegjes dhe besimit. Është mjaft e rëndësishme për shtetet demokratike dhe liberale që t'u japin respekt të barabartë individëve me botëkuptime dhe grupe të ndryshme vlerash. Kjo mund të kuptohet përmes formulimeve të thjeshta siç janë “ndarja e kishës

²³⁸ Christof H. Heyns, Peter W. Edge, Frans Viljoen Legal Responses to Religious Difference.

nga shteti”, “asnjanësia e shtetit ndaj feve” ose “privatizimi i fesë”, megjithëse të gjitha këto formulime përmbajnë një pjesë të së vërtetës²³⁹.

3.2 Liria e ndërgjegjes dhe besimit në legjislacionin dhe praktikën juridike shqiptare

Analiza e rregullimit kushtetues të lirisë së ndërgjegjes dhe besimit.

Në ndryshim nga koncepti i përgjithshëm dhe unitar i lirisë fetare, i përdorur gjerësisht në dokumentet dhe konventat ndërkombëtare, legjislacioni shqiptar i referohet një nocioni dualist, i cili përfshin “besimin” dhe “fenë”. Pra, në gjithë legjislacionin shqiptar do të gjejmë tre koncepte kryesore: “ndërgjegje”, “besim” dhe “fe”.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë gjejmë një sërë konceptesh dhe rregullimesh në lidhje me të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe lirisë së ndërgjegjes dhe besimit në veçanti.

Preambula e Kushtetutës

Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit, Vendosim këtë Kushtetutë:

²³⁹MACLURE, JOCELYN, CHARLES TAYLOR, and Jane Marie Todd. "THE PRINCIPLES OF SECULARISM." In *Secularism and Freedom of Conscience*, 19-26. Cambridge, Massachusetts; London, England: Harvard University Press, 2011. <http://www.jstor.org/stable/j.ctt2jbrc0.5>.

3.2.1 Preambula e Kushtetutës (1998)

Ndonëse Preambula e Kushtetutës nuk ka efekte detyruese ligjore ajo është jo vetëm një hyrje në ligjin më të lartë në hierarkinë e normave të një shteti por edhe komunikon qëllimet dhe kornizën e këtij dokumenti. Dispozitat Kryesore Kushtetuese, të miratuara në vitin 1991, nuk parashikuan një hyrje, që shpjegonte qëllimet dhe parimet kryesore, mbi të cilat mbështeteshin këto ndryshime të rëndësishme kushtetuese pas rënies së sistemit komunist.

3.2.2 Besimi te Zoti dhe / ose vlerat universale

Preambula e Kushtetutës së parë pluraliste në Shqipëri, ofron legjitimitetin popullor për të gjitha parimet, vlerat, institutet dhe kufizimet e përcaktuara në ligjin themeltar. Në të gjejmë edhe bazën e vlerave, të cilave i'u referohet në emër të popullit të Shqipërisë për të “ndërtuar një shtet të së drejtës” dhe “për të “garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”. Baza e garantimit të këtyre të drejtave ashtu edhe vetë shtetit demokratik buron së pari nga lidhja mes së kaluarës dhe të ardhmes, historisë dhe përgjegjësisë së përbashkët si dhe besimit “te Zoti dhe / ose vlera[të] tjera universale”. Duke mbajtur një qëndrim afirmues ndaj besimit fetar dhe vlerave universale, të cilat lidhen apo jo me të, hartuesit e Kushtetutës kanë shprehur, në thelb, asnjësinë e shtetit në çështjet e ndërgjegjes dhe fesë, besimit fetar apo ndaj vlerave universale si “drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi,” të mishëruara si nga feja, morali apo burime të tjera metafizike apo jo por, të cilat, sipas hartuesve të Kushtetutës, janë pjesë e autoritetit dhe e legjitimitetit të vetë rendit kushtetues.

3.2.3 Toleranca dhe bashkëjetesa fetare

Një element i rëndësishëm për tu theksuar në Preambulën e Kushtetutës është referenca ndaj “tolerancës dhe bashkëjetesës fetare” si pjesë e frymës së Kushtetutës. Ky është një afirmim i rëndësishëm, i cili lidhet edhe me pohimin e vetëdijes historike dhe të përgjegjesisë, por edhe një konfirmim i rëndësishëm në lidhje me disa nga vlerat e shoqërisë shqiptare, si një shoqëri pluraliste nga pikëpamja e besimeve dhe feve të ndryshme tradicionale, por edhe atyre që e karakterizojnë veten si ateistë apo janë indiferentë në çështjet e fesë. Toleranca dhe bashkëjetesa janë dy koncepte të ndryshme. Vetë koncepti i tolerancës është mjaft i rëndësishëm për të shpjeguar si marrëdhëniet mes komuniteteve fetare në Shqipëri por edhe një aspekt mjaft të rëndësishëm të lirisë së ndërgjegjes dhe besimit, që është aftësia për të lejuar ekzistencën e mendimeve, opinioneve dhe sjelljeve, të cilat janë si të papëlqyeshme, të pavërteta apo të papranueshme. Koncepti i bashkëjetesës qëndron një shkallë më lartë dhe buron nga ai i tolerancës, pasi ai kupton pranimin e diversitetit fetar brenda komuniteteve dhe respektimin e këtyre besimeve të ndryshme.

Neni 3

Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë.

Bashkëjetesa fetare është një nga parimet e rëndësishme, të cilat jo vetëm njihen, frymëzojnë dhe përbëjnë një nga bazat e rendit kushtetues në Shqipëri por si të tilla, shteti ka detyrimin më të lartë në nivel kushtetues që t’i respektojë dhe t’i mbrojë. Pikërisht në nenin 3 të Kushtetutës, bashkëjetesa fetare renditet krahas parimeve të themelore si: pavarësia shtetërore dhe territoriale, rendi kushtetues, pluralizmi, dinjiteti,

të drejtat dhe liritë, drejtësia shoqërore, identiteti dhe trashëgimia kombëtare, mbrojtja e pakicave kombëtare. Dy koncepte të rëndësishme për tu analizuar si baza të shtetit dhe së drejtës kushtetuese në nenin 3 janë: “pluralizmi” dhe “bashkëjetesa fetare”. Mbrojtja e pluralizmit është mjaft e rëndësishme për vetë ekzistencën e idealeve dhe botëkuptimeve të ndryshme në të gjitha fushat, jo vetëm atë morale e fetare por edhe në sferën ekonomike, politike e sociale. Pluralizmi është parakusht për tolerancën, bashkëjetesën dhe respektin mes individëve të veçantë, por edhe grupeve e veçanërisht pakicave fetare, etnike apo kombëtare brenda një shteti unitar.

3.2.4 Qëndrimi zyrtar i shtetit ndaj fesë

Ndikimi i së kaluarës totalitare dhe ndalimit të fesë me ligj deri në vitin 1991 nuk mund të kalonte një reflektim si në Kushtetutën e vitit 1998, por edhe në debatin kushtetues lidhur me rolin e shtetit në lidhje me besimin fetar dhe komunitetet fetare. Ligji Nr.5506, Datë 28.12.1976 ose Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë nga njëra anë nuk njihte asnjë fe dhe nga ana tjetër ndalonte krijimin e çfarëdo organizate me karakter fashist, antidemokratik, fetar dhe antisocialist.

C. ARSIMI, SHKENCA, KULTURA

Neni 37 Shteti nuk njeh asnjë fe dhe përkrah e zhvillon propagandën ateiste për të rrënjësuar te njerëzit botëkuptimin materialist shkencor.

KREU II TË DREJTAT DHE DETYRAT THEMELORE TË SHTETASVE.

Neni 55 Ndalohet krijimi i çfarëdo organizate me karakter fashist, antidemokratik, fetar dhe antisocialist. Ndalohet veprimtaria dhe propaganda fashiste, antidemokratike, luftënxitëse, si edhe nxitja e urrejtjes kombëtare e racore.

Ndalimi i besimit dhe organizimeve fetare nga ana e shtetit u realizua gradualisht. Në Kushtetutën e 5 Korrikut 1995²⁴⁰, e drejta e besimit dhe fesë si dhe marrëdhënia e fesë me shtetin përcaktohej në Kapitullin III, i cili titullohej “Të Drejtat dhe detyrat e shtetasve” dhe nenin 18, i cili lexon si vijon: *“Të gjithë shtetasve u garantohet liria e ndërgjegjes dhe e besimit. Kisha është e ndarë nga shteti. Komunitetet fetare janë të lira në çështjet e tyre të besimit si edhe në ushtrimin dhe praktikimin e jashtëm të tyre. Ndalohet që Kisha dhe Feja të shpërdorohen për qëllime politike. Gjithashtu, ndalohen organizatat politike me bazë fetare. Shteti mund të ndihmojë materialisht komunitetet fetare.”*

Nga miratimi i Ligjit Nr. 7491, Datë 29.4.1991 ose Dispozitave Kryesore Kushtetuese, të cilat shfuqizuan Kushtetutën e RPSSH, e miratuar më 28.12.1976 dhe deri në hartimin dhe miratimin e Kushtetutës së parë pluraliste në vitin 1998, qëndrimi i shtetit ndaj fesë është minimalist dhe mishërohet në nenin 7 të “Dispozitave Kryesore Kushtetuese”, si vijon²⁴¹ *“Republika e Shqipërisë është shtet laik. Shteti respekton lirinë e besimit fetar dhe krijon kushte për ushtrimin e tij”*. Konceptimi i një shteti laik, shekullar apo jo fetar, është një kthim prapa në konceptin e “ndarjes së kishës nga shteti” si përcaktohet edhe në Kushtetutën e vitit 1950, ku përveç ndalimit të organizatave politike me bazë fetare, afirmohet ndihma e shtetit për ringritjen e komuniteteve fetare, të cilat ishin shkatërruar si nga pikëpamja e burimeve njerëzore ashtu edhe nga ajo e burimeve materiale dhe objekte të kultit.

²⁴⁰ <https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2015/10/Kushtetuta-e-Republikes-Popullore-te-Shqiperise-1950.pdf>

²⁴¹ <https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2015/10/Dispozitat-kryesore-kushtetuese-1991.pdf>

Një pjesë e këtyre çështjeve u diskutuan edhe gjatë debatit kushtues në lidhje me nenin 10 të Kushtetutës, i cili do të analizohet më poshtë. Në një përmbledhje të këtyre koncepteve, Krenar Loloçi një nga ekspertët që morën pjesë në Komisionin Nismëtar për Hartimin e Kushtetutës thotë: “Tre momente kryesore kushtetuese në lidhje me fenë janë: së pari, asnjënjësia e shtetit, së dyti, njohja e veprimtarisë së brendshme të fesë, dhe së fundmi, çështja e personalitetit juridik të komuniteteve fetare.” (Debati Kushtetues, f: 38) . Qëndrimi juridik, që mban shteti në një vend me shumë fe është mos ndërhyrja në organizimin e brendshëm të fesë (Abdiu, faqe: 37). Në themel të marrëdhënieve të shtetit dhe komuniteteve fetare qëndron respekti ndaj njëri-tjetrit (Islami, faqe: 38).

Neni 10 është një nga 14 nenet e pjesës së parimeve themelore të Kushtetutës, në të cilat përcaktohen bazat e shtetit si: regjimi, sovraniteti, pavarësia territoriale, bazat e së drejtës dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit, e drejta ndërkombëtare, organizimi dhe funksionimi i organeve kushtetuese, sistemi i qeverisjes sipas parimit të ndarjes dhe balancimit të pushtetit, pluralizmi, pronës private si bazën e sistemit ekonomik, forcat e armatosura, decentralizimin e qeverisjes, gjuhën dhe simbolet kombëtare. Në ndryshim nga kushtetutat totalitariste dhe për shkak të pasojave të kësaj së kaluarë çështja e fesë, lirisë së ndërgjegjes dhe besimit merr një vend të rëndësishëm në Kushtetutën e parë pluraliste të Shqipërisë. Me gjithë ndryshimet e shumta, pesë herë deri në vitin 2016, neni 10 si dhe të gjitha nenet e tjera që lidhen me besimin, ndërgjegjen dhe fenë nuk janë ndryshuar.

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 10 të Kushtetutës shprehet karakteri shekullar i shtetit shqiptar përmes afirmimit të asnjënjësisë së shtetit në çështjet e besimit dhe të ndërgjegjes si dhe më tej roli i shtetit në një shoqëri, ku ka më shumë se një fe tradicionale ku asnjëra prej

tyre nuk gëzon një status të veçantë apo identifikues të tij, duke theksuar në paragrafin e parë se “në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare”.

Është i rëndësishëm dallimi mes “besimit” dhe “fesë” në nenin 10 pasi këto dy koncepte nuk përdoren si sinonime të njëra-tjetrës. Ndërsa me besim dhe ndërgjegje i referohet të drejtave individuale dhe garantimit të tyre në nivel kushtetues, me fe i referohet një manifestimi të institucionalizuar të një tërësie praktikash dhe besimesh me natyrë ideologjike dhe dogmatike, e cila i vishet komuniteteve, që i përkasin denominimeve të ndryshme fetare.

Marrëdhëniet mes fesë dhe shtetit karakterizohen nga: barazia, asnjënia dhe respekti reciprok i pavarësisë. Roli i shtetit, në lidhje me çështjet e ndërgjegjes dhe besimit fetar është jo vetëm lejues por edhe garantues në kuptimin pozitiv të manifestimit por edhe atë negativ të ruajtjes nga mos cënimi i tyre. Me gjithë përmasat e ndryshme të komuniteteve fetare, shteti njeh barazinë e tyre dhe nxit bashkëjetesën fetare duke kërkuar në mënyrë të ndërsjellët, që si shteti ashtu edhe *“bashkësitë fetare të respektojnë në mënyrë të ndërsjellët pavarësinë e njëri-tjetrit dhe të bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve”*.

Meqenëse marrëdhëniet me komunitetet fetare në Shqipëri janë vendosur në kuadrin e pluralizmit të denominimeve, historia e pasur shekullore e bashkësive kryesore fetare, e cila në disa raste i ka shërbyer forcimit të shtetit kombëtar, rezistencës ndaj sundimit totalitar, por edhe në disa të tjera është lidhur me ndikimet e huaja, cenimin e sovranitetit apo pretendimeve të ndryshme territoriale nga jashtë, kjo marrëdhënie është mjaft komplekse me ndjeshmëri shoqërore dhe politike të lartë.

Për këtë arsye, marrëdhënia mes shtetit dhe bashkësive fetare është trajtuar në nivel kushtetues dhe ku ndërthuren tre elementë kryesore: së pari, vendosja e marrëdhënieve me komunitetet fetare në analogji me ato me shtetet e huaja, ku njohja kalon nga nënshkrimi marrëveshjeve, të cilat kërkojnë ratifikimin nga parlamenti. Së dyti, për të bërë të mundur marrëdhëniet e bashkësive me shtetin, këtyre bashkësive fetare u jepet personalitet juridik, që i lejon ato të operojnë në fushën e të drejtës private për sa i përket zotërimit dhe administrimit të pasurive të tyre. Në këtë kuptim, rregullimi i personalitetit juridik i bashkësive fetare është i ngjashëm si me organizatat jo-fitimprurëse, sindikatat dhe shoqëritë tregtare. Së treti, bashkësive fetare u lejohet një lloj autonomie dhe vetë-rregullim në fushën e veprimtarive të tyre dhe administrimit të pasurive të tyre sipas rregullave dhe kanoneve të brendshme, për aq sa nuk cenohen interesat e të tretëve.

Neni 10

1. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare. 2. Shteti është asnjans në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike. 3. Shteti njeh barazinë e bashkësive fetare. 4. Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjellë pavarësinë e njëri-tjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve. 5. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend. 6. Bashkësitë fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk cenohen interesat e të tretëve.

3.2.5 Të drejtat dhe liritë themelore

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut parashikohen shprehimisht në pjesën e dytë të Kushtetutës, parimet e përgjithshme, të së cilës përbëhen nga 6 nene, ku më i rëndësishmi për t'u analizuar në kontekstin e këtij punimi doktorial është neni 18, që bën

fjalë për barazinë dhe mosdiskriminimin, ndërsa liria e ndërgjegjes dhe fesë parashikohet specifikisht në kreun e dytë, i përbërë prej 24 nenesh dhe që parashikon edhe liritë dhe të drejtat vetjake.

Liria e ndërgjegjes dhe fesë, siç parashikohet edhe në Kushtetutë është pjesë e të drejtave të njeriut. Për këtë arsye, është e rëndësishme të shpjegohet rregullimi i përgjithshëm kushtetues i korpusit të të drejtave të njeriut. Në nenin 15 të Kushtetutës parashikohet shprehimisht se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë “të pandashme”, “të patjetërsueshme” e “të padhunueshme”. Si të tilla, ato qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik dhe roli i shtetit dhe organeve publike nuk është vetëm në respekt të këtyre lirive dhe të drejtave, por edhe në aspektin proaktiv ose pozitiv, pra *“organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”*.

Me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara, “të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë”. Është e rëndësishme të theksohet në kontekstin e bashkësive fetare, të paracaktuara si persona juridikë në nenin 10 të Kushtetutës, se “të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve”.

Duke vendosur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut si limitin e kufizimeve, të cilat në asnjë rast nuk mund të tejkalohen në lidhje me cenimin e lirive dhe të të drejtave, neni 17 i Kushtetutës, afirmon të drejtën e shtetit për të vendosur kufizime, të cilat duhet të plotësojnë tre kritere që janë ligjshmëria, interesi publik ose mbrojtja e të drejtave të të tjerëve dhe të qenit në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar nevojën për vendosjen e këtyre kufizimeve.

Neni 18 i Kushtetutës është mjaft i rëndësishëm, pasi përveçse afirmimit në paragrafin e parë të barazisë përpara ligjit, parashikon se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkak të “bindjeve politike, fetare a filozofike”. Pra, duke iu referuar nenit 17 mbi kufizimet e të drejtave dhe lirive të njeriut, kufizimet në rastin e diskriminimit duket të jenë të drejta në kuptimin të ligjshme, proporcionale dhe të diktuar si nga interesi publik apo nevoja për mbrojtjen e interesave të të tjerëve.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

3.2.6 Të drejtat dhe liritë vetjake

Liria e ndërgjegjes dhe fesë gjendet posaçërisht në kreun e dytë të pjesës së dytë të Kushtetutës, e cila titullohet “Liritë dhe të drejtat vetjake”. Kushtetuta vendos një dallim të rëndësishëm mes të drejtave vetjake apo atyre që gëzohen në rrafshin individual në krahasim me ato kolektive apo sociale. Këto të fundit gjenden në krerët e tretë dhe të

katërt, përkatësisht “Liritë dhe të drejtat politike” dhe “Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”.

Kreu i të drejtave dhe lirive vetjake përmban të drejta, të cilat gjenden edhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut si: e drejta e jetës (Neni 21), liria e shprehjes dhe e shtypit (neni 22), e drejta e informimit për veprimtarinë e organeve dhe personave, që ushtrojnë funksione shtetërore (neni 23), liria e ndërgjegjes dhe e fesë (neni 24), e drejta për të mos i’u nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor poshtërues (neni 25) dhe punës së detyruar (neni 26); heqjes së lirisë (neni 28); e drejta e mbrojtjes së arsyeshme dhe procesit të rregullt dhe trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të personit, i cili vuan dënimin me heqje lirie (neni 28); ligjshmëria në kuadrin e të drejtës penale (neni 29); prezumimi i pafajësisë (neni 30); e drejta e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale (neni 35; liria dhe fshehtësia e korrespondencës (neni 36); paprekshmëria e banesës dhe integritetit të personit (neni 37); e drejta e zgjedhjes së vendbanimit dhe liria e lëvizjes (neni 38); e drejta e rezidencës, ekstradimi dhe dëbimi (neni 39); e drejta e strehimit për të huajt (neni 40); e drejta e pronës private (neni 41); e drejta e një procesi të rregullt në lidhje me çështjen e të drejtës së gëzimit të pronës; e drejta për një gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj (neni 43; e drejta për tu rehabilituar dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin (neni 44).

Liria e ndërgjegjes dhe fesë garantohet në nenin 24 të Kushtetutës. Kjo përmban zgjedhjen vetjake të fesë apo të drejtën e ndryshimit lirisht të saj; të drejtën për të manifestuar bindjet fetare individualisht apo kolektivisht; privatisht apo në publik si dhe përmes formave të praktikimit, kultit, riteve dhe mësimave fetare. Me përjashtim të lirisë së mendimit, neni 24 i Kushtetutës perfrazon pjesën e parë të nenit 9 të Konventës

Evropiane të të Drejtave të Njeriut me të gjitha elementet e saj, që do të shtjellohen më gjerësisht në seksionin në vijim.

Në paragrafin e tretë të nenit 24 gjendet e edhe e drejta për të mos besuar apo praktikuar fenë duke ndaluar si detyrimin, ashtu edhe ndalimin për të marrë pjesë në një bashkësi apo në praktikat fetare si dhe për të bërë publike bindjet apo besimin fetar. Pra, nga njëra ana mbrohet e drejta e zgjedhjes, ndryshimit dhe manifestimit të besimit fetar por, nga ana tjetër edhe e drejta e asaj pjesë të shoqërisë, e cila është indiferente apo dëshiron që ta mbajë çështjen e besimit brenda sferës së jetës private. Neni 24, në përputhje me nenin 10 të Kushtetutës të shtjelluar më sipër, përveçse afirmon asnjësinë dhe barazinë e bashkësive fetare, por edhe vendos në nivel të barabartë mbrojtjen mes individëve besimtarë dhe atyre jo besimtarë; mes publikes dhe private; mes kolektives dhe individuale.

Meqenëse limitet dhe kufizimet e vendosura ndaj të drejtave dhe lirive themelore kanë si referencë Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut duhet theksuar se për sa i përket lirive të ndërgjegjes dhe fesë këto kufizime duhet të jenë “të përcaktuara me ligj dhe janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve”. Ligjshmëria, interesi publik dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, si dhe nevoja për vendosjen e këtyre masave, gjenden edhe në nenin 17 të Kushtetutës.

Neni 24

1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar. 2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve. 3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.

3.3 E drejta ndërkombëtare dhe evropiane në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe fesë

Pasi siguroi një burim konflikti dhe lufte për shekuj, shekulli i 20-të, përveç afirmimit të gjerë të të drejtave të njeriut, solli “një kodifikim të së drejtës së individit për të zgjedhur, manifestuar dhe ndryshuar fenë dhe besimin e tyre”. Liria e ndërgjegjes dhe fesë, gjendet jo vetëm në dokumentet më të rëndësishme të të drejtës kombëtare të shumë vendeve por, është një e drejtë themelore, e cila sanksionohet dhe mbrohet posaçërisht si në të drejtën ndërkombëtare dhe në atë evropiane. Përtej Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që do të trajtohet në një seksion të veçantë të këtij punimi doktoral, liria e ndërgjegjes dhe fesë gjendet e lidhur ngushtë edhe me lirinë e mendimit, ku të treja këtyre të drejtave u jepet mbrojtje e përbashkët. Këto të drejta janë përcaktuar edhe në kornizën e Kombeve të Bashkuara, duke filluar me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventat Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut të vitit 1966 (Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike) dhe Deklarata e vitit 1981 për eliminimin e të gjitha formave të intolerancës dhe diskriminimit bazuar në fe ose besim.

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë është pjesë e Paktit Ndërkombëtar të të Drejtave Civile dhe Politike, si e tillë edhe një nga të drejtat kryesore të Kombeve të Bashkuara. Në nenin 18 të këtij pakti thuhet se *“çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë; kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur apo ndjekur besimin e zgjedhur dhe lirinë për të shfaqur, individualisht ose në bashkësi me të tjerët dhe në publik apo privatisht, fenë apo besimin nëpërmjet adhurimit, riteve, praktikës dhe mësimdhënies. Asnjë nuk mund t’i nënshtrohet detyrimit me forcë, që do të dëmtonte lirinë e tij për të pasur apo ndjekur një fe apo besimin, sipas zgjedhjes së tij. Liria e shfaqjes së fesë apo besimeve mund t’i nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve, që janë të*

përcaktuar me ligj dhe janë të nevojshme për të mbrojtur sigurinë publike, rendin, shëndetin ose moralin e të drejtave dhe lirive themelore të të tjerëve. Shtetet Palë të Paktit marrin përsipër të respektojnë lirinë e prindërve dhe kur është rasti, të kujdestarëve ligjorë për të siguruar arsimimin fetar e moral të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet që kanë”.

Më konkretisht, sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, individët janë të lirë nga shtrëngimi, mund të kenë vende adhurimi, të shfaqin simbole fetare, të vëzhgojnë festat dhe ditët e pushimit, të emërojnë klerikë, të japin mësim dhe të shpërndajnë materiale etj., në përputhje me bindjet dhe besimet e tyre të brendshme. Prindërit kanë të drejtë të zgjedhin lirisht edukimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre; kjo e drejtë kupton, gjithashtu, se individët mund të zgjedhin të mos besojnë apo të mos e praktikojnë fenë.

Në të gjitha dokumentet ndërkombëtare theksohet se subjektet e mbrojtjes së lirisë së fesë dhe besimit janë individët dhe jo fetë, gjë kjo e rëndësishme në vendosjen e kufizimeve të lirisë së shprehjes. Për shembull, në Deklaratën e përbashkët të OSBE-së për Shpifjen dhe legjislacionin anti-terrorizëm dhe anti-ekstremizmin, përcaktohen si kufizime të lirisë së shprehjes, mbrojtja e të drejtave individuale dhe interesave shoqërore dhe jo mbrojtja e institucione të veçanta, nocioneve abstrakte apo besimeve të ndryshme, përfshirë ato fetare.

E drejta ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut siguron një kornizë për zgjidhjen praktike të situatave, kur liria e fesë ose besimit duket se bie ndesh me të drejtat e tjera, të tilla si të drejtat e lirisë së shprehjes, liria e mbledhjes, mbrojtja nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes ose ku ka pretendime konkurruese për mbrojtjen e

lirisë së fesë ose besimit. Në këtë kuptim, nuk ekziston një hierarki e të drejtave të njeriut, që do të thotë se një e drejtë nuk mund të ‘shkelë’ një tjetër.

Neni 12 i Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut shprehet se *“gjithkush ka të drejtën e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të ruajtur apo ndryshuar fenë ose besimet, si dhe lirinë për të deklaruar apo përhapur fenë apo besimin tënd, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht. Askush nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve, që mund të cenojnë lirinë e tij për të ruajtur apo ndryshuar fenë ose besimet e tij. Liria për shfaqjen e fesë dhe besimeve të dikujt mund t’iu nënshtrohet vetëm kufizimeve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme për të mbrojtur sigurinë publike, rendin, shëndetin ose moralin ose të drejtat apo liritë e të tjerëve”*

3.4 Analiza e nenit 9 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut²⁴²

3.4.1 Parimet e përgjithshme

Neni 9 *“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve. 2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t’i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.”*

Neni 9 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (konventa) është i organizuar në dy paragrafë. Paragrafi i parë përmban dy pjesë: të drejtën e pacilësuar për lirinë e

²⁴² Udhëzues për nenin 9, Liria me mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, Këshilli i Evropës / Gjykata evropiane e të drejtave të njeriut, 2015

mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, e cila përfshin lirinë e ndryshimit të fesë ose besimit të dikujt; dhe të drejtën e cilësuar për të manifestuar fenë ose besimin e dikujt, vetëm ose me të tjerë, publikisht ose privatisht, nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve. Vetëm e drejta e dytë është objekt i kualifikimeve të paragrafit të dytë.

Paragrafi i dytë i nenit 9 të Konventës lidhet me kufizimet e pranuar të së drejtës të besimit dhe të fesë. Çdo kufizim i të drejtës duhet të parashikohet me ligj. Qëllimet legjitime të renditura janë: sigurimi publik, mbrojtja e rendit publik, shëndetit dhe moralit dhe mbrojtja e të drejtave dhe e lirive të të tjerëve. Kufizimet, që janë mbështetur nga GjEDNj përfshijnë: ndalimin e mbajtjes së një kryqi nga personeli mjekësor; kufizimet tek veshjet fetare në institucionet arsimore, ndalimin e kryerjes së riteve fetare nga ana e të burgosurve etj. Gjykata i ka njohur diskrecion të gjerë shteteve për të vendosur kufizime. Kufizimet e rrëzuara përfshijnë: ndjekjen për “proselitizëm”; mos lejimin e mbajtjes së simboleve të dukshme fetare për shkak të politikave të kompanisë; regjimet ushqimore për të burgosurit etj.

3.4.2 Liria individuale dhe kolektive

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë qëndron në themel të një “shoqërie demokratike,” e cila që të jetë e tillë duhet të karakterizohet medoemos nga “pluralizmi”. Kjo përfshin në vetvete identitetin dhe konceptin për jetën si të besimtarëve ashtu edhe ateistëve, skeptikëve dhe të pa interesuarve për çështjet e fesë pra, në kuptimin juridik, lirinë për të pasur ose jo besime fetare dhe për të praktikuar ose jo një fe. Pra, neni 9, pika 1 "Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë," i referohet “çdo individ,” i cili ka potencialin për të krijuar bindje të brendshme, pavarësisht nga

qëndrimi i tij personal ndaj fesë. Përveç individëve (*Kokkinakis kundër. Greqisë; Buscarini dhe të tjerët kundër San Marinos*), organizatat ose institucionet fetare mund të ushtrojnë të drejtat e garantuara në Nenin 9 të Konventës (*Cha'are Shalom Ve Tsedek kundër Francës; Leela Förderkreis e.V. dhe të tjerët kundër Gjermanisë*), në rastet kur preken aspekte kolektive të lirisë së besimit. Ndryshe nga liria e besimit, liria e ndërgjegjes nuk mund të pretendohet nga personat juridike (*Kontakt-Information-Therapie (KIT) dhe Hagen kundër Austrisë*).

Objekti i mbrojtur nga neni 9 i Konventës

Fjala “fe” nuk përkufizohet as në tekstin e Nenit 9, as në jurisprudencën e Gjykatës. Kjo lënie jashtë e përkufizimit është mjaft logjike, pasi një përkufizim i tillë do duhej të ishte elastik mjaftueshëm për të përqafuar të gjithë gamën e feve në mbarë botën dhe të gjente zbatim për rastet individuale. Objekti i Nenit 9 përfshin bindjet fetare dhe jofetare. Ai gjithashtu, nuk mbulon çdo akt, që motivohet apo ndikohet nga një fe a besim (*Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar*). Bindja personale ose kolektive duhet të arrijë një nivel të caktuar bindës, serioziteti, kohezioni dhe rëndësie.

Organet e Konventës e kanë pranuar shprehimisht apo në mënyrë të nënkuptuar, se garancitë e Nenit 9 § 1 të Konventës gjejnë zbatim për: (a) fetë “e mëdha” ose “të lashta” botërore, të cilat kanë ekzistuar prej mijëvjeçarësh ose përgjatë disa shekujve, (b) fe të reja ose relativisht të reja, (c) bindje të ndryshme filozofike koherente të mbajtura me sinqeritet, si: pacifizmi (*Arroësmith kundër Mbretërisë së Bashkuar*); kundërshtimi parimor ndaj shërbimit ushtarak (*Bayatyan kundër Armenisë*); veganizmi (*Ë. kundër Mbretërisë së Bashkuar*); kundërshtimi ndaj abortit (*Knudsen kundër Norvegjisë*), opinionin e mjekut për mjekësinë alternative, që përbën një formë manifestimi të filozofisë

mjekësore (*Nyyssönen kundër Finlandës*); bindja se martesë është bashkimi heteroseksual dhe kundërshtia ndaj bashkimeve homoseksuale (*Eweida dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*). Megjithatë, Gjykata nuk ka dhënë ndonjë mendim përfundimtar në lidhje me shenjtologjinë, ateizmin, frimasonerinë etj. Një çështje tjetër ende e diskutuar në lidhje me mbrojtjen e ofruar nga ana e nenit 9 të Konventës është nëse feja duhet të karakterizohet ose jo nga aspekti jo-fitimprurës apo nëse shoqëritë tregtare mund të pretendojnë mbrojtje në emër të shpalosjes së lirisë fetare.

3.4.3 E drejta e besimit dhe e drejta e shfaqjes së tij

Paragrafi i parë i Konventës e sheh të drejtën e besimit si një e drejtë nga njëra anë absolute pra, si e drejtë e *zotërimit*, *mbajtjes* së një besimi dhe si një të drejtë relative me atë të *shfaqjes* së jashtme të këtij besimi:

(a) e drejta për mbajtje besimin apo për t'u identifikuar me një fe të caktuar është një e drejtë absolute dhe e pakushtëzuar. Kjo e përfshin edhe të drejtën për të (mos) ndryshuar fenë ose besimet pa u diktuar apo shtrënguar nga jashtë, si për shembull në çështjen *Ivanova kundër Bullgarisë*, “shteti nuk mund të ndërhyjë apo të diktojë se çfarë duhet të besojë një person apo të ndërmarrë hapa shtrënguese për ta bërë personin të ndryshojë besimet e tij / saj”.

(b) e drejta e shfaqjes së besimeve është një e drejtë relative, meqenëse lidhet me ushtrimin e besimit dhe fesë në mjedise publike apo në shoqërinë e të tjerëve. Për këtë arsye, në paragrafin 2 të nenit të Konventës, janë parashikuar edhe kufizime, që mund vendosen mbi lirinë e dikujt për të shfaqur fenë ose besimin. Këto kufizime duhet të përcaktohet me ligj, të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe në përputhje

me një apo më shumë synime legjitime (*Eweida dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

3.4.4 Ndërhyrja e shtetit: Detyrimet negative dhe pozitive

Sipas përkufizimeve të Këshillit të Evropës për një kuptim më të mirë të koncepteve të Konventës, “detyrimet negative” i japin detyrë autoriteteve shtetërore të përmbahen nga veprime që padrejtësisht ndërhyjnë në të drejtat e Konventës. Shumica e të drejtave të Konventës janë përshtatur në këtë mënyrë. Nga ana tjetër “detyrimet pozitive” u japin detyrë dhe të drejtë autoriteteve shtetërore të ndërmarrin hapa aktivë për të mbrojtur të drejtat e Konventës. Në shumicën e rasteve, këto nuk janë shprehur në mënyrë të qartë në tekst, por edhe në jurisprudencën e GjEDNj-së²⁴³.

Detyrimet negative të shtetit

Në paragrafin e dytë të nenit 9 të Konventës parashikohen edhe qëllimet e ligjshme, që justifikojnë ndërhyrjen e autoritetit publik në shfaqjen e fesë apo besimit të një individi. Këto justifikime për ndërhyrje janë: siguria publike, mbrojtja e rendit publik, shëndeti dhe morali ose mbrojtja e të drejtave e lirive të të tjerëve. Kjo renditje e qëllimeve të ligjshme është rigorozisht shteruese dhe se një kufizim i kësaj lirie të jetë në përputhje me Konventën, ai duhet të përmbushë, posaçërisht, një qëllim që mund të lidhet me një prej atyre të renditura në këtë dispozitë (*Sviato-Mykhailivska Parafiya kundër Ukrainës, S.A.S. kundër Francës*). Për më tepër, Neni 15 i Konventës, i cili parashikon rastet e gjendjes së jashtëzakonshme përfshirë edhe në kuadër të nenit 9 “në shkallën e kërkuar rreptësisht nga nevojat e situatës, me kusht që këto masa të mos jenë në kundërshtim me

²⁴³<https://www.coe.int/sq/web/echr-toolkit/definitions>

detyrimet e tjera (të tyre) në kuadrin e së drejtës ndërkombëtare”, si në aspektin material dhe në atë procedural.

Ndërhyrja në ushtrimin e të drejtave të siguruara në nenin 9 të Konventës, mund të shfaqet në formën e: dënimeve penale ose administrative (*Kokkinakis kundër Greqisë; Ivanova kundër Bullgarisë; Masaev kundër Moldavisë*); pengesës fizike ndaj personave, që ushtrojnë të drejtat e tyre nga organet e rendit (*Boychev dhe të tjerët kundër Bullgarisë*); mbylljes së organizatës fetare (*Dëshmitarët e Jehovahit të Moskës dhe të tjerët kundër Rusisë*); mosnjohjes apo miratimit të ushtrimit të të drejtave në fjalë (*Kisha Mitropolite e Besarabisë dhe të tjerët kundër Moldavisë; Vergos kundër Greqisë*); nxjerrja apo zbatim i një ligji që lejon ndërhyrjen e shtetit në një çështje të brendshme (*Sinoda e shenjtë e Kishës Ortodokse bullgare dhe të tjerët kundër Bullgarisë*); etj.

Duke i njohur të drejtën shteteve për të ndërhyrë në rastet kur organizatat fetare kryejnë veprimtari në dëm të popullatës ose rendit publik (*Manoussakis dhe të tjerët kundër Greqisë; Kisha Mitropolite e Besarabisë dhe të tjerët kundër Moldavisë*), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) i ka njohur shtetit dhe të drejtën të ndërmarrë veprime parandaluese për të mbrojtur të drejtat themelore të të tjerëve (*Leela Förderkreis e.V. dhe të tjerët kundër Gjermanisë*).

Ruajtja e pluralizmit dhe mirëfunksionimi i demokracisë, bën të nevojshme të vendosen kufizimet e lirisë së besimit, me qëllim që të pajtohen interesat e grupeve të ndryshme dhe të sigurohet se respektohen besimet e çdokujt. Shtetet në ushtrimin e kompetencave të veta rregullatore dhe në marrëdhëniet me bashkësitë dhe besimet e ndryshme kanë për detyrë të mbeten asnjans dhe të paanshëm (*Kisha Mitropolite e Besarabisë dhe të tjerët kundër Moldavisë*). Për këtë arsye, masat e marra në nivel kombëtar duhet të jenë të

justifikuara dhe në mënyrë përpjesëtimore (*Leyla Şahin kundër Turqisë*). Gjykata iu jep shteteve palë të Konventës një lloj kufiri vlerësimi për të përcaktuar ekzistencën dhe shkallën e nevojës për këtë ndërhyrje. Por autoriteteve u takon barra e provës në lidhje me mjetet e përzgjedhura prej tyre për arritjen e qëllimeve. Këto ndërhyrje duhet të përkrijnë jo vetëm me një “nevojë të ngutshme shoqërore” por edhe me mungesën e ndërhyrjeve të tjera më të favorshme.

Detyrimet pozitive të shtetit në sigurimin e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë

Shtetet, në përputhje me nenin 1 të Konventës, duhet “t’i sigurojnë gjithkujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në [...] Konventë”. Kufiri midis detyrimeve pozitive dhe negative të shtetit në kuadrin e Konventës merr në konsideratë vendosjen e një ekuilibri të drejtë midis interesave konkurruese të individit dhe të bashkësisë në tërësi. Ashtu si në lidhje me detyrimet negative edhe me ato pozitive, shteti gëzon një lloj kufiri vlerësimi.

3.5 Detyrimet e shtetit për garantimin e lirisë fetare

3.5.1 Detyrimi për të mos ndaluar funksionimin normal të organizatave fetare

Në Evropë nuk ka asnjë model për marrëdhëniet midis shtetit dhe bashkësive fetare; krejt e kundërta: Evropa ka një larmi të gjerë të modeleve kushtetuese. Sistemet aktuale mund të ndahen në tri kategori, të cilat Gjykata i ka pranuar si në përputhje me Nenin 9 të Konventës (CoE, 2015):

a) vendet me një kishë shtetërore, e cila ka një status të posaçëm kushtetues; GjEDNJ ka vendosur se detyra e shtetit për të qëndruar asnjans në çështjet fetare nuk mund të

konceptohet si gjasë për të ulur rolin e besimit apo kishës, me të cilët popullsia e një vendi të caktuar është shoqëruar historikisht dhe nga pikëpamja kulturore (*“Gldani” dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*). Vendimi, nëse një traditë duhet të ketë ose jo vazhdimësi, i takon shtetit brenda kufirit të tij të vlerësimit. Megjithatë, referenca ndaj një tradite nuk mund ta lehtësojë shtetin palë nga detyrimi i tij për të respektuar të drejtat dhe liritë e sanksionuara në Konventë dhe në Protokollin e saj (*Lautsi dhe të tjerët kundër Italisë*). Sipas kërkesave të Nenit 9 të Konventës, shteti duhet të garantojë për lirinë fetare të individit, duke mos e detyruar atë të hyjë apo të largohet nga kisha shtetërore (*Ásatrúarfélagið kundër Islandës; Darby kundër Suedisë*).

b) ndarja e plotë midis shtetit dhe të gjitha organizatave fetare, ku modeli kushtetues mbështetet në parimin e laicizmit ose në ndarjen e plotë të shtetit dhe bashkësive fetare. Gjykata ka deklaruar se një model i tillë është po ashtu në përputhje me vlerat, që qëndrojnë në thelb të Konventës (*Leyla Şahin kundër Turqisë; Dogru kundër Francës*).

c) marrëdhënie të llojit të konkordatit, ku modeli kushtetues lejon lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimi me një bashkësi apo institucion fetar të caktuar sipas një statusi ligjor apo fiskal, si kusht për trajtimin e përveçëm. Këto marrëveshje nuk janë ekskluzive dhe preferenciale. (*Alujer Fernández dhe Caballero Garcia kundër Spanjës; Savez crkava«Riječživota»dhe të tjerët kundër Kroacisë*). Shteti mund t’u japë ose jo personalitet juridik ose një status të posaçëm të grupeve fetare. Por, për të përmbushur detyrimet, që rrjedhin nga Konventa, duhet që të gjitha bashkësitë fetare të kenë mundësi të barabartë për ta kërkuar këtë status dhe kriteret e vendosura duhen zbatuar në mënyrë jo diskriminuese (*Religionsgemeinschaft der Zeugen Jehovas dhe të tjerët kundër Austrisë*).

3.5.2 Njohja, regjistrimi dhe ndalimi i organizatave fetare

Shtetet kanë kompetenca për të verifikuar veprimtarinë e një shoqate dhe të një bashkësie, e cila mund të kryejë veprimtari të dëmshme për popullsinë apo që mund të rrezikojnë sigurinë publike. Kjo vlen edhe për sa i takon njohjes dhe regjistrimit të bashkësive fetare. Refuzimi për të regjistruar një organizatë fetare mund të justifikohet me nevojën për të përcaktuar nëse kjo organizatë paraqet ndonjë rrezik për një shoqëri demokratike dhe interesat themelore të njohura, siç përcaktohen edhe në paragrafin e dytë të nenit 9 (*Cârmuirea Spirituală a Musulmanilor din Republica Moldova kundër Moldavisë; Kisha e Shentologjisë e Moskës kundër Rusisë; Lajda dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*).

Mbyllja, ndalimi apo shkrirja e organizatave fetare është një nga format më ekstreme të ndërhyrjes së shtetit në aspektin kolektiv të lirisë së fesë. Justifikimi nga ana e shtetit për marrjen e një mase kaq drastike duhet të jetë shumë serioz dhe i motivuar nga “e nevojshme në një shoqëri demokratike” (*Qendra Biblike Republikës Cuvash kundër Rusisë*). Shkeljet e këtij lloji GjEDNj i ka arsyetuar të lidhura mes nenit 9 dhe nenit 11 të Konventës, si në rastet në vijim: shpërbërja e një dege lokale të Dëshmitarëve të Jehovahit me urdhër gjykate duke pretenduar ndërhyrjen në jetën private të ndjekësve dhe në të drejtën e tyre për të zgjedhur profesionet; shkrirja nga gjykatat ruse e një qendre biblike protestante, e cila lëshonte certifikata studimi pa pasur statusin e subjektit juridik (*Qendra Biblike e Republikës së çuvashit kundër Rusisë*); etj.

Në të njëjtën kategori me shkrirjen qëndron edhe mos regjistrimi, refuzimi për të njohur personalitetin juridik të bashkësi fetare ose për t’ia dhënë këtë personalitet. Kjo përbën

ndërhyrje në të drejtat e siguruara në bazë të nenit 9 në lidhje me shfaqjen kolektive të vetë bashkësisë, por edhe anëtarëve të saj (*Kisha Mitropolitë e Besarabisë dhe të tjerët kundër Moldavisë*). Në bazë të nenit 11, aftësia për të krijuar një subjekt juridik për të vepruar në një fushë me interes të ndërsjellë është një nga aspektet më të rëndësishme të lirisë së organizimit, pa të cilën kjo e drejtë do të zhvishej nga çdo kuptim. Refuzimi nga autoritetet për t'i dhënë statusin e subjektit juridik një organizimi individësh, fetare apo tjetër, përbën shkelje të ushtrimit të së drejtës së lirisë së organizimit. Në këtë drejtim, refuzimi i autoriteteve për të regjistruar në grup cenon drejtpërdrejtë grupin dhe kryetarët, themeluesit apo anëtarët e tij individualë (*Kimlya dhe të tjerët kundër Rusisë*).

Lejimi nga ana e shtetit të një krijimit të një organizate fetare dhe aktivitetit të saj nuk zëvendëson njohjen formale dhe mbrojtjen e ofruar nga legjislacioni për grupet dhe organizatat e regjistruara ose me personalitet juridik. Kjo, për shkak se këto të drejta përfshijnë hapjen dhe mbajtjen e llogarive bankare, rekrutimin e punonjësve, sigurimin e mbrojtjes gjyqësore të bashkësisë, anëtarëve dhe pasurive të saj, ngritjen e vendit të kultit, zhvillimin e shërbesave në vende të arritshme për publikun, prodhimin, përfitim dhe shpërndarjen e literaturës fetare, krijimin e institucioneve edukuese dhe mbajtjen e kontakteve për shkëmbime e konferenca ndërkombëtare. Për më tepër, një bashkësi fetare, e cila ka personalitet juridik në përmasën e vet kolektive, ka edhe mundësi të mbrojtjes gjyqësore të bashkësisë si kolektiv, duke përfshirë edhe pasuritë dhe të drejta jo pasurore. Për këtë arsye, neni 9 mund të shihet edhe në bashkëveprim me neni 6 të Konventës, i cili rregullon për të drejtën e aksesit në gjykatë dhe procesit të rregullt ligjor.

Detyrimet negative të shtetit përfshijnë edhe respektin për autonominë e organizatave fetare, mos ndërhyrjen e shtetit në konfliktet midis feve, besimeve dhe besimtarëve si dhe organizatave fetare dhe punonjësve të tyre.

a) Autonomia e organizatave fetare duhet kuptuar në ndërthurje me nenin 11 të Konventës, i cili garanton lirinë organizative, nga ndërhyrja e pajustificuar e shtetit. Cenimi i autonomisë organizative të bashkësisë fetare do t'i bënte të gjitha aspektet e tjera të lirisë së fesë të bëheshin të cenueshme (*Hassan dhe Tchaouch kundër Bullgarisë; Fernández Martínez kundër Spanjës*).

b) Ndërhyrja e shtetit në konfliktet e brendshme apo midis feve duhet të bazohet mbi parimin e paanësisë, të pluralizmit si tipar thelbësor i rendit demokratik. Demokracia, në këtë rast, ka të bëjë jo me tiraninë e ideve të shumicës por, me një ekuilibër dhe dialog. Në një shoqëri demokratike, në të cilën bashkekzistojnë disa fe, kufizime mund të vendosen me qëllim pajtimin e interesat e grupeve të ndryshme dhe për të siguruar se e drejta dhe besimet e gjithsecilit do të respektohen (*S.A.S. kundër Francës*).

c) Roli i shtetit, në lidhje me mosmarrëveshjet mes organizatave fetare dhe anëtarëve të tyre, duhet të jetë në përputhje si me autonominë organizative të bashkësive fetare, ashtu edhe me parimin e rëndësishëm të asnjësisë së shtetit në çështjet, që lidhen me rregullat e brendshme të besimit.

Shumë fe përcaktojnë standarde doktrinale të sjelljes dhe anëtarët duhet t'i zbatojnë në jetën e tyre private (*Dëshmitarët e Jehovahit të Moskës dhe të tjerët kundër Rusisë*). Nuk është detyra e autoriteteve kombëtare të veprojnë si arbitër midis organizatave fetare dhe fraksioneve kundërshtare, që ekzistojnë apo mund të shfaqen brenda tyre (*Sindicatul « Păstorul cel Bun » kundër Rumanisë; Fernández Martínez kundër Spanjës*). Shteti duhet të pranojë të drejtën e këtyre bashkësive për të reaguar, në përputhje me vetë rregullat dhe interesat e tyre, ndaj çdo lëvizjeje kundërshtare që shfaqet brenda tyre, e cila mund të përbëjë kërcënim për kohezionin, imazhin apo unitetin e tyre.

3.5.3 Detyrimet pozitive të shtetit

Detyrimet pozitive të shtetit mund të ilustrohen në tre fusha të veçanta që janë: a) mbrojtja kundër sulmeve nga palët e treta; b) të drejtat, që lidhen me shfaqjen e besimit në vendin e punës dhe në shërbimin publik dhe c) liritë fetare për personat, që vuajnë dënimet me heqje lirie.

a) Mbrojtja e besimtarëve dhe përfaqësuesve fetarë nga sulmet verbale dhe fizike janë detyrime pozitive nga ana e shtetit, që mundësojnë respektimin efektiv të të drejtave të garantuara nga neni 9 i Konventës. Këto masa nuk lidhen me mbrojtjen nga çdo kritikë, mospranimin apo refuzimin nga të tjerët të doktrinave kundërshtare me besimin e tyre (*Dubowska dhe Skup kundër Polonisë*), por masa, të cilat sigurojnë respektimin e ndërsjellë të lirisë së fesë në sferën e marrëdhënieve të individëve midis tyre. Pra, kur besimet fetare kundërshtohen apo mohohen nga të tjerë në atë mënyrë, që i ndalon besimtarët që kanë besime të caktuara, të ushtrojnë lirinë e tyre për t'i pasur apo për t'i shprehur ato. Konventa nuk krijon ndonjë hierarki midis të drejtave *a priori*: në parim, ato meritojnë respektim të barabartë. Shtetet duhet ta bëjnë këtë duke përmbushur tri parimet në vijim: (a) për aq sa është e mundur në mënyrë të arsyeshme, shteti duhet të sigurojë se dy të drejtat konkurruese janë të mbrojtura; ky detyrim u takon autoriteteve kombëtare, edhe kur veprimet që priren të ndalojnë ushtrimin e lirë të secilës prej të drejtave, nxiten nga individë privatë; (b) në përputhje me këtë, shteti duhet të sigurohet për hartimin e një kuadri të përshtatshëm ligjor dhe të ndërmarrë veprime efektive për t'u siguruar që të drejtat të respektohen në praktikë; (c) ekuilibri i përshtatshëm mes të drejtave mund t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor.

b) shfaqja e besimit në sektorin publik është trajtuar në një mori rastesh nga GjEDNj (*Kalaç kundër Turqisë; Çinar kundër Turqisë; Acarca kundër Turqisë; Sert kundër Turqisë; Pitkevich kundër Rusisë*). Ritualet dhe normat e disa feve mund të bien në kundërshtim me detyrimet profesionale të ndjekësve të tyre dhe për rrjedhojë lindin kërkesa dhe pretendime nga ana e ndjekësve të fesë, që punëdhënësi i tyre (qoftë publik apo privat) të marrë masa të posaçme për t’ju përshtatur atyre. Në kuadrin e shërbimit ushtarak, gjykata ka vendosur se shtetet mund të miratojnë rregulla disiplinore, që ndalojnë lloje të caktuara sjelljesh dhe qëndrimesh, të cilat pasqyrojnë kërkesat e shërbimit ushtarak. Këto kërkesa të fesë dhe manifestimit të saj mund të bien në kundërshtim me detyrimet thelbësore të profesionit, si për shembull gjyqësorit, duke minuar autoritetin dhe paanësinë e këtij të fundit ndaj palëve. Për shembull, një gjyqtare në Rusi kishte përdorur postin e saj si gjyqtare për të përhapur interesat e bashkësisë së saj fetare dhe për të frikësuar palët në procesin gjyqësor përpara saj. Një nga rastet treguese në lidhje me marrëdhëniet e punës në sektorin publik është *Ivanova kundër Bullgarisë*. Në kuadrin e kësaj çështjeje, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 9 të Konventës në një çështje që kishte të bënte me shkarkimin e një administratore të pishinës së notit në një shkollë shtetërore të arsimit profesional në Bullgari, për shkak të anëtarësimit të saj në një bashkësi protestante ungjillore, në sfondin e përgjithshëm të një fushate politike/mediatike kundër kësaj bashkësie.

c) çështja e lirive fetare të të burgosurve lidhet me ushtrimin e lirë të të drejtave të njeriut, duke pasur parasysh kushtet e veçanta të mjedisit të burgut. Shtetet duhet të respektojnë lirinë e fesë të të burgosurve dhe të lehtësojnë ushtrimin e këtyre të drejtave, si për shembull, kryerjen e ritualeve të faljes, aksesit në literaturën fetare etj. Kjo nuk duhet të kuptohet se neni 9 nuk i’u jep të drejtën të burgosurve as të konvertojnë në

besimtarë të tjerët brenda apo jashtë institucionit (*J.L. kundër Finlandës*); as ndonjë status të veçantë si “të burgosur të ndërgjegjes” dhe as ndonjë përjashtim nga rregullat e përgjithshme, që drejtojnë jetën në burg, si detyrimi për të punuar, për të mbajtur uniformën e burgut dhe për të pastruar qelitë e tyre (*McFeeley dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.); *X. kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

KAPITULLI IV: DEBATET MBI LIRINË E NDËRGJEGJES DHE BESIMIN FETAR NË EVROPË, RAJON DHE NË SHQIPËRI

4.1 Liria fetare dhe të drejtat e njeriut në Evropë²⁴⁴

Liria e fesë dhe besimit ka mbrojtje të konsiderueshme në BE dhe në legjislacionin e të gjitha vendeve anëtare të BE-së. Sipas një studimi të Shërbimeve Kërkimore të Parlamentit Evropian (2018), marrëdhënia midis qytetarëve të BE-së dhe fesë është mjaft komplekse. Ndonëse për dekada në agjendën e BE-së, krizat e ndryshme si dhe çështjet e lidhura me shtetin e së drejtës në disa shtete anëtare, e kanë rikthyer diskutimin politik mbi çështjen e vlerave të përbashkëta të komunitetit si: barazia, liria dhe të drejtat e njeriut.

Sondazhet e opinioneve tregojnë mospërputhje mes përkatësisë fetare dhe përcaktimit të fesë, si një nga vlerat më të rëndësishme personale. Sipas Eurobarometrit të vitit 2018, feja ishte shumë pak e zgjedhur si vlerë që përfaqëson më së miri BE-në (3%) dhe si një çështje, që krijon më së shumti ndjenjën e bashkësisë midis qytetarëve të BE-së (8%), ndonëse sipas hulumtimeve të bëra nga Pew (2017, 2018) shumica e evropianëve ende e identifikojnë veten si të krishterë (edhe pse pak prej tyre ndjekin rregullisht shërbesat fetare). Po sipas hulumtimeve të Pew Research (2015), identifikimi fetar në Evropë ka ardhur çdo vit në rënie.

Kuadri legjislativ i BE-së bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës (neni 2 i Traktatit të BE). Karta e të drejtave themelore të BE-së është korniza

²⁴⁴ EPRS | European Parliamentary Research Service Author: Martina Prpic Members' Research Service PE 630.290 – December 2018. Religion and human rights. <http://www.europarl.europa.eu/at-your-service/files/be-heard/religious-and-non-confessional-dialogue/events/en-20181204-eprs-briefing-religion-and-human-rights.pdf>

ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kur shtetet anëtare veprojnë brenda sferës së ligjit të BE-së. Jashtë sferës së ligjit të BE-së, zbatohet Konventa Evropiane e Këshillit të Evropës për të drejtat e njeriut. Liria e fesë dhe e besimit është e garantuar në Bashkimin Evropian nga këto instrumente. Me miratimin e Udhëzimeve të BE-së të vitit 2013 për promovimin dhe mbrojtjen e lirisë së fesë ose besimit, BE, gjithashtu, është angazhuar të avancojë lirinë e fesë dhe besimit përmes shërbimit të saj të jashtëm dhe instrumenteve të saj financiare.

Përveç arsimimit dhe edukimit të fëmijëve nga ana e prindërve, në përputhje me bindjet e tyre fetare, filozofike e pedagogjike dhe ligjet kombëtare (neni 14), Karta e të Drejtave Themelore të BE-së, gjithashtu, ndalon diskriminimin në bazë të fesë në fushën e punësimit përmes Direktivës për barazi të punës (2000/78 / EC). Shkeljet e kryera nga personat, që bazohen në fe janë bërë të dënueshme në ligjin penal nga Vendimi kuadër i Këshillit (2008/913 / JHA) dhe standardet minimale të të drejtave, mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave të krimit të urrejtjes, që janë përcaktuar nga Direktiva e viktimave të krimit (2012 / 29 / EU).

Sipas të dhënave të EQUINET (2018)²⁴⁵ si nga ana e kuadrit ligjor, por edhe nga ana e praktikës gjyqësore në vendet e BE, shtetet kanë ende vështirësi në arritjen e një ekuilibri midis të drejtës së një individi ose të një grupi për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, kundrejt kufizimeve në lidhje me sigurinë dhe rendin publik, shëndetin ose moralit, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Rastet më të hasura të diskriminimit janë në fushën e punës, ku BE-ja ka edhe legjislacion specifik, si për shembull: rekrutimi dhe përzgjedhja; mbajtja e shamive dhe simboleve fetare; ngacmimi

²⁴⁵ <http://equineteurope.org/2018/03/30/faith-in-equality-religion-and-belief-in-europe/>

në vendin e punës, zgjedhja e detyrave dhe modeleve të punës, si dhe konfliktet për të drejtat. Në arsim, shumica e rasteve i referohet fesë myslimane, veçanërisht veshjes së grave myslimane dhe në aksesin ndaj mallrave dhe shërbimeve, ku kërkohet një analizë më e plotë e justifikimeve për sjelljet diskriminuese.

Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian detyron dialog të rregullt midis Bashkimit Evropian dhe kishave, shoqatave fetare dhe komuniteteve, si dhe organizatave filozofike dhe jo-konfesionale (neni 17 TBE). Kjo ofron një mundësi për këto organizata, që të angazhohen dhe të përfshihen në hartimin e politikave të BE-së. Fetë, gjithashtu, mund të ndihmojnë edhe në luftën kundër terrorizmit duke mbështetur përhapjen e narrativave alternative, paqësore dhe tolerante, kundrejt atyre radikale dhe të dhunshme. Meqenëse radikalizmi luftohet më së miri në bashkësitë lokale, roli i udhëheqësve fetarë është i domosdoshëm. Për këtë arsye, BE-ja ka krijuar kushtet dhe mundësitë për një forum me pjesëmarrje të gjerë si dhe Rrjetin e Ndërgjegjësimit kundër Radikalizmit, ku politik-bërësit dhe praktikuesit e fesë mund të lidhen dhe të shkëmbejnë praktikat më të mira.

Një çështje tjetër aktuale ku feja ka luajtur një rol të rëndësishëm është emigracioni, integrimi dhe pranimi i emigrantëve. Institucionet dhe vendet e lutjes mund të shërbejnë si vende të përbashkëta të besimit dhe inkurajimit të të drejtave të njeriut, përmes mikpritjes dhe integritit të emigrantët, si dhe nxitjes së dialogut ndërkulturor dhe ndërfaqet.

4.2 Liria fetare dhe të drejtat e minoriteteve në Ballkan²⁴⁶

Deri vonë në fundin e shekullit të kaluar, në Ballkan ka ekzistuar një tendencë për të pranuar ‘modelin grek’ të shtetit, model i cili njih kishën tradicionalisht mbizotëruese si kishën zyrtare. Në Greqi lidhja midis shtetit dhe kishës theksohet në Kushtetutë, e cila përshkruan Kishën Ortodokse greke si fe shtetërore dhe për më tepër, i ngjit rregullat e brendshme të kishave në ligjin shtetëror, me ndryshime të mundshme vetëm me miratimin e shtetit. Greqia është dërguar shpesh në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me të drejtat fetare. Në shumë vende, mjetet formale dhe jo-formale janë përdorur për t’i ofruar trajtim të privilegjuar kishës mbizotëruese, në dëm të pakicave tradicionale fetare ose lëvizjeve të reja fetare. Si për shembull, në rastin e Kroacisë, ku Kishat Katolike u restauruan pas përfundimit të luftës, ndërsa ndërtesat e tjera fetare morën vetëm pak mbështetje për rindërtimin. Besimtarët e grupeve të tjera fetare, veçanërisht Kisha Ortodokse Serbe, janë nën presion të konsiderueshëm në bashkësitë të vogla. Kjo preferencë joformale mund të identifikohet edhe në deklaratat e zyrtarëve të ndryshëm, të cilat lidhin një fe apo vlerat e fesë me mbështetjen, si edhe me suksesin politik dhe ekonomik të vendit.

Në Serbi²⁴⁷, Kushtetuta e mbron lirinë fetare, por ligjet dhe politikat e tjera kufizojnë këtë liri, duke diskriminuar midis grupeve dhe komuniteteve fetare. Ndonëse nuk ka një fe shtetërore, Kisha Ortodokse Serbe dhe komunitetet e tjera fetare “tradicionale” marrin një konsideratë preferenciale. Hetimet policore për aktet e gjuhës së urrejtjes dhe vandalizmit kanë tendencë të jenë të ngadalta dhe jo-përfshirëse. Respektimi i qeverisë për lirinë fetare është inkonsistent dhe raportet për abuzim shoqëror ose diskriminim

²⁴⁶ **Florian Bieber.** *Minority Rights and the Freedom of Religion in Balkan Countries* Herceg-Novi, Montenegro, September 24-26 1999. <https://www.immi.se/tidskrifter/invandragen/inv991/minority.htm>

²⁴⁷ <https://2009-2017.state.gov/documents/organization/171719.pdf>

bazuar në përkatësinë fetare, besimin ose praktikën janë të vazhdueshme. Drejtuesit e bashkësive fetare të pakicave raportuan akte vandalizmi, gjuhë të urrejtjes, sulme fizike dhe qasje negative të mediave ndaj tyre dhe komuniteteve që ata përfaqësojnë.

Në Malin e Zi,²⁴⁸ Kushtetuta garanton lirinë e fesë, si dhe të drejtën e personit për të ndryshuar fenë; specifikon se nuk ka fe shtetërore dhe garanton barazi dhe liri për të gjitha bashkësitë fetare. Ligji ndalon diskriminimin fetar dhe gjuhën e urrejtjes. Grupet fetare, veçanërisht, Kisha Ortodokse Serbe vazhdon të deklarojë se ligji, që rregullon statusin e tyre juridik ishte i papërshtatshëm. Shqetësimet e sigurisë në lidhje me përplasjet e mundshme midis anëtarëve të Kishës Ortodokse Malazeze dhe asaj Serbe vazhdojnë, veçanërisht, me rastet e aktiviteteve fetare, ku kërkohet edhe angazhimi i policisë. Problem mbetet edhe çështja e pronave, për të cilat qeveria vendosi kundër rikthimit të pronave të konfiskuara nga regjimi komunist. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) vendosi në favor të një myslimani me përkatësi rome, i cili kishte ngritur padi kundër qeverisë mbi dështimin për të hetuar sulmet e motivuara etnike dhe/ose fetare kundër tij dhe familjes së tij në vitin 2009. Zyra e Avokatit të Popullit raporton perceptime të larta të diskriminimit fetar.

Maqedonia e Veriut²⁴⁹. Koncepti i të drejtave dhe lirive të njeriut, siç janë liritë fetare në Kushtetutën e Maqedonisë bazohet në vlera liberale demokratike. Kushtetuta maqedonase i lidh të drejtat dhe liritë themelore të njeriut me konceptin e individit dhe qytetarit, por edhe me të drejtat kolektive të pakicave etnike, duke respektuar standardet

²⁴⁸ 2017 Report on International Religious Freedom: Montenegro. <https://www.state.gov/reports/2017-report-on-international-religious-freedom/montenegro/>

²⁴⁹ ALBANA METAJ-STOJANOVA RELIGIOUS FREEDOMS IN REPUBLIC OF MACEDONIA. SEEU REVIEW, Special Edition, Magna Carta 800th Volume 11, Issue1, 2015. <https://www.degruyter.com/downloadpdf/j/seeur.2015.11.issue-1/seeur-2015-0019/seeur-2015-0019.pdf>

dhe përgjegjësitë ndërkombëtare, të marra në bazë të konventave dhe traktateve të shumta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat ish-Republika e Maqedonisë i ka ratifikuar. Sfida e vërtetë qëndron në zbatimin e standardeve ndërkombëtare. Disa nga këto konventa dhe traktate ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Evropës janë trashëguar nga radhët e ish-federatës Jugosllave mes viteve 1948 dhe 1951. Sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, “Liria e besimit fetar është e garantuar. E drejta për të shprehur besimin e tij lirisht dhe publikisht, individualisht ose me të tjerët, është e garantuar”. Pas konfliktit të vitit 2001, Marrëveshja kuadër e Ohrit siguroi të drejtat e grupeve për etnitë, që nuk janë me shumicë në Republikën e Maqedonisë. Ligji për statusin juridik të kishës, bashkësive fetare dhe grupeve fetare të vitit 2007, shfuqizoi ligjin “Për fenë dhe grupet fetare” të vitit 1997. Regjistrimi i një entiteti të ri fetar si një person juridik nuk është më në kompetencat e pushtetit ekzekutiv por, transferohet në gjyqësor. Ky është një zhvillim pozitiv në situatën aktuale të subjekteve fetare. Por, entitetet fetare të paregjistruara, gjithashtu, mund të manifestojnë lirshëm fenë e tyre në bashkësi. Statusi i subjekteve fetare, që nuk duan të regjistrohen duhet të specifikohet në mënyrë jo-diskriminuese, siç kërkohet nga standardet ndërkombëtare.

Kushtetuta e Kosovës²⁵⁰ ndalon diskriminimin fetar dhe parashikon lirinë e fesë, duke iu nënshtruar kufizimeve për të siguruar rendin publik, shëndetin dhe sigurinë ose për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve. Ligji nuk lejon që grupet fetare të regjistrohen si persona juridikë, duke krijuar pengesa për ta në kryerjen e punëve të tyre. Në vitin 2017 Parlamenti votoi që të merrte në konsideratë një projektligj, i cili lejonte grupet fetare të regjistroheshin si persona juridikë, në mënyrë që ata të ishin në gjendje të drejtonin

²⁵⁰KOSOVO 2018 INTERNATIONAL RELIGIOUS FREEDOM REPORT. <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2019/05/KOSOVO-2018-INTERNATIONAL-RELIGIOUS-FREEDOM-REPORT.pdf>

çështje tregtare dhe juridike me shtetin dhe entitetet private, por ligji nuk mori miratimin përfundimtar.

Ndërsa grupet fetare deklarojnë marrëdhënie bashkëpunuese me qeveritë lokale, disa grupe ende ankohen në lidhje me mos-trajtimin e organizatave fetare në mënyrë të barabartë për çështjet e pronës, përfshirë lejet e ndërtimit. Përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe janë ankuar vazhdimisht se Qeveria shkelt të drejtat e pronës, duke përfshirë refuzimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore në favor të tyre, si dhe refuzimin për të lejuar ndërtime në Zonat e Mbrojtura. Komuniteti Islamik i Kosovës (BIK) vazhdon të raportojë diskriminim social dhe të punësimit ndaj myslimanëve të devotshëm, veçanërisht në sektorin publik. Qeveria vazhdoi të punojë me BIK-un për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe dënon dhunën mbi baza fetare.

4.3 Diskutimet brenda komuniteteve fetare në lidhje me të drejtën e besimit në Shqipëri.

4.3.1 Liria e besimit në ligj dhe në praktikë

Shqipëria ka ratifikuar të gjitha dokumentet ndërkombëtare në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe të besimit. Në Kushtetutë ka disa nene, siç janë shtjelluar edhe në disa nga seksionet e mësipërme që garantojnë lirinë e fesë qoftë në parim dhe qoftë si një e drejtë vetjake. Të gjitha këtë ndryshime ligjore, të ndodhura me vendosjen e një sistemi demokratik në Shqipëri nuk kanë kaluar pa debate mes juristëve, përfaqësuesve të klerit edhe qytetarëve, besimtarë këta apo jo. Këto debate më tepër sesa çështjen e ndikimit të shtetit kishin në themel të tyre çështjen e ndikimeve të jashtëme, fqinje dhe pretendimeve territoriale përmes ndikimeve fetare. Veçanërisht në fillimin e viteve '90,

çështja më kryesore e debatuar ka qenë ajo e drejtimit të Kishës Ortodokse Autoqefale nga një primat grek, ndonëse kjo gjë ndodhi për shkak të mungesës së klerit shqiptar, në vitet e para të vendosjes së sistemit demokratik.

Për të kuptuar se si perceptohet liria e besimit dhe e fesë në praktikë janë intervistuar 23 përfaqësues klerikë dhe laikë prej të gjitha komuniteteve kryesore fetare. Të gjithë të intervistuarit mendojnë se jo vetëm në ligj por edhe në praktikë, besimi fetar mund të praktikohet lirisht nga besimtarët që i përkasin një komuniteti të caktuar.

Përfaqësuesi i një prej komuniteteve shprehet se “ndërgjegjja nuk ka të bëjë me një ligj që dikush ta garanton, por është veprimi i lirë i njeriut për t’u përgjigjur, për të vepruar, për të marrë vendime që kanë të bëjnë me moralin dhe etikën e tij” pra “njeriu është i lirë në ndërgjegje të zgjedhë, ndër të tjera edhe besimin që më së shumti e plotëson në jetë”. Një tjetër klerik i një besimi tjetër thotë se “Si shteti, ashtu dhe kisha, ka rregullat e veta. Njerëzit janë të lirë si të besojnë si të mos besojnë”. Përgjithësisht, ata bien dakord se garancia e shtetit në ushtrimin e besimit lidhet me “momentin kur [kjo praktikë] nuk cenon të drejtën e tjetrit.

Megjithatë, një pjesë e të intervistuarve kanë shprehur shqetësimin se garantimi i kësaj të drejte nuk është i njëjtë për të gjitha komunitetet fetare. Për shembull, një përfaqësues i bashkësisë islame thotë “ ndërkohë që hebrenjtë dhe të krishterët kanë pushim ditët e tyre të rëndësishme që janë e shtuna dhe e diela, myslimanët si shumicë në Shqipëri, jo vetëm nuk e kanë pushim ditën e premte por, ju bëhet edhe pothuajse e pamundur që të shkëputen nga puna qoftë edhe një orë të vetme, për të shkuar në xhami për të plotësuar ritin fetar të xhumasë. Liria e ndërgjegjes dhe e besimit në Shqipëri akoma nuk është e

garantuar plotësisht e as praktikisht”. Pengesa të tjera lidhen me mbajtjen e shamive nga ana e besimtarëve myslimanë.

4.3.2 Bashkëjetesa fetare

Shqipëria është një vend në të cilin për shekuj kanë bashkëjetuar disa fe të mëdha, për qëllim të këtij studimi vlen të kuptohen se cilat janë disa nga arsyet apo faktorët që e kanë nxitur dhe brumosur tolerancën fetare. Një nga të përbashkëtat e të gjitha opinioneve ishte se bashkëjetesa fetare nuk ka lidhje me shtetin. Ajo ka lidhje me përputhjen mes vlerave fetare dhe atyre kulturore, normave të përbashkëta që kanë të gjitha fetë monoteike, madhësisë së komuniteteve fetare si dhe epërsia kombëtare mbi atë fetare.

Së pari bashkëjetesa fetare nuk duhet kuptuar si homogjene gjatë të gjitha periudhave historike, të marra në shqyrtim në këtë punim. Sipas një kleriku katolik, arsyeja e bashkëjetesës lidhet me “vlerat që secili besim përfaqëson dhe aty ku vlerat bashkojnë vlerat, aty ka edhe më tepër bashkëpunim, bashkëjetesë dhe bashkëveprim”. Kjo bashkëjetesë nuk ka qenë e imponuar, ajo ka qenë vlerë e kulturës shqiptare. “Si komb e kemi shumë të theksuar këtë ndjenjë të kulturës, e cila nuk na ndan, por na bashkon, pavarësisht kredos së secilit”. Një përfaqësues i fesë islame thotë “besoj se është në traditën e shqiptarëve që të respektojnë besimin dhe liritë e njëri-tjetrit”.

Së dyti, normat e të gjitha besimeve fetare në Shqipëri, si fe monoteike, të cilat kanë lindur nga shtrate të përbashkëta dhe besimi te një Zot i vetëm, kanë të përbashkët nderimin dhe respektin për tjetrin duke i quajtur të gjitha qeniet njerëzore si vëllezër të të njëjtit besim apo besimeve të ndryshme. Një nga të intervistuarit e komunitetit katolik

thotë “ligjet dhe normat tona nuk e lejojnë të dalë kundër “vëllait” por ta dojë, ta respektojë dhe ta nderojë”.

Së treti, madhësia e komuniteteve ka ndikuar që secila prej tyre të njihet dhe pranohet nga të tjerët. Një nga klerikët myslimanë të Shkodrës thotë se “prezenca e Islamit në Shqipëri [respektohet] duke ditur se shumica e popullsisë është myslimane”. Pra komunitetet fetare tradicionale kanë pasur përmasa të tilla që e kanë penguar nga njëra anë asimilimin e tyre dhe nga ana tjetër pranimin e ndërsjellë.

Së katërti, lidhjet familjare, farefisnore, krahinore kanë qenë më të fuqishme dhe më të konsolidura se ato fetare. Një nga arsyet e shprehura gjatë intervistave është se “duke qenë se jemi një vend i vogël, ndonëse me fe dhe besime të ndryshme, një pjesë e mirë kanë lidhje gjaku me njëri-tjetrin”.

4.3.3 Roli i shtetit në lidhje me bashkëjetesën fetare

Shteti nuk shihet nga përfaqësuesit e komuniteteve fetare si faktori kryesor i tolerancës ndër-fetare. Në opinionin e shumicës, shteti e ka përdorur dhe nxitur këtë bashkëjetesë për qëllimet e veta. “Më shumë sesa është kujdesuar për ruajtjen, besoj se është kujdesuar për status quo-në e saj”, thotë një besimtar katolik. Pluralizmi fetar apo të pasurit e disa feve ka nxituar apo detyruar shtetin që të mbajë qëndrime të caktuara në lidhje me bashkësitë fetare.

Megjithatë, disa nga klerikët bëjnë dallimin midis individit dhe bashkësisë. Një klerik katolik thotë “Jo çdo individ, sado që t’i përkasë një besimi fetar, domosdoshmërisht dëshmon bashkësinë fetare në tërësi. Nëse individit në fjalë, me veprime apo me gjeste

dhe situata konkrete dëmton rëndë rendin dhe ligjin e një Kombi, nuk është mbështetur nga Bashkësia, përkundrazi është distancuar nga ai/ajo, atëherë është më se normale që ligjet e një shteti të vihen në veprim në ruajtjen e çdo qytetari të saj”.

Çfarë roli duhet të mbajë shteti në këtë kontekst? Të gjithë mendojnë se shteti duhet të jetë asnjans, “pra nuk është se mbështet në veçanti njërin apo tjetrin besim fetar”. Por kjo asnjansësi nuk do të thotë se shteti nuk ka përgjegjësitë e veta. “[...] Shteti [duhet] të shohë pas, të kuptojë se ecuria e deritanishme është edhe si rrjedhojë e veprimit pozitiv konkret të individëve apo bashkësive fetare. [...] një Shtet t’i vijë në ndihmë bashkësisë/bashkësive fetare në përballimin e nevojave financiare, meqë nga edukimi i tyre përfitues i drejtpërsëdrejti është mbarë qytetaria”.

Megjithatë, në mendimin e këtyre përfaqësuesve, shteti ose nuk ka qenë ose nuk mund të jetë asnjans. Së pari, një pjesë e konsiderueshme mendojnë se shteti nuk është një nocion abstrakt “nuk ka se si të jetë asnjans apo të mos mbështesë fetë, sepse ai është i formuar prej vetë qytetarëve të tij, ku shumica janë fetarë”. Një klerik katolik thotë se “edhe shtetet më të përparuar, si SHBA-të apo shtetet e Evropës nuk është se nuk e mbështesin besimin e qytetarëve të tyre, madje një pjesë e mirë e tyre, përpara se të marrin detyrën e presidentit apo ndonjë detyre tjetër madhore, betohen në librin e shenjtë”.

Në një opinion tjetër më kritik “ligjet e shtetit shqiptar nuk kanë asnjë ndikim në ruajtjen e tolerancës fetare madje kam frikë, se mund të bëhen shkak për prishjen e pjesshme të saj me anë të favorizimit në forma të ndryshme të besimit të krishterë, përballë ndrydhjes dhe shtrëngimeve ndaj atij mysliman”. Disa nga të intervistuarit nga komuniteti mysliman janë shprehur se shteti ka favorizuar komunitetet e tjera në dhënien e trojeve

dhe pronave për ngritjen e objekteve të kultit dhe aktiviteteve të tjerave edukative apo sociale.

4.3.4 Problemet e brendshme dhe të jashtme të bashkësive fetare

Bashkësitë fetare në Shqipëri sot përballen me një sërë problemesh. Grupi i parë i problemeve ka të bëjë me globalizimin si dhe me të gjitha problemet sociale që lidhen me të që nga individualizmi, konsumizmi, pamundësia por edhe mungesa e reflektimit në lidhje me ndikimin e fenomeneve globale, në lidhje me rolin dhe qëllimin e individit sot në botë, rendja drejt materiale si një qëllim që nxit edhe fenomene të tilla si emigracioni, kriza dhe braktisja e familjes, divorcet në rritje.

Një grup i dytë i problemeve lidhet me papunësinë dhe kushtet ekonomike, për të cilat komunitetet fetare mund të bëjnë shumë pak. Një klerik ortodoks thotë se “nëse shteti do të na i kthente pronat, kisha mund të bënte më shumë për të mbështetur individët dhe komunitetet që kanë nevojë”.

Grupi i tretë i problemeve ka të bëjë me çështjen e pronave, e cila i ka prekur të gjitha komunitetet fetare. Kjo është edhe një nga pikat më të nxehta në lidhje me marrëdhëniet e shtetit me bashkësitë. Opinioni i përgjithshëm është se, nëse shteti ka garantuar mjaftueshëm liritë individuale për të praktikuar besimin e tyre, ai u ka mohuar komuniteteve fetare burimet e mjaftueshme dhe të drejtat e tyre pasurore, të mohuara nga sistemi i mëparshëm totalitar. Meqenëse çështja e pronave nuk lidhet drejtpërdrejtë me lirinë e besimit, ajo nuk është trajtuar në këtë punim.

Një çështje e katërt dhe specifike për Komunitetin Mysliman është ajo e rrymave të brendshme, disa prej tyre edhe të influencuara nga vende si Turqia apo bota arabe.

Probleme e brendshme dhe të jashtme të bashkësisë islame kanë krijuar mjaft tensione gjatë këtyre viteve të fundit, të lidhura si me zhvillimet politike në Turqi, luftërat kundër Shtetit Islamik në Siri e Irak me pjesëmarrjen edhe të disa shtetasve shqiptarë dhe me arrestimin në Tiranë të disa imamëve të “vetëshpallur” si përgjegjës për radikalizmin dhe përhapjen e ideve ekstremiste. Këto zhvillime janë reflektuar edhe në lidhshmërinë e Komunitetit Mysliman Shqiptar si dhe në zgjedhjet e zhvilluara gjatë vitit 2019 për të zgjedhur këta drejtuesin e komunitetit. Në këtë kontekst, disa përfaqësues të këtij komuniteti shprehin shqetësimin për “etiketimin e Islamit dhe myslimanëve sikur ata gjithmonë kanë lidhje me terrorizmin”.

Përveç çështjes së pronave, që ka lidhje të drejtpërdrejtë me shtetin, komunitetet fetare shprehin edhe disa shqetësime të tjera, si për shembull: ndërhyrjen e shtetit në konfliktet e brendshme të një bashkësie fetare duke ndikuar në favorizimin e njërit apo tjetrit fraksion. Ky shqetësim është shprehur kryesisht nga bashkësia Islame.

“Shteti jep një kontribut “modest” për bashkësitë fetare”. Disa nga përfaqësuesit e komuniteteve fetare kanë theksuar se shteti ka ndihmuar bashkësitë fetare në financimin e rrogave të klerikëve dhe dhënien e fondeve për klerikët në të gjithë Shqipërinë. Një klerik katolik thotë se “Shteti i është përgjigjur, sidomos kur kërkesa e ndihmës kishte lidhje me banorët në tërësi”. “Ne si Komunitet Katolik, kemi bërë të mundur që ai kontribut të shkojë në ndihmesë të shkollave të kësaj bashkësie për t’i mbështetur dhe për t’i subvencionuar ato”. Në mendimin e përfaqësuesve të komuniteteve fetare, shteti duhet të bëjë më shumë së financimi i përvitshëm, që shkon nga buxheti i shtetit për bashkësitë fetare”.

4.3.5 Edukimi fetar

Sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të ratifikuar edhe nga Shqipëria, prindërit në Shqipëri kanë mundësi të zgjedhin dhe t'u ofrojnë edukim fetar fëmijëve të tyre, në përputhje me fenë apo besimin e tyre. “Përgjithësisht prindërit janë të gatshëm t'i lejojnë fëmijët e tyre në edukimin fetar”. Megjithatë, sipas një përfaqësuesi të komunitetit mysliman edukimi fetar “është pothuajse i pamundur në fshatrat dhe zonat rurale, ku shumica e hoxhallarëve nuk e kanë mundësinë e pjesëmarrjes së rregullt në hapjen dhe aktivizimin e xhamive”.

4.3.6 E drejta për të mos besuar apo për të ndryshuar besimin

Sipas një kleriku mysliman “ateizmi në vetvete, është formë besimi [...] Përderisa shteti shqiptar është laik, përpara tij njerëzit duhet të jenë të barabartë, pavarësisht besimit të tyre. Një shtet laik, i cili garanton lirinë e besimit, automatikisht e ka garantuar lirinë e ndryshimit të besimit të çdo personi sa herë të dëshirojë”. Një klerik ortodoks thotë se “ka një pjesë të popullsisë që nuk beson, që është ateiste dhe ata kanë të drejtën e tyre. Sot është madje e modës të qenurit ateist”.

Çështjen e ndryshimit të fesë, përfaqësuesit e komuniteteve fetare e shohin si një çështje private të individit, e cila nuk ka nevojë për ndonjë mbrojtje nga ana e shtetit. Një klerik thotë se “të caktosh një ligj të veçantë, në një kohë dhe në një komb, që këto problematika s'i ka, besoj se është e tepërt”. Ndërsa një klerik ortodoks thotë se: “Në Kishën Ortodokse ka rregulla strikte, të cilat duhet t'i respektojnë jo-besimtarët që duan të konvertohen. Duhet të nënshkruajnë një lloj kontrate. Për këtë arsye, kontaktohen edhe

anëtarët të familjes. Ka pas raste që prindërit kanë qenë dakord të konvertohet personi, i konvertuar për shkak të martesës mes besimeve të ndryshme”. Konvertimi nuk duhet të bëhet për përfitime personale.

4.3.7 Ndërhyrja e shtetit dhe kufizimi i lirisë së shprehjes së një besimi fetar

Përfaqësuesit e bashkësive fetare bien dakord se shteti duhet të ndërhyjë si rregullator kur shfaqen “qëllime keqdashëse ndaj komuniteteve të tjera fetare”, “cenohet kushtetuta” dhe “shfaqen tendenca radikale”. Një klerik ortodoks thotë se: “radikalizmi pjell urrejtje”, ndërsa një klerik katolik shprehet se ndërhyrja e shtetit duhet të jetë vetëm në raste të veçanta “kur ka një radikalizëm të tepruar që fyen, cenon apo kërcënon lirinë e të tjerëve”

Thuhet shpesh se në demokraci çdo individ është i lirë që ta shprehë hapur besimin e tij fetar. Megjithatë, një nga diskutimet kryesore, jo vetëm në Shqipëri, është nëse individë, të cilët mbajnë pozicione zyrtare, si për shembull: gjyqtarë, ushtarakë, punonjës të rendit, mjekë, mësues, të mund të lejohen të mbajnë në publik simbole të dukshme fetare. Në këtë çështje, opinioni i të intervistuarve është i përzier. Disa nga mendimet e shprehura për këtë çështje gjenden si më poshtë, duke cituar disa nga të intervistuarit:

- Një klerik katolik thotë: “Meqë Shteti Shqiptar është laik, d.m.th.-në, nuk i përket, nuk mbështet dhe as nuk ushtron një besim të caktuar, ka edhe ligje, të cilat ndalojnë punonjësit publikë të shfaqin përmes simboleve përkatësinë fetare, në veçanti kur janë të veshur me “rrobën e punës”. Sidoqoftë, nuk është simboli që mban, i cili dëshmon jetën fetare të personit. Për mua, personalisht, mbajtja e tij nuk do binte ndesh me shtetin laik të së drejtës”.

- Një klerik ortodoks thotë se në lidhje me simbolet fetare të zyrtarëve: “Shqipëria, në ndryshim nga vendet e tjera, nuk është gati për një diskutim të tillë”.
- Ndërsa një përfaqësues i bashkësisë myslimane thotë se: “Shtet laik nuk do të thotë shtet i ndarë nga feja dhe asnjëherë në lidhje me besimet, pra një shtet që nuk ka fe zyrtare. Pra, çdo person pavarësisht përkatësisë fetare mund të punojë në çfarëdolloj posti, si dhe të mbajë simbolet fetare përkatëse që e identifikojnë besimin e tij”.

Megjithatë, mbajtja e simboleve fetare shpesh është kthyer në një problem për besimtarët në vendin e punës. Shumë nga këto ankesa vijnë nga ana e komunitetit mysliman. Një klerik thotë: “Ankesat në lidhje me punëdhënësit që ndalojnë nga mbajtja e simboleve fetare janë të shumta. Madje, jo vetëm në sektorin privat, por edhe në atë shtetëror. Në Madje, në këtë pikë, diskriminimi ndodh edhe në shkollë, ku ka pasur raste të pengimit nga pjesëmarrja në mësimet e vajzave të mbuluara me shami. Madje, unë personalisht jam përballur me një problem të tillë me vajzën time, që mëson në klasën e tretë fillore. Në disa raste, psikologja e shkollës e shkëputte atë nga ora e mësimet dhe në zyrën e saj i bënte propagandë për të mos veshur funde dhe këmbë të gjata derisa të mbushte moshën 18 vjeç”. Problemet e mbajtjes së shamisë janë evidentuar edhe nga përfaqësues të komuniteteve të tjera. Nga ana e besimeve të krishtera nuk u paraqitën problematika të diskriminimit në punë nga ana e besimtarëve të tyre.

KAPITULLI V: KONKLUSIONE

Në rrjedhën e këtij studimi analizuam marrëdhëniet mes shtetit dhe fesë në Shqipëri përmes dy qasjeve kryesore, së pari, asaj historike, e cila e sheh zhvillimin e këtyre marrëdhënieve në mënyrë kronologjike, duke u ndalur në periudhat më të rëndësishme, si në legjislacionin shqiptar mbi lirinë e ndërgjegjes dhe besimit, por edhe të ngjarjeve të rëndësishme në historinë e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri. Së dyti, si dhe në funksion të së parës, analiza ligjore shtjelloi modelin kompleks kushtetues dhe standardet e së drejtës ndërkombëtare të pranuar si eprorë, por edhe si kufizim i të drejtës vendase kur vjen puna tek garantimi i lirive dhe të drejtave të njeriut (neni 17, 116 dhe nenet 121 e vijues të Kushtetutës).

Në ndryshim nga shumë vende, të cilat kanë disa ngjashmëri të rëndësishme me Shqipërinë, si për shembull, për nga e kaluara e përbashkët totalitare dhe tranzicionet e përbashkëta demokratike në vitet '90 e në vazhdim, siç janë vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, Shqipëria, e cila ka mbi 200 raste të përfunduara apo në shqyrtim pranë GjEDNj-së, kryesisht për shkelje të nenit 6 “E drejta për një proces të rregullt” dhe nenit 13 “E drejta për zgjidhje efektive”, nuk ka asnjë rast të vetëm pranë kësaj Gjykate, në lidhje me shkeljen e nenit 9 ose në lidhje me lirinë e ndërgjegjes, besimit dhe fesë.

Duke e krahasuar me vendet e Evropës Juglindore, si për shembull Greqia, e cila ka rreth 19 raste ku Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka gjetur shkelje të nenit 9 të Konventës, disa prej këtyre janë vendime kyçe në zbërthimin e jurisprudencës së GjEDNj-së, si për shembull Kokkinakis kundër Greqisë apo Manoussakis dhe të tjerë kundër Greqisë. Shqipëria jo vetëm nuk ka çështje pranë kësaj Gjykate në lidhje me zbatimin e nenit 9, por edhe pranë gjykatave më të larta vendase, si për shembull

Gjykatës Kushtetuese nuk i është kërkuar ndonjëherë mendim për interpretimin e neneve të Kushtetutës, të cilat lidhen me lirinë e ndërgjegjes dhe fesë apo për cenimin e këtyre të drejtave nga sistemi vendas i drejtësisë.

Mungesa e një jurisprudence të mirëfilltë vendase në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe besimit si para ashtu edhe pas miratimit të Kushtetutës së parë pluraliste në Shqipëri, më 12 Shtator 1998 me referendum popullor, është një tregues kuptimplotë, që mbështet hipotezën e këtij punimi, i cili mbron idenë se historia e gjatë e pluralizmit, e ndërthurur me vlerat shoqërore të bashkëjetesës fetare ka kontribuar në përqafimin e modeleve ligjore, të cilat nuk kërkojnë ndërhyrjen e shtetit qoftë në rregullimin e brendshëm, por edhe të jashtëm të marrëdhënieve të tij me bashkësitë fetare. Pra, toleranca, bashkëjetesa dhe respekti i ndërsjellë ndaj lirisë së të pasurit dhe ndaj manifestimit të besimit janë parime, të cilat nuk burojnë nga shtrëngimi i ligjit por, janë vlera dhe norma shoqërisht të përvetësuara nga individët, si pjesë e proceseve shoqërizuese brenda familjeve, institucioneve shoqërore, por edhe atyre publike.

Kjo nuk mbron se ndërhyrjet e shtetit përmes ligjeve apo mjeteve të tjera me natyrë pozitive ose negative nuk kanë pasur ndikimin e tyre, madje, përkundrazi, këto ndërhyrje, qofshin pozitive për të thelluar frymën e bashkëjetesës paqësore dhe bashkëpunimit për qëllimet e bashkimit kombëtar dhe konsolidimit të shtetit shqiptar, ashtu edhe negative, duke frenuar tendencat separatiste apo ndikimet e pushteteve të huaja përmes nxitjes së krijimit të bashkësive fetare shqiptare dhe ndarjes nga burimet e autoritetit fetar të Romës apo Stambollit, si dhe të vendeve fqinje.

Një dimension i dytë, që është shtjelluar gjerësisht në këtë punim është ai i historisë së shtetit dhe së drejtës në Shqipëri nga pikëpamja e marrëdhënieve ndër-fetare dhe atyre

mes shtetit dhe fesë. Dimensionit historik i është dhënë edhe pesha më e madhe në këtë studim, për shkak edhe të pasurisë si të literaturës, por edhe të ngjarjeve të rëndësishme, që lidhen me shtet-formimin dhe me vendosjen e bazave të rregullimit të aspektit juridik dhe institucional të bashkësive fetare nën ndikimet e brendshme dhe të jashtme. Këto aspekte mjaft delikate të politikës së jashtme duhet të jenë pjesë e një studimi të veçantë, i cili duhet të fokusohet në aspektet gjeopolitike dhe marrëdhëniet me fqinjët si shtete deri diku unitare si nga pikëpamja e kombësisë ashtu edhe fesë. Meqenëse shteti shqiptar, që me lindjen e tij bënte një përjashtim nga fqinjët për shkak të pranimi të konceptit të diversitetit fetar përkundërt unitetit etnik dhe kombëtar, modeli shqiptar është interesant për t'u studiuar më tej edhe nga qasja krahasuese.

Që nga momenti kur Shqipëria u shpall shtet i pavarur dhe sovran, politika e shtetit mbi fenë është karakterizuar nga parimet e asnjësisë ndaj bashkësive fetare. Meqenëse në territorin shqiptar, historikisht nuk ka ekzistuar një fe e vetme, shteti shqiptar është përpjekur të mos mbajë anën e një feje të caktuar dhe ka mbetur laik apo neutral në raport me çështjet fetare, duke theksuar nevojën për tolerancë dhe mirëkuptim mes qytetarëve dhe bashkësive.

Shqipëria është simbol i unitetit në diversitet, parim i cili në ditët tona është kthyer në një nga parimet kryesore të Bashkimit Evropian. Nga ana tjetër, përkatësitë e ndryshme fetare të shqiptarët krijuan edhe ndarje, të cilat kontribuan negativisht në përpyekjet disa shekulle për bashkim dhe për të krijuar një shtet të pavarur shumë më vonë se fqinjët, të cilët kishin homogjenitet si kombëtar ashtu edhe fetar.

Dy vjet pas shpalljes së pavarësisë, në Statutin e vitit 1914, proklamohet jo vetëm laiciteti i shtetit, por edhe se ndryshimi në fe nuk mund të përbëjë shkak përjashtimi apo

paaftësie “për sa i përket gëzimit të të drejtave civile e politike, pranimi në punë shtetërore, në funksione ose ndere ose [...] ushtrimit të profesioneve dhe aktiviteteve të ndryshme”. Gjurma juridike e lënë nga ky sistem, bëri që shteti të njohë të gjitha komunitetet fetare shqiptare duke vendosur epërsinë e vet mbi besimet e ndryshme pa e zbehur mbikëqyrjen ndaj tyre.

Në vazhdim politika e Zogut kishte për qëllim forcimin e unitetit të grupeve të ndryshme fetare. Duke qenë i vetëdijshëm për veçoritë e shoqërisë shqiptare, qëndrimi i Zogut ndaj feve ishte nacionalist. Zogu u tregua reformatör dhe i vendosur në çështjen e epërsisë së shtetit ndaj të gjitha feve, konsolidimit të feve kombëtare duke afirmuar dhe konsoliduar laicitetin e shtetit. Parimi se “shteti nuk ka fe zyrtare”, u sanksionua që në Statutin e vitit 1922 dhe u ripohua edhe në “Statutin Themeltar të Republikës” edhe në “Statutin Themeltar të Mbretërisë”. Gjatë qeverisjes së vendit nga Ahmet Zogu (periudhës pas Revolucionit të Qershorit, respektivisht Republikës (1925-1928) dhe Monarkisë zogiste (1928-1939), marrëdhëniet tolerante mes elementeve të ndryshëm fetare në vend erdhën duke u konsoliduar.

Hapi më i rëndësishëm në këtë drejtim ishte distancimi dhe më pas ndarja si nga koncepti mbi fenë por edhe nga vetë legjislacioni osman dhe ndikimi, i cili krijonte një marrëdhënie dualiste ligjore mes ligjeve civile dhe atyre fetare. Për herë të parë në programin e një qeverie shqiptare, që nga shpallja e pavarësisë, flitet për reforma fetare, të cilat kulmuan me miratimin nga Parlamenti Shqiptar i “Statutit Legal të Komuniteteve Fetare” në vitin 1923 dhe projektligjit mbi statutin e bashkësive fetare. Në këtë mënyrë, shtetasit shqiptarë nga njëra anë mund të zgjidhnin të mos t’i nënshtroheshin asnjë legjislacioni kanonik duke i’u nënshtuar nga ana tjetër në mënyrë të detyrueshme ligjeve

të shtetit. Me këtë reformë filloi procesi i ndarjes së fesë nga shteti dhe krijimi i institucioneve fetare kombëtare.

Politika e Zogut, në pikëpamjen formale, synonte vendosjen e bazave të një shteti laik dhe në pikëpamjen praktike vendosjen e të tre bashkësive kryesore fetare në kontrollin e plotë të shtetit. Për këtë arsye, më 16 Korrik 1929, Parlamenti miratoi ligjin e bashkësive fetare, i cili i dha një goditje të plotë imunitetit fetar që ekzistonte deri përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ky ligj vendosi detyrimin që kleri aktiv në Shqipëri të ishte i kombësisë dhe i trungut etnik shqiptar dhe parashikonte kontrollin e shtetit mbi administrimin e pasurive të çdo besimi fetar. Përveç ndërhyrjes në rregullimin e marrëdhënieve të bashkësive tradicionale, Zogu inkurajoi edhe diversitetin e mëtejshëm fetar në Shqipëri, duke i hapur rrugë edhe feve të tjera të praktikonin besimin e tyre, gjë që u shoqërua edhe me rezistencë dhe përplasje mes bashkësive fetare tradicionale.

Një nga ngjarjet më të rëndësishme në legjislacionin shqiptar të asaj periudhe ishte hyrja në fuqi e Kodit Civil më 1 Prill 1929. Kodi i ri Civil, në ndryshim nga Kodin Civil osman i botuar më 1876 i cili ishte më pak i sistematizuar, mund të cilësohet edhe si reforma më e madhe në legjislacionin shqiptar, i cili ndau përfundimisht shtetin nga feja në domenin e së drejtës private, solli dispozita dhe zgjidhje të reja e të njësura për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe zgjidhje të tjera të së drejtës formale. Kodi i Ri Civil solli një sërë artikujsh që binin ndesh me parimet bazë të së drejtës kanunore. Për herë të parë me shpalljen e Kodit Civil, familja nuk ishte më objekt i rregullimeve nga e drejta fetare, kishtare apo kanunore.

Nevoja për legjitimitet të qeverisjes gjatë periudhës 1920-1939 çoi në hartimin si të politikave shtetërore ashtu edhe të legjislacionit, që synonin eliminimin e opozitave me

karakter fetar ndaj pushtetit legjitim. Vendorsja e parimeve të rrepta kombëtare për veprimtarinë e institucioneve fetare, por edhe një kontroll i përgjithshëm i shtetit mbi bashkësitë fetare i shërbeu këtij qëllimi. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe komuniteteve në këtë kohë nuk vendoseshin me marrëveshje të ratifikuara me ligj por, me statute, që pasi miratoheshin nga organet përfaqësuese të komuniteteve fetare, kalonin në Këshillin e Ministrave për tu verifikuar nëse ishin në përputhje me normën dhe ligjet në fuqi. Krahës qëllimit për krijimin e një shteti evropian dhe laik, Zogu kishte si qëllim ndërtimin e bashkësive dhe klasës së klerikëve të pavarur e të pa politizuar. Kjo e fundit sepse figura të shquara të klerikëve dhe komuniteteve fetare shpesh i kishin bërë një opozitë jo vetëm me karakter fetar, por edhe politik pushtetit të tij.

Nevoja për legjitimitet dhe eliminimin i opozitave me bazë shoqërore apo fetare vazhdoi edhe gjatë vendosjes dhe konsolidimit të regjimit komunist në Shqipëri, ndonëse masat e ndërmarra, si politike ashtu edhe ligjore, çuan gradualisht nga nënshtrimi i fesë ndaj autoritetit të shtetit në eliminimin total të fesë si nga sfera publike ashtu edhe nga ajo private. Në të gjitha vendet e bllokut komunist, ku mbizotëronte ideologjia e doktrinës marksiste leniniste, feja do të konsiderohej si një element i padëshirueshëm në procesin e ndërtimit të shoqërisë të shtetit komunist. Në ndryshim nga vendet e tjera, regjimi komunist shqiptar e shpalosi këtë qëndrim me miratimin e Kushtetutës së vitit 1967, duke treguar një nga variantet më rigorozë të ateizmit shtetëror, deri në vitin 1991 me Dispozitat Kryesore Kushtetuese. Përveç ateizmit shtetëror, gjatë periudhës komuniste u zhvillua një politikë e ashpër antifetare, e cila u shoqërua me një kontroll të rreptë të shtetit mbi klerin, shkatërrimin e objekteve të kultit, shtetëzimin e pronave fetare, si dhe persekutimin e klerit dhe manifestimin e besimit fetar si publik ashtu edhe privat qoftë nga ana e organizatave ashtu edhe nga ana e individëve të të gjitha komuniteteve fetare.

Në vitet e para të regjimit komunist, zbatimi i dispozitave statusore ishte çështje e brendshme e komuniteteve fetare. Marrëdhëniet e institucioneve të kultit me shtetin rregulloheshin njëllor si edhe më parë nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë. Kjo varësi institucionale në raportet me shtetin do të ruhej deri në fund të vitit 1949. Edhe pse Komiteti për Çështjet e Kultit, i formuar në vitin 1929, u suprimua më 1944 pas ardhjes së komunistëve në pushtet, tradita e mëparshme, ku Ministria e Drejtësisë ishte lidhja ndërmjet enteve fetare dhe shtetit, mbeti e pandryshuar. Vetëm se në ndryshim nga gjendja e mëparshme, ky raport ishte i përqendruar dhe bëhej drejtpërdrejt nga ministri dhe jo nga ndonjë departament i ministrisë sikundër ndodhte përpara vitit 1944. Kjo gjendje do të vazhdonte deri në vitin 1949.

Ndër masat e para, të ndërmarra nga diktatura komuniste kundër komuniteteve fetare në Shqipëri ishte reforma agrare dhe konfiskimi i pasurisë së tyre me ligjin nr. 108, datë 29.8.1945 “Mbi reformën agrare”. Reforma preku rëndë pronat e institucioneve fetare dhe çoi në rrënimin e situatës ekonomike të bashkësive fetare. Përveç reformës agrare, reforma arsimore e vitit 1946 pati si synim largimin e rinisë nga besimi fetar.

Në Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë të vitit 1946, ishte sanksionuar liria e ndërgjegjes dhe e besimit, si dhe liria e ushtrimit të tyre, e garantuar nga asnjënjësia dhe laiciteti i shtetit. Paragrafi i katërt i nenit 18 ndalonte që kisha dhe feja të shpërdoreshin për qëllime politike, shërbeu si bazë për persekutimin e dhjetëra klerikëve, të cilët u akuzuan për pjesëmarrje politike, me qëllim rrëzimin e regjimit. Kushtetuta e kësaj kohe, theksonte laicizmin e shtetit dhe të sistemit arsimor, garantonte pronën dhe ndërmarrjen e lirë private edhe pse u vendos që prona private mund të kufizohej dhe të tjetërsohej kur ta kërkonte interesi i përgjithshëm, gjithnjë në bazë të ligjit.

Më 26 Nëntor 1949, qeveria komuniste shpalli Dekretin Nr.743 me titull “Mbi komunitetet fetare”. Ky dekret kufizoi të drejtat e besimtarëve për të ndjekur praktikat fetare dhe të praktikojnë bindjet e tyre fetare, me kusht që këto rregulla dhe besimet fetare nuk duhet të ishin në kundërshtim me ligjet e shtetit, me rendin dhe moralin e mirë. Nuk lejohet marrja e personelit me shtetësi të huaj për kryerjen e funksioneve fetare. Neni 16 i dekretit i lejon qeverisë kontroll ekonomik mbi komunitetet fetare nëpërmjet miratimit të preventivit të bilancit të tyre. Lidhjet në mes të komuniteteve fetare dhe të qeverisë bëhen me anë të Kryesisë së Komunitetit dhe Këshillit Ministror.

Duke e krahasuar këtë dekret me atë të kohës së Zogut, mund të thuhet se ai mbart ndryshime rrënjësore në statusin juridik të komuniteteve fetare, pasi u kufizon ndjeshëm lirinë e veprimit dhe ndërhyr në punët e tyre të brendshme. Qëllimi i sistemit ishte eliminimi në mënyrë graduale i ideologjisë fetare. Kështu, për të sanksionuar shtetin laik synohej ndarja e komuniteteve fetare nga shteti dhe nga qendrat fetare të huaja. Ndarja e shkollës nga feja dhe laicizimi i saj. Qëllimi i ligjit ishte vendosja e institucioneve të kultit nën kontrollin e plotë të shtetit dhe sidomos nën atë të Kryeministrit. Ligji detyronte bashkësitë fetare për të kërkuar nga besimtarët besnikëri ndaj pushtetit të popullit dhe Republikës Popullore të Shqipërisë për ta forcuar unitetin kombëtar. Më tepër se sa të nxirrte në pah të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella midis shtetit dhe fesë në këtë ligj përcaktohej vargu i tërë i të drejtave të shtetit kundrejt bashkësive për të kontrolluar, madje edhe çështjet e brendshme të këtyre të fundit.

Frymëzuar nga miqësia me Kinën, në vitet 1960, Shqipëria nisi të ashtuquajturin “revolucion ideologjik dhe kulturor”, i cili u karakterizua nga përpjekja për të bashkërenduar luftën kundër organizatave fetare dhe ndikimit fetar në vend. Me braktisjen dhe denoncimin e politikave hrushoviane nga ana e Shqipërisë komuniste në

vitin 1961 dhe me daljen e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës në vitin 1968, ndikimi i politikave kineze për më shumë se një dhjetëvjeçar ishte mjaft i pranishëm, si në fushën ekonomike ashtu edhe në modelin socialist të eksperimentuar nga Pekini.

Në mbështetje të nenit 58, pika 6, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë me propozimin e Qeverisë, Presidiumi i Kuvendit Popullor nxjerr Dekretin Nr.3660, Datë 10.4.1963, dekret ky, mbi disa ndryshime në Dekretin Nr.743, Datë 26.11.1949 “Mbi komunitetet fetare”, të titulluar “Ndryshime në ligjin për Bashkësitë Fetare”. Nga pikëpamja juridike kjo ishte një goditje tjetër ndaj komuniteteve fetare duke kërkuar miratimin e qeverisë ose organeve lokale për çdo aktivitet fetar.

Në verën e vitit 1967 nisi edhe likuidimi i plotë i institucioneve fetare. Me 19 Nëntor 1967, regjimi komunist shpalli Dekretin Nr.4337, “Mbi abrogimin e disa dekretëve” të nxjerra në vitet 1949-1951, që legalizonin statutet e rishikuara të katër komuniteteve fetare në Shqipëri. Ky dekret ndalonte të gjitha ritet fetare dhe vendoste dënime të rrepta për shkelësit e ligjit dhe binte ndesh me parimet kushtetuese. Eliminimi i lirive fetare deri më 1967 ishte bërë pa asnjë bazë juridike. Në vitin 1967 qeveria nxjerr jashtë ligjit praktikat fetare, duke ligjëruar persekutimin fetar. Nga aspekti kushtetues, situata joligjore do të zgjasë deri në vitin 1976 me miratimin e Kushtetutës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, e cila plotësoi në mënyrë përfundimtare bazën ligjore të mungesës së lirisë fetare.

Lufta kundër fesë në Shqipëri zgjati për rreth 25 vjet. Gjatë këtyre viteve, u zhvillua një proces jo i menjëhershëm, por i shtrirë historik, gjatë të cilit shteti komunist veproi dhe hartoi platforma politike, gjithnjë në përputhje me kushtet konkrete të vendit dhe zbatoi metoda antifetare, të cilat u shtrinë në të gjitha fushat e së drejtës dhe veçanërisht në atë

penale. Kodi Penal i vitit 1977 sanksionoi dënime të ashpra ndaj shprehjes, përhapjes së ideve dhe praktikimit të riteve dhe festave fetare.

Pas ndryshimeve demokratike të viteve 1990, u rivendos liria e fesë dhe e të drejtave të komuniteteve të vjetra fetare në Shqipëri. Që në Dispozitat Kryesore Kushtetuese të vitit 1991, u riafirmuan liritë fetare dhe shteti shqiptar merr një rol aktiv në mbrojtjen dhe garantimin e lirisë së ndërgjegjes dhe besimit. Institucionet shqiptare kanë punuar për të përshtatur sistemin ligjor shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe veçanërisht Konventën dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Hapi i parë në këtë drejtim është garancia në nivel kushtetues për respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, duke përfshirë këtu, gjithashtu, edhe lirinë e ndërgjegjes dhe besimit.

Për herë të parë bëhet fjalë për fenë në nenin 7 të “Dispozitave Kryesore Kushtetuese”, ku u vendosën dy parime tepër të rëndësishme, së pari Republika e Shqipërisë është një shtet laik, që do të thotë se veprimtaria e shtetit nuk bazohet në normat apo rregullat e ndonjë feje dhe së dyti, si shtet laik, Republika e Shqipërisë respekton lirinë e besimit fetar, që do të thotë se shteti respekton lirinë e individëve për të ushtruar atë besim që dëshirojnë, gjithashtu, shteti jep ndihmën e vet në gëzimin e një besimi të dhënë. Shteti i së drejtës nuk mund të kryejë asnjë veprim pa e bazuar atë në dispozita ligjore, prandaj ishte e domosdoshme dalja e një ligji të posaçëm për këtë qëllim për rregullimin e lirive dhe të drejtave themelore në vitin 1993.

Fillimisht, veprimtaria e komuniteteve fetare u rregullua sipas dispozitave të Kodit Civil, i cili hyri në fuqi më 1 Nëntor 1994. Në nenin 39, ky Kod përfshin “organizata[t] shoqërore që ndjekin qëllime fetare”, një rregullim ky i vonuar pasi veprimtaria e

organizatave fetare kishte filluar që në vitin 1990. Por, dispozitat e Kodit Civil ishin të papërshtatshme sepse veprimtaria e komuniteteve fetare dhe organizimi i tyre, gëzonin një status të veçantë për shkak të statusit të posaçëm, i cili shkon përtej ndarjes në persona juridike privatë apo publikë.

Marrëdhëniet mes shtetit dhe komuniteteve fetare morën një drejtim të ri dhe krejt origjinal pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1998 por, pa cenuar traditën e sistemit shqiptar, thellësisht pluralist, me grupet fetare dhe në marrëveshje të plotë me organizmat e zgjedhur apo emëruar lirisht prej tyre. Norma kushtetuese sanksionon lirinë për proselitizëm, rolin “kombëtar” të grupimeve fetare, që shihet dhe vlerësohet si dukuri e përbashkët kolektive për të gjitha shtresat shoqërore, të cilat konvergojnë në interesin e përbashkët të kohezionit dhe bashkimit kombëtar. Po kështu, një mbrojtje e veçantë gjen e drejta e lirisë dhe besimit edhe në nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si një ndër të drejtat themelore të individit. Kushtetuta Shqiptare duket se ka zgjedhur gjuhën më të ndjeshme ndaj të gjitha grupeve fetare. Neni 10 i saj siguron trajtim të njëjtë të të gjitha grupeve fetare në Shqipëri.

Sipas Kushtetutës, bashkësitë fetare janë të lira, të rregullojnë çështjet e tyre, në përputhje me normat e tyre të veçanta apo me bindje të tjera se si duhet të organizohet sa më mirë bashkësia e tyre. Kështu, ato mund të dëshirojnë të shtojnë praninë e tyre, që vjen nga ekzistenca e organizmave ligjore sipas ligjeve për organizatat jofitimprurëse dhe duhet të lejohen të veprojnë. Ato mund të parapëlqejnë të organizojnë veprimtarinë e tyre nën organizma, si dioqeza dhe bashkësi kishtare sipas rregullave të veta të brendshme ose mund të dëshirojnë të ngrenë organizma ligjore zyrtare, që u përgjigjen strukturave të tilla kishtare për të lehtësuar administrimin e veprimtarisë të tyre. Shteti duhet të jetë bashkëpunues për lehtësimin e problemeve të tilla. Në disa raste,

organizmat fetare mund ta bënin këtë për të ngritur organizma ligjorë të veçantë si institucionet e bamirësisë apo ato arsimore fetare.

Termi “bashkësi fetare” duhej formuluar me saktë, për të mos u drejtuar vetëm te fetë kryesore tradicionale në Shqipëri por, të ishte më gjithëpërfshirës, në mënyrë që të sigurojë barazi dhe përfshirje. Kjo do të thotë se klauzolat e Kushtetutës shqiptare duhen interpretuar, në mënyrë që të shmangen kufizimet në përdorimin e tyre vetëm për fetë tradicionale.

Organi kompetent për kontrollin e veprimtarisë së organizatave fetare është Ministria e Drejtësisë, pasi nëpërmjet saj është bërë edhe miratimi i statuteve të tyre nga Këshilli i Ministrave. Marrëdhëniet mes shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje i ratifikon Kuvendi.

Marrëveshjet janë mjete për garantimin e të drejtave të sanksionuara në Kushtetutë për komunitetet nënshkruese, sipas një shkalle prioritetesh të ndryshme, të përcaktuara prej tyre por të cilat, konvergojnë në njohjen e rëndësisë për rolin e strukturës fetare. Komunitetet fetare theksojnë nevojën e mbrojtjes së lirisë fetare individuale, jo vetëm për pjesëmarrjen në ritet fetare, por edhe për të ndërruar besimin fetar, duke njohur plotësisht lirinë e proselitizmit dhe të drejtën e secilit për të mos marrë pjesë në asnjë rit fetar, ashtu si të drejtën për të mos qenë pjesë e asnjë kulti.

Shteti nuk mund të ndërhyjë në çështjet e komuniteteve fetare veçse nëpërmjet marrëveshjeve të sipërpërmendura. Vendoset kështu pavarësia e komuniteteve fetare, duke lënë të kuptohet në një farë mënyre se ato konsiderohen si trupa të huaja ndaj shtetit. Për sa i përket qëllimit të këtyre marrëveshjeve, mund të themi se ato duhet të

garantojnë realizimin e të drejtave të sanksionuara nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe fesë, të njohin e të garantojnë respektimin e të drejtave të komuniteteve fetare, të garantojnë lirinë e individit për të zgjedhur ose ndryshuar fenë, për ta shfaqur atë individualisht ose kolektivisht në institucionet fetare ose jashtë tyre, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve fetare, të sigurojnë lirinë e individit për të mos u ndaluar dhe as për tu detyruar të bëjë pjesë në një bashkësi fetare ose të marrë pjesë në praktikat, ritet dhe në strukturat drejtuese të saj.

Duke i rregulluar marrëdhëniet përmes marrëveshjeve mes qeverisë shqiptare dhe komuniteteve fetare, qeveria shqiptare ka ndërmarrë hapa, së pari me Kishën Katolike dhe më pas, me të gjithë bashkësitë e tjera fetare. Kështu, më 23 mars të vitit 2002 u firmos marrëveshja e parë mes Selisë së Shenjtë dhe Republikës së Shqipërisë, e cila u miratua nga parlamenti më 21 Shtator 2002. Kjo shënoi mbylljen e një faze të gjatë përballjesh në marrëdhëniet mes shtetit dhe Kishës Katolike dhe vendosjes së marrëdhënieve të ndërsjella. Qëllimi i marrëveshjes shprehet që në parathënien e marrëveshjes, e cila konsistonte në rregullimin e statusit juridik të Kishës Katolike në Shqipëri, në mënyrë që ajo të gëzonte garancitë ndërkombëtare. Kjo marrëveshje mund të konsiderohet edhe si protokolli i ndarjes mes shtetit dhe fesë.

Marrëveshjet e nënshkruara me komunitetet fetare janë të rëndësishme sepse për herë të parë, pas vendosjes së demokracisë, bëhen përpjekje për ta disiplinuar në rrugë ligjore sistemin arsimor fetar në vend. Në aktmarrëveshje me komunitetet fetare, shteti ju njeh të drejtën që ato “në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, të ngrenë dhe të administrojnë institucione edukative dhe arsimore të gjitha niveleve” por vetëm në bashkëpunim me shtetin, komunitetet fetare duhet të “hartojnë kurrikulat përkatëse për shkollat fetare jopublike, si dhe të bëjnë vlerësimin dhe certifikimin e

personelit pedagogjik. Për miratimin e tyre ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kjo është e një rëndësie të veçantë, pasi edukimi fetar për kushtet e vendit tonë, që ka një popullsi relativisht të vogël, me katër besime fetare tradicionale, nuk mund të jetë thjesht një problem pedagogjik dhe arsimor por ai ka ndikimet e tij edhe në sigurinë kombëtare.

Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve nuk cenon laicitetin dhe shekullarizimin, të cilët janë të shenjtë për një shtet demokratik. Marrëveshjet nuk cenojnë të drejtën e besimit të njerëzve si një e drejtë e jetës private, që njihet dhe mbrohet në të gjitha dokumentet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Përkundrazi, me qëllim që liria e besimit të mos mbetet deklarative, shteti ka për detyrë të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar gëzimin efektiv të kësaj lirie për ta mbrojtur atë, sidomos nga ndërhyrjet, të cilat synojnë të nxisin deformime, nga prirjet ekstreme apo të çdo shfaqjeje tjetër ashpërsie në mjediset e besimtarëve.

Marrëveshja mbi çështjet juridike të nënshkruara nga palët, përbën një pikë referimi nga ku rrjedhin aktet e mëtejshme normative dhe marrëveshje, që kthehen në ligje të zakonshme apo në norma rregulluese, ndërsa negociatat për përcaktimin e marrëveshjeve rreth çështjeve të tjera vijojnë ende.

Për të fituar personalitetin juridik civil, komunitetet fetare, nënshkruese të marrëveshjes, duhet të paraqesin kërkesë pranë Gjykatës së Tiranës, por edhe këtu udhëzimet ndahen sipas tipareve të komuniteteve. Konvergimi drejt një metodologjie të përbashkët pune, prodhon marrëveshje me dispozita të përbashkëta, pa anashkaluar ato ndryshime të veçanta, të cilat lindin për shkak të traditës apo nevojave të secilit komunitet, e për rrjedhojë, natyrshëm, gjejnë pasqyrim në statutet përkatëse të komuniteteve. Arsytet për procedura të ndryshme, në varësi të komunitetit, kanë të bëjnë me strukturën hierarkike

dhe statusore të Kishës Ortodokse, si strukturë më e hapur dhe e ndryshueshme nga ajo e dy komuniteteve myslimane të cilët, ndonëse të ngarkuar me detyrën për të drejtuar lutjet dhe organizuar kultin, nuk kanë hierarkinë e një kleri të strukturuar si ai ortodoks. Juridiksioni i besimeve fetare shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përjashtuar atë Bektashian që ka shtrirje ndërkombëtare. Pjesa e përbashkët për të gjitha komunitetet, e cila ka të bëjë me aktivitetet dhe subvencionet, që përjashtohen nga taksat e veçanërisht, subvencionet e ndryshme të fituara në mënyrë ligjore dhe donacionet, që shkojnë për kryerjen e misionit të komunitetit, ndërtimin e godinave të reja të kultit dhe pasuritë e patundshme, që i përkasin si komunitetit ashtu dhe enteve të krijuara prej saj e që kanë si qëllim vetëm ushtrimin e aktiviteteve fetare.

Marrëveshja e nënshkruar mes Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe komunitetit fetar Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella u bë pjesë e sistemit shqiptar nëpërmjet Ligjit Nr.10 394, datë 10 Mars 2011, me të njëjtën procedurë të ndjekur për komunitetet e tjera fetare. Ajo çfarë e dallon dukshëm marrëveshjen e Vëllazërisë Ungjillore nga marrëveshjet e të gjitha komuniteteve të tjera është fakti se VUSH-i nuk kërkon fare financimi nga shteti për kryerjen e veprimtarive të kultit, gjë që parashikohet me ligj për të gjitha komunitetet fetare. Ky qëndrim përjashton çdo lloj lehtësimi apo financimi, përveç rasteve kur kjo e drejtë buron nga legjislacioni i përbashkët, duke e vënë komunitetin fetar dhe veprimtarinë e tij në të njëjtat pozita me veprimtarinë e zhvilluar nga subjekte jofetare, si për shembull, me organizatat jo fitimprurëse. Ky është një tregues që e bën marrëveshjen e VUSH-it me koherente ndaj parimit të ndarjes, të laicitetit, të pluralizmit dhe të autonomisë së komunitetit fetar, çka përbën edhe tiparet dalluese të sistemit ligjor shqiptar.

Nënshkrimi i marrëveshjes midis shtetit shqiptar dhe komuniteteve fetare do t'i hapë rrugë hartimit dhe miratimit të një pakete ligjore, që do të mbushë vakumin ligjor, që ekziston në vend lidhur me financimin e komuniteteve fetare, sistemin arsimor fetar dhe kthimin e kompensimin e pronave të këtyre komuniteteve. Kjo përbën një investim serioz për sigurinë tonë kombëtare.

Shqipëria ka nevojë për një ligj të mirfilltë për të rregulluar problematikat e veçanta që ka ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare në vend, në mënyrë që marrëdhëniet rregulluese mes tyre të mos mbesin vetëm në nivelin e marrëveshjeve.

Në Shqipëri ka një pluralizëm të shënuar fetar, ashtu siç ka edhe një numër në rritje të popullsisë, që identifikohet vetëm formalisht apo për shkak të prejardhjes familjare me një fe të caktuar. Fetë e ndryshme kanë qenë burim potencial konflikti për shoqërinë shqiptare dhe për shkak të ndërhyrjeve të jashtme, si edhe një pengesë për bashkimin dhe krijimin e një shteti kombëtar multi-fetar. Një lloj i tillë shteti ishte pak i njohur në Evropën Jug-lindore gjatë shekullit të kaluar. Në historinë e Shqipërisë komunitetet fetare kanë arritur të bashkëekzistojnë në mënyrë paqësore edhe për shkak të një roli aktiv nga ana e shtetit nga vitet '20 dhe deri në fillimin e luftës së dytë botërore për nënshtrimin e komuniteteve fetare ndaj autoritetit civil pa u diskriminuar mes tyre. Rritja e pavarësisë dhe forcimi i autoritetit të shtetit laik i shërbeu edhe ndërgjegjësimit për përkatësinë kombëtare përtej identitetit fetar, të përcaktuar, kryesisht, nga faktorë të jashtëm. Politika ateiste mes viteve 1944-1990, gjithashtu, ndikoi në konsolidimin e tolerancës dhe bashkëpunimit mes komuniteteve fetare. Ato i bashkuan edhe vështirësitë e përbashkëta që ato kanë hasur e kanë kaluar gjatë periudhës komuniste.

Duke qënë se tema e punimit i referohet lirisë së ndërgjegjes dhe besimit në legjislacionin shqiptarë, nuk është trajtuar problematika që egziston në lidhje me të drejtën e pronësë mes shtetit dhe komuniteteve fetare. Gjithashtu kjo tematikë mund të jetë objekt për një studim tjetër.

Orientimi drejt Evropës Perëndimore dhe vlerave të demokracisë moderne e kanë çuar interesin fetar në plan të dytë përkundrejt pranimi të vlerave universale, humane, të dinjitetit njerëzor, të cilat sot janë më pak të frymëzuara nga feja sesa nga të gjitha institucionet shoqërore dhe politike. Pluralizmi fetar dhe diversiteti është konsideruar si një vlerë thelbësore në shoqërinë demokratike, ku bashkëjetesa e shumë besimeve fetare garanton në mënyrë jo të drejtpërdrejtë edhe të drejtat e minoriteteve.

Shqipëria është simbol i unitetit nën diversitet, parim i cili në ditët tona është kthyer në një nga parimet kryesore të Bashkimit Evropian. E gjendur gjeografikisht në një rajon ku konfliktet mes kombeve kanë marrë edhe ngjyrim të identiteteve të ndara dhe fesë, modeli i tolerancës së praktikuar prej shekujsh në Shqipëri është një model, që ka si vlerë studimore ashtu edhe praktike.

BIBLIOGRAFIA

I. Literaturë

Akademia e Shkencave e Shqipërisë“Historia e popullit Shqiptar I-Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane, gjatë Shek. XVI-Vitet 20 të Shek. XIX, botimet Toena, Tiranë2002

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Historia e Popullit Shqiptar II-Rilindja Kombetare- Vitet 30 të Shek. XIX-1912, botimet Toena, Tiranë2002

Akademia e Shkencave e Shqipërisë,“Historia e popullit Shqiptar III- Periudha e pavarësisë, 28 Nëntor 1912–7 Prill 1939”, botimet Toena, Tiranë 2007

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Historia e popullit shqiptar IV- Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj-1939-1990 Toena, Tiranë2009

Anastasi A.,“Liria e besimit fetar në kushtetutën e Shqipërisë”, në “Fetë dhe Qytetërimet në Mijëvjeçarin e ri-Rasti i Shqipërisë-Konferencë Ndërkombëtare, 14-15 Nëntor 2003”, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë 2004

Anastasi A., “E Drejta Kushtetuese e Krahastuar”, Dajti 2000, Tiranë 2009

Alb Juris, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në interpretimin e Gjykatës Kushtetuese”, Tiranë 2008

Arbnori P., “Martirët 10300 ditë e net në burgjet komuniste” Gjergj Fishta, Tiranë 2004

Beduli D., “Kisha ortodokse Autoqefale e Shqipërisë gjer në vitin 1944”, Tiranë 1992

Beja F.,“Rregullimi ligjor i përshtatshëm është një domosdoshmëri për harmonizimin e marrëdhënieve ndërfetare me shtetin”, në “Fetë dhe Qytetërimet në Mijëvjeçarin e ri -

Rasti i Shqipërisë-Konferencë Ndërkombëtare, 14-15 Nëntor 2003”, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë 2004

Beqaj R., “Veprimtaria armiqësore e klerit katolik shqiptar 1945-1971, Libri Politeknik, Tiranë 1973

Biberaj E. “Shqipëria në tranzicion, rruga e vështirë drejt demokracisë”, Ora, Tiranë 2000

Cimbalo G., “Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri”, Naimi, Tiranë, 2013.

Clayer N., “Në fillimet nacionalizmit shqiptar”, Botimet Përpjekja, 2012

Clayer N., “Zoti në vendin e Mercedesëve”, Komunitet fetare në Shqipëri prej vitit 1990, Paris 2001

Dalipaj A., “Marrëdhëniet e shtetit shqiptar me kishën ortodokse 1945-1967, Tiranë, 1992

Della Rocca R., “Kombi dhe Feja në Shqipëri (1920-1944)”, Elena Gjika, Tiranë 1994

Dervishi K., “Historia e shtetit shqiptar 1912–2005”, Tiranë, 2006

Doja A., “Bektashizmi në Shqipëri, Histori politike e një lëvizjeje fetare”, DIIS, Tiranë 2008

Duka F., “Toleranca dhe mirëkuptimi ndërfetar si dimension i kombësisë së shqiptarëve”, “Zani i Naltë”, reviste shkencore kulturore, 21 korrik 2014

Duka F., “Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare”, UET Press, Tiranë 2009

Duka V., “Histori e Shqipërisë 1912–2000”, Libri Universitar, Tiranë 2007

Durham C. W., “Feja, demokracia dhe politika e fazës kalimtare: rëndësia e rregullave ndërkombëtare që administrojnë lirinë e fesë dhe të besimit në një botë pluraliste”, në “Fetë dhe Qytetërimet në Mijëvjeçarin e ri - Rasti i Shqipërisë-Konferencë

Ndërkombëtare, 14-15 Nëntor 2003”, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë 2004

Farago F., “Krishtërimi, judaizmi, islamizmi dhe mendimi perëndimor”, Liria për botim shqip 2007

Fischer Bernd J., “Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri”, Çabej, Tiranë 1997

Fisher Bernd J., “Feja dhe qytetërimet ndër shqiptarë”, Qendra shqiptare për të Drejtat e Njeriut, 2004

Fisher Bernd J., “Shqipëria gjatë luftës 1939-1945”, Çabej, botimi II, Tiranë 2004

Frashëri M., “Historia e lashtë Shqipërisë dhe e shqiptarëve”, Tiranë 2000

Fuga A., “Sjellja e Shqiptarëve të sotëm ndaj fesë”, në “Fetë dhe Qytetërimet në Mijëvjeçarin e ri -Rasti i Shqipërisë-Konferencë Ndërkombëtare, 14-15 Nëntor 2003”, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë 2004

Genti K., “Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërfetar”, Arbëria 2008

Gurakuqi R., “Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore”, Shkodër 2007

Gure MC. B. M, “Religjoni, konteksti shoqëror”, Qendra për hulumtim të administratës publike, Logos-A-Shkup-Prishtine –Tirane 2007

Hako H., Gjyq Zotit, Shtëpia botuese e librit politik, Tiranë 1972.

Hako H., “Feja e parë në dritën e shkencës”, Tiranë 1962

Hazizaj S., “Korniza ligjore e çështjeve fetare në shoqërinë shqiptare”, në “Fetë dhe Qytetërimet në Mijëvjeçarin e ri-Rasti i Shqipërisë-Konferencë Ndërkombëtare, 14-15 Nëntor 2003”, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë 2004

Historia e Popullit Shqiptar, vëll. IV., Toena, Tiranë 2009

Historia e Shqipërisë, vëll. IV., Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë 1983

Hoxha E., “Kur lindi partia”, 8 Nëntori, Tiranë 1981

Hotova M., “Toleranca burim i hapsirës ekumenike dhe i artit ekumenik në Ballkan”, Tiranë 1996

Hyseni A., “Të drejtat e njeriut në Kushtetutën Shqiptare”, Dita, Tirana, 2000

Hysi S., “Historia e komuniteteve fetare shqiptare”, Mësonjëtorja e parë, Tiranë 2006

Iljaz G., “Veprimtaria reaksionare e klerit katolik në fushën e arsimit”, Tiranë 1978

Kadare I., “Fetë dhe Qytetërimet në Mijëvjeçarin e ri-Rasti i Shqipërisë, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë 2004

Krasniqi M., “Toleranca në traditën shqiptare”, Botime të shkencave, Prishtinë 2007

Kristafi K., Dammacco G., “Kushtetuta për raportet shtet-fe: risitë dhe problematikat”, në Kushtetuta 10 vjet më pas, Jus & Justicia, nr.2, Uet press, Tiranë 2008

Kruja G., “Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërfetar”, Arbri 2008

Krishtërimi ndëreshqiptar, Simpozium Ndërkombëtar, Tiranë, 16-19 Nëntor 1999. Toena, Tiranë 2000. Luarasi A., “Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri”, Luarasi, Tiranë 1999

Magris C., “Panairi i Tolerancës”, Instituti shqip i medias, 2001

Maliqi Sh., “Relacionet mes religjionit dhe politikës dhe shoqëritë në tranzicion”, në “Fetë dhe Qytetërimet në Mijëvjeçarin e ri-Rasti i Shqipërisë-Konferencë Ndërkombëtare, 14-15 Nëntor 2003”, Qendra Shqiptare për të drejtat e njeriut, Tiranë 2004

Markus W. Peters, “Përballja e historisë së Kishës Katolike në Shqipëri 1919-1996”, qendra botuese Shoqata jezuite, Tiranë 2010

Meredith B. MC G, “Religjioni konteksti shoqëror” Logos-A, Shkup 2007

Mirdita Zef., “Krishtërimi ndër shqiptar”, Misioni katolik shqiptar në Zagreb, Prizren-Prishtinë, 1998

Morozzo Della R R., “Raportet ndërfaqetare në historinë e Shqipërisë: e tashmja dhe e ardhmja”, në “Fetë dhe Qytetërimet në Mijëvjeçarin e ri-Rasti i Shqipërisë-Konferencë Ndërkombëtare, 14-15 Nëntor 2003”, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë 2004,

Nano M., “Pax Albanica”, Saras, Tiranë 2014

Nogaj D. N., “Kisha Katedrale e Shkodrës 1858-1958”, Shkodra, Shkodër 2007

Nogaj D. N., “Shkëndia diturie III”, Shkodër 2007

Nogaj D. N., “Kisha Katolike Shqiptare 1944- nëntor 1990 humbje dhe fitore”, Gjergj Fishta, Shkodër 1999

Pano N., “Feja në Shqipëri: trashëgimia e epokës komuniste”, në “Fetë dhe Qytetërimet në Mijëvjeçarin e ri -Rasti i Shqipërisë-Konferencë Ndërkombëtare, 14-15 Nëntor 2003”, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë 2004

Pëllumbi A. Z., “Rrno për me tregue”, Botimi II, shtëpia botuese 55, Tiranë 2006

Pepa P, “Tragjedia dhe lavdia e Klerit Katolik në Shqipëri”, Vëll.II, Shtëpia Botuese 55, Tiranë 2007.

Puto A., “Shqipëria Politike 1912–1939” : Toena, Tiranë 2009

Puto A., “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, Vol II, Tiranë 1987

Pollo S., “Në gjurmë të historisë së Shqipërisë”, vëll. II, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 2003

Sadikaj D., “Pozita e fesë në Shqipëri në kushtet e sistemit komunist”, Tiranë 1972

Sadikaj, D., “Lëvizja revolucionare kundër fesë në vitet gjashtëdhjetë”. Studime Historike, 1981

Simpozium Ndërkombëtar, “Krishtërimi ndër shqiptarë”, Tiranë, 16-17 Nëntor 1999, Toena, Tiranë 2000

Simoni Z., “Kisha ortodokse e Shqipërisë në vitete ediktaturës”, Shkodër 2000

Simoni Z., “Persekutimi i Kishës Katolike në Shqipëri 1944-1990”, Shkodër 1998

Simpoziumi ndërkombëtar për Krishtërimin në Shqipëri, Ipeshkvnia e Shkodrës, Shkodër 2000

Sinani Sh., “Konvergjenca fetare tek Shqiptarët deri në Mesjetë”, në “Fetë dhe Qyteterimet në Mijëvjeçarin e ri -Rasti i Shqipërisë-Konferencë Ndërkombëtare, 14-15 nëntor 2003”, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë 2004

Shantoja L., “Vepra”, Botimet Franceskane, Shkodër 2005

Shehu A., “Shteti komunist dhe kisha katolike në Shqipëri (1945-1967), Simpozium ndërkombëtar, Tiranë 16-19 nëntor 1999

Shilegu T., “Lufta e klasave në Shqipëri 1948-1953’ Akademia e Shkencave të RPSSH, Instituti i Historisë, 1985

Shteti shqiptar nën Vidin dhe Statuti Organik i Shqipërisë. Vendimi përfundimtar i Konferencës së Ambasadorëve, Londër, 29 Korrik 1913

Tartari A., “Shkrime juridike e të tjera”, Albpaper, Tiranë 2008

Traja K., “Feja dhe e drejta si komponentë të rendit social dhe të ndërgjegjjes”, në “Fetë dhe Qyteterimet në Mijëvjeçarin e ri-Rasti i Shqipërisë-Konferencë Ndërkombëtare, 14-15 Nëntor 2003”, Qendra Shqiptare për të drejtat e njeriut, Tiranë 2004

Xhaferri A., “Religjioni, politika, Shqiptaret”, në “Fetë dhe Qyteterimet në Mijëvjeçarin e ri -Rasti i Shqipërisë-Konferencë Ndërkombëtare, 14-15 nëntor 2003”, Qendra Shqiptare për të drejtat e njeriut, Tiranë 2004

Yalcintas Nevzat., “Islami dhe jeta në botën globale” Instituti shqiptar i meditimimit dhe qytetërimit islam, Tiranë 2007

II. Burime parësore

Ligj Nr.10394, datë 10.3.2011, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkësisë fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë” për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”

Ligji Nr.10 140, datë 15.5.2009, “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”

Ligji Nr.10057, datë 22.1.2009, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”

Ligji Nr.10056, datë 22.1.2009, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”

Ligji Nr.10058, datë 22.1.2009, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshitës Botërore Bektashiane për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”

Ligji Nr.9865, datë 31.1.2008, “Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjë mbi disa çështje ekonomike dhe tatimore”

Ligji Nr. 9365, datë 31.3.2005, “Për procedurat e njohjes së zotësisë juridike të personave juridikë kishtarë të Kishës Katolike”<http://licodu.cois.it/571/view>.

Ligji Nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”

Ligj Nr. 8982, 12.12.2002, Për sistemin e taksave vendore

<http://licodu.cois.it/593/view>

Ligji Nr. 8982, datë 12.12.2002, “Për sistemin e taksave vendore”

Ligji Nr. 8902, datë 23.5.2002, “Per ratifikimin e marreveshjes ndermjet Republikes se Shqiperise dhe Selise se Shenjte per rregullimin e marredhenieve te ndersjella"

Ligji Nr.8788, datë 7.5.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”

Ligji Nr. 8417, datë21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligji Nr.7981, datë 27.7.1995, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7699, dt. 21.4.1993, Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”

Ligj Nr.7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”

Ligji Nr 7850, datë29 korrik 1994, Kodi Civil

Ligj Nr.7777, datë 22.12.1993, “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.

Ligj Nr. 7698, datë15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Ligj Nr.7695, datë7.4.1993, “Për fondacionet”.

LigjiNr.7692, datë 31.3.1993, “Për një shtojcë në ligjinnr.7491, datë 29.4.1991, për dispozitat kryesore kushtetuese”.

Ligj Nr.7680, datë 3.3.1993, “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.

Ligj Nr. 7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”.

Ligj Nr. 7501, datë19.7.1991, “Për Tokën”.

Ligji Nr. 7491, datë 29.4.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë 1977

Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë 1977

Ligj Nr.5506, datë 28.12.1976, “Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste e Shqipërisë”.

Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, 1964

Ligji Nr. 2362, datë16.11.1956, “Mbi organizatat shoqërore që nuk ndjekinqëllime ekonomike”

Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë, Bashkimi, Tiranë, 1946,

Ligji Nr. 108, datë 29.08.1945, “Mbi Reformën Agrare”

Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare 1928, Fletore Zyrtare, datë13Dhjetor,Tiranë 1928. Nr 111

Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare 1925, Nikaj, Tiranë, 1925

Statuti Legal i Komuniteteve Fetare 1923.

Statuti i Shtetit Shqiptar 1922.

Dekreti Nr.1807, datë 30.5.1997, “Për një ndryshim në ligjin nr.8182, datë 22.12.1996, Për një ndryshim në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifatat doganore”

Dekret Nr.4337, datë13.11.1967, “Mbi çfuqizimin e disa dekretave”

Dekret Nr.4263, datë 11.4.1967, “Mbi shtetëzimin e lokaleve që janë ndërtuar për ushtrim tregëtie, industrie, zejtarie ose profesioni, për zyra ose depo,të cilat janë pronë private, si edhe shtetëzimin e pasurisë së palujatëshme të komuniteteve fetare”

Dekret Nr.3660, datë10.4.1963, “Mbi disa ndryshime në dekretin nr.743 datë 26.11.1949, mbi Komunitetet Fetare”

Dekret-ligjë Nr. 743 datë 26.11.1949, “Mbi Komunitetet fetare”, Gazeta Zyrtare 14 Shtator 1951

Dekret-Ligjit mbi formimin e komuniteteve fetare, Tiranë, më 9 Korrik 1929

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 344, datë 7.6.2006, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.459, datë 23.9.1999 të “Për krijimin e komitetit shtetëror për kultet”, të ndryshuar, dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për ministrinë e turizmit, kulturës, rinisë dhe sporteve”

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 777, datë 14.12.2005, “Për një shtesë në vendimin nr. 459, datë 23.9.1999 “Për krijimin e komitetit shtetëror për kultet”

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 666, datë 26.10.2005, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 459, datë 23.9.1999 “Për krijimin e komitetit shtetëror për kultet”

Vendimii Këshillit të Ministrave Nr.128, datë 11.3.2004, “Për disa ndryshime në vendimin nr.459, datë 23.9.1999 “Për krijimin e komitetit shtetëror për kultet”

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 96, datë 21.3.2002, “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 226, datë 5.5.2000, “Për një ndryshim në vendimin nr.335, datë 2.9.1997,

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 459, datë 23.9.1999, “Për krijimin e komitetit shtetëror për kultet”

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë 2009

Kodi Penal 1928.

III. Burime Dytësore dhe interneti

Buletini Katolik Shqiptar;“Feja akoma turbullon liderët e rinj” volIX ,1988

Buletini Katolik Shqiptar;Qendra e informimit katolik shqiptar; vol. 5-9, 1984

Nuredin Nazarko, Feja e Shekullarizimi në Shqipëri pas 1944, Zëri Naltërevistëshkencore kulturore, <http://zaninalte.al/2014/12/historia-e-shekullarizimit-ne-shqiperi-1944-e-ne-vazhdim/> parë më 20 dhjetor, 2014

Ferid Duka, Toleranca fetare në mjedisin shqiptar: sfondi historik
<http://afalc.org/hand2hand/shtypi/3007.html>, parë më 10.04.2016

Valentina Duka, “Institucionet fetare gjatë mbretërimit të Zogut”, Zani i Naltë revista shkencore dhe kulturore,
<http://zaninalte.al/2014/01/institucionet-fetare-gjate-mbreterimit-te-ahmet-zogut-nje-veshtrim-te-legjislacionit-te-kohes-1928-1939/> parë më 15 mars 2014

Genti Kruja, “Harmonia dhe bashkëjetesa ndërjetare në Shkodër”, Zani i Naltë revista shkencore dhe kulturore <http://zaninalte.al/2016/02/harmonia-dhe-bashkejetesa-nderfetare-ne-shkoder/> parë më 10 mars 2016

Sherif Delvina, “Historia e lindjes së komuniteteve fetare kombëtare”,
<http://www.forumishqiptar.com/threads/39534-Historia-e-lindjes-se-komuniteteve-fetare-komb%C3%ABtare> , parë më 7.08.2015

Aranita Brahaj, “Raportet mes Fesë dhe Shtetit”.
<https://www.shqiperia.com/shqip/opinionart/aID/543/ESE--Raportet-mes-Fese-dhe-Shtetit>, parë më 24 janar 2014

Genc Myftiu, “Besimet Fetare” http://www.shqiperia.com/tr/besimet_fetare.php parë më 10 mars 2014

Simpozium; Domosdoshmëria e Dialogut Ndërfetar për Paqen në Botë; Prizmi; Buletini nr 2; 2008; fq 9
<http://shqiptarja.com/kulture/2730/shqiperia-moderne-e-ka-parim-themelor-ndarjen-mes-shtetit-dhe-fese-209562.html> parë më qershor 2015

Isuf Bajrami, “Shpallja e Pavarësisë nuk mund të realizohet pa bashkim kombëtar e unitet territorial”, <http://gazetadielli.com/2014/11/page/3/> parë më 10.12.2014

Sherif Delvina, “Historia e lindjes së komuniteteve fetare kombëtare”,
<http://www.forumishqiptar.com/threads/39534-Historia-e-lindjes-se-komuniteteve-fetare-komb%C3%ABtare> , parë më 7.08.2015

Sherif Delvina, “Rreth përhapjes së Islamit ndër shqiptarët”

https://sq.wikibooks.org/wiki/Rreth_p%C3%ABrhapjes_s%C3%AB_Islamit_nd%C3%ABr_shqiptar%C3%ABparë në maj 2014

Agron Tufa, “Fillimet e persekutimit komunist mbi komunitetin mysliman shqiptar”
<http://www.dritaislame.al/fillimet-e-persekutimit-komunist-mbi-komunitetin-mysliman-shqiptar-2/>parë më 20.12.2015

Isuf Bajrami, “Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë nuk mund të realizohet pa bashkimin kombëtar dhe unitetin territorial të popullit shqiptar”
<http://www.albaniapress.com/lajme/19096/SHPALLJA-E-PAVARESISE-SE-SHQIPERISE-NUK-MUND-TE-REALIZOHEJ-PA-BASHKIMIN-KOMBETAR-DHE-UNITETIN-TERRITORIAL-TE-POPULLIT-SHQIPTAR.html>parë më 15 nëntor 2015

“Deklaratë e angazhimeve morale të përbashkëta”
<http://www.albasoul.com/modules.php?op=modload&name=News&file=article&sid=1697>parë më 10 qershor 2014

Orhan Ceka, “Religion and Secularism in Post-Communist Transitions: A Comparative Analysis of BiH and Albania”
http://www.academia.edu/627253/Religion_and_Secularism_in_PostCommunist_Transitions_A_Comparative_Analysis_of_BiH_and_Albaniaparë më 10 dhjetor 2014

Artan Hoxha, “Marrëdhëniet midis Regjimit Komunist dhe Kishës Ortodokse Autoqefale e

Shqipërisë në vitet 1945–1967”www.doktoratura.unitir.edu.al,

Arben Muka, “Harmonia dhe tolerance fetare në Shqipëri”

<http://www.dw.com/sq/harmonia-dhe-toleranca-fetare-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/a-16384835> parë më 30 prill 2015

Gazmend Shpuza, “Bashkëjetesa ndërfaqetare përballë tolerancës”,
<https://www.shqiperia.com/Bashkejetesa-nderfaqetare-perballe-tolerances.21372/>

Albania in: www.licodu.com

<http://www.academia.edu>

<http://www.doktoratura.unitir.edu.al>

<http://www.qpz.gov.al/>

<http://www.parlament.al>

